

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT
(Auditim Financiar dhe Përputhshmërie)

MINISTRIA E KULTURËS

Korrik 2022

I.PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1.Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.....	3
2.Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.....	4-22
3.Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit.....	3-26

II.HYRJA (Të dhëna mbi Projektin e Auditimit)

a) Objektivat dhe qëllimi.	3
b) Identifikimi i çështjes.....	3-4
c) Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	3-4
d) Përgjegjësitë e audituesve.....	4
e) Kriteret e vlerësimit.....	4-5
f) Standardet e auditimit.....	5
g) Metodatat e auditimit.....	5
h) Dokumentimi i auditimit.....	5-6

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm.....	6-7
2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.....	7
2.1. Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit.....	7-20
2.2. Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave.....	20-25
2.3. Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.....	25-34
2.4. Auditimi i llogarive vjetore të administratës së institucionit.....	34-45
2.5. Prokurimet e fondeve publike.....	45-122
2.6. Mbi procedurat e financimit dhe mbështetjes nga MK, për projektet në fushën e artit dhe kulturës.....	122-145
2.7. Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të MFK.....	145-150
2.8. Vlerësimi i Auditit të Brendshëm.....	150-155

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET.....161-174

V. ANEKSE.....174

VI. LISTA E DOKUMENTAVE TË AUDITIMIT.....175-176

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *ËPër Organizimin dhe Funksionimin e KLSHö*, në zbatim të Programit të Auditimit nr.1420/1 prot, datë 12.01.2022, në Ministrinë e Kulturës, nga data 13.01.2022 deri më 31.03.2022, për periudhën e auditimit 01.01.2020 deri më datë 31.12.2021., u krye auditim Financiar dhe Përputhshmërie.

Grupi i auditimit, për të realizuar objektin e auditimit, për dhënien e opinionit mbi aktivitetin financiar dhe të përputhshmërisë së veprimtarisë së MK, auditoi drejtimit kryesore, në auditimin e pasqyrave financiare të institucionit, nëse janë paraqitur saktë, në përputhje me kuadrin rregullator të raportimit financiar dhe mbi auditimin e përputhshmërisë së veprimtarisë së subjektit me kuadrin rregullator në fuqi, duke përfshirë këtu procedurat e prokurimeve dhe shpenzimet vjetore, të financuara nga Buxheti i Shtetit.

Ministria e Kulturës, ushtron veprimtarinë e saj në hartimin, programimin dhe zhvillimin e politikave kombëtare të kulturës, trashëgimisë kulturore, materiale dhe shpirtërore, të rritjes së tolerancës fetare e të dialogut kulturor dhe integritit kulturor në familjen evropiane e botërore, hartimin dhe bashkërendimin e punës për politikën në fushën e artit e të kulturës, hartimin e politikave mbrojtëse dhe promovuese për trashëgiminë kulturore, udhëheqjen, programimin dhe mbështetjen e veprimtarive kombëtare e ndërkombëtare, zhvillimin e politikave për nxitjen e investimeve për pasuritë kulturore, sigurimin e mbështetjes financiare nëpërmjet Fondit Kombëtar të Kujdesit për Trashëgiminë Kulturore.

Sa më sipër, Ministria e Kulturës vepron mbi bazën ligjore të mëposhtme:

- Ligji 10296, datë 08.07.2010 *ËMbi menaxhimin Financiar dhe Kontrollinö*, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 *“Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiareö*;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 *ËPër menaxhimin e sistemit buxhetor në RSHö*, i ndryshuar me ligjin nr. 57, datë 02.06.2016;
- Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 *ËPër prokurimin publikö* i ndryshuar;
- Ligji nr.114/2015 *ËPër auditimin e brendshëm në sektorin publikö*;
- Ligji nr. 27/2018 *ËPër trashëgiminë Kulturore dhe Muzetö*;
- VKM nr. 425, Datë 27.5.2020 *ËPër Procedurat E Përzgjedhjes Së Subjekteve Të Pajisura Me Licencë Për Projektim, Zbatim, Mbikëqyrje Dhe Kolaudim Në Pasuritë Kulturore, Për Kryerjen E Investimeve Me Fonde Publike Në Pasuritë Kulturoreö*;
- VKM nr. 248, datë 10.04.1998 *ËPër miratimin e planit kontabël publik të organeve të pushtetit lokal, institucioneve shtetërore qendrore si dhe njësisive që varen prej tyreö*, ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001 *ËPër disa shtesa e ndryshime të VKM nr. 248, datë 10.04.1998ö*;
- VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *ËPër miratimin e rregullave të prokurimit publikö*;
- VKM nr.918 datë 29.12.2014 *ËPër kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronikeö*;
- Udhëzim e APP-së nr. 2 datë 27.01.2015 *ËPër hartimin e regjistrit të parashikimeve të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të prokurimit publikö*, udhëzim e APP-së nr.2 datë 08.01.2018 *ËMbi përdorimin e procedurës me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës dhe zhvillimit të saj me mjete elektronikeö* i ndryshuar;
- VKM-së nr.160, datë 02.03.2016 *ËPër mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e komitetit të auditimit të brendshëm në njësitë publikeö*.

Rëndësia e këtij auditimi është vlerësimi dhe evidentimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e raportuara janë, në çdo aspekt material, në përputhje me ligjshmërinë dhe menaxhimin financiar mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë Ministria e Kulturës, në mënyrë për të bërë të mundur ndërmarrjen e veprimeve korigjuese sipas rastit, me synimin e mirëpërdorimit të fondeve publike.

2. Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

N R	Përmbledhje e Gjetjes	Referenc a me	Rëndësia	Rekomandimi
-----	-----------------------	------------------	----------	-------------

		Raporti n Përfundimtar		
1	<p>Nga auditimi u konstatua se VKM nr.425, Datë 27.5.2020 òPër Procedurat E Përzgjedhjes Së Subjekteve Të Pajisura Me Licencë Për Projektim, Zbatim, Mbikëqyrje Dhe Kolaudim Në Pasuritë Kulturore, Për Kryerjen E Investimeve Me Fonde Publike Në Pasuritë Kulturoreòka disa problematika si më poshtë vijon:</p> <p>-Konstatohet se në faqen e Ministrisë nuk ka një rubrikë të dedikuar për procedurat e konkurrimit publik.</p> <p>-Konstatohet se në VKM nuk parashikohet komisioni dhe mënyra e llogaritjes së fondit limit, hallkë shumë e rëndësishme e procesit, e cila është reflektuar si problematikë në të gjitha procedurat e konkurrimit.</p>	45-121	I MESHËM	<p>Nga ana e Ministrisë së Kulturës të ngrihet një grup pune për të gjitha konstatimet e nxjerra përgjatë auditimit për përmirësimin ligjor të VKM-së me qëllim arritjen e një procesi të konkurrimit publik sa më transparent, rritjen e konkurrencës dhe menaxhimin me efikasitet dhe ekonomikitet të fondeve publike.</p>
2	<p>òTokaTroje, Terenò paraqitet ne vlerën 261,298,634 lekë pa ndryshuar nga viti i mëparshëm (viti 2019). Për vitin 2020 referuar VKM nr.665, datë 27.08.2020, kanë kaluar në administrim të MK, një sipërfaqe prej 2.488 m2 trualli dhe 4 objekteve (nr.10, nr.11, nr.17, nr.18) òGrup Depo Ish-reparti ushtarak nr.5001ò, me vendodhje në BRAR. Me akt dorëzimin, miratuar nga përfaqësuesit e Repartit ushtarak si dhe nga grupi i punës së MK, janë marrë në dorëzim objektet nga ku është përshkruar për secilin nga objektet viti i ndërtimit, vlera fillestare, vlera e mbetur në kontabilitet, sipërfaqja sipas planit të rivlimit etj. Nga auditimi u konstatua se kjo vlerë nuk është pasqyruar në kontabilitet duke mos paraqitur kështu një vlerë reale të këtij zëri. Sipërfaqja totale e tokës që ka MK në dispozicion nuk është vlerësuar dhe nuk është pasqyruar në kontabilitet në kundërshtim me ligji nr. 9228 datë 29.04.2004 òPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò i ndryshuar.</p> <p>Llog.212 òNdërtime e konstruksioneò, paraqitet në fund të vitit 2020 në vlerën prej 832,370,619 lekë, ku është zbritur vlera prej 10,648,392 lekë nga vitit i mëparshëm, vlerë e cila ka të bëjë amortizimin vjetor të ndërtesës. Sipas regjistrit është bërë shtesë e krijuar pa pagesë në vlerën 8,183,950 lekë e cila ka të bëjë me rikonstruksionin nga reparti i filmit për godinën e cila është në administrim të MK si dhe rikonstruksion i godinës në MK. Referuar VKM së sipërpërmendur, 4 godinat të cilat kanë kaluar në administrim të MK, nuk janë regjistruar si vlerë ndërtese edhe pse janë marrë në dorëzim nga MK në kundërshtim me Udhëzimi nr. 8 datë 09.03.2018 òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e geverisjes së përgjithshmeò.</p>	34-45	I MESHËM	<p>Titullari i Institucionit të marrë masa për ngritje e grupit të punës me qëllim vlerësimin dhe saktësimin e vlerës së aktiveve afatgjata jo materiale òToka troje terrenò, në administrim të institucionit MK. Nga Drejtoria e Buxhetimit dhe Menaxhimit Financiar (Sektori i Financës) të merren masa për të kontabilizuar dhe paraqitur në pasqyrat financiare vlerën e drejtë të Aktiveve Afatgjata Materiale, menjëherë pas përfundimit të procesit të vlerësimit nga grupi i punës.</p> <p>Të ngrihet një grup pune për të pasqyruar dinamikën dhe lëvizjet e aktiveve afatgjata materiale, të ndërtoj gjurmën e auditimit të këtyre pasurive, duke saktësuar dhe administruar dokumentacionin e nevojshëm.</p>
3	<p>Nga auditimi konstatohet se në të gjitha rastet procedurat e blerjeve të biletave jashtë vendit realizohen në një afat shumë të shkurtër nga data e udhëtimit, duke sjelle si pasojë, mungesë të studimit të tregut si rrjedhojë e afateve të limituara dhe rrit riskun e përzgjedhjes së çmimit me të lartë, pasi biletat e avionit blihen në datën e nisjes ose me datë më të afërt me nisjen, ku edhe çmimet kapin vlerën me të lartë të tyre.</p> <p>Gjithashtu nga auditimi i shpenzimeve për udhëtime dieta me jashtë dhe dokumentacionit justifikues të mandat</p>	24-34		<p>1.Nga Titullari i Institucionit, të merren masa që pas ardhjes së ftesës nga organizatorët për takime/evente jashtë vendit, të nxirret menjëherë autorizimi i pjesëmarrjes në to, në mënyrë që të minimizohet risku i</p>

	pagesave tek të gjitha praktikat mungon ftesa e vendit organizator pritës si dhe draft agjenda e punimeve. Me këto dokumente, vërtetohet qëllimi dhe objekti i shërbimit si dhe pjesa e shpenzimeve që do të mbulojë organizatori dhe pjesa që do të mbulojë buxheti i shtetit.			blerjes së biletave me çmim më të lartë si rezultat i kryerjes së procedurës së prokurimit në data të afërta me datën e nisjes së udhëtimit. 2.Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa që në të gjitha praktikat për udhëtime dieta për jashtë shtetit, dokumentit të pagesave ti bashkëngjitet ftesa e vendit pritës dhe draft agjenda e punimeve.
4	Nga auditimi i procedurës konstatohet se komisioni i prokurimit të blerjeve me vlerë të vogël (KPVV) ka mbajtur proces verbalin e rasteve emergjente dhe vlera e urdhër shpenzimit nr.1096 datë 21.12.2021 është 250,000 lekë pa tvsh. Ndërkohe që në rastet emergjente ku situata është e paparashikuar vlera nuk duhet të jetë më e madhe se 100,000 leke, në këtë situatë KPVV ka shmangur procedurën standarde të prokurimit me vlerë të vogël duke cënuar barazinë e pjesëmarrësve në tendera si dhe ka krijuar premisa për shmangien e konkurrencës.	24-34	I MËSËM	Institucioni të marrë masa që në procedurat e ardhshme kur situata është emergjente dhe e pa parashikuar, të mos tejkalohet shuma e lejuar për procedura të kësaj natyre.
5	Nga auditimi i procedurës ndërhyrje Restauruese në Mozaikun e Tiranës konstatohet se është ngritur grupi I punës me nr.362, datë 22.06.2021, për shqyrtimin e ankesës lidhur me hedhjen në sistem të tre DSK të ndryshme mbi procedurën e konkurrimit. Bazuar në VKM nr.425, datë 27.05.2020 si dhe Udhëzimit nr.269, datë 11.08.2020 për miratimin e dokumenteve standarde të konkurrimit publik, për përzgjedhjen e subjekteve të pajisura me licencë në projektim, zbatim mbikëqyrje dhe kolaudim në pasuritë kulturore për kryerjen e investimeve me fonde publike në pasuritë kulturore, autoriteti kontraktor nuk duhej ta shqyrtonte ankesën pasi operatori nuk ka respektuar afatet e ankesës dhe ai ka dorëzuar ofertën e tij ekonomike pa pasur asnjë kundërshti. Nga ana e autoritetit kontraktor është ngritur Urdhri me nr.396, datë 02.07.2021 për pranimin e ankesës dhe anulimin e procedurës së konkurrimit pasi sipas grupit të punës së shqyrtimit të ankesës nuk është respektuar parimi i transparencës nga AK pasi janë fshirë/hequr nga sistemi DSKP për këtë procedurë, pra nuk ka patur transparencë në këtë proces për operatorët ekonomikë pjesëmarrës.	45-121	I LARTË	-Nga ana e Ministrisë së Kulturës të ngrihet një grup pune me qëllim evidentimin e ndërhyrjeve që janë bërë në faqen zyrtare të Ministrisë së Kulturës dhe nxjerrjen e përgjegjësve që e kanë shkaktuar këtë situatë.
6	Nga auditimi në terren i kontratës "Restaurim i çatisë së banesës së S.Sh , Tiranë (Faza e Emergjencës)" me nr.3751/5, datë 09.10.2020 midis Ministrisë së Kulturës dhe BOE ëdD-Pëshpk & ëBM-Kö shpk, me vlerë 1,067,676 lekë pa tvsh u konstatua se gjatë zbatimit nuk janë kryer zërat: Restaurim strehë çatie tjegulla vendi me dekor, sasia 30m3, me vlerë totale 189,690 lekë pa tvsh. Por është realizuar zëvendësimi i traut të thyer të çatisë. Analiza e çmimit për heqjen dhe vendosjen e traut e llogaritur nga ana e audituesve është 94,479 lekë.	45-121	I LARTË	Nga Ministria e Kulturës të merren masa për arkëtimin e shumës së përfituar padrejtësisht nga operatori ekonomik BOE ëdD-Pëshpk & ëBM-Kö shpk në vlerën 95,211 lekë pa tvsh.

7	Nga auditimi në terren i kontratës me 5173 prot. datë 03.12.2020 me objekt òRikonstruksioni/Rivitalizimi i Magazinave të TKOBAP,në Brarö (Faza I)ò lidhur midis Ministrisë së Kulturës dhe OE ò6D-Pö sh.p.k., me vlerë 15,828,383 lekë pa tvsh u konstatua se gjatë zbatimit ka diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera, me vlerë totale 852,265 lekë pa tvsh.	45-121	I LARTË	Nga Ministria e Kulturës të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 852, 265 lekë pa tvsh nga OE ò6D-Pö sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve sipas kontratës me nr. 5173 prot., datë 03.12.2020, me objekt òRikonstruksioni/Rivitalizimi i Magazinave të TKOBAP,në Brarö (Faza I)ò,vlerë kjo që përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit.
8	Nga auditimi konstatohet është lidhur kontrata me nr.4053/14, datë 28.10.2020 midis Ministrisë së Kulturës dhe BOE òAL.Vö Shpk & òC-96ö shpk me vlerë 6,833,000 lekë pa tvsh, dhe afat për realizimin e saj 90 ditë nga data e nënshkrimit . Në këto kushte vlera e financuar nga Ministria e Kulturës prej 6,833,000 nuk është përdorur me ekonomicitet, efektivitet dhe efijencë, pasi konstatuam se kjo procedurë nuk është zhvilluar më tej me kryerjen e procedurave të zbatimit të këtij projekti deri në përfundim të periudhës objekt auditimi, gjithashtu këto procedura nuk janë planifikuar për tu kryer as në vitin 2022.	45-121	I LARTË	Nga ana e Ministrisë së Kulturës të merren masa të menjëhershme për ngritjen e grupit të punës për evidentimin e shkaqeve që kanë sjellë mos zhvillimin e projekt zbatimit të kësaj procedure, duke rrezikuar përdorim jo efektiv të fondeve prej 6,833,000 lekë.
9	Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës nr. 4049/10, datë 23.10.2020 me objekt: òRealizimin me çelësa në dorë të projektit elektrik për ndriçimin e jashtëm të kalasë së Beratitö, me vlerë kontrate (pa TVSh) 29,968,773 lekë, realizuar nga bashkimi i OE òRö shpk + òAL.Vö shpk, rezultuan diferenca në volume punimesh të pakryera sipas preventivit të miratuar nga investitori në vlerën 2,980,544 lekë pa TVSh, veprime në kundërshtim me kontratën të cilat kanë sjellë efekt negativ në buxhetin e shtetit.	45-121	I LARTË	Ministria e Kulturës të marrë masat duke ngritur një grup pune për të saktësuar, njoftuar dhe kërkuar nga subjekti OE òRö shpk + òAL.Vö shpk, plotësimin e punimeve të pakryera sipas preventivit për vlerën 2,980,544 lekë me efekte negative ndaj buxhetit të shtetit.
10	Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me 16246/10 prot datë 03.12.2020 me objekt òRikonstruksioni i aneksit të Bibliotekës Kombëtare (fondi i Bibliotekës Kombëtare)ò, me vlerë 41,192,400 lekë pa tvsh realizuar nga OE òL.Kö sh.p.k., rezultuan diferenca në volume punimesh të pakryera sipas preventivit të miratuar nga investitori në vlerën 551,336 lekë pa TVSh, veprime në kundërshtim me kontratën të cilat kanë sjellë efekt negativ në buxhetin e shtetit.	45-121	I LARTË	Ministria e Kulturës të marrë masat duke ngritur një grup pune për të saktësuar, njoftuar dhe kërkuar nga subjekti òL.Kö sh.p.k, plotësimin e punimeve të pakryera sipas preventivit për vlerën 551,336 lekë me efekte negative ndaj buxhetit të shtetit.
11	Nga auditimi në terren i kontratës me nr.2455 prot., datë 12.05.2021 me objekt òRikonstruksioni/Rivitalizimi i Magazinave të TKOBAP,në Brarö (Faza II)ò lidhur midis Ministrisë së Kulturës dhe BOE òCö sh.p.k. & ò6D-Pö sh.p.k., me vlerë 34,020,265 lekë pa tvsh u konstatua se gjatë zbatimit ka punime të situacionuara por të pajustificuar, me vlerë totale 1,883,454 lekë pa tvsh.	45-121	I LARTË	Nga ana e Ministrisë së Kulturës të merren masa të menjëhershme për ngritjen e grupit të punës për evidentimin e diferencave të volumeve dhe certifikimin e tyre në situacionin përfundimtar. Mos evidentimi i diferencave të

				mësipërme në situacionin përfundimtar i vlerës prej 1,883,454 lekë pa tvsh, nga BOE òCò sh.p.k & ò6D-Pò sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve sipas kontratës me nr.2455 prot., datë 12.05.2021 me objekt òRikonstruksioni/Rivitali zimi i Magazinave të TKOBAP, në Brarò (Faza II)ò, përbën efekt negativ ndaj buxhetit të shtetit.
--	--	--	--	---

3. KONKLuzioni I PëRGJITHSHëm DHE OPINIONI I AUDITIMIT

Nga auditimi u konstatua se VKM nr.425, Datë 27.5.2020 “Për Procedurat E Përzgjedhjes Së Subjekteve Të Pajisura Me Licencë Për Projektim, Zbatim, Mbikëqyrje Dhe Kolaudim Në Pasuritë Kulturore, Për Kryerjen E Investimeve Me Fonde Publike Në Pasuritë Kulturore” ka disa problematika si më poshtë vijon:

-Konstatohet se në faqen e Ministrisë nuk ka një rubrikë të dedikuar për procedurat e konkurrimit publik. Njoftimet e këtyre procedurave janë të hedhura te seksioni òTë reja, Njoftimeò ku ndodhen të gjitha njoftimet e Ministrisë përfshirë njoftimet për punë dhe njoftime të ndryshme nga Ministria. Pra për një operator që nuk ka informacion është shumë e vështirë të gjejë shpalljen e këtyre procedurave.

-Konstatohet se në VKM nuk parashikohet komisioni dhe mënyra e llogaritjes së fondit limit, hallkë shumë e rëndësishme e procesit, e cila është reflektuar si problematikë në të gjitha procedurat e konkurrimit.

- Nga auditimi rezultoi se, pyetësi dhe shënimet shpjeguese për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore (formati nr.5), për njësitë e qeverisjes së përgjithshme, është i miratuar nga MFE dhe përbëhet nga 19 pika. Në informacionin shpjegues për pasqyrat financiare të viteve 2018 dhe 2019, evidentohen mangësi në plotësimin e tyre si në vendosjen e përgjigjeve respektive òpoò ose òjoò, ashtu edhe në zberthimin me analizë të llogarive përkatëse, në kundërshtim me pikën 3.7 të UMF nr.8 datë 09.03.2018 òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò.

-Nga kryerja e testeve mbi urdhër shpenzimet, rezultuan shkelje të disiplinës buxhetore sa i takon likuidimit të faturave duke tejkalar afatin ligjor. Konkretisht, janë likuiduar fatura mbi afatin e parashikuar 30 ditor duke shkelur disiplinën buxhetore që dikton ligji për òMenaxhimin e Sistemit Buxhetorò si dhe Ligji nr.48/2014 òPër pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtareò neni 7 në 6 urdhër shpenzime, në shumën totale prej 1,588,870 lekë.

Nga auditimi i procedurës òNdërhyrje Restauruese në Mozaikun e Tiranësò konstatohet se është ngritur grupi I punës me nr.362, datë 22.06.2021, për shqyrtimin e ankesës lidhur me hedhjen në sistem të tre DSK të ndryshme mbi procedurën e konkurrimit.

Bazuar në VKM nr.425, datë 27.05.2020 si dhe Udhëzimit nr.269, datë 11.08.2020 òPër miratimin e dokumenteve standarte të konkurrimit publik, për përzgjedhjen e subjekteve të pajisura me licencë në projektim, zbatim mbikëqyrje dhe kolaudim në pasuritë kulturore për kryerjen e investimeve me fonde publike në pasuritë kulturore,ò autoriteti kontraktor nuk duhej ta shqyrtonte ankesën pasi operatori nuk ka respektuar afatet e ankesës dhe ai ka dorëzuar ofertën e tij ekonomike pa pasur asnjë kundërshti.

Nga ana e autoritetit kontraktor është ngritur Urdhri me nr.396, datë 02.07.2021 për pranimin e ankesës dhe anulimin e procedurës së konkurrimit pasi sipas grupit të punës së shqyrtimit të ankesës nuk është respektuar parimi i transparencës nga AK pasi janë fshirë/hequr nga sistemi DSKP për

këtë procedurë, pra nuk ka patur transparencë në këtë proces për operatorët ekonomikë pjesëmarrës.
-Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës nr. 4049/10, datë 23.10.2020 me objekt: “Realizimin me çelësa në dorë të projektit elektrik për ndriçimin e jashtëm të kalasë së Beratit”, me vlerë kontrate (pa TVSh) 29,968,773 lekë, realizuar nga bashkimi i OE òRò shpk + òAL.Vò shpk, rezultuan diferenca në volume punimesh të pakryera sipas preventivit të miratuar nga investitori në vlerën 2,980,544 lekë pa TVSh, veprime në kundërshtim me kontratën të cilat kanë sjellë efekt negativ në buxhetin e shtetit.

-Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me nr.4050/10 prot. datë 23.10.2020 me objekt òRealizimin me çelësa në dorë të projektit elektrik për ndriçimin e jashtëm të kalasë së Shkodrësò , me vlerë 17,422,642 lekë pa tvsh realizuar nga bashkimi i OE òRò sh.p.k. dhe òAL.Vò sh.p.k rezultuan diferenca në volume punimesh të pakryera sipas preventivit të miratuar nga investitori në vlerën 1,748,264 lekë pa TVSh, veprime në kundërshtim me kontratën të cilat kanë sjellë efekt negativ në buxhetin e shtetit.

- Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me nr.4051/10 prot. datë 23.10.2020 me objekt òRealizimin me çelësa në dorë të projektit elektrik për ndriçimin e jashtëm të kalasë së Krujësò , me vlerë 14,155,008 lekë pa tvsh realizuar nga bashkimi i OE òRò sh.p.k. dhe òAL-Vò sh.p.k rezultuan diferenca në volume punimesh të pakryera sipas preventivit të miratuar nga investitori në vlerën 1,671,440 lekë pa TVSh, veprime në kundërshtim me kontratën të cilat kanë sjellë efekt negativ në buxhetin e shtetit.

-Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me nr.4052/10 prot. datë 23.10.2020 me objekt òRealizimin me çelësa në dorë të projektit elektrik për ndriçimin e jashtëm të kalasë së Gjirokastrësò , me vlerë 20,361,852 lekë pa tvsh realizuar nga bashkimi i OE òRò sh.p.k. dhe òAL.Vò sh.p.k rezultuan diferenca në volume punimesh të pakryera sipas preventivit të miratuar nga investitori në vlerën 1,622,607 lekë pa TVSh, veprime në kundërshtim me kontratën të cilat kanë sjellë efekt negativ në buxhetin e shtetit.

-Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me 16246/10 prot datë 03.12.2020 me objekt òRikonstruksioni i aneksit të Bibliotekës Kombëtare (fondi i Bibliotekës Kombëtare)ò, me vlerë 41,192,400 lekë pa tvsh realizuar nga OE òL.Kò sh.p.k., rezultuan diferenca në volume punimesh të pakryera sipas preventivit të miratuar nga investitori në vlerën 551,336 lekë pa TVSh, veprime në kundërshtim me kontratën të cilat kanë sjellë efekt negativ në buxhetin e shtetit.

-Nga auditimi në terren i kontratës me nr.2455 prot., datë 12.05.2021 me objekt òRikonstruksioni/Rivitalizimi i Magazinave të TKOBAP, në Brarò (Faza II)ò lidhur midis Ministrisë së Kulturës dhe BOE òCò sh.p.k & òD-Pò sh.p.k., me vlerë 34,020,265 lekë pa tvsh u konstatua se gjatë zbatimit ka punime të situacionuara por të pajustificuar, me vlerë totale 1,883,454 lekë pa tvsh.
94,479 lekë.

OPINIONI I AUDITIMIT

Opinion mbi pasqyrat financiare (I pamodifikuar me theksim të çështjes)

Ne audituam pasqyrat financiare të Ministrisë së Kulturës (Aparati), më datë 31.12.2020 të cilat përbëhen Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve, Pasqyra e Fluksit të Arkës dhe Pasqyra e Lëvizjes së Kapitalit, si dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë pasqyrat.

Sipas opinionit tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, shprehim një opinion të pamodifikuar me theksim të çështjes për llogaritë vjetore të subjektit Ministria e Kulturës, duke arritur në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura, në llogaritë vjetore të vitit 2020, të shprehura në bazën për opinion (trajtuar më poshtë).

Baza për opinionin

Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 27, datë 20.04.2008, të Kryetarit të KLSH-së.

Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e **opinionit të pamodifikuar të auditimit me theksim të çështjes**¹.

Theksimi i çështjes:

Theksojmë nevojën e marrjes së masave nga ana e drejtimit e më pas në linjë hierarkike nga gjithë personeli i subjektit Ministria e Kulturës, sa i takon:

- evidentimit të plotë dhe të saktë në pasqyrat financiare të vitit 2020, të llogarisë *“Toka troje terrenö*, si dhe llog.212 *“Ndërtime e konstruksioneö* e cila nuk është kontabilizuar në mënyrë të drejtë, duke mos pasqyruar truallin e cila sipas VKM nr.665, datë 27.08.2020, i kaluar në administrim të MK, me një sipërfaqe prej 2.488 m² si dhe 4 objekteve *“Grup Depo Ish-reparti ushtarak nr.5001ö*, me vendodhje në BRAR.

- Nga auditimi mbi ligjshmërinë dhe saktësinë e veprimeve të kryera nëpërmjet arkës, rezultuan shkelje të disiplinës buxhetore sa i takon likuidimit të faturave duke tejkaluar afatin e parashikuar ligjor, 30 ditor .

-Mos paraqitja e saktë e formatit nr.5 pyetësorë si dhe shënimet shpjeguese mbi zbërthimin me analizë të llogarive përkatëse, për një paraqitje të saktë në përputhje me standardet kontabël kombëtare .

Opinion mbi përputhshmërinë (Opinion i modifikuar, me theksim çështje²)

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së Ministrisë së Kulturës, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat ky institucion realizon misionin e tij. Gjatë auditimit në terren janë marrë të dhëna të mjaftueshme të cilat mundësojnë dhënien e opinionit. Sipas opinionit të KLSH-së, nga auditimi i përputhshmërisë¹, i mbështetur në standardet INTOSAI dhe në Manualin e Auditimit Përputhshmërie së KLSH-së, i kryer në subjektin Ministria e Kulturës, rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionit të modifikuar.

Baza për opinionin mbi përputhshmërinë

Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs), ISSAI-n 4000 *“Standardi i Auditimit Përputhshmërieö*. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, mbështetur në ISSAI-n 10- *“Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t*, si dhe ISSAI 30- *“Kodi Etik*. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së. Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit, mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë të ushtruar nga subjekti i audituar. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit, duke marrë në konsideratë vlerësimin e riskut dhe materialitetit për subjektin e audituar.

Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një nivel të arsyeshëm për dhënien e opinionit të modifikuar, me theksim çështje.

Nga auditimi u konstatuan *raste të mospërputhshmërisë me kriteret e aplikuar të cilat rezultojnë* :

-Vlera në total e dëmit ekonomik shkaktuar nga MK prej situatave të trajtuara në material është 947,476 lekë pa tvsh lekë pa tvsh.

¹ **OPINIONI I PAMODIFIKUAR me theksim të çështjes:** *Një opinion i pamodifikuar me theksim çështje, jepet kur audituesi arrin në konkluzionin se për të gjitha aspektet materiale, pasqyrat financiare paraqesin një pamjen të vërtetë dhe të drejtë si dhe pasqyrat janë përgatitur në përputhje me bazën ligjore në fuqi për raportimin financiar. Theksimi i referohet një çështjeje të paraqitur ose shpalosur në mënyrë të duhur në pasqyrat financiare e cila, sipas gjykimin të audituesit, ka një rëndësi thelbësore për përdoruesin në mënyrë që të arrijnë të kuptojnë pasqyrat financiare. (ISSAI 1706.5)*

² **OPINION I MODIFIKUAR** *jepet në ato raste kur audituesi ka marrë siguri të arsyeshme, si dhe ka konstatuar gabime materiale, ose kur audituesi ka marrë siguri të kufizuar, pasi në bazë të punës së kryer nuk ka siguruar evidencë e mjaftueshme për të mbështetur dhënien e opinionit, por që në gjykimin profesional të audituesit mund të kenë mospërputhshmëri të aspektit material.*

-Vlera në total e shpenzime të kryera nga MK pa efikasitet, ekonomikitet si dhe eficence është 17,290,647 lekë pa tvsh.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar Menaxhimi i MK është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Staf i drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjithë bazën ligjore dhe rregullatorë në fuqi.

Përgjegjësia e Audituesve të KLSH-së:

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs), Manuali i Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 64, datë 22.06.2020, si edhe në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin ÷Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në INTOSAI-P 10, Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 130- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar.

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.

Auditimi ka identifikuar çështjet më të rëndësishme lidhur me zbatueshmërinë e kriterëve të vlerësimit, kuadrin ligjor dhe rregullator nga ana e subjektit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Audituesit e KLSH janë përgjegjës për të siguruar cilësinë e auditimit, duke zbatuar procedurat e kontrollit të cilësisë gjatë gjithë procesit të auditimit, me synim marrjen e sigurisë, se auditimi është në përputhje me standardet e aplikueshme dhe se raporti i auditimit, konkluzionet dhe opinionet e auditimit janë të përshtatshme. Ne arrijmë në konkluzionin se, problematikat e konstatuara kanë ekspozuar institucionin drejt risqeve për përmbushjen e detyrimeve, në zbatim të ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë së tij.

I. Hyrja.

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ÷Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH, në zbatim të Programit të Auditimit nr.1420/1 prot, datë 12.01.2022, në Ministrinë e Kulturës, nga data 13.01.2022 deri më 31.03.2022, për periudhën e auditimit 01.01.2020 deri më datë 31.12.2021, u krye auditim Financiar dhe Përputhshmërie, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. E.M (përgjegjës grupi),
2. B.B , anëtar
3. F.XH , anëtar
4. E.K , anëtar
5. A.Z, anëtar
6. K.A , anëtar

METODOLOGJIA DHE OBJEKTIVAT E AUDITIMIT

1) Objektivat dhe qëllimi i auditimit:

Objektivat specifike të auditimit janë dhënia e opinionit mbi pasqyrat financiare të institucionit, nëse janë paraqitur saktë, në përputhje me kuadrin rregullator të raportimit financiar dhe dhënia e opinionit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së subjektit me kuadrin rregullator në fuqi,

procedurat e prokurimeve dhe shpenzimet vjetore të buxhetit.

Qëllimi i auditimit është, vlerësimi dhe evidentimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e raportuara janë, në çdo aspekt material, në përputhje me ligjshmërinë dhe menaxhimin financiar, mbi bazën e të cilit ushtron veprimtarinë Ministria e Kulturës, në mënyrë për të bërë të mundur ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese sipas rastit, me synim të mirëpërdorimit të fondeve të financuara nga Buxheti i Shtetit.

2) Identifikimi i çështjes:

Ministria e Kulturës, në përputhje me drejtimit kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore dhe me programin e Këshillit të Ministrave, ushtron veprimtarinë e saj në këto fusha përgjegjësie shtetërore:

ó Harton, programon dhe zhvillon politikat kombëtare të kulturës, të trashëgimisë kulturore, materiale dhe shpirtërore, të rritjes së tolerancës fetare e të dialogut kulturor dhe integritetit kulturor në familjen, evropiane dhe botërore, në përputhje me programin e qeverisë së Republikës së Shqipërisë .

ó Harton dhe bashkërendon punën për politikat në fushën e artit e të kulturës nëpërmjet edukimit të popullsisë, rjetësimit të vlerave dhe trashëgimisë kulturore, nxitjes së investimeve, publike dhe private, në këta sektorë, monitorimit të mënyrës së përdorimit të fondeve publike në mbështetje të zhvillimit kulturor, edukimit në kulturë, mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, ruajtjes dhe vijimësisë së traditës së harmonisë fetare në kulturën shqiptare, si dhe të bashkëpunimit rajonal.

ó Harton politikat, mbrojtëse dhe promovuese, për trashëgiminë kulturore, materiale ose shpirtërore, si dhe krijon hapësirat e nevojshme, ligjore e mbështetëse, për ruajtjen e kultivimin e kulturës së shkruar, për krijimtarinë artistike në përgjithësi, si dhe për të promovuar arritjet e kulturës shqiptare e për të rritur konkurrencën e produktit shqiptar kulturor përtej kufijve.

ó Harton politika për ekzistencën e Shqipërisë si një partner aktiv në organizatat ndërkombëtare, evropiane dhe rajonale, në fushën e artit e të kulturës dhe të trashëgimisë kulturore, nëpërmjet aderimit në institucionet përkatëse.

ó Udhëheq, programon dhe mbështet veprimtaritë, kombëtare e ndërkombëtare, me qëllim identifikimin dhe zhvillimin e tendencave kulturore, artistike dhe letrare, brenda vendit, si dhe përfshirjen e ballafaqimin e vlerave më të mira kombëtare me ato rajonale, si ato të trashëguara dhe ato bashkëkohore dhe për krijimin e një hapësire dialogu mbarë shqiptar dhe të diversitetit kulturor.

ó Nëpërmjet strukturave të varësisë realizon regjistrimin, mbikëqyrjen dhe monitorimin e respektimit të të drejtave të autorëve dhe të të drejtave të tjera, të lidhura me të, nga subjektet, persona fizikë/juridikë, privatë a publikë, përdorues të pronësisë letrare, artistike e shkencore.

ó Kryen funksione dhe veprimtari të tjera në përputhje me ligjin.

Aktivitetet që do të jenë objekt vlerësimi nga ana e grupit të auditimit, janë parashikuar sipas drejtimeve të miratuara nga Kryetari i KLSH-së, në zbatim të Programit të Auditimit nr.1420/1 prot, datë 12.01.2022.

3) Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim:

Ministria e Kulturës është përgjegjëse për zbatimin me rigorozitet të të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kuadri ligjor ekzistues, rritjen profesionale të stafit, zbatimi i kriterëve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit, identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e riskut nga institucioni, procedurat për qarkullim e dokumentacionit, prokurimet duke filluar nga buxheti i fondit, hartuesi i specifikimeve, komisionet e vlerësimit, kontraktuesi, zbatuesi i kontratës, procedurat për pagesat dhe auditimin e brendshëm.

4) Përgjegjësia e Audituesve të KLSH:

Objektivi ynë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të

MK-së, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese. Ne komunikojmë me drejtuesit, ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm, që ne kemi identifikuar gjatë auditimit tonë. Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

7) Kriteret e vlerësimit:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;*
- Ligji 10296, datë 08.07.2010 *“Mbi menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”,* i ndryshuar;
- Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 *“Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”;*
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 *“Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”,* i ndryshuar me ligjin nr. 57, datë 02.06.2016;
- Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”* i ndryshuar;
- Ligji nr.114/2015 *“Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”;*
- Ligji nr. 27/2018 *“Për trashgiminë Kulturore dhe Muzetë”;*
- VKM nr. 425, Datë 27.5.2020 *“Për Procedurat E Përzgjedhjes Së Subjekteve Të Pajisura Me Licencë Për Projektim, Zbatim, Mbikëqyrje Dhe Kolaudim Në Pasuritë Kulturore, Për Kryerjen E Investimeve Me Fonde Publike Në Pasuritë Kulturore”;*
- VKM nr. 248, datë 10.04.1998 *“Për miratimin e planit kontabël publik të organeve të pushtetit lokal, institucioneve shtetërore qendrore si dhe njësisve që varen prej tyre”;* i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001 *“Për disa shtesa e ndryshime të VKM nr. 248, datë 10.04.1998”;*
- VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;*
- VKM nr.918 datë 29.12.2014 *“Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike”;*
- Udhëzim e APP-së nr. 2 datë 27.01.2015 *“Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të prokurimit publik”;* udhëzim e APP-së nr.2 datë 08.01.2018 *“Mbi përdorimin e procedurës me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës dhe zhvillimit të saj me mjete elektronike”* i ndryshuar;
- VKM-së nr.160, datë 02.03.2016 *“Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e komitetit të auditimit të brendshëm në njësitë publike”.*

5)Standardet e Auditimit

- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI (ISSAI);
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) të IFAC;
- ISSA 4000-4899 Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë;
- ISSAI 400-499 Parimet e Auditit të Përputhshmërisë;
- Libri Jeshil i GAO-s;
- ISSAI 1000-2999 Udhëzues të Auditimit Financiar;
- ISSAI 1300 Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare.

6)Medodat e auditimit

Auditimi ynë përfshin përputhshmërinë e aktivitetit të MK, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi lidhur me zbatimin e kriteve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit, identifikimin,

zbatimin e kriterëve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimin e planit fillestar, transferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore, si dhe planin përfundimtar, parashikimin dhe realizimin e të ardhurave dytësore, planifikimin mbi identifikimin vlerësimit dhe menaxhimin e riskut nga institucioni, ruajtjen, arkivimin e informacioneve dokumenteve, procedurat për qarkullim e dokumentacionit, procedurat e prokurimeve dhe konkurrimeve duke filluar nga buxheti i fondit, hartuesi i specifikimeve, komisionet e vlerësimit, kontraktuesi, zbatuesi i kontratës, procedurat për pagesat dhe auditimin e brendshëm.

7) Dokumentimi i auditimit

Auditimi financiar dhe i përputhshmërisë është realizuar, në bazë të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI), mbështetur në ISSAI-n 10 *ōDeklarata e Meksikësō*, mbi Pavarësinë e (SAI), si dhe ISSAI 30 Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin përputhshmërisë të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 *ōStandardi i Auditimit të Përputhshmërisëō*, ISSAI 1000-2999 *ōUdhëzues të Auditimit Financiarō*; ISSAI 1300 *ōPlanifikimi i auditimit të pasqyrave financiareō*; Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 27, datë 20.04.2018, të Kryetarit të KLSH-së si dhe Rregullore *ōMbi Procedurat e auditimit në KLSHō*, miratuar me Vendimin nr. 107, datë 08.08.2017, e ndryshuar me Vendimin nr.63, datë 22.06.2020, të Kryetarit të KLSH-së.

Grupi i audituesve, *për të realizuar objektin e auditimit*, për dhënien e opinionit financiar dhe të përputhshmërisë e veprimtarisë së Ministrisë së Kulturës, u fokusua mbi zbatimin në mbështetje të kuadri rregullator në fuqi, në lidhje mbi procedurat mbi zbatimin e kriterëve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit, identifikimin, zbatimin e kriterëve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimin e planit fillestar, transferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore, si dhe planin përfundimtar, parashikimin dhe realizimin e të ardhurave dytësore, planifikimin mbi identifikimin vlerësimit dhe menaxhimin e riskut nga institucioni, ruajtjen, arkivimin e informacioneve dokumenteve, procedurat për qarkullim e dokumentacionit, prokurimet duke filluar nga buxheti i fondit, hartuesi i specifikimeve, komisionet e vlerësimit, kontraktuesi, zbatuesi i kontratës, procedurat për pagesat dhe auditimin e brendshëm në zbatim të Ligjit organik të KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *ōPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitō*, Ligjit 10296, datë 08.07.2010 *ōMbi menaxhimin Financiar dhe Kontrollinō*, i ndryshuar; Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 *“Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.”*, Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 *ōPër menaxhimin e sistemit buxhetor në RSHō*, i ndryshuar me ligjin nr. 57, datë 02.06.2016, Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 *ōPër prokurimin publikō*, i ndryshuar, Ligji nr. 114/2015 *ōPër auditimin e brendshëm në sektorin publik, - Ligji nr. 27/2018 “Për trashgiminë Kulturore dhe Muzetë”*;

- *Vkm nr. 425, Datë 27.5.2020 “Për Procedurat E Përzgjedhjes Së Subjekteve Të Pajisura Me Licencë Për Projektim, Zbatim, Mbikëqyrje Dhe Kolaudim Në Pasuritë Kulturore, Për Kryerjen E Investimeve Me Fonde Publike Në Pasuritë Kulturore”*, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *ōPër miratimin e rregullave të prokurimit publikō*, VKM nr. 918, datë 29.12.2014 *ōPër kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronikeō*, Udhëzimin e APP-së nr. 2, datë 27.01.2015 *ōPër hartimin e regjistrit të parashikimeve të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të prokurimit publikō*, udhëzimin e APP-së nr. 2 datë 08.01.2018 *ōMbi përdorimin e procedurës me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës dhe zhvillimit të saj me mjete elektronikeō* i ndryshuar, VKM nr.160, datë 02.03.2016 *ōPër mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e komitetit të auditimit të brendshëm në njësitë publike”*.

II. PËSHKRIMI AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Ministria e Kulturës, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore dhe me programin e Këshillit të Ministrave, ushtron veprimtarinë e saj në

këto fusha përgjegjësie shtetërore:

a) Hartimin, programimin dhe zhvillimin e politikave kombëtare të kulturës, trashëgimisë kulturore, materiale dhe shpirtërore, të rritjes së tolerancës fetare e të dialogut kulturor dhe integritimit kulturor në familjen evropiane e botërore, në përputhje me programin e qeverisë së Republikës së Shqipërisë;

b) Hartimin dhe bashkërendimin e punës për politikën në fushën e artit e të kulturës, nëpërmjet edukimit të popullsisë, ri jetësimit të vlerave e të trashëgimisë kulturore, nxitjes së investimeve, publike dhe private, në këta sektorë, monitorimit të mënyrës së përdorimit të fondeve publike në mbështetje të zhvillimit kulturor, edukimit në kulturë, mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, ruajtjes dhe vijmësisë së traditës së harmonisë fetare në kulturën shqiptare, si dhe të bashkëpunimit rajonal;

c) Hartimin e politikave mbrojtëse dhe promovuese për trashëgiminë kulturore, materiale ose shpirtërore, si dhe krijimin e hapësirave të nevojshme ligjore e mbështetëse për ruajtjen dhe kultivimin e kulturës së shkruar, për krijimtarinë artistike në përgjithësi, si dhe për të promovuar arritjet e kulturës shqiptare e për të rritur konkurrencën e produktit shqiptar kulturor përtej kufijve;

ç) Hartimin e politikave për ekzistencën e Shqipërisë si një partner aktiv në organizatat ndërkombëtare, evropiane dhe rajonale, në fushën e artit e të kulturës dhe të trashëgimisë kulturore, nëpërmjet aderimit në institucionet përkatëse;

d) Udhëheqjen, programimin dhe mbështetjen e veprimtarive kombëtare e ndërkombëtare, me qëllim identifikimin dhe zhvillimin e tendencave kulturore, artistike e letrare brenda vendit, si dhe përfshirjen e ballafaqimit të vlerave më të mira kombëtare me ato rajonale, si ato të trashëguara edhe ato bashkëkohore, dhe krijimin e një hapësire dialogu mbare shqiptar e të diversitetit kulturor;

dh) Realizimin e regjistrimit, mbikëqyrjes dhe monitorimit të respektimit të të drejtave të autorëve dhe të drejtave të tjera të lidhura me to nga subjektet, personat fizikë/juridikë, privatë a publikë, përdorues të pronësisë letrare, artistike e shkencore;

e) Zhvillimin e politikave për nxitjen e investimeve për pasuritë kulturore, sigurimin e mbështetjes financiare nëpërmjet Fondit Kombëtar të Kujdesit për Trashëgiminë Kulturore, qendrat art Qëllimi është auditimi i fondeve të buxhetit, nëse janë përdorur me eficiencë, efektivitet dhe ekonomikitet.

2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit

2.1. MBI HARTIMIN DHE ZBATIMIN E BUXHETIT TË SHTETIT

Në zbatim të pikës 1 të programit të auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

-Zbatimi i kriterëve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në udhëzimet e Ministrisë së Financave mbi hartimin e buxhetit të shtetit.

-Zbatimi i kriterëve në çeljen e buxhetit për vitin 2020 dhe vitin 2021, drejtimi i planit fillestar, transferimi i fondeve buxhetore si dhe plani përfundimtar.

-Realizimi i plani të buxhetit.

- Zbatimi i kriterëve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit.

Financimi i Ministrisë së Kulturës kryhet si më poshtë:

Për shpenzimet për paga, sigurime, mallra dhe shërbime (llog.600, llog.601, llog.602 ,606 dhe 230-231) në Ministrinë e Kulturës.

Për shpenzimet për investime (llog.230 & llog.231).

Buxheti i miratuar për MK paraqitet në tre program buxhetore, Programi oPlanifikim Menaxhim Administrimö, Programi oTrashëgimia Kulturoreö, Programi oArti dhe Kulturaö.

Për vitin 2020 detajimi i buxhetit është mbështetur në Programin Buxhetor Afatmesëm 2020-2022 si dhe në prioritetet e përcaktuara në Programin e Qeverisë.

Me shkresën nr.24325/77 datë 22.01.2020 është dërguar në MK, miratimi i detajimit të planit të buxhetit për vitin 2020-2022, miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë.

Me shkresën nr.24325/183 datë 14.02.2020 është dërguar në MK detajimi i buxhetit të vitit 2020-

2022 për shpenzimet kapitale, miratuar nga Ministri i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Me shkresën nr.2804/1 datë 02.05.2019, miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm është dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë Relacioni mbi Projekt Buxhetin Afatmesëm 2020-2022 faza e I.

Me shkresën nr.771/1 datë 02.09.2019 miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm është dërguar në Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë Relacioni mbi Projekt Buxhetin Afatmesëm 2020-2022, faza II.

Buxheti i akorduar në fillim të vitit 2020 ka pësuar ndryshime gjatë vitit si rezultat i përfitimit të fondeve buxhetore nga VKM, nëpërmjet rishpërndarjeve të fondeve dhe Akteve Normative sipas tabelës më poshtë:

në 000/lekë

Programet e MK	Tipi shpenzimit	Buxheti Fillestar	Fondi Vecant	Shtesa me VKM	Pakesime nga Akti Normative	Transferime	Plani me Ndryshime
Planifikim Administrim, Menaxhim	Shpenzime personeli	115,276	-	(4,000)	(10,000)	(5,800)	95,476
	Shpenzime Korrente	49,724	400	-	-	5,800	55,924
	Shpenzime Kapitale	-	-	-	-	-	-
	TOTAL	165,000	400	(4,000)	(10,000)	-	151,400
Trashëgimia Kulturore dhe Muzete	Shpenzime personeli	304,805	-	-	(9,000)	(4,797)	291,008
	Shpenzime Korrente	251,076	1,100	(11,000)	(11,000)	4,797	234,973
	Shpenzime Kapitale	7,500	-	354,627	8,000	-	370,127
	TOTAL	563,381	1,100	343,627	(12,000)	-	896,108
Arti dhe Kultura	Shpenzime personeli	550,800	-	-	(9,000)	(18,825)	522,975
	Shpenzime Korrente	217,200	2,000	(16,000)	6,000	18,825	228,025
	Shpenzime Kapitale	579,500	-	31,000	(63,000)	-	547,500
	TOTAL	1,347,500	2,000	15,000	(66,000)	-	1,298,500
TAVANET MK	Shpenzime personeli	970,881	-	(4,000)	(28,000)	(29,422)	909,459
	Shpenzime Korrente	518,000	3,500	(27,000)	(5,000)	29,422	518,922
	Shpenzime Kapitale	587,000	-	385,627	(55,000)	-	917,627
	TOTAL	2,075,881	3,500	354,627	(88,000)	-	2,346,008

Sikurse vërehet edhe në tabelën e mësipërme Buxheti ka pësuar këto ndryshime referuar programeve të MK:

1.Programi Planifikim, Menaxhim dhe Administrim

Për këtë program, shpenzimet e personelit u pakësuan në vlerën prej 10 milion lekë nga Akti Normativ nr.15 datë 15.04.2020 dhe nga Akti Normativ nr.28 datë 02.07.2020 si rezultat i situatës së shkaktuar nga COVID19, 4 milion lekë nga VKM nr.926 datë 25.11.2020.

Ndërsa shpenzimet korrente u shtuan në vlerën prej 400 mijë lekë nga fondi i veçantë si dhe 5.8 milion nga rishpërndarjet e fondeve të lira të shpenzimeve të personelit si rezultat i mosplotësimit të vendeve vakante.

2.Programi Trashëgimia dhe Muzetë

Për këtë program, shpenzimet e personelit u pakësuan në vlerën prej 9 milion lekë nga Akti Normativ nr.15.datë 15.04.2020 dhe nga Akti Normativ nr.28 datë 02.07.2020 si rezultat i situatës së shkaktuar nga COVID19,

Shpenzimet korrente u shtuan në vlerën prej 1.1 milion lekë nga fondi i veçantë, u pakësuan në vlerën prej 11 milion lekë nga Akti Normativ nr.15.datë 15.04.2020 si rezultat i situatës së shkaktuar nga COVID19, u pakësuan 11 milion lekë nga VKM nr.926 datë 25.11.2020, si dhe u shtuan 4.7 milion lekë nga rishpërndarjet e fondeve të lira të shpenzimeve të personelit si rezultat i mosplotësimit të vendeve vakante.

Përsa i përket shpenzimeve kapitale, u shtuan në vlerën prej 236.7 milion Lekë nëpërmjet VKM nr.213 dt 11.03.2020 “Për caktimin e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore si njësi zbatuese, dhe për përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e restaurimit/rindërtimit të pasurive kulturore”, u shtuan në vlerën prej 118 milion lekë

nëpërmjet VKM nr.647 datë 30.07.2020 "Për një shitesë fondi në buxhetin e vitit 2020" si dhe si rezultat i Aktit Normativ nr.28 datë 02.07.2020 u shtua në vlerën 8 milion lekë projekti "Restaurimi Kisha e Shën Ilias Stegopullë me qëllim nxjerrjen nga zona e riskut".

3. Programi Arti dhe Kultura

Për këtë program, shpenzimet e personelit u pakësuan në vlerën prej 9 milion lekë nga Akti Normativ nr.15.datë 15.04.2020 si rezultat i situatës së shkaktuar nga COVID-19.

Shpenzimet korrente u shtuan në vlerën prej 2 milion lekë nga fondi i veçantë, u shtuan në vlerën prej 6 milion lekë nga Akti Normativ nr.15.datë 15.04.2020 dhe nga Akti Normativ nr.28 datë 02.07.2020 si rezultat i situatës së shkaktuar nga COVID-19, u shtuan 18.8 milion lekë nga rishpërndarjet e fondeve të lira të shpenzimeve të personelit si rezultat i mosplotësimit të vendeve vakante, si dhe u pakësuan 6 milion leke nga VKM nr.926 datë 25.11.2020 dhe u pakësuan 10 milion lekë nga VKM nr.981, datë 25.11.2020 «Për transferim fondi, nga buxheti i vitit 2020 miratuar për Ministrinë e Kulturës, për Qendrën Kombëtare të Kinematografisë»

Përsa i përket shpenzimeve kapitale, u shtuan në vlerën prej 31,000 mijë lekë nëpërmjet VKM nr.647 datë 30.07.2020 "Për një shitesë fondi në buxhetin e vitit 2020" si dhe u pakësua projekti "Ri jetësimi i Piramidës Tiranë në vlerën prej 63,000 mijë lekë si rezultat i Aktit Normativ nr.28 datë 02.07.2020".

Më poshtë në mënyrë tabelore paraqesim realizimin e buxhetit për 12-mujorin e vitit 2020, ndarë sipas programeve dhe zërave ekonomikë:

-Realizimi i fondeve buxhetore sipas programeve

në 000/lekë

Nr.	Programet	Plani 12 mujorit 2020		Realizimi 12 mujorit 2020		Realizimi në (%) ndaj Planit 12 mujor 2020
		Ne mijë leke	Struktura në %	Ne mijë leke	Struktura në %	
1	Planifikim, Menaxhim, Administrim	151,400	6.45%	139,650	6.50%	92.24%
2	Trashëgimia Kulturore dhe Muzete	896,107	38.20%	795,899	37.06%	88.82%
3	Arti dhe Kultura	1,298,500	55.35%	1,212,256	56.44%	93.36%
	Totali	2,346,007	100.0%	2,147,805	100%	91.55%

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme buxheti në total është realizuar në masën 91.55% ndaj planit 12-mujor. Referuar planit 12-mujor rreth 55.35% të totalit të shpenzimeve e zë zëri i shpenzimeve të programit "Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë" shpenzimet e të cilit zënë rreth 38.20% , të cilat janë realizuar në masën 92.24% si dhe rreth 6.45% të totalit të shpenzimeve e zë zëri i shpenzimeve të programit "Planifikim, Menaxhim, Administrim" buxheti i të cilit është realizuar në masën 92.24%.

-Realizimi i fondeve buxhetore sipas zërave ekonomikë

në 000/lekë

Gr.	Artikulli	Emertimi	Plani 12 mujorit 2020		Realizimi 12 mujorit 2020		Realizimi ne (%) ndaj Planit 12 mujor 2020
			Ne mije leke	Struktura ne %	Ne mije leke	Struktura ne %	
12	600-601	Shpenzime Personeli	909,459	38.77%	893,531	41.60%	98.25%
12	602-606	Shpenzime Korrente	518,921	22.12%	454,046	21.14%	87.50%
12	230-231	Shpenzime Kapitale	917,627	39.11%	800,228	37.26%	87.21%
	Totali		2,346,007	100%	2,147,805	100%	91.55%

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme buxheti në total është realizuar në masën 91.55% ndaj planit për 12-mujorin e 2020 nga ku:

-Shpenzimet për paga dhe sigurimet shoqërore zënë rreth 38.77% të totalit të planifikuar dhe janë realizuar në masën 98.25% ndaj planit 12-mujor dhe pjesa tjetër e mosrealizimit ka ardhur si rezultat i mosplotësimit të vendeve vakante.

-Shpenzimet korrente zënë rreth 22.12% të totalit të planifikuar dhe janë realizuar në masën 87.50% ndaj planit 12-mujor nga ku përkatësisht:

Këto shpenzime janë përdorur kryesisht për realizimin e shërbimeve të domosdoshme nga ana e institucioneve të MK, si shpenzime operative (për ujë, drita, postë, telefon), shpenzime të mirëmbajtjes, shpenzime (udhëtime dhe dieta) për përballimin e lëvizjeve të specialistëve të fushës në objekte që janë në kujdestari të institucioneve të MK, për pagesën e projekteve artistike, për pagesën e kuotizacioneve në bazë të marrëveshjeve që ka MK me organizata ndërkombëtare etj. Realizimi për 12-mujorin nuk është në nivelet e pritshme si rezultat edhe situatës së krijuar nga COVID-19.

-Ndërsa shpenzimet kapitale zënë rreth 39.11% të totalit të planifikuar dhe janë realizuar në masën 87.21% ndaj planit 12-mujor të parashikuar, nga ku pjesa e mosrealizimit i takon projekteve të rindërtimit, fondet e pashpenzuara të të cilëve, kthehen në buxhetin e fondit për rindërtimin dhe trashëgohen në vitin pasardhës sipas pikës nr.3 të VKM-së nr.213, datë 11.03.2020 "Për caktimin e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore si njësi zbatuese, dhe për përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e restaurimit/rindërtimit të pasurive kulturore".

Përsa i takon investimeve për vitin 2020, Ministria e Kulturës është përqendruar përkatësisht në këto projekte:

1-Rikonstruksioni i Teatrit të Operës dhe Baletit

Projekt që ka startuar që në vitin 2017, punimet e te cilit kanë përfunduar.

2-Blerje pajisje për Teatrin e Operës dhe Baletit

Projekt që ka startuar që në vitin 2019, është mbyllur paralelisht me Rikonstruksionin e Teatrit të Operës dhe Baletit.

3-Projekti për Rivitalizimin dhe rikualifikimin e territorit të ish Kinostudios "Shqipëria Sot", "Parku Artit"

Projekt me financim të huaj, për të cilën mbulimi i TVSH është planifikuar edhe për vitin 2021.

4-Rijetësimi I Piramidës Tirane

Projekt që financohet një pjese nga MK dhe një pjesë nga Bashkia TR, i cili është në vijim edhe për vitet 2021-2023.

5- Rikonstruksion I rrjetit elektrik te BK

Projekt që ka përfunduar.

6-Realizimi i punimeve të konservimit dhe drenazhimit në Portën me Kulla dhe Nimfeu, qyteti antik Butrint- projekti IPA "MoNa"

Projekt ne vijim per vitin 2021

7-Restaurim i kishës së "Shën e Premtes në fshatin Valsh", Faza II, Gjinar, Elbasan

Projekt i realizuar 100 %.

8.Hartim Projekti për magazinat e TKOB

Projekt i realizuar 100 %.

9-Blerje pajisje

Projekt i miratuar në nëntor 2020 dhe si rezultat i kohës procedurale nuk u arrit të përfundonte.

1.Programi: “PLANIFIKIM, MENAXHIM, ADMINISTRIM”

Ky program ka për qëllim mbështetjen juridike, financiare dhe me burime njerëzore për zhvillimin e artit dhe kulturës përmes instrumenteve ligjorë, institucional e financiarë si dhe objektiv krijimin e një mjedisi të qëndrueshëm ligjor e institucional për zhvillimin e artit dhe kulturës.

Për fondet e këtij programi, konstatojmë planifikimin dhe realizimin e tyre si më poshtë:

Gr.	Programi	Artikulli	Emertimi	Plani 12 mujorit 2020		Realizimi 12 mujorit 2020		Realizimi ne (%) ndaj Planit 12 mujor 2020
				Ne mije leke	Struktura ne %	Ne mije leke	Struktura ne %	
12	01110	600-601	Shpenzime Personeli	95,476	63.06%	91,251	65.34%	95.57%
12	01110	602-606	Shpenzime Korrente	55,924	36.94%	48,399	34.66%	86.54%
12	01110	230-231	Shpenzime Kapitale					
		Totali		151,400	100.00%	139,650	100.00%	92.24%

Fondet buxhetore të këtij programi janë organizuar në dy produkte si planifikimi dhe realizimi i të cilave, rezulton si më poshtë.

Për sa i përket **produktit me kod 91201AA “Akte ligjore/nënligjore të miratuara”** është konstatuar duke ngarkuar shpenzimet e personelit të aparatit të MK, shpenzime të cilat realizohen me qëllim hartimin dhe miratimin e akteve të reja ligjore dhe nënligjore në përputhje me programin e qeverisë dhe detyrimeve që rrjedhin nga MSA sipas fushës së veprimtarisë së MK. Për vitin 2020 janë miratuar gjithsej 19 akte.

Kurse **produkti me kod 91201AB** òStaf i trajnuarò është konstatuar duke ngarkuar shpenzimet operative të aparatit të MK, shpenzime të cilat justifikohen për ngritjen e kapaciteteve planifikuese dhe menaxhuese të stafit të MK, me qëllim përmbushjen me cilësi të detyrave funksionale për realizimin e objektivave të Sistemit të Kulturës nga ku për vitin 2020 janë realizuar gjithsej 28 trajnime.

2.Programi: “TRASHËGIMIA KULTURORE DHE MUZETË”

Programi Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë është një nga programet e Ministrisë së Kulturës i cili synon ruajtjen e integruar të tërësisë së vlerave të trashëgimisë kulturore, mbrojtjen dhe promovimin e saj si dëshmi e vlerave të trashëguara nga e kaluara, si shprehi e identitetit kombëtar dhe si pasuri e traditës kolektive.

Trashëgimia Kulturore përbëhet nga vlera materiale të luajtshme dhe të paluajtshme (dëshmi të arkitekturës, peizazhit, arkeologjisë) dhe vlera jo materiale që përbëjnë dijen dhe përvojën shpirtërore (ritet, zakonet, zejet tradicionale, folklori dhe gjuha) të krijuar dhe transmetuar nga populli përgjatë shekujve.

Ky program zbatohet nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Kulturës, pjesë e Ministrisë së Kulturës si dhe nëpërmjet 19 institucioneve në varësi të saj (si Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, Muzetë Kombëtarë, Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore, Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale, Zyrat e KA Parqet Arkeologjike, Drejtoritë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore, etj.) në mbrojtjen, promovimin, edukimin dhe menaxhimin e vlerave të trashëgimisë kulturore, zhvillimin e rrjetit të muzeve

kombëtarë dhe lokalë, parqeve arkeologjike dhe lëvizjen e objekteve të trashëgimisë kulturore nëpërmjet përdorimit efikas dhe efektiv të burimeve financiare shtetërore dhe bashkëpunimeve me organet e qeverisjes vendore, partnerë ndërkombëtarë dhe PPP si dhe rritjen e aksesit të publikut në funksion të turizmit kulturor.

Në lidhje me shpenzimet e këtij programi, konstatojmë planifikimin dhe realizimin e tyre si më poshtë:

në 000/lekë

Gr.	Programi	Artikulli	Emertimi	Plani 12 mujorit 2020		Realizimi 12 mujorit 2020		Realizimi në (%) ndaj Planit 12 mujor 2020
				Ne mije leke	Struktura në %	Ne mije leke	Struktura në %	
12	08220	600-601	Shpenzime Personeli	291,008	32.47%	284,660	35.77%	97.82%
12	08220	602-606	Shpenzime Korrente	234,972	26.22%	198,989	25.00%	84.69%
12	08220	230-231	Shpenzime Kapitale	370,127	41.30%	312,250	39.23%	84.36%
		Totali		896,107	100.00%	795,899	100.00%	88.82%

Sipas tabelës vëmë re se buxheti është realizuar në masën 88.82% ndaj planit të 12-mujorit 2020. Shpenzimet për paga dhe sigurimet shoqërore zënë rreth 32.47% të totalit dhe janë realizuar në 97.82% ndaj planit 12-mujor. Shpenzimet korrente zënë rreth 26.22% të totalit dhe janë realizuar në masën 84.69% ndaj planit 12-mujor. Shpenzimet kapitale zënë rreth 41.30% të totalit dhe janë realizuar në masën 84,36% ndaj planit 12-mujor. Realizimi për 12-mujorin nuk është në nivelet e pritshme si rezultat edhe i situatës së krijuar nga COVID-19.

3. Programi “ART DHE KULTURA”

Ky program ka qëllim edukimin, zhvillimin dhe promovimin e skenës artistike dhe vlerave kulturore kombëtare dhe ka objektiv rritjen e interesit të publikut ndaj programeve kulturore përmes përmirësimit të shërbimeve në infrastrukturë si dhe rritjen e cilësisë artistike.

Në lidhje me shpenzimet e këtij programi, konstatojmë planifikimin dhe realizimin e tyre si më poshtë:

në 000/lekë

Gr.	Programi	Artikulli	Emertimi	Plani 12 mujorit 2020		Realizimi 12 mujorit 2020		Realizimi në (%) ndaj Planit 12 mujor 2020
				Ne mije leke	Struktura në %	Ne mije leke	Struktura në %	
12	08230	600-601	Shpenzime Personeli	522,975	40.28%	517,620	42.70%	98.98%
12	08230	602-606	Shpenzime Korrente	228,025	17.56%	206,658	17.05%	90.63%
12	08230	230-231	Shpenzime Kapitale	547,500	42.16%	487,978	40.25%	89.13%
		Totali		1,298,500	100%	1,212,256	100%	93.36%

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatojmë se buxheti është realizuar në masën 93.36% ndaj planit për 12-mujor 2020. Shpenzimet për paga dhe sigurimet shoqërore zënë rreth 40.28% të totalit dhe janë realizuar në masën 98.98% ndaj planit 12-mujor 2020. Shpenzimet korrente zënë rreth 17.56% të totalit dhe janë realizuar në masën 90.63% ndaj planit 12-mujor. Ndërsa shpenzimet kapitale zënë rreth 42.16% të totalit dhe janë realizuar në masën 89.13% ndaj planit 12-mujor. Realizimi për 12-mujorin nuk është në nivelet e pritshme si rezultat edhe situatës së krijuar nga COVID-19.

Fondet buxhetore janë realizuar si më poshtë:

Produktin (A): Investime të reja të skenave teatrore bashkëkohore

Në lidhje me Investimet dhe ndërtime të reja të skenave bashkëkohore, rikonstruksione infrastrukturore në nivel qendror dhe vendor në institucionet e artit dhe kulturës si dhe hapësira të

reja rikualifikimi;

- Rikonstruksioni i Teatrit të Operës dhe Baletit, pritjet inaugurimi;
- Restaurimi për ndërtesën e Fondit të Bibliotekës Kombëtare (Faza 1); proces 2021
- Rijetësimi i Piramidës Tiranë; proces 2021
- Rikualifikimi i hapësirës së Parkut të Kinostudios "Parku i Artit"; proces 2021
- Restaurimi, Rikonstruksioni dhe rehabilitimi i hapësirave në Muzeun Kombëtar; të Arteve të Bukura (MKAB)-(Galeria Kombëtare e Arteve); proces 2021
- Hartim projekti për magazinën e TKOB;
- Rikonstruksioni i sallës së koncerteve të Universiteti i Arteve; proces 2021
- Projektim dhe Implementim i Mozaikut Tirane. proces 2021

Produkti (B): Veprimtari të realizuara me institucionet e art-kulturës

Bazuar në ligjin nr. 24/2020 Për Miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19". Si dhe në zbatim të masave të marra nga Ministria e Shëndetësisë, në bazë të urdhrin Nr. 132, datë 08.03.2020 për mbylljen e aktiviteteve publike dhe jopublike dhe anulimin e grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo të hapura, të urdhrin nr.156 datë 10.03.2020 për marrjen e masave të veçanta për parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19 dhe të urdhrin nr.156/2 datë 11.03.2020 për shpalljen e gjendjes së epidemisë nga infeksioni COVID-19,

Në këto kushte ka vijuar puna on-line ku Drejtorja e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit Kulturor, ka koordinuar në distancë duke përpunuar të dhënat statistikore mujore, për nr. Shfaqjeve on-line, ekspozitave on-line dhe natyrave të tjera aktiviteteve artistike që janë pjesë e kalendarëve të institucioneve qendrore në art-kulturë.

Përsa i përket programit mbarëkombëtar "**Edukimi përmes kulturës**", aktivitetet nuk kanë vijuar realizimin e tyre përgjatë muajit shtator- dhjetor 2020 për shkak të Covid 19.

Për vitin 2021

a. Zbatimi i kritereve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit. Për vitin 2021.

Buxheti i miratuar për MK paraqitet në tre program buxhetore, Programi i Planifikimit Menaxhim Administrim, Programi i Trashëgimia Kulturorë, Programi i Arti dhe Kulturës.

Për vitin 2021 detajimi i buxhetit është mbështetur në Programin Buxhetor Afatmesëm 2021-2023 si dhe në prioritetet e përcaktuara në Programin e Qeverisë.

Me shkresën nr.5106 datë 27.11.2020 miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm është dërguar në Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë Relacioni mbi Projekt Buxhetin Afatmesëm 2021-2023, faza II.

Me shkresën nr.23724/63 datë 14.01.2021 i mbi miratimin e detajimit të buxhetit për vitin 2021-2023 është dërguar miratimi i buxhetit të MK, firmosur nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë.

Me shkresën nr.2913 datë 11.02.2021 i mbi ri detajimin e buxhetit të vitit 2021-2023 për programin i Arti dhe Kulturës është dërguar miratimi i fondit firmosur nga, Ministri i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Buxheti i akorduar në fillim të vitit 2021 ka pësuar ndryshime gjatë vitit si rezultat i përfitimit të fondeve buxhetore nga VKM, nëpërmjet rishpërndarjeve të fondeve dhe Akteve Normative sipas tabelës më poshtë.

Programet e MK	Tipi shpenzimit	Buxheti Fillestar	Fondi Vecante	Shtesa/Pakesime me VKM	Shtesa/Pakesime me Akt Normativ	Shtesa/Pakesime nga Rishperndarje	Plani me ndryshime
Planifikim, Menaxhim, Administrim	Shpenzime Personeli	115,276				- 9,750	105,526
	Shpenzime Korrente	44,724	400			13,422	58,546
	Shpenzime Kapitale	-					
	Total	160,000	400	-	-	3,672	164,072
Trashëgimia Kulturore dhe Muzete	Shpenzime Personeli	304,805				- 9,596	295,209
	Shpenzime Korrente	221,196	1,200			- 6,411	215,985
	Shpenzime Kapitale (FB)	7,500		45,784		-	53,284
	Shpenzime Kapitale (FH)				43,001	-	43,001
	Total	533,501	1,200	45,784	43,001	- 16,007	607,479
Arti dhe Kultura	Shpenzime Personeli	535,430			10,000	- 20,812	524,618
	Shpenzime Korrente	184,570	1,900			19,212	205,682
	Shpenzime Kapitale (FB)	1,392,500			50,000	- 87,000	1,355,500
	Shpenzime Kapitale (FH)				93,000	-	93,000
	Total	2,112,500	1,900	-	153,000	- 88,600	2,178,800
TAVANET MK	Shpenzime Personeli	955,511	-	-	10,000	- 40,158	925,353
	Shpenzime Korrente	450,490	3,500	-	-	26,223	480,213
	Shpenzime Kapitale (FB)	1,400,000	-	45,784	50,000	- 87,000	1,408,784
	Shpenzime Kapitale (FH)	-	-	-	136,001	-	136,001
	TOTAL	2,806,001	3,500	45,784	196,001	- 100,935	2,950,351

Referuar tabelës së mësipërme buxheti i Ministrisë së Kulturës ka pësuar këto ndryshime referuar programeve të MK:

1. Programi Planifikim, Menaxhim dhe Administrim

Në këtë program, ka patur ndryshim të planit vetëm përsa i përket shpenzimeve korrente, të cilat u shtuan në vlerën prej 400 mijë lekë nga fondi i veçantë dhe 3.6 milion lekë nga krijimi i fondeve të lira të cilat u transferuar me Aktin Normativ nr. 34 dt 03.12.2021, si rezultat i mosplotësimit të vendeve vakante nga DAP për aparatin e MK.

2. Programi Trashëgimia dhe Muzetë

Për këtë program, shpenzimet korrente u shtuan nga fondi i veçantë me vlerë 1.2 milion lekë dhe 16 milion lekë u transferuan me Aktin Normativ nr. 34 dt 03.12.2021 nga krijimi i fondeve të lira si rezultat i mosplotësimit të vendeve vakante në institucionet e varësisë, për mbulimin e shpenzimeve administrative të ngutshme për institucionet e trashëgimisë.

Ndërsa shpenzimet kapitale u shtuan në vlerën prej 45.8 milion lekë, fonde të rindërtimit të pashpenzuara nga viti 2020 (shtuar në zbatim të pikës nr.3 të VKM-së nr.213, datë 11.03.2020 *“Për caktimin e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore si njësi zbatuese, dhe për përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e restaurimit/rindërtimit të pasurive kulturore”*). Për sa i përket shpenzimeve kapitale, financimit të huaj është bërë shtesa me Aktin Normativ nr. 34 dt 03.12.2021 prej 43 milion lekë.

3. Programi Arti dhe Kultura

Edhe për këtë program, ndryshim të planit ka vetëm përsa i përket shpenzimeve korrente, të cilat u shtuan në vlerën prej 1.9 milion lekë nga fondi i veçantë dhe 1.6 milion lekë nga krijimi i fondeve të lira si rezultat i mosplotësimit të vendeve vakante në institucionet e varësisë, me qëllim mbulimin e shpenzimeve administrative të ngutshme për këto institucione.

Gjithashtu shpenzimet e personelit u shtuan me 10 milion lekë nëpërmjet Aktit Normativ nr.26 datë 22.06.2021, si rezultat i pamjaftueshmërisë së fondit të pagave në dispozicion për TKOBAP bazuar në numrin e punonjësve të strukturës aktuale që ky institucion zbaton.

Ndërsa shpenzimet kapitale u shtuan në vlerën prej 50 milion lekë, nëpërmjet Aktit Normativ nr.26 datë 22.06.2021, për òHartim Projekti Qendra Kulturore për Fëmijë dhe Teatrit të Kukullaveò.

Me Aktin Normativ nr. 34 dt 03.12.2021 është hequr projekti "Projektim dhe Implementim i Mozaikut Tirane" në vlerën 87 milion leke dhe është pezulluar procesi vlerësimit të procedurave së konkurrimit publik me objekt òNdërhyrja restauruese në Mozaikun e Tiranësò, me Urdhër Ministri nr.273d t 27.04.2021. Po me këtë Akt Normativ është bërë shtesa e tavanit për FH në vlerën 93 milion lekë.

Më poshtë në mënyrë tabelore paraqesim realizimin e buxhetit për 12-mujorin e vitit 2020, ndarë sipas programeve dhe zërave ekonomikë:

-Realizimi i fondeve buxhetore sipas programeve

Realizimi fondeve buxhetore sipas programeve						
						ne mije leke
Nr.	Programet	Plani 12 mujorit 2021		Realizimi 12 mujorit 2021		Realizimi ne (%) ndaj Planit 12 mujor 2021
		Ne mije leke	Strukturuara ne %	Ne mije leke	Strukturuara ne %	
1	Planifikim, Menaxhim, Administrim	164,072	5.56%	156,828	8.56%	95.58%
2	Trashëgimia Kulturore dhe Muzete	607,479	20.59%	527,534	28.81%	86.84%
3	Arti dhe Kultura	2,178,800	73.85%	1,146,703	62.62%	52.63%
	Totali	2,950,351	100.00%	1,831,065	100.00%	62.06%

Siç vihet re edhe nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatohet se buxheti në total është realizuar në masën 62% ndaj planit 12-mujor. Referuar planit 12-mujor rreth 73.8% të totalit të shpenzimeve e zë zëri i shpenzimeve të programit òArti dhe Kulturaò buxheti i të cilit është realizuar në masën 52.6%, ndjekur nga programi "Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë" shpenzimet e të cilit zënë rreth 20.6% , të cilat janë realizuar në masën 86.8%, si dhe rreth 5.6% të totalit të shpenzimeve e zë zëri i shpenzimeve të programit òPlanifikim, Menaxhim, Administrimò , buxheti i të cilit është realizuar në masën 95.6%.

-Realizimi i fondeve buxhetore sipas zërave ekonomikë

Gr.	Artikulli	Emertimi	Plani 12 mujorit 2021		Realizimi 12 mujorit 2021		ne mije leke
			Ne mije leke	Struktura ne %	Ne mije leke	Struktura ne %	Realizimi ne (%) ndaj Planit 12 mujor 2021
12	600-601	Shpenzime Personeli	925,353	31.36%	910,877	49.75%	98.44%
12	602-606	Shpenzime Korrente	480,213	16.28%	426,725	23.30%	88.86%
12	230-231	Shpenzime Kapitale	1,544,785	52.36%	493,463	26.95%	31.94%
	Totali		2,950,351	100.00%	1,831,065	100.00%	62.06%

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatojmë se buxheti në total është realizuar në masën 62% ndaj planit për 12-mujorin e 2021 nga ku:

-Shpenzimet për paga dhe sigurimet shoqërore zënë rreth 31.3% të totalit të planifikuar dhe janë realizuar në masën 98.4% ndaj planit 12-mujor.

-Shpenzimet korrente zënë rreth 16.3% të totalit të planifikuar dhe janë realizuar në masën 88.9% ndaj planit 12-mujor nga ku përkatësisht:

Këto shpenzime janë përdorur kryesisht për realizimin e shërbimeve të domosdoshme nga ana e institucioneve të MK, si shpenzime operative (për ujë, drita, postë, telefon), shpenzime të mirëmbajtjes, shpenzime (udhëtime dhe dieta) për përballimin e lëvizjeve të specialistëve të fushës në objekte që janë në kujdestari të institucioneve të MK, për pagesën e projekteve artistike, për pagesën e kuotizacioneve në bazë të marrëveshjeve që ka MK me organizata ndërkombëtare etj.

-Ndërsa shpenzimet kapitale zënë rreth 52.3% të totalit të planifikuar dhe janë realizuar në masën 31.9% ndaj planit 12-mujor të parashikuar, për shkak edhe të kohës procedurale që zënë prokurimet.

Përsa takon investimeve për vitin 2021, Ministria e Kulturës është përqëndruar përkatësisht në këto projekte:

1-Projekti për Rivitalizimin dhe rikualifikimin e territorit të ish Kinostudios "Shqipëria Sot", "Parku Artit"

Projekt me bashkëfinancim që do të realizohet në bashkëpunim me Rajonin e Puljas, që konsiston në rikualifikimin e hapësirës së parkut të Kinostudios, për të krijuar një hapësirë të re urbane të dedikuar për art, ekspozita dhe koncerte, për të cilin është planifikuar mbulimi I TVSH si dhe pjesa e bashkëfinancimit, për të cilat është lidhur kontrata dhe kanë filluar punimet.

2-Rijetësimi I Piramidës Tirane

Projekt që financohet një pjesë nga MK dhe një pjesë nga Bashkia TR, i cili është në vijim edhe për vitet 2021-2024, për të cilin aktualisht janë obliguar fondet nga Bashkia Tirane sikurse parashikonte plani për vitin 2021.

3-Restaurimi, Rikonstruksioni dhe Rehabilitimi i hapësirave ne Muzeun e Arteve te bukura (Galerisë Kombëtare të Arteve)

Projekt i parashikuar për vitet 2021-2024, për të cilin aktualisht është lidhur kontrata dhe obliguar fondet sikurse parashikuar në planin 2021.

4-Rikonstruksion Magazinat e TKOAB, projekt në vijim nga viti 2020.

5-Restaurimi për ndërtesën e Fondit të Bibliotekës Kombëtare, projekt në vijim nga viti 2020.

6-Restaurim, Rikonstruksion dhe Rinovim sallës Koncerteve ne Universitetin e Arteve, Tirane, projekt që do të shtrihet në vitet 2021-2022, aktualisht është lidhur kontrata dhe obliguar fondet sikurse parashikuar në planin 2021.

7-Projektim dhe Implementim i Mozaikut Tiranë, projekt që do të shtrihet në vitet 2021-2022, aktualisht është lidhur kontrata.

8-Shpronësim të pasurive të paluajtshme për Muzeu Hebraik Shqiptar në Vlorë, në zbatim të VKM nr.1103 datë 24.12.2020, ende pa realizuar.

9-Realizimi i punimeve të konservimit dhe drenazimit në Portën me Kulla dhe Nimfeu, qyteti antik Butrint- projekti IPA "MoNa", përfunduar.

10-Restaurim i kishës së "Shën e Premtesë Lukovë, aktualisht është lidhur kontrata dhe obliguar fondet.

11-Planifikim për mbulimin e TVSH për projektet IPA për vitin 2021, pjesërisht realizuar.

12-Hartim "Plani i Konservimit, Ndërhyrje Përforcuese dhe Restauruese 2 objekte banimi brenda Kalasë së Krujës, brenda Zonës Arkeologjike AL.V të qytetit të Krujës vlerësuar me nivel dëmi DS4 (Nr. 54 dhe Nr. 66)", përfunduar projekti.

13-Hartim "Plani i Konservimit, Ndërhyrje Përforcuese dhe Restauruese në objektin: Muri i Kalasë Durrës (pa kullën C por me Kullën Veneciane Durrës), përfunduar projekti.

14-Hartim "Plani i Konservimit, Ndërhyrje Përforcuese dhe Restauruese në objektin: Kalaja e Prezës (duke përfshirë Xhamia në Kalanë e Prezës, duke përfshirë 2 kullat dhe murin Verilindor i kalasë), përfunduar projekti.

15-Kryerja e Monitorimit Arkeologjik në 26 zonat e reja të Zhvillimit, projekt ende i përfunduar.

16-Hartim Projekti Qendra Kulturore për Femijë dhe Teatrit të Kukullave, në procedurë e sipër.

Për sa i përket shpenzimeve kapitale, financimit të huaj është bërë shtesa me Aktin Normativ nr. 34 dt 03.12.2021 shtesa e tavanit për FH në vlerën 93 milion lekë në programin Art dhe Kulture dhe në vlerën 43 milion leke për programin Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë.

1.Programi: "PLANIFIKIM, MENAXHIM, ADMINISTRIM"

Ky program ka për qëllim mbështetjen juridike, financiare dhe me burime njerëzore për zhvillimin e artit dhe kulturës përmes instrumenteve ligjorë, institucional e financiarë si dhe objektiv krijimin e një mjedisi të qëndrueshëm ligjor e institucional për zhvillimin e artit dhe kulturës.

Për fondet e këtij programi, konstatojmë planifikimin dhe realizimin e tyre si më poshtë:

Gr.	Programi	Artikulli	Emertimi	Plani 12 mujorit 2021		Realizimi 12 mujorit 2021		Realizimi në (%) ndaj Planit 12 mujor 2021
				Ne mije leke	Struktura në %	Ne mije leke	Struktura në %	
				ne mije leke				
12	01110	600-601	Shpenzime Personeli	105,526	64.32%	102,996	65.67%	97.60%
12	01110	602-606	Shpenzime Korrente	58,546	35.68%	53,832	34.33%	91.95%
12	01110	230-231	Shpenzime Kapitale					
		Totali		164,072	100.00%	156,828	100.00%	95.58%

Nga të dhënat rezulton se buxheti është realizuar në masën 95.6% ndaj planit 12-mujor, nga ku shpenzimet për paga dhe sigurimet shoqërore zënë rreth 64.3% të totalit dhe janë realizuar në masën 97.6% ndaj planit 12-mujor. Shpenzimet korrente zënë rreth 35.6% të totalit dhe janë realizuar në masën 91.9% ndaj planit 12-mujor.

Fondet buxhetore të këtij programi janë organizuar në dy produkte si planifikimi dhe realizimi i të cilave, rezulton si më poshtë.

Për sa i përket **produktit me kod 91201AA "Akte ligjore/nënligjore të miratuara"** është konstatuar duke ngarkuar shpenzimet e personelit të aparatit të MK, shpenzime të cilat realizohen me qëllim hartimin dhe miratimin e akteve të reja ligjore dhe nënligjore në përputhje me programin

e qeverisë dhe detyrimeve që rrjedhin nga MSA sipas fushës së veprimtarisë së MK nga ku janë miratuar në total 11 vendime për vitin 2021.

Kurse **produkti me kod 91201AB** òStaf i trajnuarò është kostuar duke ngarkuar shpenzimet operative të aparatit të MK, shpenzime të cilat justifikohen për ngritjen e kapaciteteve planifikuese dhe menaxhuese të stafit të MK, me qëllim përmbushjen me cilësi të detyrave funksionale për realizimin e objektivave të Sistemit të Kulturës nga ku për periudhën janar gushtë janë kryer gjithsej 16 trajnime.

2. Programi: “TRASHËGIMIA KULTURORE DHE MUZETË”

Programi Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë është një nga programet e Ministrisë së Kulturës i cili synon ruajtjen e integruar të tërësisë së vlerave të trashëgimisë kulturore, mbrojtjen dhe promovimin e saj si dëshmi e vlerave të trashëguara nga e kaluara, si shprehi e identitetit kombëtar dhe si pasuri e traditës kolektive.

Trashëgimia Kulturore përbëhet nga vlera materiale të luajtshme dhe të paluajtshme (dëshmi të arkitekturës, peizazhit, arkeologjisë) dhe vlera jo materiale që përbëjnë dijen dhe përvojën shpirtërore (ritet, zakonet, zejet tradicionale, folklori dhe gjuha) të krijuar dhe transmetuar nga populli përgjatë shekujve.

Ky program zbatohet nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Kulturës, pjesë e Ministrisë së Kulturës si dhe nëpërmjet 19 institucioneve në varësi të saj (si Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, Muzetë Kombëtarë, Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore, Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale, Zyrat e KA Parqet Arkeologjike, Drejtoritë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore, etj.) në mbrojtjen, promovimin, edukimin dhe menaxhimin e vlerave të trashëgimisë kulturore, zhvillimin e rrjetit të muzeve kombëtarë dhe lokalë, parqeve arkeologjike dhe lëvizjen e objekteve të trashëgimisë kulturore nëpërmjet përdorimit efikas dhe efektiv të burimeve financiare shtetërore dhe bashkëpunimeve me organet e qeverisjes vendore, partnerë ndërkombëtarë, PPP si dhe rritjen e aksesit të publikut në funksion të turizmit kulturor.

Në lidhje me shpenzimet e këtij programi, konstatojmë planifikimin dhe realizimin e tyre si më poshtë:

Gr.	Programi	Artikulli	Emertimi	Plani 12 mujorit 2021		Realizimi 12 mujorit 2021		Realizimi ne (%) ndaj Planit 12 mujor 2021
				Ne mije leke	Strukturuara ne %	Ne mije leke	Strukturuara ne %	
12	08220	600-601	Shpenzime Personeli	295,209	48.60%	288,761	54.74%	97.82%
12	08220	602-606	Shpenzime Korrente	215,985	35.55%	190,306	36.07%	88.11%
12	08220	230-231	Shpenzime Kapitale	96,285	15.85%	48,467	9.19%	50.34%
		Totali		607,479	100.00%	527,534	100.00%	86.84%

Sipas tabelës vëmë re se buxheti është realizuar në masën 86.8% ndaj planit të 12-mujorit 2021. Shpenzimet për paga dhe sigurimet shoqërore zënë rreth 48.6% të totalit dhe janë realizuar në 97.8% ndaj planit 12-mujor. Shpenzimet korrente zënë rreth 35.5% të totalit dhe janë realizuar në masën 88.1% ndaj planit 12-mujor. Shpenzimet kapitale zënë rreth 15.8% të totalit dhe janë realizuar në masën 50.3% ndaj planit 12-mujor.

Realizimi për 12-mujorin, nuk është në nivelet e pritshme jo vetëm për shkak të muajve të parë të vitit por edhe si rezultat i procedurave të prokurimit, proces që zgjat deri në finalizimin e lidhjes së kontratës si për shërbimet dhe material.

3. Programi “ART DHE KULTURA”

Ky program ka qëllim edukimin, zhvillimin dhe promovimin e skenës artistike dhe vlerave kulturore kombëtare dhe ka objektiv rritjen e interesit të publikut ndaj programeve kulturore përmes përmirësimit të shërbimeve në infrastrukturë si dhe rritjen e cilësisë artistike.

Në lidhje me shpenzimet e këtij programi, konstatojmë planifikimin dhe realizimin e tyre si më poshtë:

Gr.	Programi	Artikulli	Emertimi	Plani 12 mujorit 2021		Realizimi 12 mujorit 2021		Realizimi ne (%) ndaj Planit 12 mujor 2021
				Ne mije leke	Struktura ne %	Ne mije leke	Struktura ne %	
12	08230	600-601	Shpenzime Personeli	524,618	24.08%	519,120	45.27%	98.95%
12	08230	602-606	Shpenzime Korrente	205,682	9.44%	182,587	15.92%	88.77%
12	08230	230-231	Shpenzime Kapitale	1,448,500	66.48%	444,996	38.81%	30.72%
		Totali		2,178,800	100.00%	1,146,703	100.00%	52.63%

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatojmë se buxheti është realizuar në masën 52.6% ndaj planit për 12-mujor 2021. Shpenzimet për paga dhe sigurimet shoqërore zënë rreth 24% të totalit dhe janë realizuar në masën 98.9% ndaj planit 12-mujor 2021. Shpenzimet korrente zënë rreth 9.4% të totalit dhe janë realizuar në masën 88.7% ndaj planit 12-mujor. Ndërsa shpenzimet kapitale zënë rreth 66.5% të totalit dhe janë realizuar në masën 30.7% ndaj planit 12-mujor.

Bazuar në Planifikimin e Buxhetit Afatmesëm si dhe dokumentit që shoqëron atë, Deklaratën e Politikës së Programit për vitin 2021-2023, shprehemi si më poshtë, sipas produkteve:

Produktin (A): Investime të reja të skenave teatrore bashkëkohore

Në lidhje me Investimet dhe ndërtime të reja të skenave bashkëkohore, rikonstruksione infrastrukturore në nivel qendror dhe vendor në institucionet e artit dhe kulturës si dhe hapësira të reja rikualifikimi:

- Rikonstruksioni i Teatrit të Operës dhe Baletit, (Organizimi i ceremonisë së inaugurimit 15-16 shtator 2021);
- Restaurimi për ndërtesën e Fondit të Bibliotekës Kombëtare (Faza 1); përfunduar si investim;
- Ri jetësimi i Piramidës Tiranë; proces 2021; vlera e kontratës 560,0 milion lekë, likuiduar sipas situacioneve në vlerën 17,4 milion Lekë dhe mbetur pa likuiduar 391,2 milion lekë.
- Rikualifikimi i hapësirës së Parkut të Kinostudios “Parku i Artit”, proces 2021;
- Restaurimi, Rikonstruksioni dhe rehabilitimi i hapësirave në Muzeun Kombëtar; të Arteve të Bukura (MKAB)-(Galeria Kombëtare e Arteve), proces 2021; vlera e kontratës 359,6 milion lekë, likuiduar sipas situacioneve në vlerën 17,4 milion lekë, diferenca e pa likuiduar në vlerën 342,4 milion lekë

- *Rikonstrukcion i Magazinave të TKOAB, investim i përfunduar i cili është parashikuar si vlerë kontratë në shumën 43,808 dhe është realizuar në vlerën 57,362 lekë sipas situacioneve.*
- Rikonstrukcioni i sallës së koncerteve të Universiteti i Arteve, proces 2021; vlera e kontratës në shumën 182,5 milion lekë, nga ku likuiduar sipas situacioneve në vlerën 100,9 milion lekë dhe mbetur pa likuiduar në vlerën 81,5 milion lekë
- Projektim dhe Implementim i Mozaikut Tirane, proces 2021. Fondi në vlerën 87 milion lekë i cili është pakësuar sipas aktit normativ nr.34 datë 03.12.2021 për shkak të gjetjeve të objekteve arkeologjike.

Produkti (B): Veprimtari të realizuara me institucionet e art-kulturës:

Bazuar në ligjin nr. 24/2020 Për Miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, *“Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”*. Si dhe në zbatim të masave të marra nga Ministria e Shëndetësisë, në bazë të urdhrin Nr. 132, datë 08.03.2020 dhe Për mbylljen e aktiviteteve publike dhe jopublike dhe anulimin e grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo të hapura, të urdhrin nr.156 datë 10.03.2020 dhe Për marrjen e masave të veçanta për parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19 dhe të urdhrin nr.156/2 datë 11.03.2020 dhe Për shpalljen e gjendjes së epidemisë nga infeksioni COVID-19.

Për 8 mujorin e vitit 2021, ka vijuar alternimi i aktiviteteve me prezencë të audiencës në 30% Urdhër Nr. 375, datë 30.8.2021 *“Për një ndryshim në urdhrin nr. 633, datë 17.11.2020, “Për ndalimin e grumbullimeve në vende të mbyllura apo të hapura”, të ndryshuar.*

Përsa i përket programit mbarëkombëtar **“Edukimi përmes kulturës”**, aktivitetet për periudhën maj-gusht 2021 kanë vijuar realizimin e tyre por në një formë të përmbledhur duke u bazuar në kufizimet që kanë diktuar aktet ligjore / udhëzimet nga Komiteti i Teknikëve në fuqi, për shkak të Covid 19.

Përgjatë vitit shkollor 2020-2021, të gjitha institucionet e varësisë në bashkëpunim me DAR në Tiranë dhe rrethet kanë përshtatur kalendarët e tyre fizikisht dhe format on-line, në kuadër të edukimit përmes kulturës, me angazhime sipas profileve artistike, duke respektuar protokollet dhe masat parandaluese në fuqi. Ky bashkëpunim ka vijuar dhe për vitin shkollor 2021-2022, për muajt shtator-dhjetor 2021.

Programi Pakti për Universitetin: Marrëveshje - Pakti për Universitetin.

Në vijim të bashkëpunimit ndër institucional me 9 institucionet e varësisë të Ministrisë së Kulturës dhe Universitetit të Arteve, mbi paktin për Universitetin, i cili vijon të jetë prioritet në politikën e Ministrisë së Kulturës, janë realizuar disa projekte/aktivitete/ëorkshope etj., në të cilat kanë qenë të përfshirë 334 studentë përgjatë periudhës **janar – dhjetor 2021.**

2.2. ZBATIMI I DISPOZITAVE LIGJORE PËR MARRËDHËNIET E PUNËS DHE PAGAVE

Për të realizuar objektin, auditimi u fokusua, në përputhshmërinë e akteve ligjore dhe nënligjore për çështjet si vijon:

a) Respektimi i strukturave organike të miratuara dhe krahasimi me faktin.

b) Respektimi i dispozitave ligjore për pagat e punonjësve.

c) Respektimi i dispozitave ligjore për pagat e punonjësve. Realizimi i fondit të pagave.

1. Rregullorja e brendshme dhe urdhërat për organizimin dhe funksionimin
2. Urdhërat e Kryeministrit për miratimin e strukturës dhe organikes për periudhën objekt auditimit
3. Struktura Organizative e Ministrisë së Kulturës dhe numri i punonjësve
4. Listëpagesat, Urdhër Shpenzime të pagave

5. Planet e nevojave për rekrutim, Dosje të personelit të punësuar
6. Vendimet gjyqësore për punonjësit e larguar nga puna
7. Informacion mbi punonjës të larguar nga puna gjatë periudhës 2020 deri në fund të vitit 2021 të cilët kanë ngritur padi.
8. Veprimtaria e komisionit disiplinor.

a) Respektimi i strukturave organike të miratuara dhe krahasimi me faktin.

Në zbatim të VKM nr.507 dt.13.09.2017 për përcaktimin e Fushës së përgjegjësisë shtetërore të MKö, Urdhër I Kryeministrit nr.164 dt.05.10.2017 për miratimin e strukturës dhe organikës së MKö, u krijua Struktura dhe Organigrama e Re e Ministrisë së Kulturës e cila shfuqizoi VKM nr.844 dt.27.09.2013 për përcaktimin e Fushës së përgjegjësisë shtetërore të MKö dhe Urdhrin e Kryeministrit nr.187 dt.18.10.2013 për miratimin e strukturës dhe organikës së MKö është miratuar Misioni dhe Vizioni i Ministrisë së Kulturës (MK). Misioni i Ministrisë së Kulturës është, hartimi, programimi dhe zhvillimi i politikave kombëtare të kulturës; Hartimi dhe bashkërendimi i punës për politikën e artit dhe kulturës; Hartimi i politikave mbrojtëse dhe promovuese për trashëgiminë kulturore (materiale dhe shpirtërore); Hartimi i politikave për ekzistencën e Shqipërisë si një partner aktiv në organizatat ndërkombëtare; Udhëheq, programon dhe mbështet veprimtaritë kombëtare dhe ndërkombëtare me qëllim identifikimin dhe zhvillimin e tendencave kulturore; Respektimi i regjistrimit, mbikëqyrjes dhe monitorimit të respektimit të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera lidhur me to.

Struktura organizative

Nga verifikimi i dokumentacionit në lidhje me respektimin e strukturave të MK për periudhën 01.01.2020 deri më 31.12.2021, u konstatua se Ministria e Kulturës nuk ka pësuar ndryshime në strukturë dhe organikë, dhe funksionin në bazë të:

Urdhërit të Kryeministrit nr.164, datë 05.10.2017 *“Miratim e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Kulturës* ö numri total i strukturës plan është 91 punonjës pozicionet si më poshtë:

1. Funksione Politike - Ministër, Asistent Ministër (2 persona), Kabineti (7 persona), Zv/Ministër (1 person)
2. Funksione Administrative- Sekretar i Përgjithshëm (1 person), Drejtor i Përgjithshëm (3 persona), Drejtor Drejtorie (3 drejtori x 3 persona/ 9 persona), Përgjegjës Sektori (10 persona), specialistë dhe të tjerë (57 persona).

Planifikimi Rekrutimeve në Ministrinë e Kulturës

Në zbatim të nenit 18, Kreu II, të Ligjit nr.152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, si dhe Vendimit nr. 108, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil, përgatitet plani vjetor i pranimit në shërbimin civil për pozicionet e administrimit të përgjithshëm dhe të posaçëm, si dhe për pozicionet e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues.

Ministria e Kulturës ka bërë planifikimin e rekrutimit për vitin 2020, ku me shkresë nr.7413/1 prot datë 27.12.2019, ka dërguar pranë Departamentin e Administratës Publike **öPlanin e nevojave për rekrutim për vitin 2020ö.**

Ndërkohë me shkresë nr.5131/1 prot datë 18.12.2020 MK ka dërguar pranë Departamentit të Administratës Publike me lëndë **öPlanifikimin e nevojave për pranimit në shërbimin civil, për vitin 2021ö.**

Emërimet

Për periudhën 01.01.2020-31.12.2020, në MK janë emëruar gjithsej 9 punonjës, nga të cilët 4 punonjës janë pranuar në shërbimin civil, 4 punonjës me lëvizje paralele dhe 1 punonjës rikthim nga pezullimi i statusit.

Për periudhën 01.01.2021-31.12.2021, në MK janë emëruar gjithsej 11 punonjës, nga të cilët 8 punonjës janë pranuar në shërbimin civil dhe 3 punonjës me ngritje në detyrë.

Largimet

Për periudhën 01.01.2020-31.12.2020, në MK i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës 9 punonjësve për arsyt e mëposhtme:

Lirimet gjate vitit 2020		
Arsyeja e largimit	Nr. i punonjësve	Përqindja
Lirim nga Sherbimin Civil (doreheqje)	1	10%
Pezullim statusi (me kerkese te punonjesit)	4	45%
Pension pleqerie	1	10%
Emerohet ne institucion tjeter	3	35%
Totali	9	100%

Për periudhën 01.01.2021 - 31.12.2021 në MK i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës 11 punonjësve për arsyt e mëposhtme:

Lirimet gjate vitit 2021		
Arsyeja e largimit	Nr. i punonjësve	Përqindja
Lirim nga Sherbimin Civil (doreheqje)	6	55%
Pension pleqerie	2	18%
Emerohet ne institucion tjeter (levizje paralele)	3	27%
Totali	11	100%

Administrimi i Dosjeve të Personelit.

-Gjatë auditimit u konstatua se, për nëpunësit e MK zbatohen procedurat e legjislacionit për nëpunësin civil parashikuar për institucionet e administratës shtetërore. Nga auditimi me përzgjedhje rastësore të dosjeve të personelit rezultoi se ato administrohen të inventarizuara në zbatim VKM nr.833, datë 28.10.2020 *“Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit.”*

Për periudhën objekt auditimi 01.01.2020-31.12.2021 është kryer vlerësimi periodik i rezultateve individuale në punë të bashkëlidhura në çdo dosje të nëpunësit. Vlerësimi i fundit periodik është ai i periudhës qershor - dhjetor të vitit 2021.

U audituan gjithsej 32 dosje personale të punonjësve të MK-së, nga të cilët:

-25 dosje personale të nëpunësve të rekrutuar sipas Ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar;

-1 dosje personale të studentëve të ekselencës, të punësuar sipas VKM nr. 766, datë 26.12.2018 òPër punësimin e studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore, pjesë të shërbimit civil, për vitin 2019ò dhe VKM Nr. 586, datë 30.8.2019 òPër punësimin e përkohshëm të studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetëroreò;

-1 dosje personale të punonjësve mbështetës, të punësuar sipas Ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, òKodi i Punës i Republikës së Shqipërisëò, i ndryshuar;

- 2 dosje personale të punonjësve me kontratë të përkohshme (6 orë/ditë), të punësuar sipas VKM-së òPër përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2021, në njësitë e qeverisjes qendroreò dhe VKM Nr.1151, datë 24.12.2020, òPër përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2021, në njësitë e qeverisjes qendroreò.

- 3 dosje personale Drejtor Drejtorie.

Nga auditimi i dosjeve të personelit u konstatua se, janë plotësuar në zbatim të VKM nr. 117, datë 05.03.2014, *“Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit*. Në dosjen teknike të nëpunësit janë përfshirë : LIDHJA NR 1. *“Fletë inventari me listën e gjithë dokumentacionit që ndodhet në dosje dhe LIDHJA NR 2. “Të dhënat që duhet të përmbajë fleta prezantuese e dosjes teknike të nëpunësit 1. Numri i identifikimit të nëpunësit civil; 2. Emri, atësia, mbiemri; 3. Numri kombëtar i identifikimit; 4. Shtetësia; 5. Gjinia; 6. Datëlindja; 7. Gjendja civile; 8. Përbërja familjare; 9. Adresa e vendbanimit të përhershëm; 10. Adresa e vendbanimit të përkohshëm; 11. Arsimimi; 12. Diploma; 13. Kualifikimi (llojet); 14. Gradë shkencore (titulli); 15. Njohuri gjuhe të huaj; 16. Data e fillimit të punës në pozicionin përkatës;”17. Trajnimet e ndryshme pranë DAP, nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA).*

b) Respektimi i dispozitave ligjore për pagat e punonjësve.

Nga auditimi në lidhje me pagat e punonjësve të MK, u konstatua se:

Në bazë të të dhënave në tabelat e mëposhtme pasqyrohen treguesit e realizimit të fondit të pagave për periudhat 01.01.2020-31.12.2021.

Nga auditimi rezultoi se fondi i pagave për **vitin 2020**, u planifikua në vlerën 95,476,000 lekë dhe u realizua në vlerën 91,250,921 lekë (ose 97.52% ndaj planit përfundimar).

Nga auditimi rezultoi se fondi i pagave për **vitin 2021**, u planifikua në vlerën 105,526,000 lekë dhe u realizua në vlerën 102,996,751 lekë (ose 96.86% ndaj planit përfundimar).

Në tabelën e mëposhtme janë pasqyruar fondi i pagave plan dhe fakt për vitin 2020 dhe 2021.

Nr	Viti 2020 emërtimet	Plan	Fakt	Realizimi në %
1	Paga (600)	80,876,000	78,582,199	97.16%
2	Sigurime Shoqërore Shëndetësor (601)	14,600,000	12,668,722	86.77%
Totali		95,476,000	91,250,921	97.52%

Nr	Viti 2021 emërtimet	Plan	Fakt	Realizimi në %
1	Paga (600)	90,326,000	88,306,398	97.76%
2	Sigurime Shoqërore Shëndetësor (601)	15,200,000	14,690,353	96.65%
Totali		105,526,000	102,996,751	96.86%

Shënim: Të dhënat janë disponuar nga Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në MK.

-Krahasimi përmbledhës i listëpagesave me shumat e urdhër shpenzimit e pagesave të kryera.

U bë krahasimi përmbledhës së listë pagesave me likuidimet, ndërsa nuk u konstatuan pasaktësi në shpenzimet për paga e sigurime. Pagesat janë shoqëruar me dokumentacionin mbështetës listë-prezencat, urdhër shpenzimet për paga dhe urdhra të veçantë të titullarit të nënshkruara nga nëpunësi urdhërues, zbatues (Punonjësi i financës) të nënshkruara edhe nga Dega e Thesarit .

-Respektimi i dispozitave ligjore për përcaktimin e nivelit të pagave, hapja dhe azhurnimi periodik i regjistrit të punëmarrësve (libri i pagave). Niveli i pagave është përcaktuar në zbatim të VKM nr. 187, datë 08.03.2017 *“Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendës ministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve,*

gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura , institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit , lidhja I ÷ *Struktura e pagave për nëpunësit civilë/nëpunësit në të gjitha institucionet pjesë e fushës së veprimit të këtij vendimiö .*

Nga auditimi rastësor me përzgjedhje i listëpagesave për periudhat raportuese (3/mujori I-të dhe të II-të 2020; 3/mujori I-të dhe I IV-të 2021) u verifikua niveli pagave për çdo punonjës, arsimimi sipas diplomës, vjetërsia në punë me librezën e secilit, nuk u konstatuan mospërputhje të nivelit të diplomës me kategorinë e vendit të punës dhe funksionit sipas emërimit. Për rrjedhoje rezultoi se ato janë në përputhje me kriteret e përcaktuara në VKM nr. 545, datë 11.08.2011 i ndryshuar. Përlllogaritjet e kontributit sigurime shoqërore e shëndetësore përballuar nga punëmarrësi dhe ato nga punëdhënësi, deklaratimet, ndalesat si dhe derdhjet e tyre janë bërë në përputhje me ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 ÷ Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisëö i ndryshuar, ligjin nr. 7770, datë 13.10.1994 ÷ Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisëö i ndryshuar dhe ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 ÷ Për tatimin mbi të ardhuratö i ndryshuar. Listë pagesat janë përpiluar me gjithë elementet përbërës, sipas listë prezencave dhe shumat e tyre janë të rakorduara. Vendosija e pagave e shtesave mbi pagë janë bërë me klasën përkatëse për çdo kategori dhe ndalesat janë përlllogaritur në përputhje me dispozitat ligjore për kontributet e sigurimeve dhe tatimi mbi të ardhurat, sipas pasqyrës së realizimit të buxhetit.

Për përdorimin e fondit të pagave, sigurime shoqërore e shëndetësore është respektuar legjislacionin përkatës ligji nr. 9136, datë 11.09.2013 ÷ Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore e shëndetësore në Republikën e Shqipërisëö i ndryshuar, UMF nr. 26, datë 16.04.2009 ÷ Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësoreö i ndryshuar dhe ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 ÷ Për tatimin mbi të ardhuratö i ndryshuar janë bërë llogaritjet dhe ndalesat për tatimin mbi të ardhurat si dhe derdhjet e tyre në favor të tatimeve.

Nuk ka tejkallim të numrit të punonjësve në strukturën organizative. Është mbajtur libër për pagat e punonjësve, dhe janë hedhur pagesat e kryera për secilin punonjës për periudhën të përcaktuara nga emërimi, fillimi marrëdhënies të punës dhe të rakorduar me listë pagesat.

Fondi Veçantë

Për periudhën objekt auditimi, (Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar) në zbatim të *VKM Nr.929, datë 17.11.2010 “ Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë” i ndryshuar* ka planifikuar dhe realizuar fondin e veçantë, si më poshtë:

Nr.	Viti buxhetor	Fondi i pagave i planifikuar	Fondi i veçantë I planifikuar)	Fondit i veçantë i Realizuar
1	2020	80,876,000	400,000	262,000
2	2021	90,326,000	400,000	543,500

Shënim: Të dhënat janë disponuar nga Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në MK.

Nga auditimi në lidhje me destinacionin e përdorimit të fondit të veçante në respektim të përcaktimeve të *VKM Nr.929, datë 17.11.2010 i ndryshuar* u konstatua:

Gjate periudhës objekt auditimi fondi veçantë është përdorur në këto destinacione:

Nr.	Vitet	Ndarja sipas natyrës se përfitimit			Totali (në lekë) i realizuar
		Ndihma per pension pleqërie (në lekë)	Ndihma per fatkeqesie ose vdekje (në lekë)	Ndihma per rast sëmundje	
1	2020	82,000	30,000	150,000	262,000

2	2021	173,500	120,000	250,000	543,500
Shuma 2020-2021		255,500	150,000	400,000	805,500

Shënim: Të dhënat janë disponuar nga Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në MK.

3. MBI ADMINISTRIMIN E PRONËS SHTETËRORE. ZBATIMI I DISPOZITAVE LIGJORE PËR ADMINISTRIMIN, RUAJTJEN, DOKUMENTIMIN DHE QARKULLIMIN E VLERAVE MATERIALE E MONETARE

Në zbatim të pikës nr.3 të programit të auditimit nr.1420/1, datë 12.01.2022ö, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Dokumentet bazë të kontabilitetit si: fletëhyrje, fletëdalje, faturë, mandatarkëtim, mandatpagesë, urdhër-shpenzim.
- Transaksionet e llogarive bankare
- Procedurat për blerje te vogla.
- Shpenzimet për udhëtime dhe dieta.
- Inventarizimi

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

a) Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera përmes arkës

Nga auditimi me zgjedhje për vitet objekt auditimi mbi ligjshmërinë dhe saktësinë e plotësimit të dokumentacionit bazë të kontabilitetit (fletëhyrje, fletëdalje, faturë, mandatarkëtim, mandatpagesë, urdhër shpenzim, etj.) i kryer në Sektorin e Financës, për veprimet e arkës në valutë rezultoi se, veprimet janë kryer konformë kërkesave të ligjit nr.9228, datë 29.04.2004 òPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareö, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.248, datë 10.04.1998 òPër miratimin e planit kontabël publik të organeve të Pushtetit Lokal, Institucioneve shtetërore qendrore si dhe njërive që varen prej tyreö, i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001 dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 14, datë 28.12.2006 òPër përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetoreö, i ndryshuar. Transaksionet janë kontabilizuar në mënyrë kronologjike dhe gjendja e llogarive bankare rakordon me ekstraktet e bankës në fund të çdo muaji. Të gjitha tërheqjet me çek nga banka në lekë dhe valutë, janë bërë hyrje në arkë dhe kontabilizimi i tyre në ditarin e bankës dhe të arkës.

Nga auditimi i shpenzimeve për udhëtime, dieta me jashtë dhe dokumentacionit justifikues të mandat pagesave, tek të gjitha praktikrat mungon ftesa e vendit organizator pritës si dhe draft agjenda e punimeve. Me këto dokumente, vërtetohet qëllimi dhe objekti i shërbimit si dhe pjesa e shpenzimeve që do të mbulojë organizatori dhe pjesa që do të mbulojë buxheti i shtetit. Këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, dhe pikën 4 të Udhëzimit nr. 22, date 10.07.2013 të Ministrisë së Financave.

Mban përgjegjësi: znj. M.B

Titulli i Gjetjes:	Mungesa e ftesës së vendit organizator pritës si dhe draft agjenda e punimeve.
Situata:	Nga auditimi i shpenzimeve për udhëtime dieta me jashtë dhe dokumentacionit justifikues të mandat pagesave tek të gjitha praktikrat mungon ftesa e vendit organizator pritës si dhe draft agjenda e punimeve. Me këto dokumente, vërtetohet qëllimi dhe objekti i shërbimit si dhe pjesa e shpenzimeve që do të mbulojë organizatori dhe pjesa që do të mbulojë buxheti i shtetit.
Kriteri:	VKM nr. 870, datë 14.12.2011 òPër trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë venditö, dhe pikën 4 të Udhëzimit nr. 22, date 10.07.2013 të Ministrisë së Financave.
Ndikimi/Efekti:	Mos justifikim i shërbimit të kryer.

Shkaku:	Parregullsi në plotësimin e dokumenteve justifikues.
Rëndësia:	I lartë
Rekomandimi:	Drejtorja e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa që në të gjitha praktikatat për udhëtime dieta për jashtë shtetit, dokumentit të pagesave ti bashkëngjitet ftesa e vendit pritës dhe draft agjenda e punimeve.

Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera përmes bankës

Në pagesat e kryera me urdhër shpenzime nuk u konstatuan mangësi në hartimin dhe mbajtjen e dokumentacionit justifikues për lëvrimin e tyre. Është bërë regjistrimi dhe kontabilizimi i rregullt dhe në fund të çdo muaji, shuma e pagesave të bankës është e barabartë me ekstraktin e saj, kjo për sa i përket veprimeve të kryera gjatë vitit. Nga verifikimi i regjistrimit të veprimeve, shpenzimet janë regjistruar me numra rendor, në mënyrë kronologjike. Në përgjithësi urdhër shpenzimet kishin të bashkëlidhur dokumentin justifikues si faturat, kontratat e lidhura për blerjet e shërbimet, proces verbalet dhe aktet e marrjes në dorëzim të mallrave apo shërbimeve.

b) Saktësia dhe rregullshmëria e veprimeve të kryera në magazinë

Organizimi i evidentimit të lëvizjes së mallrave nga magazina dhe kontabilizimi i saj është bërë në mënyrë manuale. Fletë daljet e fletë hyrjet e magazinës ishin me blloqe dhe numra të ndarë për hyrjet dhe daljet e ÷brendshme.

Nga audituan me zgjedhje hyrjet dhe daljet e ÷brendshme rezultoi:

Fletë Hyrjet e mallrave dhe materialeve ÷në përdorimë ishin të plotësuar në rregull me numër artikulli, sasi, çmim vlerë, shoqëruar me urdhër dorëzimi.

Fletë Daljet e brendshme janë të ndara për dalje të mallrave e materialeve, për dalje të inventarit të imët, mobilieri e pajisje dhe magazina e librit. Fletë Daljet ishin të plotësuar në rregull me numër artikulli, sasi, çmim vlerë të firmosura nga marrësi në dorëzim, shoqëruar me urdhër dorëzimi.

Magazina përkon me specialisten e financës me kartelat respektive çdo 3 muaj dhe në fund të vitit firmosin për lëvizjet, gjendjet në librat dhe regjistrat respektiv.

c) Inventarizimi

Nisur nga rëndësia dhe materialiteti sasior dhe në natyrë të aspekteve të menaxhimit material dhe mundësisë për veprime të pajustificuara, ky aspekt është audituar për periudhën 2020-2021.

Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i praktikave të dokumentuara të vëna në dispozicion të grupit të auditimit, ka rezultuar se për periudhën 2020-2021 çdo vit janë realizuar proceset e inventarizimit parashikuar në Paragrafi nr.74, i Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 ÷Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikë i ndryshuar që sanksionin se: *“Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës” dhe neni 31, citohet “ ...për objektet e dhëna me qira – sipërfaqja e objektit në m², numri dhe data e kontratës së qirasë, afati i vlefshmërisë së kontratës...*

Regjistrimi i aktiveve është kryer konformë Kreut III, "Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre", të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 30, date 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik". Hyrja e aktiveve për çdo rastë dokumentohet me fletë hyrjen përkatëse, të hartuat sipas gjendjes fizike të tyre, konformë pikës 37, të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 30, date 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik". Dalja e aktiveve për çdo rast, janë kryer konformë pikës 38, të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 30, date 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik".

Më konkretisht:

Procesi i inventarizimit të aktiveve, **për vitin 2020-2021** është kryer nga disa komisione të ngritura sipas urdhrit të Titullarit të Institucionit ÷Për krijimin e komisionit të inventarizimit

Për vitin 2020

Në zbatim të urdhrit të Ministrit nr.5701 prot datë 30.12.2020 *“Ngritja e komisionit për inventarizimin fizik të aktiveve në Ministrinë e Kulturës” për vitin 2020.*

Komisionit të Inventarizimit i është ngarkuar të verifikojë gjendjen fizike dhe cilësore të aktiveve, të bëjë krahasimin e gjendjes konkrete të aktiveve me të dhënat e librave kontabël që mbahen nga punonjësit me përgjegjësi materiale dhe që janë të rakorduara me financën dhe të pasqyrojë të dhënat e inventarizimit në procesverbale.

Komisioni është bazuar në të dhënat e regjistrit kontabël për kryerjen e inventarizimit të pasurisë. Për sa sipër është vepruar në bazë të përcaktimeve të paragrafit nr.26, të Udhëzimit të MF me nr.30/2011, ku përcaktohet se:

“Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësojë një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo kanë administrim, përfshi dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura. Regjistri mbahet në formën e kartelave ose në formë të sintetizuar”.

Komisioni i inventarizimit ka hartuar një relacion mbi inventarin fizik të aktiveve të vitit 2020 me shkresë nr.1388 prot datë 17.03.2021 në lidhje me rezultatet e nga ku ka konstatuar se ka mallra të dëmtuar.

Gjithashtu në zbatim të urdhërit të Ministrit nr.5702 datë 30.12.2020 *“Ngritja e komisionit për inventarizimin fizik të aktiveve të magazinës në Ministrinë e Kulturës” për vitin 2020.*

Komisioni i inventarizimit ka hartuar një relacion mbi inventarin fizik të magazinës të vitit 2020 me shkresë nr.1241 prot datë 10.03.2021 drejtuar Sekretares së Përgjithshme në lidhje me rezultatet e inventarizimit.

Për vitin 2021

Në zbatim të urdhërit të Ministrit nr.6765 prot, datë 31.12.2021 *“Ngritjen e komisionit për inventarizimin fizik të aktiveve të magazinës në MK”* dhe nr. 6768 prot, datë 31.12.2021 *“Ngritjen e komisionit për inventarizimin fizik të aktiveve në Mk”*, komisionet duhet të përfundojnë inventarin brenda datës 20.01.22.

Ndërkohë deri me datë 31.03.2022 komisionet nuk kanë përfunduar brenda afateve të përcaktuara inventarët e sipër cituar.

Nga auditimi u konstatua se komisioni i inventarizimit i ngritur me urdhër të Ministrit nr.5701 prot datë 30.12.2020 *“Ngritja e komisionit për inventarizimin fizik të aktiveve në Ministrinë e Kulturës” për vitin 2020*, në përfundim të inventarit ka hartuar një relacion me shkresë nr.1388 prot datë 17.03.2021 në lidhje me rezultatet, ku ka konstatuar se ka mallra të dëmtuar.

Ndërkohë nga MK nuk është ngritur një komision mbi vlerësimin e aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi duke mos e çuar kështu procesin deri në fund. *Në kundërshtim me Udhëzimin nr.30/2011 pikat 95 dhe 96 ku citohet: **Procesi i vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi në njësi. Pika 95:** Është një proces që kryhet gjatë ose pas procesit të inventarizimit. Mbi bazën e të dhënave kontabël për vitin e vënies në punë, kohën e përdorimit, vlerën fillestare, vlerën e mbetur, vlerën e rivënies dhe mbajtjes në punë, vlerësimin kosto-përfitim, bëhet vlerësimi i aktiveve afatgjata dhe afatshkurtra materiale. **Pika 96.** Procesi i vlerësimit të aktiveve realizohet nga komisioni i vlerësimit, ndërsa procesi i dhënies në përdorim/tjetërsimit apo nxjerrjes jashtë përdorimit kryhet nga komisioni i nxjerrjes së aktiveve nga përdorimi në njësi. Këto dy komisione ngrihen me urdhër të titullarit të njësisë publike me propozim të nëpunësit autorizues. Nëpunësi Autorizues ngarkohet me ndjekjen dhe monitorimin e realizimit të procesit.*

Mban përgjegjësi: Nëpunësi Autorizues znj, E.C

Titulli i gjetjes:	Për vitin 2020 procedurat e inventarizimit nuk rezultojnë të finalizuara duke kryer vetëm procesin e inventarizimit dhe mungon procesi i vlerësimit të aktiveve të dëmtuara.
Situata:	Nga auditimi u konstatua se komisioni i inventarizimit i ngritur me urdhër të Ministrit nr.5701 prot datë 30.12.2020 <i>“Ngritja e komisionit për inventarizimin fizik të aktiveve në Ministrinë e Kulturës” për vitin 2020</i> , në përfundim të inventarit ka hartuar një relacion me shkresë

	nr.1388 prot datë 17.03.2021 në lidhje me rezultatet, ku ka konstatuar se ka mallra të dëmtuar. Ndërkohë nga MK nuk është ngritur një komision mbi vlerësimin e aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi duke mos e çuar kështu procesin deri në fund.
Kriteri:	UMF nr. 30, datë 27.12.2011 <i>“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”</i> i ndryshuar. Pika 95 dhe 96
Ndikimi/Efekti:	Pasqyrat financiare nuk sigurojnë të dhënave të plota dhe nuk paraqesin, të dhënat e nevojshme për vendimmarrje, në regjistrat kontabël.
Rëndësia:	I mesëm
Rekomandime:	Institucioni të ndjekë hapat e mëtejshëm bazuar në konkluzionet e grupeve të inventarizimit për procesin e vlerësimin të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi në njësinë shpenzuese, duke bërë të mundur kështu përfundimin e procesit të inventarizimit si dhe heqjen nga kontabiliteti referuar masave të cilat do merren për aktivet e vlerësuara për tu nxjerrë jashtë përdorimit.

Tejkalimi i afatit 30 ditor të likuidimit të faturave

Grupi i auditimit kreu me zgjedhje testime për të identifikuar pagesat e kryera për periudhën objekt auditimi me datën e urdhër shpenzimit mbi 30 ditë, nga data e lëshimit të faturës së furnitorit. *Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, neni 52 dhe Në ligjin Nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” neni 7.*

Nga kryerja e testimeve mbi urdhër shpenzimet, rezultuan shkelje të disiplinës buxhetore sa i takon likuidimit të faturave duke tejkaluar afatin ligjor. Konkretisht, janë likuiduar fatura mbi afatin e parashikuar 30 ditor duke shkelur disiplinën buxhetore që dikton ligji për *“Menaxhimin e Sistemit Buxhetor”* si dhe ligjin nr.48/2014 *“Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” neni 7*, si më poshtë:

Numri dhe data e urdhër-shpenzimeve		Data e Faturës së dorëzuar nga subjekti	Vlera totale (lekë)
260	03.06.2020	16.04.2020	463,560
340	08.07.2020	05.06.2020	77,440
400	20.05.2021	07.04.2021	70,680
401	20.05.2021	07.04.2021	46,680
402	20.05.2021	07.04.2021	63,360
403	20.05.2021	07.04.2021	108,150
669	23.08.2021	09.07.2021	180,000
670	23.08.2021	15.07.2021	459,000
734	09.09.2021	06.07.2021	120,000

Nga tabela e mësipërme rezulton:

a. Tejkalim të afateve që parashikon ligji nr.9936, datë 26.06.2008 *“Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, neni 52* ku citohet: *“specifikohet se Nëpunësi zbatues i njërive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën e thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, Brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të OE-së”*,

dhe si pasojë

b. Duke implikuar risqe për krijimin e detyrimeve të reja (prapambetura).

Mban përgjegjësi: Nëpunësit zbatues z, Sh.Sh .

Titulli gjetjes:	Mbi tejkalimin e afatit 30 ditor të likuidimit të faturave
Situata:	Nga kryerja e testeve mbi urdhër shpenzimet, rezultuan shkelje të disiplinës buxhetore sa i takon likuidimit të faturave duke tejkeluar afatin ligjor. Konkretisht, janë likuiduar fatura mbi afatin e parashikuar 30 ditor duke shkelur disiplinën buxhetore që dikton ligji për menaxhimin e Sistemit Buxhetorë si dhe Ligji nr.48/2014 për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtareë neni 7 në 6 urdhër shpenzime, në shumën totale prej 1,588,870 lekë , duke sjellë: a.Tejkalim të afateve që parashikon Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSHö, i ndryshuar, neni 52 (ku specifikohet se Nëpunësi zbatues i njëjsteve shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën e thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, Brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të OE-së), b. Duke implikuar risqe për krijimin e detyrimeve të reja (prapambetura)
Kriteri:	Ligji nr. 8438, dt. 28.12.1998 për tatimin mbi të ardhuratë i ndryshuar, neni 33; Ligji nr.48/2014 për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtareë neni 7
Ndikimi/Efekti	Mundësia e krijimit të detyrimeve të prapambetura.
Shkaku:	Shkelje e disiplinës buxhetore
Rëndësia:	I lartë
Rekomandimi:	Nëpunësi Zbatues të marrë masat të paraqesë në strukturën e thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të OE-ik, dhe jo ndryshe, me qëllim respektimin e disiplinës buxhetore dhe shmangien e riskut për krijimin e detyrimeve të prapambetura.

Nga auditimi me zgjedhje mbi rregullshmërinë e kryerjes së Shpenzimeve për karburant për automjetet e MK-së, u konstatua se:

Nga Sektori i Administrimit të Aseteve dhe Shërbimeve të Përgjithshme, për secilin automjet mbahet si dokument vërtetues për konsumin e karburantit kartela, në të cilat pasqyrohen të gjitha shpenzimet të shoqëruara me flete udhëtimet e tyre përkatëse.

Për asnjë nga automjet që administron institucioni, në fillim dhe në fund të vitit nuk është evidentuar kilometrazhi i tyre, për të bërë ndjekjen e shpenzimeve periodike, të cilat nuk mund të përlllogariten pa pasqyruar elementin bazë (kilometrazhin), si dhe për përlllogaritjen dhe planifikimin e shpenzimeve për mirëmbajtje dhe shfrytëzimin e automjeteve.

Nga auditimi me përzgjedhje i kartelave të automjeteve të cilat janë dokumentet vërtetues për lëvizjet, kilometrazhin dhe shpenzimet e karburantit të automjeteve, rezultoi se në të gjithë fletë-udhëtimet e shoferëve janë të përshkruara inteneraret e lëvizjeve brenda rrethit të Tiranës, por nuk janë të përshkruara kilometrat dhe litrat e harxhuara për secilin nga inteneraret e lëvizjeve. *Veprimet kundërshtimkundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar.*

Mbajnë përgjegjësi: znj, A.Ç dhe znj, A.O .

Titulli gjetjes:	Plotësimi i fletë udhëtimeve të karburantit.
Situata:	Nga auditimi me përzgjedhje i kartelave të automjeteve të cilat janë dokumentet vërtetues për lëvizjet, kilometrazhin dhe shpenzimet e karburantit të automjeteve, rezultoi se në të gjitha fletë-udhëtimet e shoferëve janë të përshkruara intenerarët e lëvizjeve brenda rrethit të Tiranës, por nuk janë të përshkruara kilometrat dhe litrat e harxhuara për secilin nga intenerarët e lëvizjeve.
Kriteri:	<i>Veprimet kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar.</i>
Ndikimi/Efekti	Mosjustifikim i shpenzimeve të kryera.

Shkaku:	Parregullsi në plotësimin e dokumenteve justifikues.
Rëndësia:	I mesëm.
Rekomandimi:	Sektori i administrimit të aseteve dhe shërbimeve të përgjithshme të marrë masa që për çdo fletë-udhëtimi të dorëzuar nga shoferet, në fund të muaj të jenë të plotësuar në mënyrë të sakte me të gjithë elementet e nevojshme siç janë <i>1. intenerari i udhëtimit të përshkruar, 2. kilometrat e udhëtimit të përshkruar si dhe litrat e karburantit të harxhuar për intenerarin e udhëtimit, 3. Punonjësi i MK në me të cilin ka udhëtuar shoferi për arsye pune si dhe firma e tij.</i> Në fund të fletë udhëtimeve të bëhet përmbledhja e kilometrave të përshkruara si dhe litrat e harxhuara.

Mbi shpenzimet për prokurimet me vlera të vogla.

Për vitin 2020 me urdhrin nr.166/2 prot datë 15.01.2020 òKrijimi i komisionit të prokurimeve me vlerë të vogël miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm komisioni përbehet nga B.H Kryetare, A.Z dhe T.H anëtare.

Per vitin 2021 me urdhrin nr.116 prot datë 12.01.2021 òKrijimi i komisionit të prokurimeve me vlerë të vogël miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm, komisioni përbehet nga B.H Kryetare, M.H dhe E.P anëtare.

Për periudhën prill- dhjetorë të 2020 janë kryer gjithsej 45 procedura prokurimi, ku 26 prej tyre me vlerë më të vogël se 100,000 lekë dhe 19 procedura prokurimi me vlerë mbi 100,000 leke.

Për procedurat e prokurimit janë parashikuar 10,224,231 lekë si fond limit nga ku është realizuar 8,701,992 lekë pa tvsh. Nga grupi i auditimit janë përzgjedhur 10 procedura prokurimi me fond limit të parashikuar në vlerën 4,751,074 dhe me fond te realizuar në vlerë kontratë ne shumën 3,888,171 lekë pa tvsh.

Për vitin 2021 janë kryer gjithsej 38 procedura prokurimi, ku 18 prej tyre me vlerë më të vogël se 100,000 lekë dhe 20 procedura prokurimi me vlerë mbi 100,000 leke.

Për procedurat e prokurimit janë parashikuar 12,109,744 lekë si fond limit nga ku është realizuar 10,139,942 lekë. Nga grupi i auditimit janë përzgjedhur 10 procedura prokurimi me fond limit të parashikuar në vlerën 5,554,167 dhe me fond te realizuar në vlerë kontratë ne shumën 4,708,889 lekë pa tvsh.

Per vitin 2021 janë realizuar 11 procedura në sistemi dinamik bileta për transportit ajror ndërkombëtar, vlerën totale e realizuar është 2,248,206 lekë.

Nga grupi i auditimit u përzgjedhën 6 procedura të sistemit dinamik biletave të transportit ajror ndërkombëtar me vlere 1,613,156 leke.

Nga auditimi konstatohet se në të gjitha rastet procedurat e blerjeve te biletave jashtë vendit realizohen në një afat shumë të shkurtër nga data e udhëtimit, duke sjelle si pasojë, mungesë të studimit të tregut si rrjedhoje e afateve të limituara dhe rrit riskun e përzgjedhjes së çmimit me të lartë, pasi biletat e avionit blihen në datën e nisjes ose me datë më të afërt me nisjen, ku edhe çmimet kapin vlerën me të lart të tyre. *Në kundërshtim Ligji nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm” neni 8, pika 1, neni 9, pika 1 dhe neni 12.*

Udhëzimi Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë” nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Kap.I, pika 1, 40 dhe 48, germa a, dhe me ligjin e LPP nr.162 dt. 23.12.2020, neni 2 citon: a) të rrisë eficiency dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Nga auditimi me përzgjedhje të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, konstatohet se në përgjithësi janë kryer konformë bazës ligjore, ku janë respektuar afatet, dokumentimi si dhe parimet bazë për mosdiskriminim, shtrembërim të konkurrencës si dhe transparence në përzgjedhjen e

fituesit.

Nga auditimit i dokumentacionit të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël u konstatua mangësi si me poshtë

1. Me shkresë 6499/1 datë 17.12.2021 komisioni i prokurimeve me vlerë të vogël i ka përgatitur Memo drejtuar Sekretar së Përgjithshme me lënde: *“Për zhvillimin e procedurës së prokurimit me emergjence për riparimi i sistemit të kondicionimit të ArTurbinës”, pasi në Ministrinë e Kulturës ka ardhur shkresë nr.6499 prot datë 16.12.2021 nga Teatri Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogliö (TKEKS) për marrje masash të menjëhershme për riparimin e defektit të pajisjes së kondicionimit, bashkangjitur shkresës është dhe proces verbali i emergjencës i mbajtur me nr.478/1 prot datë 16.12.2021 nga punonjësit e TKEKS.*

Me shkresës nr.6499/2 prot datë 17.12.2021 është mbajtur formulari nr.4 **“Procesverbali i Rasteve Të Emergjencës”**.

Me urdhër o shpenzimin nr.1096 datë 21.12.2021 është bërë pagesa për subjektin òA.Sò ne vlerën 300,000 lekë me Tvsh.

Nga auditimi i procedurës konstatohet se komisioni i prokurimit të blerjeve me vlere të vogël (KPVV) ka mbajtur proces verbalin e rasteve emergjente dhe vlere e urdhër shpenzimit nr.1096 datë 21.12.2021 është 250,000 lekë pa tvsh. Ndërkohe që në rastet emergjente ku situata është e paparashikuar vlere nuk duhet të jetë më e madhe se 100,000 leke, në këtë situatë KPVV ka shmangur procedurën standarte të prokurimit me vlerë të vogël duke cenuar barazinë e pjesëmarrësve në tenderi në kundërshtim me ligjin e LPP nr.162 dt. 23.12.2020, neni 2, me udhëzimi nr.05 dt 25.06.2021 dhe me VKM nr.285 dt 19.5.2021 neni 56 pika 9 citon: *Autoriteti/enti kontraktor mund të përdorë procedurën e prokurimit me vlerë të vogël për blerjen e mallrave, për të cilat ka një nevojë emergjente apo për kryerjen e shërbimeve të paparashikueshme me kusht që vlere e përlogaritur e mallrave dhe shërbimeve, për plotësimin e nevojave të lidhura me situatën e paparashikuar, nuk është më e madhe se 100 000 (njëqind mijë) lekë. Në të tilla raste emergjence ose ku prania e komisionit është e pamundur, prokurimet mund të kryhen edhe nga persona që nuk janë anëtarë të komisionit.*

Titulli gjetjes:	Mbi çmimet e biletave të paguara nga institucioni për udhëtime jashtë vendit.
Situata:	Nga auditimi konstatohet se në të gjitha rastet procedurat e blerjeve të biletave jashtë vendit realizohen në një afat shumë të shkurtër nga data e udhëtimit, duke sjelle si pasojë, mungesë të studimit të tregut si rrjedhojë e afateve të limituara dhe rrit riskun e përzgjedhjes së çmimit me të lartë, pasi biletat e avionit blihen në datën e nisjes ose me datë më të afërt me nisjen, ku edhe çmimet kapin vlerën me të lart të tyre.
Kriteri:	Ligji nr.10296, datë 8.7.2010 òPër menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëmò neni 8, pika 1, neni 9, pika 1 dhe neni 12. Udhëzimi Ministrisë së Financave dhe Ekonomisëò nr.9, datë 20.03.2018 òPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitò, Kap.I, pika 1, 40 dhe 48, germa a. Ligjin e LPP nr.162 dt. 23.12.2020, neni 2
Ndikimi/Efekti	Risku i përzgjedhjes së çmimit më të lartë në rastet kur bileta blihet në data të afërta me datën e nisjes së udhëtimit.
Shkaku:	Nxjerrja me vonesë e autorizimit për pjesëmarrjen në këto evente nga momenti i ardhjes së ftesës nga organizatorët.
Rëndësia:	I lartë.
Rekomandimi:	Nga Titullari i Institucionit, të merren masa që pas ardhjes së ftesës nga organizatorët për takime/evente jashtë vendit, të nxirret menjëherë autorizimi i pjesëmarrjes në to, në mënyrë që të minimizohet risku i blerjes së biletave me çmim më të lartë si rezultat i kryerjes së procedurës së prokurimit në data të afërta me datën e nisjes së udhëtimit.

Titulli gjetjes:	Mbajtja e proces verbalit të raste emergjente në tejkalim të shumës së parashikuar në LPP.
-------------------------	--

Situata:	Nga auditimi i procedurës <i>ōRiparimi i sistemit të kondicionimit të ArTurbinës</i> ”, konstatohet se komisioni i prokurimit të blerjeve me vlera të vogël (KPVV) ka mbajtur proces verbalin e rasteve emergjente dhe vlera e urdhër shpenzimit nr.1096 datë 21.12.2021 është 250,000 lekë pa tvsh. Ndërkohe që në rastet emergjente ku situata është e paparashikuar vlera nuk duhet të jetë më e madhe se 100,000 leke, në këtë situatë KPVV ka shmangur procedurën standarte të prokurimit me vlerë të vogël duke cenuar barazinë e pjesëmarrësve në tenderi si dhe ka krijuar premisa për shmangien e konkurrencës.
Kriteri:	<i>Në kundërshtim me ligjin e LPP nr.162 dt. 23.12.2020, neni 2, me udhëzimi nr.05 dt 25.06.2021 dhe me VKM nr.285 dt 19.5.2021 neni 56 pika 9 citon: Autoriteti/enti kontraktor mund të përdorë procedurën e prokurimit me vlerë të vogël për blerjen e mallrave, për të cilat ka një nevojë emergjente apo për kryerjen e shërbimeve të paparashikueshme me kusht që vlera e përlllogaritur e mallrave dhe shërbimeve, për plotësimin e nevojave të lidhura me situatën e paparashikuar, nuk është më e madhe se 100 000 (njëqind mijë) lekë. Në të tilla raste emergjente ose ku prania e komisionit është e pamundur, prokurimet mund të kryhen edhe nga persona që nuk janë anëtarë të komisionit. dhe udhëzimi nr.05 dt 25.06.2021.</i>
Ndikimi/Efekti	Shmangia e procedurës së prokurimeve me vlerë të vogël
Shkaku:	Moszbatim të Ligjit të Prokurimit Publik.
Rëndësia:	I lartë.
Rekomandimi:	Institucioni të marrë masa që në procedurat e ardhshme kur situata është emergjente dhe e pa parashikuar, të mos tejkalohej shuma e lejuar për procedura të kësaj natyre.

2.4. AUDITIMI I LLOGARIVE VJETORE TË ADMINISTRATËS SË INSTITUCIONIT

- a. Auditimi i bilancit kontabël dhe plotësimi i pasqyrave financiare përkatëse në zbatim të UMF nr. 14, datë 28.12.2006, *ōPër përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2020, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësite që varen prej tyre* ò i ndryshuar si dhe UMF nr.8 datë 09.03.2018 *ōPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme* ò
- b. Auditimi i për llogarie të të ardhurave dhe shpenzimeve .
- c. Vlerësimi nëse aktivi dhe pasivi janë llogaritur saktë dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse si edhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare.
- Ç. Auditimit të pasqyrës së fluksit të mjeteve monetare.

a. Auditimi i Bilancit Kontabël dhe Plotësimi i Pasqyrave Financiare përkatëse:

Për hartimin e Pasqyrave Financiare të vitit 2020 për Aparatin e Ministrisë së Kulturës, janë respektuar rregullat dhe kriteret e përcaktuara në:

- VKM nr.248 dt.10.04.1998 "Për miratimin e Planit Kontabël Publik të organeve të pushtetit lokal, institucioneve shtetërore qendrore, lokale dhe njësite që varen prej tyre" I ndryshuar
- Udhëzimit nr.8 dt.09.03.2018 të MFE ",Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme"
- Bilanci i vitit 2020 (me të gjitha pasqyrat financiare përkatëse) është hartuar dhe depozituar më shkresën nr.1605 datë 29.03.2021 brenda afatit ligjor, i miratuar edhe nga Dega e Thesarit Tiranë. Pasqyrat Financiare të Bilancit janë sigluar nga Nëpunësi i Parë Zbatues i Autorizuar (Sekretari i Përgjithshëm) dhe nga hartuesi i tyre Shef i Sektorit të Financës, bazuar në Nenin 42 të Ligjit 9936 dt.26.06.2008 "Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë. Pasqyrat e llogaridhënies vjetore kanë të plotësuar pasqyrat si vijon: Pasqyra e Pozicionit Financiar(Formati 1), Pasqyra e Performancës Financiare (Formati 2), Pasqyra e Flukseve Monetare(Formati 3), Pasqyra e Ndryshimeve në Aktivitet Neto/Fondet Neto (Formati 4), Pasqyra Investimet dhe Burimet e Financimit (Formati 6), Pasqyra Gjendje dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata (Formati 7/a dhe 7/b), Pasqyra Numri i Punonjësve dhe Fondi i Pagave (Format 8) si dhe pasqyrat dhe anekset përkatëse mbi shpenzimet e të ardhurat e ushtrimit, investimet sipas Pyetësori dhe Shënime Shpjeguese (Formati 5).

Veprimet janë mbartur nga dokumentacioni bazë në ditarët përkatës, në librin e madh dhe më tej në bilanc. Përgatitja e të dhënave për Pasqyrat Financiare të vitit 2020 është bërë duke kryer

paraprakisht regjistrimin në mënyrë kronologjike sipas natyrës të të gjitha veprimeve financiare të realizuara nga Aparati i Ministrisë së Kulturës gjatë vitit, rakordimi i llogarive analitike me ato sintetike si dhe përmbledhja në centralizatori.

b. Llogaritë e të Ardhurave dhe Shpenzimeve

- Në Pasqyrën e Performancë Financiare Grupimi A – Format 2 janë të pasqyruara të Ardhurat e Institucionit të realizuara në vitin 2020. Ato janë të ndara në 7 Kategori (sipas zërave përkatës), ku paraqiten sipas tabelës së mëposhtme:

Në lekë

Nr. llog	P E R S H K R I M I I O P E R A C I O N E V E	VITI 2020	VITI 2019
A	TE ARDHURAT	345,388,292	307,082,269
75	II.KONTRIBUTE SIGURIME SHOQERORE E SHENDETESORE	0	0
71	III.TE ARDHURA JO TATIMORE	0	31,113,252
719	3.Te tjera te ardhura jo tatimore		31,113,252
76	IV.TE ARDHURA FINANCIARE	0	0
72	V.GRANTE KORENTE	345,388,292	275,969,017
720	1.Grant korrent I Brendshëm	283,183,848	275,969,017
7200	Nga Buxheti për NJQP(Qendrore)	256,205,708	248,448,022
7205	Financim shtese për te ardhurat e krijuara brenda sistemit		
7206	Financim I pritshëm nga buxheti	8,229,022	8,681,270
7207	Sponsorizime te brendshme(nga te trete)	18,749,118	18,839,725
721	2.Grant korrent I Huaj	62,204,444	0
	Nga Qeveri te Huaja ipa	13,873,859	
	Nga Organizata Ndërkombëtare	48,330,585	
	VI.TE ARDHURA TE TJERA	0	0
73	VII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT TE PRODUKTEVE		

Burimi: MK

Në këtë pasqyrë përfshihen të ardhurat e arkëtuara gjatë vitit 2020, në vlerën 355,243,250 lekë, analizuar si më poshtë:

Në postin 71 “Të ardhura jo tatimore” shuma 0 lekë dhe përfshihen (7109) të ardhura nga sponsorizimet.

Në postin 76 “Të ardhura financiare” shuma 0 lekë.

Në postin 72 òGrante Korrenteò shuma 345,388,292 lekë paraqet transfertat nga buxheti i shtetit (7200) për MK në vlerën 283,183,848 lekë, Financimi i pritshëm nga buxheti (7206) në vlerën 8,229,022 lekë përputhet me llogarinë 4342 òTë tjera operacione me shtetin (debitor)ò, (7207) sponsorizime nga ORD në vlerën 18,749,118 lekë. Në postin Grant i Huaj (721) paraqitet transferta nga Grante te Huaja në vlerën 62,204,444 lekë nga ku në vlerën 13,873,859 transferta nga qeveria per projektin IPA dhe në vlerën 48,330,585 nga organizata ndërkombëtare.

Përsa i përket shpenzimeve të MK Grupi B Shpenzimet, paraqiten në vlerën 292,347,724 lekë për aparatit e MK, nga ku të analizuar sipas llog janë si më poshtë vijon:

Në lekë

Nr.Llog	P E R S H K R I M I I O P E R A C I O N E V E	viti 2020	viti 2019	Ndryshimi	Ne %
B	SHPENZIMET	292,347,724	292,032,414	315,310	1%
600	I.PAGAT DHE PERFITIMET E PUNONJSEVE	78,927,490	84,172,657	-5,245,167	-6%
6001	Paga, personel I përhershëm	78,927,490	84,172,657	-5,245,167	-6%
601	II.KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE	12,729,582	13,607,393	-877,811	-6%
6010	Kontributi I Sigurimeve Shoqërore	12,729,582	13,607,393	-877,811	-6%

602	III.BLERJE MALLRA E SHERBIME	53,520,121	52,554,858	965,263	2%
6020	Materiale zyre e te përgjithshme	3,628,956	1,946,820	1,682,136	47%
6022	Shërbime nga te trete	11,921,046	8,524,741	3,396,305	29%
6023	Shpenzime transporti	7,423,650	6,639,711	783,939	11%
6024	Shpenzime udhëtimi	2,763,515	8,226,792	-5,463,277	-197%
6025	Shpenzime për mirëmbajtje te zakonshme	2,803,304	559,680	2,243,624	80%
6027	Shpenzime për detyrime për kompensime legale	2,104,046	6,194,216	-4,090,170	-194%
6029	Shpenzime te tjera operative	22,875,604	20,462,898	2,412,706	11%
	V.TRANSFERIME KORENTE	152,769,042	143,070,097	9,698,945	7%
604	1.Transferime korente te brendshme	128,467,246	118,712,116	9,755,130	8%
6044	Transferime korente tek Organizatat jo fitimprurëse	128,467,246	118,712,116	9,755,130	8%
605	2.Transferime korente me jashtë	23,198,037	22,915,713	282,324	2%
6051	Transferime Për Organizatat Ndërkombëtare	23,198,037	22,915,713	282,324	2%
606	3.Transferime për Buxhetet familjare e Individë	1,103,759	1,442,268	-338,509	-30%
6060	Transferta Te paguara nga ISSH e ISKSH	1,103,759	1,442,268	-338,509	-30%
	VI.SHPENZIME FINANCIARE	0	0	0	
63	VIII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT	-5,598,512	-1,372,591	-4,225,921	76%
85	TEPRICA OSE DEFICITI I PERIUDHES	53,040,568	15,049,855	37,990,713	72%

Burimi: MK/përpunuar nga grupi i auditimit

Grupimit B SHPENZIMET ne vlerën 292,347,724 , të ndara sipas zërave janë si më poshtë vijon:
Llog.600 òPaga e shpenzime personeliò për 78,927,490 lekë, në këtë post janë paraqitur pagat e personelit, gjatë vitit ushtrimor 2020 përgjatë muajve shkurt 2020-dhjetor 2020.

Llogaria.601 òKontribute të Sigurimeve Shoqëroreò për 12,729,582 lekë, që paraqet shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, pjesa e paguar nga punëdhënësi.

Llogaria.602 òMallra dhe shërbime të tjeraò për 53,520,121 lekë që paraqet shpenzimet për blerje mallrash dhe shërbimesh të analizuar si më poshtë:

Llog.6020 òMateriale dhe shërbime zyre të përgjithshmeò për 3,628,956 lekë e cila paraqet shpenzimet që institucionet kanë kryer për kancelari në vlerën 1,001,685 lekë, materialesh pastrimi në vlerën 2,541,879 lekë, materiale për funksionimin e pajisjeve të zyrës ne vlerën 85,400 lekë.

Llog. 6023 òShpenzime transportiò ka një rritje në vlerën 783,939 lekë, e cila përfaqëson shpenzimet për automjetet e institucioneve si karburant, pjesë këmbimi dhe riparime mjjetesh, si dhe sigurimi I automjeteve.

Llog.6025 òShërbime për mirëmbajtje të zakonshmeò ka një rritje ne vlerën ne vlerën 2,243,624 lekë e cila përfaqëson shpenzimet që janë bërë për mirëmbajtje dhe riparime të zakonshme të AQT-ve si dhe mirëmbajtje godine.

Llog.6029 òShpenzime të tjera operative një rritje në vlerën 2,412,706lekë përfaqëson shpenzime të tjera që nuk janë përfshirë në zërat e sipërpërmendur sipas kritereve të klasifikimit buxhetor.

Llog.6022 òShërbime nga te treteò, një rritje ne vlerën 3,396,305 lekë ku në vlerë totale në shumën 11,921,046 nga ku në vlerën 7,868,459 shërbim të sigurisë dhe ruajtjes dhe ne vlerën 1,940,717 shpenzime për elektricitet.

Si dhe figuron në ulje te vlerës së shpenzimit për llogaritë:

Llog.6024 òShpenzime udhëtimitò ka një rënie në vlerën 5,463,277 lekë.

Llog.6027 òShpenzime për detyrime dhe kompensime legaleò ka një rënie në vlerën 4,090,170 lekë në të cilën përfaqëson shpenzimet gjyqësore.

Kateg. V- TRANSFERIME KORENTE në vlerën 152,769,042 lekë ose 7 % me shumë së një vit i mëparshëm, ku pjesën më të madhe e zë .

Llog.604- òTransferime korente te brendshmeo në vlerën 128,467,246 lekë e cila përbëhet nga transferime korente tek organizatat jo fitimprurëse.

Llog.605 -"Transferime korente me jashtë" në vlerën 23,198,037 lekë e cila përbëhet për organizata ndërkombëtare.

Llog.606 -òTransferita për buxhete familjare e individëtò në vlerën 1,103,759 lekë të tij e cila përbëhet nga transferita të paguara nga ISSH dhe ISKSH

Llog.63 "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit" në vlerën -5,598,512 lekë, përfaqëson ndryshimin e gjendjes së inventarit në magazinën e materialeve dhe objekteve të inventarit të imët në përdorim të punonjësve.

Llog.686 "Shuma të Parashikuara për Aktivet Financiare" në vlerën 0 lekë përputhet me **Llog.711** e Kat.III TË ARDHURA JO TATIMORE.

Nga auditimi rezultoi se formatet e miratuara nga Ministria e Financave janë zbatuar.

Ndryshimi i gjendjes së inventarit në Grupimin B është i barabartë me diferencën e Klasës 3 në Aktiv të Bilancit.

Nga grupi i auditimit u bë rakordimi i shpenzimeve të Pasqyrës së Performancës Financiare me thesarin ku konstatohet se:

-Vlerat e paraqitura në pasqyrën financiare me vlerat e paraqitura në Akt rakordimin me Degën e Thesarit Tiranë òMallra dhe shërbime te tjera, sipas bilancit në vlerën 53,520,121 lekë, ndërsa Akt rakordimit me Degën e Thesarit vlera është 47,446,280 lekë. **Llogaria 602** e këtij formati përbehet nga shuma 47,446,280 leke, e cila paraqet shpenzimet operative me fondet buxhetore, shuma 457,345 leke, qe paraqet shpenzimet operative nga sponsorizimet (artikulli 06), shuma 6,209,854 leke, qe paraqet shpenzimet operative nga fondet IPA, te cilat kane llogarinë ne bankën e nivelit te dyte (Projekti 3C dhe Projekti MONET) si dhe shuma 265,040 leke qe është paradhënie për dieta e marre ne vitin 2019 dhe është kthyer ne vitin 2020 e cila rendon shpenzimet operative te vitit 2020 (Ne vitin 2019 është paraqitur ne bilancin e këtij viti ne llog 423). Shuma 858,398 leke paraqet tatimin ne burim te muajit dhjetor 2019 dhe është derdhur ne muajin janar 2020. Kjo shume është e paraqitur ne llog 602 te evidencës, por nuk është ne llog. 602 te bilancit pasi është pasqyruar si shpenzim ne bilancin e vitit 2019.

-òPaga, shpërblime e të tjera personeliò sipas bilancit paraqiten në vlerën 78,927,490 lekë, ndërsa sipas akt rakordimit me degën e thesarit vlera e tyre është 78,582,199 lekë, ku diferenca prej 345,291 lekë vjen si rezultat diferencës së pagës dhjetor 2020 me atë të janar 2021.

Në thesar në muajin janar të vitit 2021 kanë kaluar pagat e dhjetor 2020, ndërsa në pasqyrë vlera e Paga, përfitime të punonjësve është totali për periudhën Janar-Dhjetor 2020, ku vlera e pagave Dhjetor 2020 kalon në thesar në janar të 2021. I njëjti fenomen ndodh dhe me Llog. 601 òKontrib.te sig.shoq.e shëndetësoreò ku kemi një diference ne vlerën 60,860 lekë.

Pasqyra krahasuese si më poshtë:

Në lekë

Nr. Llog	Shpenzimet e ushtrimit 2020	Pasqyrat financiare	Rakordimi me thesarin	Diferenca
60	I. Shpenzime Korrente	292,347,724	264,028,581	28,319,143
600	Paga përfitime të punonjësve	78,927,490	78,582,199	345,291
601	Kontrib.te sig.shoq.e shëndet.	12,729,582	12,668,722	60,860
602	Mallra dhe shërbime te tjera	53,520,121	47,446,280	6,073,841
604	Transferime korente te brendshme	128,467,246	117,649,915	10,817,331
605	Transferita korente me jashtë	23,198,037	6,577,706	16,620,331
606	Transferita paguar nga ISSH dhe ISKSH	1,103,759	1,103,759	0

Llog.604 e këtij formati përbehet nga shuma 117,649,915 leke, qe paraqet shumen e shpenzimeve per projekte me fondet buxhetore dhe shuma 10,817,331 leke shumen e shpenzimeve për projekte nga sponsorizimet (artikulli 06).

Llog.605 e këtij formati përbehet nga shuma 6,577,706 leke, qe paraqet shumen e shpenzimeve për transferita për pjesëmarrje ne organizatat ndërkombëtare si Creativ Europa, rrjetin TRADUKI etj me

fondet buxhetore dhe shuma 16,620,331 leke shumen e shpenzimeve për transferta për pjesëmarrje ne organizatat ndërkombëtare (Creativ Europa) (artikulli 06).

Në Grupimin A të Ardhurat te Pasqyra Format 2 - Llog. 720 financimi nga buxheti i shtetit për vitin 2020 (*grant*) në shumën 283,183,848 lekë dhe financimi i pritshëm nga buxheti i shtetit i në vlerën 256,205,708 lekë.

Të ardhurat tatimore e jo tatimore janë pasqyruar në Formatin 2 në vlerën 0 lekë

Në lekë

Nr.llog	Përshkrimi i operacioneve	Viti 2020	Viti 2019
72	IV. Grante Korrente (a+b)	345,388,292	275,969,017
720	a) Grant I brendshëm	283,183,848	275,969,017
7200	Nga buxheti për NJQP (Qendrore)	256,205,708	248,448,022
7206	Financimi I pritshëm nga buxheti	8,229,022	8,681,270
7207	Sponsorizime te brendshme (nga te tret)	18,749,118	18,839,725
721	b) Grante korrent I huaj	62,204,444	0
	Nga qeveri te huaj IPA	13,873,859	0
	Nga organizata ndërkombëtare	48,330,000	0

Burimi: MK

-Në Pasqyrën Formatin 2 “Grante Korente”, përfaqësojnë të ardhura sekondare, të ardhura nga organizata ndërkombëtare, korigjim nga sponsorizimet, të ardhur nga qiratë dhe ndërtesa etj, të cilat të detajuara si dhe të rakorduara me thesarin janë si më poshtë vijon.

Në lekë

Kodi I llogarisë ekonomike	Përshkrimi I të ardhurave 2020	Shuma e arkëtuar	Pjese e Institucionit	Derdhur në Buxhet
7111099	Të tjera të ardhura sekondare	570,000	-	570,000
7115499	Arkëtime gjoba	50,000	-	50,000
7211100	Grante nga organizata ndërkombëtare	48,330,585	48,330,585	-
7207010	Sponsorizime për mirëmbajtje	2,813,578	2,813,578	-
7109600	Të ardhura nga qiraja dhe ndërtesa	1,284,884	-	1,284,884
7207011	Të ardhura nga sponsorizimet	7,200,000	7,200,000	-
7113010	Të ardhura	1,500	-	1,500
	TOTALI	60,250,547	58,344,163	1,960,384

Burimi: MK

- Shuma **1,960,384** leke janë te ardhura te realizuara nga aktiviteti i institucionit si tarife e te drejtës se autorit në vlerën 570,000 lekë, nga arkëtimi I vlerës 50,000 lekë prej përmbaruesit per ZZHDA, ne vlerën 1,284,884 lekë arkëtuar prej qiradhënies e cila vjen prej dhënies me qera te ish-godinës se Lidhjes së Shkrimtareve, në përdorim të Vetingut, si dhe vlera 1,500 lekë, vlerë ë cila është akëtuar për llogaritë MK, por financa nuk ka dijeni se për çfarë pagese behet fjale. Te gjitha këto të ardhura janë arkëtuar në buxhetin e shtetit.

Shuma në 58,344,163 lekë të cilat vijimësi të ardhura nga sponsorizimet për mirëmbajtje të cilat bëhen nga vetingu për godinën e marrë me qera si dhe grantet ndërkombëtare.

c. Vlerësimi nëse aktivi dhe pasivi janë llogaritur saktë dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse si edhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare.

Bilanci kontabël i vitit 2020 për MK është përpiluar nga Sektori i Financës dhe miratuar nga Drejtori i Drejtorisë së Financës. Kopje e gjithë pasqyrave financiare është dërguar në Degën e Thesarit Tiranë me shkresën nr. 1605, datë 29.03.2021. Nga Dega e Thesarit Tiranë është bërë edhe vulosja e bilancit dhe formateve të pasqyrave financiare; Pasqyrimi kontabël i MK për vitin 2020 është i përbërë nga pasqyrat financiare sipas formateve të miratuara nga Ministria e Financave si dhe është respektuar afati i dorëzimit të tij në thesar.

Përmbledhja e llogarive vjetore për vitin 2020 dhe krahasimi me periudhat e mëparshme.

Aktivi - Pasqyra e Pozicionit Financiar për vitin 2020

Në lekë

Llog	E M E R T I M I	Viti 2020	Viti 2019
A	A K T I V E T	3,898,011,659	3,284,844,278
	I. Aktivët Afat shkurtër	250,151,182	201,474,099
	1.Mjete monetare dhe ekuivalent të tyre	146,365,916	102,570,057
531	Mjete monetare në Arke		
512,56	Mjete monetare në Banke	7,664,005	
520	Disponibilitete në Thesar	138,701,911	102,570,057
	2.Gjendje Inventari qarkullues	30,749,504	25,150,992
31	Materiale	20,642,836	15,350,324
32	Inventar i imët	10,106,668	9,800,668
	3.Llogari të Arkëtueshme	41,361,151	41,220,042
411	Klientë e llogari të ngjashme		
423,429	Personeli, paradhënie, deficite, gjoha	9,979,281	10,244,322
468	Debitorë të ndryshëm	23,152,848	23,152,848
4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	8,229,022	7,822,872
	4.Te tjera aktive afatshkurtra	31,674,611	32,533,008
486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	31,674,611	32,533,008
	II. Aktivët Afat gjatë	3,647,860,477	3,083,370,179
20	1.Aktive Afatgjatë jo materiale	75,363,331	77,995,581
202	Studime dhe kërkime	75,363,331	77,995,581
21	2.Aktive Afatgjatë materiale	1,529,398,214	1,169,207,289
210	Toka, Troje, Terrene	261,298,634	261,298,634
212	Ndërtesa e Konstruksione	832,370,619	843,019,011
214	Instalime teknike, makineri e pajisje	11,383,746	14,229,683
215	Mjete Transporti	7,165,270	8,637,547
218	Inventar ekonomik	417,179,945	42,022,414
25-26	3.Aktive Afatgjatë Financiare	0	0
	4.Investime	2,043,098,932	1,836,167,309
230	Për Aktive Afatgjatë jo materiale	5,739,444	
231	Për Aktive Afatgjatë materiale	2,037,359,488	1,836,167,309

Burimi: MK

Grupimi A – AKTIVET, përfaqëson shumën: *Aktivët Afatshkurtra* (Mjete monetare dhe ekuivalent të tyre, Gjendje Inventari qarkullues, Llogari të Arkëtueshme dhe Të tjera aktive afatshkurtra) me *Aktivët Afatgjatë* (Aktive Afatgjatë jo materiale, Aktive Afatgjatë materiale, Aktive Afatgjatë Financiare dhe Investime).

Nga të dhënat përmbledhëse të *Aktivitetit për vitin ushtrimor 2020*, rezulton se totali i Aktivitetit më 31.12.2020 ka vlerën **3,898,011,659 lekë** dhe se në krahasim me vitin 2019 është **613,167,381 lekë** më shumë;

“Aktivët Afatgjatë”(AAGJMM, AAGJM dhe AAGJF) në vlerën 3,647,680,477 lekë zënë 93.5% të vlerës totale të aktivitetit;

Aktivët Afatshkurtra zënë 6.5 % të vlerës totale në vlerën 250,151,182 lekë .

Aktivët Afatgjatë në krahasim me vitin 2019, janë rritur në vlerën 564,490,298 lekë, ndërsa Aktivët Afatshkurtra janë rritur në vlerën 48,677,083 lekë.

Auditimi i Aktiveve Afatgjatë:

a. Objektivat e auditimit të aktiveve të qëndrueshme, janë që të sigurohemi se:

- *Aktivët ekzistojnë fizikisht; ato i përkasin subjektit;*

- *janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte;*

- është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve korrente dhe aktiveve të qëndrueshme;

- informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe e korrekte.

b. Kontrollë të përgjithshme të llogarive dhe dokumenteve:

Për auditimin e aktiveve të qëndrueshme, paraprakisht u kryen një numër kontrollesh të përgjithshme si:

- U verifikua tabela e lëvizjeve të aktiveve të qëndrueshme në raport me gjendjet dhe ndryshimin e tyre gjatë periudhës ushtrimore;

- U ekzaminua tabela e lëvizjeve, nëse ka ndodhura ndonjë variacion anormal mbi aktivet e qëndrueshme;

- U ekzaminuan të gjitha shpjegimet që janë paraqitur lidhur me shmangiet dhe përjashtimet e veçanta;

- U verifikua nëse parimet kontabël të ndjekura prej subjektit për vlerësimin dhe kontabilizimin janë konformë parimeve të përgjithshme të pranuar dhe udhëzimeve përkatëse.

- U verifikua nëse shifrat e çeljes rakordojnë me ato të mbylljes së ushtrimit të mëparshëm;

- U krahasuan investimet e realizuara gjatë ushtrimit me ato të planifikuara në buxhet, evidentimi kontabël.

- U verifikua rregullshmëria e procedurës së kalimeve kapitale të AAGJM.

c. Disa nga parimet e zbatuara për auditimin e Aktiveve Afatgjata:

1. Gjatë hyrjes së aktiveve në pronësinë e subjektit, duhet të sigurohemi se:

- Aktivet e blera kontabilizohen sipas vlerës së tyre të marrjes. (çmimit të blerjes shtuar shpenzimet e tjera të nevojshme për vënien në gjendje përdorimi të pasurisë);

- Aktivet e prodhuara nga subjekti (Nëse ka) kontabilizohet sipas kostos së tyre të prodhimit.

- Aktivet e marra falas kontabilizohet duke i vlerësuar ato me vlerën e shitjes;

- Aktivet e sjella në subjekt nga të tretët nëse kontabilizohet me vlerën e tyre të sjelljes. (UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 *“Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”*, i ndryshuar).

Në mënyrë analitike llogaritë financiare të aktivitetit të pasqyrës financiare paraqiten si më poshtë vijon:

1. Aktivet Afatgjata

- **Llog.202 “Studime dhe kërkime”** paraqitet në vlerën 75,363,331 lekë nga ku në krahasim me vitin 2019 kemi një zbritje në vlerën 2,632,250 lekë, e cila është e përberë nga amortizimi vjetor.

- **Llog.210 “Toka, Troje, Terrene”** paraqitet në vlerën 261,298,634 lekë pa ndryshuar nga viti i mëparshëm (viti 2019). Për vitin 2020 referuar VKM nr.665, datë 27.08.2020, kanë kaluar në administrim të MK, një sipërfaqe prej 2.488 m² trualli dhe 4 (nr.10, nr.11, nr.17, nr.18) objekteve ÷Grup Depo Ish-reparti ushtarak nr.5001ö, me vendodhje në BRAR. Me akt dorëzimin, miratuar nga përfaqësuesit e Repartit ushtarak si dhe nga grupi i punës së MK, janë marrë në dorëzim objektet nga ku është përshkruar për secilin nga objektet viti i ndërtimit, vlera fillestare, vlera e mbetur në kontabilitet, sipërfaqja sipas planit të rievimit etj. ***Nga auditimi u konstatua se kjo vlerë nuk është pasqyruar në kontabilitet duke mos paraqitur kështu një vlerë realë të këtij zëri. Sipërfaqja totale e tokës që ka MK në dispozicion nuk është vlerësuar dhe nuk është pasqyruar në kontabilitet.***

- **Llog.212 “Ndërtime e konstruksione”**, paraqitet në fund të vitit 2020 në vlerën prej 832,370,619 lekë, ku është zbritur vlera prej 10,648,392 lekë nga viti i mëparshëm, vlerë e cila ka të bëjë amortizimin vjetor të ndërtesës. Sipas regjistrimit është bërë shtesë e krijuar pa pagës në vlerën 8,183,950 lekë e cila ka të bëjë me rikonstruksionin nga repartit i filmit për godinën e cila është në administrim të MK si dhe rikonstruksion i godinës në MK. ***Referuar VKM së sipërpërmendur, 4 godinat të cilat kanë kaluar në administrim të MK, nuk janë regjistruar si vlerë ndërtesë edhe pse janë marrë në dorëzim nga MK.***

- **Llog.214** ÷Instalime Teknike makineri, pajisjeö, paraqitet në fund të vitit 2020 në vlerën 11,383,746 lekë e cila ka një rënie në vlerën 2,845,937 lekë e cila përbën amortizimin vjetor për vitin 2020.

- **Llog.215** ÷Mjete Transportiö, paraqitet në fund të vitit 2020 në vlerën 7,165,270 lekë, nga ku

diferenca prej 1,472,277 lekë ka te bëjë me amortizimi vjetor për vitin 2020, nga ku nuk ka pasur shtesa apo nxjerrje jashtë përdorimit.

- **Llog.218 “Inventar ekonomikö**, paraqitet në vlerën prej 417,179,945 lekë dhe ku për vitin 2020 është shtuar vlera 381,270,491 lekë si rezultat marrjes në dorëzim të materialeve të TOB si dhe shtesa të krijuara por pa pagës jashtë sistemit në vlerën 357,264 lekë si dhe brenda sistemit në vlerën 2,801,959 lekë si dhe pakësime në vlerën 7,251,613 transferime kapitale të bëra në institucionet e varësisë.

-**Llog.230 “Për aktive afatgjatë jo materiale”** paraqitet në aktiv në vlerën 5,739,444 lekë me vlerë e cila vjen si rezultat i dy investimeve të cilat janë ende në proces, të papërfunduara.

-**Llog.231 “Për aktive afatgjatë materiale”** në fund të vitit ushtrimor 2020 konstatohet të jetë në vlerën 2,037,359,488 lekë dhe përbën 60% të totalit të aktiveve afatgjata. Kjo llogari përfaqëson aktive të qëndrueshme ende në proces dhe që nuk janë në funksionim dhe nuk janë kapitalizuar deri në fund të vitit 2020. Nga krahasimi i dy viteve financiare 2019 dhe 2020 konstatohet se ky zë ka pësuar një rritje në shumën 201,192,179 lekë, si rezultat i realizimit të investimeve por ende të përfunduara për vitin 2020 në vlerën 582,078,447 lekë siç janë ndriçimi i kalave, rikonstruksion i Bibliotekës kombëtare, TVSH parku i artit etj si dhe është bërë dalje në vlerën 380,883,268 lekë marrja në dorëzim e pajisjeve të TOB.

2. Aktivitet Afatshkurtra

- **Llog.520 “Disponibilitete në Thesar”** janë pasqyruar të ardhurat në shumën 138,701,911 lekë e cila përbehet nga llog 466 në vlerën 93,942,174 lekë dhe kapitulli 60/602 në vlerën 44,759,737 lekë. Pra totali i llog 520 është i përbërë nga 5% e garancisë se projekteve në vlerën 93,942,174 lekë, si dhe nga vlera 44,759,737 lekë e cila përbehet nga sponsorizimet e ndryshme.

-**Llog.512 “Mjete monetare në Bankë”** në vlerën 7,664,005 lekë e cila përfaqëson vlerën e derdhur nga aktivitetet e krijuara si Projekti òMonetö në vlerën 43,173 lekë, Projekti ò3Cö në vlerën 7,326,895 lekë, projekti òAdrifortö në vlerën 287,415 lekë si dhe projekti òAdrifortö në vlerën 6,521 lekë.

- **Llog.423 “Personeli, paradhënie, deficite gjabaö** ë vlerën 9,979,281 lekë, përbehet nga paradhënie në euro dhe \$ punonjësve, të pambyllura ende edhe në 2020, që mbarten në 2021. Këto pasqyrojnë detyrimet e punonjësve përgjatë viteve 2003-2013 për paradhëniet në valutë dhe ende të pambyllura.

Llog.468 “Debitorë të ndryshëmö në vlerën 23,152,848 lekë përfaqëson detyrime të subjekteve private dhe ish punonjësve. Kjo llogari në vitin 2020 ka qëndruar e pandryshuar kundrejt vitit 2019. Kjo llogari ka si kundërparti llogaritë 401-408 “Furnitorë dhe llogari të lidhura me to”, 467 “Kreditorë të ndryshëm”, përkatësisht në vlerat 19,673,654 lekë dhe 12,000,957 lekë.

Llogaria.4342 “Të tjera operacione me shtetit debitorö paraqitet në vlerën 8,229,022 lekë dhe përfaqëson detyrimet që ka MK ndaj punonjësve për muajin dhjetor 2020, përkatësisht për pagat në vlerën 5,502,386 lekë, për tatim taksa në vlerën 592,778 lekë, për sigurime shoqërore në vlerën 1,892,804 lekë dhe sigurime shëndetësore në vlerën 241,055 lekë, të cilat paguhet në vitin në vijim. Kjo llogari ka si kundërparti llogaritë e pasivit 421, 431, 435 dhe 436.

Nga Ministria e Kulturës, së bashku me njësitë e varësisë, në bashkëpunim dhe me Ministrinë e Financave të merren masa për të regjistruar dhe siguruar arkëtimin e debitorëve të trashëguar me vite dhe të krijuar rishtazi. Për debitorët pa shpresë arkëtimi të ri verifikojë dhe evidentojë realisht statusin apo mundësinë për arkëtim të detyrimit në favor të buxhetit të shtetit dhe vetëm pas miratimit nga Ministria e Financave për “Debitorët pa shpresë arkëtimi”, të bëjë parashkrimin e tyre dhe sistemimin në kontabilitet.

Grupimi B - PASIVET

Llog	EMERTIMI	VITI 2020	Viti 2019
B	PASIVET(DETYRIMET)	166,977,937	161,625,304
	I.Pasivet Afat shkurtra	166,977,937	161,625,304

	1. Llogari te Pagueshme	166,977,937	161,625,304
401-408	Furnitorë e llogari te lidhura me to	19,673,654	19,673,654
42	Detyrime ndaj personelit	5,502,386	5,234,393
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	592,778	563,375
435	Sigurime Shoqërore	1,892,804	1,795,777
436	Sigurime Shëndetësore	241,055	229,327
466	Kreditore për mjete ne ruajtje	93,942,174	87,872,254
467	Kreditore te ndryshëm	12,000,957	12,859,354
4341	Operacione me shtetin(detyrime	33,132,129	33,397,170
	2.Te tjera pasive afatshkurtra	0	0
	II.Pasivet Afat Gjata	0	0
C	AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)	3,731,033,722	3,123,218,974
D	FONDI I KONSOLIDUAR :	3,731,033,722	3,123,218,974
101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	1,620,660,153	1,263,101,479
12	Rezultatet e mbartura	14,234,069	8,900,331
85	Rezultati I Veprimtarisë Ushtrimore	53,040,568	15,049,855
14		2,043,098,932	1,836,167,309
E	TOTALI I PASIVEVE(B+C)	3,898,011,659	3,284,844,278

Burimi: MK

Nga të dhënat përmbledhëse të Pasivit të Pasqyrës Financiare rezultojnë se totali i pasivit me 31.12.2020, paraqitet me vlerën 3,898,011,656 lekë, ku me C- òAKTIVET NETO/FONDET ò janë në vlerën 3,731,033,722 lekë e njëjtë në vlerë me D- òFONDI I KONSOLIDUAR ò dhe zënë respektivisht 95 % të vlerës totale të pasivit ndërsa B- òDETYRIMET ò janë në vlerën 166,977,937 lekë e njëjtë në vlerë me òPasivet Afatshkurtra ò zënë rreth 5 %.

- **Llog.401“Furnitorë e llogari të lidhura me tëo,** në vlerën 19,673,654 lekë, vlerë e cila i ka gjenezat që nga vitit 2006 deri ne vitin 2018 për mos likuidim te faturave të ndryshme për mosplotësim të dokumentacionit vërtetues apo plotësues.

- **Llog.42 “Detyrime ndaj Personelit“** në vlerën 5,502,386 lekë , përfaqëson pagat e muajit Dhjetor 2019; si dhe tatimi i pagave të muajit Dhjetor 2019 të cilat likuidohen në Janar të vitit 2020 me fondet buxhetore të planifikuara për vitin 2020.

- **Llog.435 & 436 “Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore ò** përfaqëson kontributet e sigurimit shoqëror në shumën 1,892,804 lekë dhe sigurimit shëndetësor në shumën 241,055 lekë të muajit Dhjetor 2019,të cilat likuidohen në muajin Janar 2020 me fondet buxhetore të planifikuara për vitin 2020.

- **Llog.466 “Kreditore për mjete në ruajtje”** është në vlerën 93,642,174 lekë.

Kjo llogari mbart në vetvete ngurtësimin 5% si garancinë bankare për investimet e kryera nga firmat ndërtuese për ikonstruksionet nga ku të cilat likuidohen pas mbarimit të garancisë së punimeve.

- **Llog.4341 “Te tjera operacione me shtetin (kreditor) ò** në shumën prej 33,132,129 lekë. Kjo llogari ka si kundërparti llog.423 & llog.429.

	Llog.	Vlera / leke
Llogaria 4341 Operacione me shtetin (detyrime)		0
Kundra parti		
Llogaria 423 ,429 personel paradhënie deficite gjoba	423/429	9,979,281
Debitorë të ndryshëm	468	23,152,848
	Total	33,132,129

-**Llog.467 “Kreditore të ndryshëm”** në shumën prej 12,000,957 lekë, janë kreditorë të cilat i kane

fillesat qe prej vitit 2006-2012, nga te cilat nuk janë kryhet pagesat për shkak të mosparaqitjes së saktë të faturave të dorëzuara.

Rakordimet e Pasqyrave Financiare:

Auditimi u bë me zgjedhje për këto llogari, formate e pasqyra financiare:

- Auditimi për **barazimin e vlerës totale** të Pasivit me Aktivin:

-Totali i aktiveve **A** është i barabartë me totalin e pasiveve **E(B+C)** të bilancit kontabël (*Format1*), në shumën 3,989,011,659 lekë.

Në pasiv të bilancit janë paraqitur me **C** *“Aktivet Neto/Fonde”* të institucionit që arrijnë në vlerën **3,731,033,722** lekë, e cila konfirmohet si diferencë ndërmjet vlerës së **Aktivitet të bilancit A** ó 3,898,011,659lekë dhe grupeve **B** *“Detyrimeve”* ó 166,977,937 lekë.

- Tek Pasqyra e Performancës Financiare (*Format 2*) Vlera e Grupimit Aó Të Ardhurat" është i barabartë me totalin Vlera e Grupimit B óShpenzimetó dhe vlera e Llog.85 (53,040,568 lekë).

- **Llog.85** óRezultati i veprimtarisë së Vitit Ushtimor" në *Formatin 2* është në vlerën 53,040,568 lekë e njëjtë në vlerë me **Llog.85** óRezultati i Veprimtarisë Ushtimoreó në Grupimin D te Pasqyra e Pozicionit Financiar (*Format1*).

- **Llog. 63** óNdryshim i gjendjeve të inventarit", evidentuar në Pasqyrën *Format 2* për 5,598,512 lekë në fund të vitit 2020, rakordon me ndryshimin e gjendjes së magazinës dhe është sa diferenca e klasës 3 óGjendja e Inventarit Qarkulluesó në aktivin e bilancit. *Pra*, janë të barabarta që të dyja me vlerën prej 5,598,512 lekë.

- Pasqyra e Flukseve Monetare Format 3.

Nga auditimi rezulton se óAkordimi i Fondeve Buxhetore për Shpenzime korrenteó,Vlerat në lekë e Arkëtimeve është e njëjtë me vlerat respektive të llogarive në Pasqyrën *Format 1* për vitin 2020 në vlerën 292,090,398 lekë; óAkordim Fonde Buxhetore për shpenzime Kapitaleó për vitin 2020 është në vlerën 767,483,262 lekë.

óTransferime në Buxhet të Fondeve të pa përdoruraó në vlerën prej 204,503,389 lekë;

Rezulton me Rritje të vlerës monetare në shumën 43,795,859 lekë;

Teprica në fillim të vitit 2020 është e njëjtë në vlerë me atë të mbylljes së vitit 2019 në shumën prej 102,570,057 lekë;

Teprica e Likuiditeteve të vitit 2020 është 146,365,916 lekë e njëjtë në vlerë me Llog.520 óDisponibilitete në Thesaró + Llog.512,56 óMjete monetare në bankëó te Pasqyra *Format 1*.

- Pasqyra e Ndryshimeve të Aktiveve Neto Format 4.

Totali i Fondeve sipas Pasqyrës *Format 4* është i barabartë me totalin e Fondeve në Pasqyrën *Format 1*.

- Pasqyra e Investimeve dhe Burimet e Financimit Format 6.

Nga Grupi i Auditimit u bënë verifikimet:

Llog.105 e F6 është e barabartë me Llog.105 në F1;

Llog.106 e F6 është e barabartë me Llog.106 në F1;

Llog.111 e F6 është e barabartë me Llog.111 në F1;

Llog.115 e F6 është e barabartë me Llog.115 në F1;

Llog.12 e F6 është e barabartë me Llog.12 në F1;

Llog.16+17 e F6 është e barabartë me Llog.16+17 në F1;

Llog.230 & Llog.231 e F6 janë të barabarta me Llog.230 & Llog.231 në F1;

Llog.25/26 e F6 është e barabartë me Llog.25/26 në F1.

- Pasqyra Pyetësor dhe Shënime Shpjeguese Format 5.

Kjo pasqyrë është plotësuar pjesërisht duke mos e përmbushur qëllimin e saj. Plotësimi i të gjitha posteve të kësaj pasqyre do të sillte një lehtësi në verifikimin e çdo llogarie dhe dhënien e opinionit mbi saktësinë, plotësinë dhe qartësinë e pasqyrave financiare.

Shënim: Referuar programit të auditimit mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë në MK, përsa i përket auditimit mbi pasqyrat financiare për vitin 2021, grupi i auditimit nuk u shpreh si rezultat i mbylljes së pasqyrave në datën 31.03.2022, datë e cila e tejkalonte afatin e auditimi

(periudha në terren).

Titulli i Gjetjes 1	Mos kontabilizim I tokës si dhe ndërtesës te cilat janë në administrim nga MK
Situata:	<p>Llog.210 òToka Troje, Terenò paraqitet ne vlerën 261,298,634 lekë pa ndryshuar nga viti i mëparshëm (viti 2019). Për vitin 2020 referuar VKM nr.665, datë 27.08.2020, kanë kaluar në administrim të MK, një sipërfaqe prej 2.488 m2 trualli dhe 4 (nr.10, nr.11, nr.17, nr.18) objekteve òGrup Depo Ish-reparti ushtarak nr.5001ò, me vendodhje në BRAR. Me akt dorëzimin, miratuar nga përfaqësuesit e Repartit ushtarak si dhe nga grupi i punës se MK, janë marrë në dorëzim objektet nga ku është përshkruar për secilin nga objektet viti i ndërtimit, vlera fillestare, vlera e mbetur në kontabilitet, sipërfaqja sipas planit të rivelimin etj. <i>Nga auditimi u konstatua se kjo vlerë nuk është pasqyruar në kontabilitet duke mos paraqitur kështu një vlerë realë te këtij zëri. Sipërfaqja totale e tokës që ka MK në dispozicion nuk është vlerësuar dhe nuk është pasqyruar në kontabilitet.</i></p> <p>Llog.212 “Ndërtime e konstruksione”, paraqitet në fund të vitit 2020 në vlerën prej 832,370,619 lekë, ku është zbritur vlera prej 10,648,392 lekë nga vitit i mëparshëm, vlerë e cila ka të bëjë amortizimin vjetor të ndërtesës. Sipas regjistrit është bërë shtesë e krijuar pa pagës në vlerën 8,183,950 lekë e cila ka të bëjë më rikonstruksionin nga reparti i filmit për godinën e cila është në administrim te MK si dhe rikonstruksion i godinës në MK. <i>Referuar VKM së sipërpërmendur, 4 godinat të cilat kanë kaluar në administrim të MK, nuk janë regjistruar si vlerë ndërtese edhe pse janë marrë në dorëzim nga MK.</i></p>
Kriteri :	Ligji nr. 9228 datë 29.04.2004 òPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò i ndryshuar. Udhëzimi nr. 8 datë 09.03.2018 òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò.
Ndikimi/Efekti	Pasqyrat financiare nuk sigurojnë të dhëna të plota dhe nuk paraqesin, të dhënat e nevojshme për vendimmarrje lidhur me këtë zë, në regjistrat kontabël.
Shkaku:	Mungesë veprimesh nga strukturat përgjegjëse.
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandimi:	Drejtoria e Buxhetimit dhe Menaxhimit Financiar (Sektori i Financës) të marri masa për të kontabilizuar dhe paraqitur në pasqyrat financiare vlerën e drejtë të Aktiveve Afatgjata Materiale, menjëherë pas përfundimit të procesit të vlerësimit nga grupi i punës. Të ngrihet një grup pune për të pasqyruar dinamikën dhe lëvizjet e aktiveve afatgjata materiale, të ndërtojë gjurmën e auditimit të këtyre pasurive, duke saktësuar dhe administruar dokumentacionin e nevojshëm, dhe mbi këtë bazë të ndërmerren veprimet e nevojshme ligjore dhe të aplikohet për regjistrimin e pasurisë së paluajtshme të institucionit.

Titulli i Gjetjes 2	Mosdhënia e informacionit të plotë në pyetësorin me shënime shpjeguese për vitet 2019 - 2020 (Formati 5)
Situata:	Nga auditimi rezultoi se, pyetësori dhe shënimet shpjeguese për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore (formati nr.5), për njësitë e qeverisjes së përgjithshme, është i miratuar nga MFE dhe përbëhet nga 19 pika. Në informacionin shpjegues për pasqyrat financiare për vitin 2020, evidentohen mangësi në plotësimin e tyre si në vendosjen e përgjigjeve respektive òpoò ose òjoò, gjithashtu nuk është kryer asnjë zbrëthimin me analizë të llogarive përkatëse.
Kriteri :	Ligji nr. 9228 datë 29.04.2004 òPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò i ndryshuar. Udhëzimi nr. 8 datë 09.03.2018 òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò.
Ndikimi/Efekti	Mosrespektimi i standardeve kontabël.
Shkaku:	Mungesë veprimesh nga strukturat përgjegjëse.
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandimi:	Nga Sektori i Financës të merren masat që në vijimësi, pyetësori dhe shënimet shpjeguese për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore (formati nr.5), të përgatiten dhe paraqiten në përputhje me standardet kontabël kombëtare dhe ky seksion të plotësohet me të dhëna të sakta për elementë të ndryshme të raportimit financiar të njësisë.

2.5. PROKURIMET E FONDEVE PUBLIKE

-Nga auditimi u konstatua se për vitin 2020 në Ministrinë e Kulturës janë realizuar 80 procedura prokurimi, me vlerë totale 255,423,338 lekë me TVSH dhe 10 procedura konkurrimi publik në

zbatim të VKM-së 425, datë 27.05.2020 e ndryshuar me fond limit 149,494,167 lekë pa tvsh dhe vlerë kontrate në total 134,483,433 lekë pa tvsh. Në total fondi 389,906,771 lekë pa tvsh.

Ndër të cilat :

- Procedure e Hapur -Vlera e Kontratave pa TVSH- 15,828,383 leke- 1 procedurë;
- Kërkesë për propozim- Vlera e Kontratave pa TVSH- 1,556,449 leke- 1 procedurë;
- Marrëveshje Kuadër (ABP)- Vlera e Kontratave pa TVSH ó 1,500,000 leke-1 procedurë;
- Negocim pa shpallje paraprake- Vlera e Kontratave pa TVSH- 1,370,597 leke- 6 procedura;
- Prokurim me vlerë të vogël- Vlera e Kontratave pa TVSH ó 8,551,167 leke- 19 procedura;
- Blerje nën 100.000 leke- Vlera e Kontratave pa TVSH ó1,305,209 leke- 21 procedura;
- Procedure me emergjencë - Vlera e Kontratave pa TVSH- 289,717 leke- 5 procedura;
- Shërbimi Rojeve (Sipas Udhëzimit të Përbashkët të Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 407/1, datë 14.06.2019)- Vlera e Kontratave pa TVSH- 6,566,009 leke pa TVSH- 1 procedure;

Procedurat për tu audituar janë përzgjedhur në bazë të vlerave më të larta të zhvilluara.

-Janë audituar 8 procedura konkurrimi me vlerë kontrate 95,660,396 lekë pa tvsh.

-Janë audituar 10 procedura me vlerë të vogël me fond limit 4,751,074 lekë pa tvsh dhe vlerë kontrate 3,888,171 lekë pa tvsh.

Një procedurë e hapur òRehabilitimi I Teatrit Kombëtar I Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor 20% òme vlerë kontrate 165,083,333 lekë pa tvsh, është audituar nga grupi I mëparshëm I KLSH me vendimin nr.68, datë 23.06.2020.

Në total janë audituar 68% e vlerës së procedurave të realizuara në Ministrinë e Kulturës.

-Për vitin 2021 në Ministrinë e Kulturës janë realizuar 58 procedura prokurimi, me vlerë totale fondi limit 122,375,214 lekë pa tvsh dhe 5 procedura konkurrimi publik në zbatim të VKM-së 425, datë 27.05.2020 e ndryshuar me fond limit 1,641,322,089 lekë me tvsh. Në total fondi 1,763,697,303 lekë pa tvsh.

Ndër të cilat :

- Procedurë e Hapur e Thjeshtuar -Vlera e Kontratave pa TVSH- 5,453,700 leke- 2 procedura
- Kërkesë për propozim- Vlera e Kontratave pa TVSH- 2,988,000 leke- 1 procedurë
- Marrëveshje Kuadër (ABP)- Vlera e Kontratave pa TVSH - 1,163,993 leke- 1 procedurë
- Procedure e hapur- Vlera e Kontratave pa TVSH - 34,020,265 leke- 1 procedurë
- Prokurim me vlerë të vogël- Vlera e Kontratave pa TVSH - 8,519,422 leke- 20 procedura
- Shërbim konsulence - Vlera e Kontratave pa TVSH - 62,795,285 leke- 5 procedura
- Sistemi dinamik i blerjeve (biletat)- Vlera e Kontratave pa TVSH -1,855,634 leke- 8 procedura
- Blerje nën 100.000 leke- Vlera e Kontratave pa TVSH -1,270,520 leke-16 procedura
- Procedurë me emergjencë - Vlera e Kontratave pa TVSH- 742,572 leke- 4 procedura

Procedurat për tu audituar janë përzgjedhur në bazë të vlerave më të larta të zhvilluara.

-Janë audituar 2 procedura konkurrimi me vlerë 1,232,928,871 lekë pa tvsh.

-Janë audituar 10 procedura me vlerë të vogël me fond limit 5,554,167 lekë pa tvsh dhe vlerë kontrate 4,708,889 lekë pa tvsh.

-Janë audituar 6 procedura të sistemit dinamik të blerjeve me vlerë 1,613,156 lekë pa tvsh.

Në total janë audituar 70% e vlerës së procedurave në Ministrinë e Kulturës.

Me daljen e Vkm-së nr. 425, Datë 27.5.2020 òPër Procedurat E Përzgjedhjes Së Subjekteve Të Pajisura Me Licencë Për Projektim, Zbatim, Mbikëqyrje Dhe Kolaudim Në Pasuritë Kulturore, Për Kryerjen E Investimeve Me Fonde Publike Në Pasuritë Kulturore, të gjitha procedurat që kanë lidhje me investimet me fondet publike në pasuritë kulturore janë zhvilluar me procedurën e konkurrimit .

Në gjykimin tonë si auditues dhe duke parë dhe relacionin shpjegues të Ministrisë së Kulturës lidhur me nxjerrjen e kësaj VKM ka disa problematika si më poshtë vijon:

Duke parë përcaktimin që është bërë në relacion pika III *“Risia e këtij projektvendimi është parashikimi i një procedure më të thjeshtuar, për të qenë më fleksibël në ndërhyrjen tek monumentet e kulturës, duke iu përgjigjur kështu nevojave urgjente që mund të lindin, pasi për monumentet e kulturës, për shkak të karakteristikave dhe specifikeve që ato mbartin, kërkohet të merren veprime dhe të bëhet ndërhyrja sa më e shpejtë në kohë, me qëllim mos rrezikimin e tyre nga dëmtimi apo shkatërrimi. Nëse për objekte të tjera, dëmtimi i tyre është lehtësisht i recuperueshëm, në rastin e monumenteve të kulturës, dëmtimi i tyre mund të mos zhbëhet dot, nëse nuk ndërhyet me shpejtësi, për rregullimin e gjendje.ö*, shohim se natyra e procedurave të kryera në më të shumtat e rasteve nuk kanë të bëjnë me ndërhyrje të shpejtë me qëllim mos rrezikimin e tyre nga shkatërrimi apo dëmtimi pasi disa nga këto projekte lidhen me ndriçimin e jashtëm të kalave gjithashtu afati për vlerësimin e këtyre procedurave është i njëjtë i vendosur me afatin në VKM për Prokurimin Publik I cili është 15 ditë në të dyja rastet, pra nuk mund të themi se në procedurën e konkurrimit I përgjigjen nevojave në mënyrë më të shpejtë.

-Këto lloj procedurash ndryshe nga çfarë është argumentuar në pikën I të relacionit *“Nëpërmjet këtij projektvendimi synohet përmirësimi i procedurës së realizimit të konkurimit publik, duke thjeshtuar procedurat e përzgjedhjes së subjekteve të licencuar për projektim, zbatim, mbikëqyrje, apo kolaudim në pasuritë kulturore. Një procedurë e thjeshtuar, por që garanton konkurrimin, është thelbësore për të siguruar që pasuritë kulturore të mbrohen pa vonesë, kur ekziston një rrezik për dëmtimin e tyre, por duke siguruar njëkohësisht edhe mirë administrimin e fondeve publike, nëpërmjet konkurrencës midis subjekteve të interesuara”*, jo vetëm që nuk e kanë nxitur konkurrimin por e kanë ngushtuar atë, pasi vëmë re se në të gjitha procedurat e konkurrimit në vitin 2020, janë paraqitur 1operator dhe në shumë pak raste dy operatorë. Gjithashtu shohim se një operator ka fituar 5 procedura në të njëjtën periudhë kohore, kjo tregon se është vendosur një monopol ku operojnë shumë pak operatorë ekonomik.

-Konstatohet se në faqen e Ministrisë nuk ka një rubrikë të dedikuar për procedurat e konkurrimit publik. Njoftimet e këtyre procedurave janë të hedhura te seksioni 0Të reja, Njoftimeö ku ndodhen të gjitha njoftimet e Ministrisë përfshirë njoftimet për punë dhe njoftime të ndryshme nga Ministria. Pra për një operator që nuk ka informacion është shumë e vështirë të gjejë shpalljen e këtyre procedurave.

-Konstatohet se në VKM nuk parashikohet mënyra e llogaritjes së fondit limit, hallkë shumë e rëndësishme e procesit, e cila është reflektuar si problematikë në të gjitha procedurat e konkurrimit. Në të gjitha procedurat e zhvilluara hartimi I fondit limit është bërë nga Njësia e Hartimit të Dokumenteve të Konkurrimit.

Titulli i Gjetjes	<i>Mbi VKM nr.425, Datë 27.5.2020 “Për Procedurat E Përzgjedhjes Së Subjekteve Të Pajisura Me Licencë Për Projektim, Zbatim, Mbikëqyrje Dhe Kolaudim Në Pasuritë Kulturore, Për Kryerjen E Investimeve Me Fonde Publike Në Pasuritë Kulturore”</i>
Situata1:	Lidhur me nxjerrjen e kësaj VKM ka disa problematika si më poshtë vijon: -Konstatohet se në faqen e Ministrisë nuk ka një rubrikë të dedikuar për procedurat e konkurrimit publik. Njoftimet e këtyre procedurave janë të hedhura te seksioni 0Të reja, Njoftimeö ku ndodhen të gjitha njoftimet e Ministrisë përfshirë njoftimet për punë dhe njoftime të ndryshme nga Ministria. Pra për një operator që nuk ka informacion është shumë e vështirë të gjejë shpalljen e këtyre procedurave. -Konstatohet se në VKM nuk parashikohet mënyra e llogaritjes së fondit limit, hallkë shumë e rëndësishme e procesit, e cila është reflektuar si problematikë në të gjitha procedurat e konkurrimit. Në të gjitha procedurat e zhvilluara hartimi i fondit limit është bërë nga Njësia e Hartimit të Dokumenteve të Konkurrimit.
Kriteri:	Vkm nr.425, Datë 27.5.2020 öPër Procedurat E Përzgjedhjes Së Subjekteve Të Pajisura Me Licencë Për Projektim, Zbatim, Mbikëqyrje Dhe Kolaudim Në Pasuritë Kulturore, Për Kryerjen E Investimeve Me Fonde Publike Në

	Pasuritë Kulturoreë
Ndikimi/efekti:	-Mospasja e një rubrike të dedikuar për procedurat e konkurrimit për një operator që nuk ka informacion është shumë e vështirë të gjejë shpalljen e këtyre procedurave. - Në të gjitha procedurat e zhvilluara hartimi I fondit limit është bërë nga Njësia e Hartimit të Dokumenteve të Konkurrimit pa u specifikuar në VKM komisionin që duhet ta kryejë llogaritjen e fondit limit dhe mënyrën e llogaritjes.
Shkaku:	Dalja e Vkm-së nr. 425, Datë 27.5.2020 ÷Për Procedurat E Përzgjedhjes Së Subjekteve Të Pajisura Me Licencë Për Projektim, Zbatim, Mbikëqyrje Dhe Kolaudim Në Pasuritë Kulturore, Për Kryerjen E Investimeve Me Fonde Publike Në Pasuritë Kulturoreë.
Rëndësia e shkeljes:	E mesme
Rekomandimi	Nga ana e Ministrisë së Kulturës të ngrihet një grup pune për përmirësimin ligjor të VKM-së me qëllim arritjen e një procesi të konkurrimit publik sa më transparent, rritjen e konkurrencës dhe menaxhimin me efikasitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve publike duke përcaktuar qartë në VKM komisionin dhe mënyrën e llogaritjes së fondit limit. -Në nenin 13 të VKM-së duhet të përcaktohet në mënyrë të saktë rubrika e dedikuar për procedurat e konkurrimit publik, në mënyrë lehtësimin e marrjes së informacionit për të gjithë operatorët ekonomik të interesuar.

I.Procedura e Konkurrimit: “Hartimi i projektit elektrik për ndriçimin e jashtëm të 15 kalave”

-Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike.

Me anë të memos nr.3538/1, datë 26.08.2020, është kërkuar miratimi i fillimit të procedurave të konkurrimit publik për Hartimin e projektit elektrik për ndriçimin e jashtëm të 15 kalave me një fond të alokuar prej 8,894,000 lekë me tvsh dhe për procedurat me objekt Projekti elektrik për ndriçimin e kalave të Shkodrës, Beratit, Gjirokastrës dhe Krujës me një fond total prej 74,000,000 lekë me tvsh.

Është ngritur Urdhri nr.352, datë 23.09.2020, ku përcaktohet lloji i procedurës ÷Procedurë konkurrimi të dhënat për pasuri kulturore, lloji i investimit: projektim dhe punë , fondi limit 6,833,333 lekë pa tvsh, komisioni i konkurrimit publik i përbërë nga A.Xh (NJVO), A.H (NJVO), A.O (NJVO), E.K (NJHDPK), V.G (NJHDPK), T.H (NJHDPK).

Është mbajtur procesverbali për llogaritjen e fondit limit në datën 23.09.2020, pra në të njëjtën datë që është ngritur Urdhri i Zhvillimit të procedurës. *Ky procesverbal është mbajtur nga Njësia e hartimit të dokumenteve të procedurës së konkurrimit publik edhe pse nuk ka asnjë urdher që ky komision do të hartonte llogaritjen e fondit limit.*

Sipas Procesverbalit të mbajtur ky komision ka përcaktuar fondin limit bazuar mbi fishat e projektit në vlerën 6,833,333 lekë pa tvsh, *por konstatohet se nuk ka asnjë nga fishat bashkëlidhur dhe se si ka dalë kjo vlerë.*

Është mbajtur procesverbali me nr.4053/1, datë 24.09.2020 për hartimin e dokumenteve standarte të konkurrimit publik.

-Mbi auditimin e realizimit të procedurës në bazë të DST dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues.

Në datën 16.10.2020 është mbajtur procesverbali për hapjen e procedurës së konkurrimit ku citohet se është paraqitur një operator ekonomik BOE ÷Aö Shpk & ÷C-96ö shpk.

Me shkresën nr.4053/7, datë 19.10.2020, i është dërguar Ftesë për propozim BOE ÷AL.Vö Shpk & ÷C-96ö shpk.

Është mbajtur procesverbali i vlerësimit me nr.4053/10, datë 23.10.2020 ku është vendosur të shpallet fitues BOE ÷Aö Shpk & ÷C-96ö shpk me vlerë oferte 6,833,000 lekë pa tvsh.

-Lidhja e kontratës.

Është lidhur kontrata me nr.4053/14, datë 28.10.2020 midis Ministrisë së Kulturës dhe BOE òAL.Vò Shpk & òC-96ò shpk me vlerë 6,833,000 lekë pa tvsh, dhe afat për realizimin e saj 90 ditë nga data e nënshkrimit.

Sa më sipër, nga auditimi konstatohet se kryerja e kësaj procedure “Projektim” nuk është zhvilluar më tej me kryerjen e procedurave të zbatimit të këtij projekti deri në përfundim të periudhës objekt auditimi, gjithashtu këto procedura nuk janë planifikuar për tu kryer as në vitin 2022. Duke qenë se kanë kaluar dy vite nga hartimi I këtij projekti teknologjitë mund të ndryshojnë gjithashtu dhe çmimet duke përbërë element risku për implementimin e projekt zbatimit.

Në këto kushte vlera e financuar nga Ministria e Kulturës prej 6,833,000 nuk është përdorur me ekonomikitet, efektivitet dhe efijçencë.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi : E.Ç, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, E.K në cilësinë e Njesisë së Hartimit të Dokumenteve të Konkurrimit, V.G, në cilësinë e Njesisë së Hartimit të Dokumenteve të Konkurrimit, T.H, në cilësinë e Njesisë së Hartimit të Dokumenteve të Konkurrimit.

Titulli i Gjetjes:	<i>Mbi Procedurën e Konkurrimit: “Hartimi i projektit elektrik për ndriçimin e jashtëm të 15 kalave”</i>
Situata:	Nga auditimi konstatohet është lidhur kontrata me nr.4053/14, datë 28.10.2020 midis Ministrisë së Kulturës dhe BOE òAL.Vò Shpk & òC-96ò shpk me vlerë 6,833,000 lekë pa tvsh, dhe afat për realizimin e saj 90 ditë nga data e nënshkrimit . Në këto kushte vlera e financuar nga Ministria e Kulturës prej 6,833,000 nuk është përdorur me ekonomikitet, efektivitet dhe efijçencë, pasi konstatuam se kjo procedurë nuk është zhvilluar më tej me kryerjen e procedurave të zbatimit të këtij projekti deri në përfundim të periudhës objekt auditimi, gjithashtu këto procedura nuk janë planifikuar për tu kryer as në vitin 2022.
Kriteri:	Vkm nr.425, Datë 27.5.2020 òPër Procedurat E Përzgjedhjes Së Subjekteve Të Pajisura Me Licencë Për Projektim, Zbatim, Mbikëqyrje Dhe Kolaudim Në Pasuritë Kulturore, Për Kryerjen E Investimeve Me Fonde Publike Në Pasuritë Kulturoreò
Ndikimi/efekti:	Duke qenë se kanë kaluar dy vite nga hartimi I këtij projekti teknologjitë mund të ndryshojnë gjithashtu dhe çmimet duke përbërë element risku për implementimin e projekt zbatimit.
Shkaku:	Mos zhvillimi më tej me kryerjen e procedurave të zbatimit të këtij projekti òNdriçimi i jashtëm i 15 kalaveò deri në përfundim të periudhës objekt auditimi.
Rëndësia e shkeljes:	E lartë
Rekomandimi	Nga ana e Ministrisë së Kulturës të merren masa të menjëhershme për ngritjen e grupit të punës për evidentimin e shkaqeve që kanë sjellë mos zhvillimin e projekt zbatimit të kësaj procedure, duke rrezikuar përdorim jo efektiv të fondeve prej 6,833,000 lekë.

II. Procedura e Konkurrimit: “Realizimin me çelësa në dorë të projektit elektrik për ndriçimin e jashtëm të Kalasë së Shkodrës”

-Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike.

Me anë të memos nr.3538/1, datë 26.08.2020, është kërkuar miratimi i fillimit të procedurave të konkurrimit publik për Hartimin e projektit elektrik për ndriçimin e jashtëm të 15 kalave me një

fond të alokuar prej 8,894,000 lekë me tvsh dhe për procedurat me objekt Projekti elektrik për ndriçimin e kalave të Shkodrës, Beratit, Gjirokastrës dhe Krujës me një fond total prej 74,000,000 lekë me tvsh.

Është ngritur Urdhri nr.349, datë 23.09.2020, ku përcaktohet lloji i procedurës òProcedurë konkurrimiò të dhënat për pasuri kulturore, lloji i investimit: projektim dhe punë, fondi limit 17,500,000 lekë pa tvsh, komisioni i konkurrimit publik i përbërë nga A.Xh (NJVO), K.N (NJVO), A.O (NJVO), E.K (NJHDPK), E.T (NJHDPK), T.H (NJHDPK).

Është mbajtur procesverbali për llogaritjen e fondit limit në datën 23.09.2020, në të njëjtën datë që është ngritur Urdhri i Zhvillimit të procedurës. *Ky procesverbal është mbajtur nga Njësia e hartimit të dokumentave të procedurës së konkurrimit publik edhe pse nuk ka asnjë urdhër që ky komision do të hartonte llogaritjen e fondit limit.*

Sipas Procesverbalit të mbajtur ky komision ka testuar tregun duke marrë tre oferta përkatësisht:

F. Electric me ofertë ekonomike 17,071,027 lekë pa tvsh

Al.Vshpk me vlerë 16,606,382 lekë pa tvsh

H shpk me vlerë 18,872,590 lekë pa tvsh

Fondi limit ka dalë në vlerën 17,500,000 lekë pa tvsh. Nga auditimi konstatohet se tre ofertat e marra në treg nuk përmbajnë datë, pra nuk mund të vërtetohet nëse këto oferta janë reale për kohën e zhvillimit të kësaj procedure.

Gjithashtu nga auditimi konstatohet se në llogaritjen e fondit limit nuk ka asnjë preventiv fillestar apo planimetri të objektit dhe se si kanë dalë këto zëra dhe sasitë e secilës prej tyre.

Është mbajtur procesverbali me nr.4050/1, datë 24.09.2020 për hartimin e dokumenteve standarde të konkurrimit publik.

Në datën 16.10.2020 është mbajtur procesverbali për hapjen e procedurës së konkurrimit ku citohet se është paraqitur një operator ekonomik BOE òRö dhe òAL.Vò Shpk me vlerë 17,422,642 lekë pa tvsh.

Është mbajtur procesverbali i vlerësimit të procedurës ku është shpallur fitues BOE òRö dhe òAL.Vò Shpk me vlerë 17,422,642 lekë pa tvsh.

Është miratuar raporti përmbledhës nga Titullari i Autoritetit Kontraktor me nr.4052/8, datë 26.10.2020.

-Mbi auditimin e realizimit të procedurës në bazë të DST dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues.

Në datën 16.10.2020 është mbajtur procesverbali për hapjen e procedurës së konkurrimit ku citohet se është paraqitur një operator ekonomik BOE òRö dhe òAL.Vò Shpk me vlerë 17,422,642 lekë pa tvsh.

Është mbajtur procesverbali i vlerësimit të procedurës ku është shpallur fitues BOE òRö dhe òAL.Vò Shpk me vlerë 17,422,642 lekë pa tvsh.

Është miratuar raporti përmbledhës nga Titullari i Autoritetit Kontraktor me nr.4052/8, datë 26.10.2020.

Nga auditimi i dokumentacionit të operatorit fitues konstatohet se janë në përputhje me dokumentet standarde të konkurrimit.

-Lidhja e kontratës.

Është lidhur kontrata me nr.4050/10, datë 28.10.2020 midis Ministrisë së Kulturës dhe BOE òRö dhe òAL.Vò Shpk me vlerë kontrate 17,422,642 lekë pa tvsh, dhe afat për realizimin e saj 90 ditë nga data e nënshkrimit.

-Zbatimi i kontratës.

Është nënshkruar aneks Kontrata nr.1 me nr.102/3 Prot. Me datë 29.01.2021 òPër një ndryshim në kontratën nr.4050/10 prot. Datë 28.10.2020 me objekt : òRealizimi me çelsa në dorë të projektit elektrik për ndriçimin e jashtëm të Kalasë së Shkodrësò

Pika 3.2:

Afati për plotësimin dhe dorëzimin e dokumentacionit teknik përfundimtar objekt kontrate, zgjatet deri në përfundimin e procedurës së marrjes në dorëzim të punimeve nga AK nëpërmjet përfaqësuesve të caktuar nga Titullari i tij, por në çdo rast jo më vonë se afati i zbatimit të kontratës

bazë.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me nr 5269/8 prot, datë 11.12.2020, midis Autoritetit Kontraktor Ministria e Kulturës, të përfaqësuar nga sekretari i përgjithshëm znj. E.Ç dhe Operatorit Ekonomik òA&E.Eò sh.p.k. me NIPT K72..... përfaqësuar nga znj. E.Ç. me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1476/11, si dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 309,057 lekë pa tvsh / 370,869 lekë me tvsh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me OE òA.SH.Eò, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 2463/6, si dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 40,800 lekë me tvsh.

Miratimi i lejes

Miratimi i projektit me anë të vendimit nr376 datë 06.11.2020, me nr.1014 prot. Datë 09.11.2020 miratuar nga kryetari i KKTKM znj. E.M. Projekti është hartuar nga òAL.Vò sh.p.k., pjesë e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik, duke qenë se është procedurë me çelsa në dorë.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se dorëzimi i sheshit të ndërtimit dhe fillimi i punimeve, proces verbali i fillimit të punimeve, sipas njoftimeve përkatëse është bërë në datën 18.11.2020. Punimet duhet të përfundonin në datën 22.01.2021 dhe kanë përfunduar me datë 24.12.2020, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve.

Sipas shkresës nr.43/1 prot., datë 23.01.2021, protokolluar në MK me nr. 102/1 Prot., datë 25.01.2021, mbikëqyrësi i punimeve òA&E.Eò sh.p.k. kërkon AK **“Shtyrjen e Afatit të dorëzimit të dosjeve me dokumentacionin teknik përfundimtar (shtyrjen e kontratës), deri në marrjen në dorëzim të materialeve të sistemit ekzistues të demoluara për secilin objekt, nga Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore”**, duke qenë se ky i fundit ka miratuar kërkesën e BOE-së për përdorimin e fondit rezervë.

Për këto pajisje është mbajtur një proces verbal dorëzimi, i mbajtur midis sipërmarrësit të punimeve dhe Mbikëqyrësit të punimeve DRTK Shkodër, Prot.229/1 datë 28.12.2020, dhe protokolluar me nr.75 prot. Shkodër 04.03.2021 nga Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore.

Është bërë kërkesë në datën 16.12.2020 nga sipërmarrësi i punimeve (kontraktori) drejtuar mbikëqyrësit të punimeve, për dijeni Ministrisë së Kulturës, për përdorimin e fondit rezervë me një vlerë prej 829,600 lekë pa t.v.sh., pas të cilës është bërë kërkesë me nr 490/2 prot, datë 16.12.2020 e mbikëqyrësit të punimeve drejtuar AK. Sipas kësaj letre thuhet se në preventivin e kontratës nuk janë parashikuar punime për demontimin e ndriçimit ekzistues, i cili interferon si nga pikëpamja funksionale ashtu dhe nga ana vizuale për peizazhin e kalasë.

- Konstatime të projekt-preventivit dhe legjislacioni i ndërtimit.

Nga verifikimi në objekt konstatohet se janë realizuar punime në objekt të ndryshme nga përcaktimi i tyre në preventiv dhe në situacion, të cilat renditen si më poshtë:

1. Zëri òÇift Projektorësh të montuar në shtyllë, me optikë, ekran anti-verbim, fluksi i daljes min.9000lm dimërueshëmò, ishin vendosur 92 copë projektor dhe jo 92 çift projektorësh.
2. Zëri òKrah për montimin e projektorëve në shtyllëò ishin vendosur nje krah për çdo shtyllë që kishte me më shumë se 1 projektor.
3. Zëri òBllok betoni 1mx1m për instalimin e shtyllaveò nga verifikimi në terren përmasat ishin më të vogla se 1mx1m.
4. Zëri òSensor Muzguò ishte vendosur vetëm 1 copë.
5. Situacioni përfundimtar mungon në dosje.

Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- 1) Dokumentacioni teknik i zbatimit: Projekt preventivi, Libri i masave, ditarët e objektit etj. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Realizimin me çelësa në dorë të projektit elektrik për ndriçimin e jashtëm të kalasë së Shkodrës”
--

14.Lidhja e kontratës nr. 4050/10 prot datë 23.10.2020	15.Vlera e kontratës (me tvsh) 20,907,170 lekë BOE fitues “R” sh.p.k. dhe “AL.V” sh.p.k.,	16.Likuiduar deri dt USH 771 datë 28.12.2020 Deri në vlerën 18,963,358 lekë
17- Situacioni Përfundimtar -Vlera me tvsh 20,907,111 lekë me tvsh (Vlerë e marrë nga Akti i Kolaudimit)	18.Afati i kontratës në dite Parashikuar 90 ditë, Zbatuar 37 ditë. Fillimi punimeve: 18.11.2020 Përfundimi punimeve: 24.12.2020	19. Zgjatja e kontratës Aneks Kontrata nr.1 me nr.102/3 Prot. Me datë 29.01.2021 òPër një ndryshim në kontratën nr.4050/10 prot. Datë 28.10.2020
20. Mbikëqyrësi i punimeve OE òA&E.Eò sh.p.k.	Licenca Nr: MK 1476/11	Kontrata me nr. 5269/8 prot. datë 11.12.2020
21. Kolaudatori i punimeve òA.SH.Eò	Licenca Nr: MK 2463/6	Kontrata
22.Akt Kolaudimi datë 20.04.2021	23.Akt i marrjes në dorëzim	

Nga auditimi i librezave të masave, projektit dhe preventivit bazë, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor.

Tabela nr. 1

Nr	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
							Vol.	Vlera
1	Çift Projektorësh të Montuar në shtyllë, me optikë , ekran anti-verbim,fluksi i daljes MIN.9000lm Dimërueshëm	copë	95,800 88,700	92	92	92 tek projektorësh	92	653,200
13	Krah për montimin e projektoreve në shtyllë	copë	1,720	192	192	35	157	270,040
14	Bllok betoni 1mx1m për instalimin e shtyllave	copë	4,092	40	40	0	40	163,680
21	Sensor muzgu	copë	6,800	6	6	1	5	34,000
<i>Shuma 1</i>								<i>1,121,600</i>
Fondi Rezervë								
Nr	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi	Preventivi i fondit rezerv	Çmimi i rillogaritur	Diferenca në çmim	Diferenca në +	
							Vol.	Vlera
1	Demontimi I ndriçuesve ekzistues	copë	5,970	55	1,334	4,636	55	254,980
2	Demontimi I stafave montuese	copë	2,701	100	470	2,231	100	223,100
3	Demontimi I linjave ekzistuese - Kabëll ABC - 25mm2	m	130	1,300	39	91	1,300	118,300
4	Pastrim nga ndryshku me rere abrazive (kuarci) me presion	copë	382.5	10	147	235.5	10	2,355
5	Lyerje e shtyllave me bojë dekorative kundër korrozionit dhe ndryshkjes	copë	3,755	10	1,273	2,482	10	24,820
6	Veshje me dru dekorativ të shtyllave për përshtatjen e tyre me model dekorativ	copë	6,925	3	5,662	1,263	3	3,789
<i>Shuma 2</i>								<i>627,344</i>
Total								<u>1,748,944</u>

Zëri 1. Çift Projektorësh të Montuar në shtyllë, me optikë , ekran anti-verbim, fluksi i daljes MIN.9000lm Dimërueshëm. Në preventivi ky zë pune ka emërtimin çift projektorësh. Nga verifikimi i librit të masave dhe verifikimit në terren, ky zë pune figuron në sasinë 92 copë sasi tek projektorësh. Sipas Specifikimeve teknike ky zë është i ngjashëm me zërin 5 i cili është tek

projektor. Nga rillogaritja, volumi i këtij zëri pune sipas çmimit të zërit 5 i projektorëve, sipas çmimit të ri vlera e këtij volumit prej 653,200 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Zëri 13. Krah për montimin e projektorëve në shtyllë. Në preventivin bazë dhe në librin e masave sasia e këtij zëri pune është 192 copë. Sipas faktit, ky zë pune figuron në sasinë 35 copë. Nga rillogaritja, volumi i këtij zëri pune është 35 copë, ose 157 copë më pak se volumi i situacionuar, për pasojë vlera e këtij volumit është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Zëri 21. Sensor muzgu. Në preventivin bazë dhe në librin e masave sasia e këtij zëri pune është 6 copë. Sipas faktit, ky zë pune figuron në sasinë 1 copë. Nga rillogaritja, volumi i këtij zëri pune është 1 copë, ose 5 copë më pak se volumi i situacionuar, për pasojë vlera e këtij volumit është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Zëri 14. Bllok betoni 1mx1m për instalimin e shtyllave. Në preventivin bazë dhe në librin e masave dimensionet e bazamentit jepen 1mx1m. Sipas faktit, këto bazamente kishin dimensione më të vogla se 1mx1m, varionin 20x20cm deri 40x40 cm. Ky zë nuk është realizuar sipas specifikimeve, për pasojë vlera e këtij volumit është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Fondi rezervë. Sipas analizës së çmimeve për zërat e fondit rezervë një pjesë e zërave nuk janë bazuar në manualin e çmimeve sipas VKM nr.629 datë 15.07.2015.

Sipas manualit të çmimeve:

Çmimi punëtorisë është 185 lekë;

Çmimi skelë inventari është 130 lekë;

Çmimi gur fleksibël është 84 lekë;

Çmimi trapano elektrik është 95 lekë;

Çmimi kompresorit është 858 lekë;

Çmimi rërë kuarci është 7 lekë;

Çmimi bojë zmalto është 250 lekë;

Çmimi për dru dekorativ, astar për bojën, bojë me bazë uji mungon çmimi i referencës.

Zëri 1 Demontimi i ndriçuesve ekzistues. Në preventivin e fondit rezervë çmimi e këtij zëri pune është llogaritur 5,970 lekë, sipas çmimeve të sipër përmendura bazuar në manualin e çmimeve sipas VKM nr.629 datë 15.07.2015. Çmimi i rillogaritur është 1,334 lekë.

Nga rillogaritja, sipas çmimit të ri vlera e këtij volumit prej 254,980 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Zëri 2 Demontimi i stafave montuese. Në preventivin e fondit rezervë çmimi e këtij zëri pune është llogaritur 2,701 lekë, sipas çmimeve të sipër përmendura bazuar në manualin e çmimeve sipas VKM nr.629 datë 15.07.2015. Çmimi i rillogaritur është 470 lekë.

Nga rillogaritja, sipas çmimit të ri vlera e këtij volumit prej 223,100 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Zëri 3 Demontimi i linjave ekzistuese - Kabëll ABC - 25mm². Në preventivin e fondit rezervë çmimi e këtij zëri pune është llogaritur 130 lekë, sipas çmimeve të sipër përmendura bazuar në manualin e çmimeve sipas VKM nr.629 datë 15.07.2015. Çmimi i rillogaritur është 39 lekë.

Nga rillogaritja, sipas çmimit të ri vlera e këtij volumit prej 118,300 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Zëri 4 Pastrim nga ndryshku me rërë abrazive (kuarci) me presion. Në preventivin e fondit rezervë çmimi e këtij zëri pune është llogaritur 382.5 lekë, sipas çmimeve të sipër përmendura bazuar në manualin e çmimeve sipas VKM nr.629 datë 15.07.2015. Çmimi i rillogaritur është 147 lekë.

Nga rillogaritja, sipas çmimit të ri vlera e këtij volumit prej 2,355 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Zëri 5 Lyerje e shtyllave me bojë dekorative kundër korrozionit dhe ndryshkjes. Në preventivin e fondit rezervë çmimi e këtij zëri pune është llogaritur 3,755 lekë, sipas çmimeve të

sipër përmendura bazuar në manualin e çmimeve sipas VKM nr.629 datë 15.07.2015. Çmimi i rillogaritur është 1,273 lekë.

Nga rillogaritja, sipas çmimit të ri vlera e këtij volumit prej 24,820 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Zëri 6 Veshje me dru dekorativ të shtyllave për përshtatjen e tyre me model dekorativ. Në preventivin e fondit rezervë çmimi e këtij zëri pune është llogaritur 6,925 lekë, sipas çmimeve të sipër përmendura bazuar në manualin e çmimeve sipas VKM nr.629 datë 15.07.2015. Çmimi i rillogaritur është 5,662 lekë.

Nga rillogaritja, sipas çmimit të ri vlera e këtij volumit prej 3,789 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Për këtë investim rezultoi se nuk argumentohet apo justifikohet vlera prej 1,748,944 lekë pa tvsh, e përfituar nga sipërmarrësi, për llogaritje të gabuara nga fakti i punës së realizuar.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

- **Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve** OE òA&E.Eò sh.p.k. nuk kanë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në:

1) Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, ku përcaktohet se:

“Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit.”

2) Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve me nr. 5269/8 prot. datë 11.12.2020.

- **Nga ana e kolaudatorit të punimeve** òA.SH.Eò sh.p.k.nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në:

1) Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 12, ku përcaktohet se:

“Të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 duhet t'i nënshtrohen kolaudimit tekniko ekonomik, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse: 1. objekti është realizuar në kushtet teknike; 2. objekti është realizuar në përputhje me kontratën dhe anekset e saj; 3. çmimet e aplikuara janë sipas përcaktimeve të kontratës; 4. në këtë akt verifikohen edhe kërkesat e zbatuesit të paraqitura gjatë zbatimit të punimeve”

2) Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3 ku përcaktohet se:

Kolaudatori ose grupi i kolaudimit duhet të verifikojë me përgjegjësi:

a. Realizimin e objektit, në përputhje me projektin, lejen e ndërtimit, standardet dhe rregullat teknike.

b. Realizimin e objektit, në përputhje me kontratën e nënshkruar.

c. Përputhjen e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi.

Titulli i Gjetjes	<i>Mbi Procedurën e Konkurrimit: “Realizimin me çelësa në dorë të projektit elektrik për ndriçimin e jashtëm të Kalasë së Shkodrës”</i>
Situata	1.Nga auditimi i zhvillimit të procedurës u konstatua se është mbajtur procesverbali për llogaritjen e fondit limit në datën 23.09.2020, në të njëjtën datë që është ngritur Urdhri i Zhvillimit të procedurës. Ky procesverbal është mbajtur nga Njësia e Hartimit të Dokumenteve të Procedurës së Konkurrimit Publik edhe pse nuk ka asnjë urdher që ky komision do të hartonte llogaritjen e fondit limit. 2.Fondi limit ka dalë në vlerën 17,500,000 lekë pa tvsh. Nga auditimi konstatohet se tre ofertat e marra në treg nuk përmbajnë datë, pra nuk mund të vërtetohet nëse këto oferta janë reale për kohën e zhvillimit të kësaj procedure. 3.Gjithashtu nga auditimi konstatohet se në llogaritjen e fondit limit nuk ka

	asnjë preventiv fillestar apo planimetri të objektit dhe se si kanë dalë këto zëra dhe sasitë e secilës prej tyre.
Kriteri:	Vkm nr.425, Datë 27.5.2020 òPër Procedurat E Përzgjedhjes Së Subjekteve Të Pajisura Me Licencë Për Projektim, Zbatim, Mbikëqyrje Dhe Kolaudim Në Pasuritë Kulturore, Për Kryerjen E Investimeve Me Fonde Publike Në Pasuritë Kulturoreò
Ndikimi/efekti:	-Marrja e tre ofertave pa datë ndikon në llogaritjen e saktë të fondit limit pasi nuk dihet nëse këto oferta janë aktuale apo jo. Nga Mungesa e preventivit fillestar apo planimetri të objektit konstatohet se nuk është e qartë se si kanë dalë zërat dhe sasitë .
Shkaku:	-Mos ngritja e komisionit të hartimit të llogaritjes së fondit limit. -Marrja e tre ofertave pa datë. - Mungesa e preventivit fillestar apo planimetri të objektit.
Rëndësia e shkeljes:	E mesme
Rekomandimi	-Ministria e Kulturës të marri masa për përmirësimin e VKM Vkm nr.425, Datë 27.5.2020 òPër Procedurat E Përzgjedhjes Së Subjekteve Të Pajisura Me Licencë Për Projektim, Zbatim, Mbikëqyrje Dhe Kolaudim Në Pasuritë Kulturore, Për Kryerjen E Investimeve Me Fonde Publike Në Pasuritë Kulturoreòme qëllim përcaktimin e qarte të mënyrës së përlllogaritjes së fondit limit. -Nga ana e MK, të merren masa që në çdo procedurë konkurrimi , llogaritja e fondit limit të bëhet në bazë të ofertave reale dhe të përkohet në kohën e zhvillimit të procedurës së konkurrimit. - Nga ana e Ministrisë së Kulturës të ngrihet një grup pune me qëllim verifikimin e planimetrive dhe preventivave fillestarë të Kalave, objekte të investimeve.

Titulli i gjetjes: xx	Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin òRealizimin me çelësa në dorë të projektit elektrik për ndriçimin e jashtëm të kalasë së Shkodrësò
Situata:	<p>Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, për objektin: òRealizimin me çelësa në dorë të projektit elektrik për ndriçimin e jashtëm të kalasë së Shkodrësò, si dhe nga verifikimi i kryer në terren në prezencë të përfaqësuesve të KLSH, Ministrisë së Kulturës dhe Mbikëqyrësit të punimeve rezultuan që janë përfshirë në situacion punime të cilat nuk janë realizuar si dhe çmimet e reja nuk janë bazuar në manualin e çmimeve sipas VKM nr.629 datë 15.07.2015.</p> <p>Këto diferenca rezultuan në zërat si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> o Zëri òÇift Projektorësh të montuar në shtyllë, me optikë, ekran anti-verbim, fluksi i daljes min.9000lm dimërueshëmò. Vlera prej 653,200 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve. o Zëri òKrah për montimin e projektorëve në shtyllëò. Vlera prej 270,040 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve. o Zëri òBlok betoni 1mx1m për instalimin e shtyllaveò. Vlera prej 163,680 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve. o Zëri òSensor Muzguò. Vlera prej 34,000 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve. o Fondi rezervë. Referuar analizës së çmimeve për zërat e fondit rezervë, një pjesë e zërave nuk janë bazuar në manualin e çmimeve sipas VKM nr.629 datë 15.07.2015. <p>Zëri 1-Demontimi i ndriçuesve ekzistues. Vlera prej 254,980 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.</p> <p>Zëri 2-Demontimi i stafave montuese. Vlera prej 223,100 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.</p> <p>Zëri 3-Demontimi i linjave ekzistuese - Kabëll ABC - 25mm2. Vlera prej 118,300 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.</p>

	<p>Zëri 4-Pastrim nga ndryshku me rërë abrazive (kuarci) me presion. Vlera prej 2,355 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.</p> <p>Zëri 5-Lyerje e shtyllave me bojë dekorative kundër korrozionit dhe ndryshkjes. Vlera prej 24,820 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.</p> <p>Zëri 6-Veshje me dru dekori të shtyllave për përshtatjen e tyre me model dekorativ. Vlera prej 3,789 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.</p>
<p>Kriteri:</p>	<p>Situacioni i punimeve dhe librezat e masave jo në përputhje me faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 òPër Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimitò, i ndryshuar, Kreu III, <u>ku përcaktohet se:</u> <p>Neni 7: <i>“Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit.”</i></p> <p>Neni 12: <i>Të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 duhet t'i nënshtrohen kolaudimit tekniko ekonomik, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. objekti është realizuar në kushtet teknike; 2. objekti është realizuar në përputhje me kontratën dhe anekset e saj; 3. çmimet e aplikuara janë sipas përcaktimeve të kontratës; 4. në këtë akt verifikohen edhe kërkesat e zbatuesit të paraqitura gjatë zbatimit të punimeve. <ul style="list-style-type: none"> - Udhëzim Nr.2, datë 13.5.2005 òPër Zbatimin e Punimeve të Ndërtimitò, Kreu II, <u>ku përcaktohet se:</u> <p><i>Pika 8.1 Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori. Zërat, sasi, çmimet jashtë kontratës dhe përdorimi i fondit rezervë në situacionin përfundimtar justifikohen me dokumentacionin përkatës</i></p> <p><i>Pika 8.3 Çmimet jashtë kontratës caktohen sipas analizave teknike në fuqi, me vlerën ekonomike më të mirë.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Udhëzim Nr. 3 datë 15.2.2001 òPër Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimitò e konkretisht Kreu II, Pika 3, <u>ku përcaktohet se:</u> <p><i>Kolaudatori ose grupi i kolaudimit duhet të verifikojë me përgjegjësi:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> a. Realizimin e objektit, në përputhje me projektin, lejen e ndërtimit, standardet dhe rregullat teknike. b. Realizimin e objektit, në përputhje me kontratën e nënshkruar. c. Përputhjen e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi. <ul style="list-style-type: none"> - VKM nr.629 datë 15.07.2015 òPër Miratimin e Manualeve Teknike të Çmimeve të Punimeve të Ndërtimit dhe të Analizave Teknike të tyreò, i ndryshuar. - Kontratës publike shërbime me nr. 4050/10 prot. datë 23.10.2020 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Ministria e Kulturës dhe Bashkimi i Operatorëve Ekonomik òRö sh.p.k. dhe òAL.Vö sh.p.k. Vlera e kontratës është 17,422,642 lekë pa tvsh / 20,907,170 lekë me tvsh. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 90 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës. - Aneks Kontrata nr.1 me nr.102/3 prot. me datë 29.01.2021 òPër një ndryshim në kontratën nr.4050/10 prot. datë 28.10.2020 me objekt : òRealizimin me çelësa në dorë të projektit elektrik për ndriçimin e jashtëm të Kalasë së Shkodrësò. - Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me nr.5269/8 prot, datë 11.12.2020, midis Autoritetit Kontraktor Ministria e Kulturës dhe Operatorit Ekonomik òA&E.Eò sh.p.k., me vlerë të kontratës së shërbimit 309,057 lekë pa tvsh / 370,869 lekë me tvsh. - Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me OE òA.SH.Eò, me vlerë të kontratës së shërbimit 40,800 lekë me tvsh. - Miratimi i projektit me anë të vendimit nr.376 datë 06.11.2020, me nr.1014 prot.

	Datë 09.11.2020 miratuar nga kryetari i KKTKM znj. E.M. - Librezat e masave, situacionet pjesore, vizatimet As Built etj.
Ndikimi/Efekti	Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar efekt negativ ndaj buxhetit të shtetit me vlerë prej 1,748,264 lekë pa tvsh në fondet e Buxhetit të Shtetit.
Shkaku	Mungesë e kontrollit periodik të punimeve nga ana e Mbikëqyrësit.
Rëndësia	E lartë
Rekomandime	Nga ana e Ministrisë së Kulturës të merren masa të menjëhershme për ngritjen e grupit të punës për evidentimin e diferencave të volumeve dhe certifikimin e tyre në situacionin përfundimtar. Mos evidentimi i diferencave të mësipërme në situacionin përfundimtar i vlerës prej 1,748,264 lekë pa tvsh, nga BOE òRò sh.p.k. dhe òAL.Vò sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve sipas kontratës nr. 4050/10 prot. datë 23.10.2020, me objekt òRealizimin me çelësa në dorë të projektit elektrik për ndriçimin e jashtëm të kalasë së Shkodrës, përbën efekt negativ ndaj buxhetit të shtetit.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi përfaqësuesi i Mbikëqyrësit të punimeve OE "A&E.E" sh.p.k., znj. E.Ç, sipas kontratës së mbikëqyrjes me nr 5269/8 prot, datë 11.12.2020.

III. Procedura e Konkurrimit: "Realizimin me çelësa në dorë të projektit elektrik për ndriçimin e jashtëm të Kalasë së Krujës"

-Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike

Me anë të memos nr.3538/1, datë 26.08.2020, është kërkuar miratimi i fillimit të procedurave të konkurrimit publik për Hartimin e projektit elektrik për ndriçimin e jashtëm të 15 kalave me një fond të alokuar prej 8,894,000 lekë me tvsh dhe për procedurat me objekt Projekti elektrik për ndriçimin e kalave të Shkodrës, Beratit, Gjirokastrës dhe Krujës me një fond total prej 74,000,000 lekë me tvsh.

Është ngritur Urdhri nr.350, datë 23.09.2020, ku përcaktohet lloji i procedurës òProcedurë konkurrimiò të dhënat për pasuri kulturore, lloji i investimit: projektim dhe punë, fondi limit 30,000,000 lekë pa tvsh, komisioni i konkurrimit publik i përbërë nga E.K (NJVO), K.N (NJVO), A.O (NJVO), E.P (NJHDPK), E.T (NJHDPK), T.H (NJHDPK).

Është mbajtur procesverbali për llogaritjen e fondit limit në datën 23.09.2020, pra në të njëjtën datë që është ngritur Urdhri i Zhvillimit të procedurës. Ky procesverbal është mbajtur nga Njësia e hartimit të dokumenteve të procedurës së konkurrimit publik edhe pse nuk ka asnjë urdhër që ky komision do të hartonte llogaritjen e fondit limit.

Sipas Procesverbalit të mbajtur ky komision ka testuar tregun duke marrë tre oferta përkatësisht:

òF.Eò me ofertë ekonomike 14,607,567 lekë pa tvsh;

òAL.Vò shpk me vlerë 13,967,463 lekë pa tvsh;

òHò shpk me vlerë 13,924,971 lekë pa tvsh.

Fondi limit ka dalë në vlerën 14,166,667 lekë pa tvsh. Nga auditimi konstatohet se tre ofertat e marra në treg nuk përmbajnë datë, pra nuk mund të vërtetohet nëse këto oferta janë reale për kohën e zhvillimit të kësaj procedure.

Gjithashtu nga auditimi konstatohet se në llogaritjen e fondit limit nuk ka asnjë preventiv fillestar apo planimetri të objektit dhe se si kanë dalë këto zëra dhe sasitë e secilës prej tyre.

Është mbajtur procesverbali me nr.4051/1, datë 23.09.2020 për hartimin e dokumenteve të konkurrimit publik.

Në datën 16.10.2020 është mbajtur procesverbali për hapjen e procedurës së konkurrimit ku citohet se është paraqitur një operator ekonomik BOE òRò dhe òAL.Vò Shpk me vlerë 14,155,008 lekë pa tvsh.

Është mbajtur procesverbali i vlerësimit të procedurës ku është shpallur fitues BOE òRò dhe òAL.Vò Shpk me vlerë 14,155,008 lekë pa tvsh.

Është miratuar raporti përmbledhës nga Titullari i Autoritetit Kontraktor me nr.4051/8, datë

26.10.2020.

Nga auditimi i dokumentacionit të operatorit fitues konstatohet se janë në përputhje me dokumentet standarde të konkurrimit.

-Lidhja e kontratës.

Është lidhur kontrata me nr.4051/10, datë 28.10.2020 midis Ministrisë së Kulturës dhe BOE òRö dhe òAL.Vö Shpk me vlerë kontrate 14,155,008 lekë pa tvsh, dhe afat për realizimin e saj 90 ditë nga data e nënshkrimit .

-Zbatimi i kontratës.

Është nënshkruar aneks Kontrata nr.1 me nr.102/4 Prot. Me datë 29.01.2021 òPër një ndryshim në kontratën nr.4051/10 prot. Datë 28.10.2020 me objekt : òRealizimi me çelësa në dorë të projektit elektrik për ndriçimin e jashtëm të Kalasë së Krujës

Pika 3.2:

Afati për plotësimin dhe dorëzimin e dokumentacionit teknik përfundimtar objekt kontrate, zgjatet deri në përfundimin e procedurës së marrjes në dorëzim të punimeve nga AK nëpërmjet përfaqësuesve të caktuar nga Titullari i tij, por në çdo rast jo më vonë se afati i zbatimit të kontratës bazë.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me nr 5267/8 prot, datë 11.12.2020, midis Autoritetit Kontraktor Ministria e Kulturës, të përfaqësuar nga sekretari i përgjithshëm znj. E.Ç dhe Operatorit Ekonomik òA&E.Eö sh.p.k. me NIPT K72..... përfaqësuar nga znj. E.Ç. me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1476/11, si dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 255,195 lekë pa tvsh / 306,234 lekë me tvsh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me OE òA.SH.Eö, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 2463/6, si dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 33,600 lekë me tvsh.

Miratimi i lejes

Miratimi i projektit me anë të vendimit nr.376 datë 06.11.2020, me nr.1014 prot. Datë 09.11.2020 miratuar nga kryetari i KKTKM znj. E.M. Projekti është hartuar nga òAL.Vö sh.p.k., pjesë e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik, duke qenë se është procedurë me çelsa në dorë.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se dorëzimi i sheshit të ndërtimit dhe fillimi i punimeve, proces verbali i fillimit të punimeve, sipas njoftimeve përkatëse është bërë në datën 18.11.2020. Punimet duhet të përfundonin në datën 22.01.2021 dhe kanë përfunduar me datë 24.12.2020, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve.

Sipas shkresës nr.43/1 prot., datë 23.01.2021, protokolluar në MK me nr. 102/1 Prot., datë 25.01.2021, mbikëqyrësi i punimeve òA&E.Eö sh.p.k. kërkon AK ***“Shtyrjen e Afatit të dorëzimit të dosjeve me dokumentacionin teknik përfundimtar (shtyrjen e kontratës), deri në marrjen në dorëzim të materialeve të sistemit ekzistues të demoluara për secilin objekt, nga Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore”***, duke qenë se ky i fundit ka miratuar kërkesën e BOE-së për përdorimin e fondit rezervë.

Për këto pajisje është mbajtur një proces verbal dorëzimi, i mbajtur midis sipërmarrësit të punimeve dhe Mbikëqyrësit të punimeve DRTK Krujë, Prot.8861 datë 24.12.2020.

Është bërë kërkesë në datën 17.12.2020 nga sipërmarrësi i punimeve (kontraktori) drejtuar mbikëqyrësit të punimeve, për dijeni Ministrisë së Kulturës, për përdorimin e fondit rezervë me nje vlerë prej 674,040 lekë pa t.v.sh., pas të cilës është bërë kërkesë me nr 492/3 prot, datë 17.12.2020 e mbikëqyrësit të punimeve drejtuar AK. Sipas kësaj letre thuhet se në preventivin e kontratës nuk janë parashikuar punime për demontimin e ndriçimit ekzistues, i cili interferon si nga pikëpamja funksionale ashtu dhe nga ana vizuale për peizazhin e kalasë.

- Konstatime të projekt-preventivit dhe legjislacioni i ndërtimit.

Nga verifikimi në objekt konstatohet se janë realizuar punime në objekt të ndryshme nga përcaktimi i tyre në preventiv dhe në situacion, të cilat renditen si më poshtë:

1. Zëri òÇift Projektorësh të montuar në shtyllë, me optikë, ekran anti-verbim, fluksi i daljes

- min.9000lm dimërueshëm, ishin vendosur 52 copë projektor dhe jo 52 çift projektorësh.
- Zëri òKrah për montimin e projektorëve në shtyllë ishin vendosur nje krah për çdo shtyllë që kishte me më shumë se 1 projektor.
 - Zëri òBllok betoni 1mx1m për instalimin e shtyllave nga verifikimi në terren përmasat ishin më të vogla se 1mx1m.
 - Zëri òSensor Muzgu ishte vendosur vetëm 1 copë.
 - Situacioni përfundimtar mungon në dosje.

Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Dokumentacioni teknik i zbatimit: Projekt preventivi, Libri i masave, ditarët e objektit etj. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Realizimin me çelësa në dorë të projektit elektrik për ndriçimin e jashtëm të kalasë së Krujës”			
14.Lidhja e kontratës nr. 4051/10 prot datë 23.10.2020	15.Vlera e kontratës (me tvsh) 16,986,010 lekë BOE fitues “R” sh.p.k. dhe “AL.V” sh.p.k.,		16.Likuiduar deri dt USH 782 datë 28.12.2020 Deri në vlerën 15,439,576 lekë
17- Situacioni Përfundimtar -Vlera me tvsh 16,986,002 lekë me tvsh (Vlerë e marrë nga Akti i Kolaudimit)	18.Afati i kontratës në dite Parashikuar 90 ditë, Zbatuar 37 ditë. Fillimi punimeve: 18.11.2020 Përfundimi punimeve: 24.12.2020		19. Zgjatja e kontratës Aneks Kontrata nr.1 me nr.102/4 Prot. Me datë 29.01.2021 òPër një ndryshim në kontratën nr.4051/10 prot. Datë 28.10.2020
20. Mbikëqyrësi i punimeve OE òA&E.Eò sh.p.k.	Licenca Nr: MK 1476/11	Kontrata me nr. 5267/8 prot. datë 11.12.2020	
21. Kolaudatori i punimeve òA.SH.Eò	Licenca Nr: MK 2463/6	Kontrata	
22.Akt Kolaudimi datë 19.04.2021	23.Akt i marrjes në dorëzim		

Nga auditimi i librezave të masave, projektit dhe preventivit bazë, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor.

Tabela nr. 1

Nr	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
							Vol.	Vlera
1	Çift Projektorësh të Montuar në shtyllë, me optikë , ekran anti-verbim,fluksi i daljes MIN.9000lm Dimërueshëm	copë	88,584	52	52	52 tek projektorësh	52	841,568
72,400								
12	Krah për montimin e projektorëve në shtyllë	copë	1,720	121	121	53	68	116,960
13	Bllok betoni 1mx1m për instalimin e shtyllave	copë	4,092	53	53	0	140	216,876
20	Sensor muzgu	copë	6,800	4	4	1	3	20,400
<i>Shuma 1</i>								<i>1,195,804</i>
Fondi Rezervë								
Nr	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi	Preventivi i fondit rezervë	Çmimi i rillogaritur	Diferenca në çmim	Diferenca në +	
							Vol.	Vlera
1	Demontimi I ndriçuesve ekzistues	copë	8,501	40	1,763	6,738	40	269,520
2	Demontimi I stafave montuese	copë	5,165	40	790	4,375	40	175,000
3	Pastrim nga ndryshku me rere abrazive (kuarci) me presion	copë	375	4	145	230	4	920

4	Lyerje e shtyllave me bojë dekorative kundër korrozionit dhe ndryshkjes	copë	3,775	4	1,278	2,497	4	9,988
5	Veshje me dru dekorativ të shtyllave për përshtatjen e tyre me model dekorativ	copë	6,925	16	5,662	1,263	16	20,208
							Shuma 2	475,636
							Total	1,671,440

Zëri 1. Çift Projektore të Montuar në shtyllë, me optikë , ekran anti-verbim, fluksi i daljes MIN.9000lm Dimërueshëm. Në preventivi ky zë pune ka emërtimin çift projektore. Nga verifikimi i librit të masave dhe verifikimit në terren, ky zë pune figuron në sasinë 52 copë sasi tek projektore. Sipas Specifikimeve teknike ky zë është i ngjashëm me zërin 2 tipi B i cili është tek projektor. Nga rillogaritja, volumi i këtij zëri pune sipas çmimit të zërit 2 tipi B i projektorëve, sipas çmimit të ri vlera e këtij volumit prej 923,780 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Zëri 12. Krah për montimin e projektorëve në shtyllë. Në preventivin bazë dhe në librin e masave sasia e këtij zëri pune është 121 copë. Sipas faktit, ky zë pune figuron në sasinë 53 copë. Nga rillogaritja, volumi i këtij zëri pune është 53 copë, ose 68 copë më pak se volumi i situacionuar, për pasojë vlera e këtij volumit është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Zëri 20. Sensor muzgu. Në preventivin bazë dhe në librin e masave sasia e këtij zëri pune është 4 copë. Sipas faktit, ky zë pune figuron në sasinë 1 copë. Nga rillogaritja, volumi i këtij zëri pune është 1 copë, ose 3 copë më pak se volumi i situacionuar, për pasojë vlera e këtij volumit është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Zëri 13. Bllok betoni 1mx1m për instalimin e shtyllave. Në preventivin bazë dhe në librin e masave dimensionet e bazamentit jepen 1mx1m. Sipas faktit, këto bazamente kishin dimensione më të vogla se 1mx1m, varionin 20x20cm deri 50x50 cm. Ky zë nuk është realizuar sipas specifikimeve, për pasojë vlera e këtij volumit është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Fondi rezervë. Sipas analizës së çmimeve për zërat e fondit rezervë një pjesë e zërave nuk janë bazuar në manualin e çmimeve sipas VKM nr.629 datë 15.07.2015.

Sipas manualit të çmimeve:

Çmimi punëtorisë është 185 lekë;

Çmimi skelë inventari është 130 lekë;

Çmimi gur fleksibël është 84 lekë;

Çmimi trapano elektrik është 95 lekë;

Çmimi kompresorit është 858 lekë;

Çmimi rërë kuarci është 7 lekë;

Çmimi bojë zmalto është 250 lekë;

Çmimi për dru dekorativ, astar për bojën, bojë me bazë uji mungon çmimi I referencës.

Zëri 1 Demontimi I ndriçuesve ekzistues. Në preventivin e fondit rezervë çmimi e këtij zëri pune është llogaritur 8,501 lekë, sipas çmimeve të sipër përmendura bazuar në manualin e çmimeve sipas VKM nr.629 datë 15.07.2015. Çmimi i rillogaritur është 1,763 lekë.

Nga rillogaritja, sipas çmimit të ri vlera e këtij volumit prej 269,520 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Zëri 2 Demontimi I stafave montuese. Në preventivin e fondit rezervë çmimi e këtij zëri pune është llogaritur 5,165 lekë, sipas çmimeve të sipër përmendura bazuar në manualin e çmimeve sipas VKM nr.629 datë 15.07.2015. Çmimi i rillogaritur është 790 lekë.

Nga rillogaritja, sipas çmimit të ri vlera e këtij volumit prej 175,000 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Zëri 3 Pastrim nga ndryshku me rërë abrazive (kuarci) me presion. Në preventivin e fondit rezervë çmimi e këtij zëri pune është llogaritur 375 lekë, sipas çmimeve të sipër përmendura bazuar në manualin e çmimeve sipas VKM nr.629 datë 15.07.2015. Çmimi i rillogaritur është 145 lekë.

Nga rillogaritja, sipas çmimit të ri vlera e këtij volumit prej 920 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Zëri 4 Lyerje e shtyllave me bojë dekorative kundër korrezionit dhe ndryshkjes. Në preventivin e fondit rezervë çmimi e këtij zëri pune është llogaritur 3,755 lekë, sipas çmimeve të sipër përmendura bazuar në manualin e çmimeve sipas VKM nr.629 datë 15.07.2015. Çmimi i rillogaritur është 1,278 lekë.

Nga rillogaritja, sipas çmimit të ri vlera e këtij volumit prej 9,988 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Zëri 5 Veshje me dru dekori të shtyllave për përshtatjen e tyre me model dekorativ. Në preventivin e fondit rezervë çmimi e këtij zëri pune është llogaritur 6,925 lekë, sipas çmimeve të sipër përmendura bazuar në manualin e çmimeve sipas VKM nr.629 datë 15.07.2015. Çmimi i rillogaritur është 5,662 lekë.

Nga rillogaritja, sipas çmimit të ri vlera e këtij volumit prej 20,208 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Për këtë investim rezultoi se nuk argumentohet apo justifikohet vlera prej 1,671,440 lekë pa tvsh, e përfituar nga sipërmarrësi, për llogaritje të gabuara nga fakti i punës së realizuar.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

- **Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve** OE òA&E.Eò sh.p.k. nuk kanë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në:

3) Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, ku përcaktohet se:

“Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit.”

4) Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve me nr. 5267/8 prot. datë 11.12.2020.

- **Nga ana e kolaudatorit të punimeve** òA.SH.Eò sh.p.k.nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në:

3) Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 12, ku përcaktohet se:

“Të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 duhet t'i nënshtrohen kolaudimit tekniko ekonomik, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse: 1. objekti është realizuar në kushtet teknike; 2. objekti është realizuar në përputhje me kontratën dhe anekset e saj; 3. çmimet e aplikuara janë sipas përcaktimeve të kontratës; 4. në këtë akt verifikohen edhe kërkesat e zbatuesit të paraqitura gjatë zbatimit të punimeve”

4) Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3 ku përcaktohet se:

Kolaudatori ose grupi i kolaudimit duhet të verifikojë me përgjegjësi:

a. Realizimin e objektit, në përputhje me projektin, lejen e ndërtimit, standardet dhe rregullat teknike.

b. Realizimin e objektit, në përputhje me kontratën e nënshkruar.

c. Përputhjen e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi.

Titulli i Gjetjes:	<i>Mbi Procedurën e Konkurrimit: “Realizimin me çelësa në dorë të projektit elektrik për ndriçimin e jashtëm të Kalasë së Krujës”</i>
Situata:1	1.Nga auditimi i zhvillimit të procedurës u konstatua se është mbajtur procesverbali për llogaritjen e fondit limit në datën 23.09.2020, në të njëjtën datë që është ngritur Urdhri i Zhvillimit të procedurës. Ky procesverbal është mbajtur nga Njësia e hartimit të dokumentave të procedurë së konkurrimit publik edhe pse nuk ka asnjë urdher që ky komision do të hartonte llogaritjen e fondit limit. 2.Fondi limit ka dalë në vlerën 14,166,667 lekë pa tvsh. Nga auditimi

	konstatohet se tre ofertat e marra në treg nuk përmbajnë datë, pra nuk mund të vërtetohet nëse këto oferta janë reale për kohën e zhvillimit të kësaj procedure. Nga auditimi konstatohet se ofertat janë llogaritur në të njëjtën datë dhe nga të njëjtët operatorë . U konstatua se dhe pse janë të njëjtat zëra në ofertë çmimet e ofertuara nga të njëjtët operatorë janë shumë herë më të larta. Në këtë rast themi se kemi një fryrje të fondit limit. 3.Gjithashtu nga auditimi konstatohet se në llogaritjen e fondit limit nuk ka asnjë preventiv fillestar apo planimetri të objektit dhe se si kanë dalë këto zëra dhe sasi të e secilës prej tyre.
Kriteri:	Vkm nr.425, Datë 27.5.2020 òPër Procedurat E Përzgjedhjes Së Subjekteve Të Pajisura Me Licencë Për Projektim, Zbatim, Mbikëqyrje Dhe Kolaudim Në Pasuritë Kulturore, Për Kryerjen E Investimeve Me Fonde Publike Në Pasuritë Kulturorë
Ndikimi/efekti:	-Marrja e tre ofertave pa datë ndikon në llogaritjen e saktë të fondit limit pasi nuk dihet nëse këto oferta janë aktuale apo jo. Nga Mungesa e preventivit fillestar apo planimetri të objektit konstatohet se nuk është e qartë se si kanë dalë zërat dhe sasi të .
Shkaku:	-Mos ngritja e komisionit të hartimit të llogaritjes së fondit limit. -Marrja e tre ofertave pa datë. - Mungesa e preventivit fillestar apo planimetri të objektit.
Rëndësia e shkeljes:	E mesme
Rekomandimi	-Nga ana e MK, të merren masa që në çdo procedurë konkurrimi , llogaritja e fondit limit të bëhet në bazë të ofertave reale dhe të përkojnë në kohën e zhvillimit të procedurës së konkurrimit. - Nga ana e Ministrisë së Kulturës të ngrihet një grup pune me qëllim verifikimin e planimetrive dhe preventivave fillestarë të Kalave, objekte të investimeve.

Titulli i gjetjes:	Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin <i>òRealizimin me çelësa në dorë të projektit elektrik për ndriçimin e jashtëm të kalasë së Krujësò</i>
Situata:	<p>Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, për objektin: <i>òRealizimin me çelësa në dorë të projektit elektrik për ndriçimin e jashtëm të kalasë së Krujësò</i>, si dhe nga verifikimi i kryer në terren në prezencë të përfaqësuesve të KLSH, Ministrisë së Kulturës dhe Mbikëqyrësit të punimeve rezultuan që janë përfshirë në situacion punime të cilat nuk janë realizuar si dhe çmimet e reja nuk janë bazuar në manualin e çmimeve sipas VKM nr.629 datë 15.07.2015.</p> <p>Këto diferenca rezultuan në zërat si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ò Zëri òÇift Projektorësh të montuar në shtyllë, me optikë, ekran anti-verbim, fluksi i daljes min.9000lm dimërueshëmò. Vlera prej 841,568 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve. ò Zëri òKrah për montimin e projektorëve në shtyllëò. Vlera prej 116,960 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve. ò Zëri òBllok betoni 1mx1m për instalimin e shtyllaveò. Vlera prej 216,876 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve. ò Zëri òSensor Muzguò. Vlera prej 20,400 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve. ò Fondi rezervë. Referuar analizës së çmimeve për zërat e fondit rezervë, një pjesë e zërave nuk janë bazuar në manualin e çmimeve sipas VKM nr.629 datë 15.07.2015. <p>Zëri 1-Demontimi i ndriçuesve ekzistues. Vlera prej 269,520 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve. Zëri 2-Demontimi i stafave montuese. Vlera prej 175,000 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve. Zëri 3-Pastrim nga ndryshku me rërë abrazive (kuarci) me presion. Vlera prej 920 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve. Zëri 4-Lyerje e shtyllave me bojë dekorative kundër korrozionit dhe ndryshkjes.</p>

	<p>Vlera prej 9,988 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.</p> <p>Zëri 5-Veshje me dru dekori të shtyllave për përshtatjen e tyre me model dekorativ. Vlera prej 20,208 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.</p>
<p>Kriteri:</p>	<p>Situacioni i punimeve dhe librezat e masave jo në përputhje me faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 ðPër Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit, i ndryshuar, Kreu III, <u>ku përcaktohet se:</u> <p>Neni 7: <i>“Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit.”</i></p> <p>Neni 12: <i>Të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 duhet t'i nënshtrohen kolaudimit tekniko ekonomik, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. objekti është realizuar në kushtet teknike; 2. objekti është realizuar në përputhje me kontratën dhe anekset e saj; 3. çmimet e aplikuar janë sipas përcaktimeve të kontratës; 4. në këtë akt verifikohen edhe kërkesat e zbatuesit të paraqitura gjatë zbatimit të punimeve. <ul style="list-style-type: none"> - Udhëzim Nr.2, datë 13.5.2005 ðPër Zbatimin e Punimeve të Ndërtimit, Kreu II, <u>ku përcaktohet se:</u> <p><i>Pika 8.1 Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori. Zërat, sasi, çmimet jashtë kontratës dhe përdorimi i fondit rezervë në situacionin përfundimtar justifikohen me dokumentacionin përkatës</i></p> <p><i>Pika 8.3 Çmimet jashtë kontratës caktohen sipas analizave teknike në fuqi, me vlerën ekonomike më të mirë.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Udhëzim Nr. 3 datë 15.2.2001 ðPër Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit të konkretisht Kreu II, Pika 3, <u>ku përcaktohet se:</u> <p><i>Kolaudatori ose grupi i kolaudimit duhet të verifikojë me përgjegjësi:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> a. Realizimin e objektit, në përputhje me projektin, lejen e ndërtimit, standardet dhe rregullat teknike. b. Realizimin e objektit, në përputhje me kontratën e nënshkruar. c. Përputhjen e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi. <ul style="list-style-type: none"> - VKM nr.629 datë 15.07.2015 ðPër Miratimin e Manualeve Teknike të Çmimeve të Punimeve të Ndërtimit dhe të Analizave Teknike të tyre, i ndryshuar. - Kontratës publike shërbime me nr. 4051/10 prot. datë 23.10.2020 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Ministria e Kulturës dhe Bashkimi i Operatorëve Ekonomik ðRË sh.p.k. dhe ðAL.VË sh.p.k. Vlera e kontratës është 14,155,008 lekë pa tvsh / 16,986,010 lekë me tvsh. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 90 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës. - Aneks Kontrata nr.1 me nr.102/4 prot. me datë 29.01.2021 ðPër një ndryshim në kontratën nr.4051/10 prot. datë 28.10.2020 me objekt : ðRealizimin me çelësa në dorë të projektit elektrik për ndriçimin e jashtëm të Kalasë së Krujës. - Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me nr 5267/8 prot, datë 11.12.2020, midis Autoritetit Kontraktor Ministria e Kulturës dhe Operatorit Ekonomik ðA&E.EË sh.p.k., me vlerë të kontratës së shërbimit 255,195 lekë pa tvsh / 306,234 lekë me tvsh. - Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me OE ðA.SH.EË, me vlerë të kontratës së shërbimit 33,600 lekë me tvsh. - Miratimi i projektit me anë të vendimit nr.376 datë 06.11.2020, me nr.1014 prot. Datë 09.11.2020 miratuar nga kryetari i KKTKM znj. E.M. - Librezat e masave, situacionet pjesore, vizatimet As Built etj.

Ndikimi/Efekti	Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar efekt negativ ndaj buxhetit të shtetit me vlerë prej 1,671,440 lekë pa tvsh në fondet e Buxhetit të Shtetit.
Shkaku	Mungesë e kontrollit periodik të punimeve nga ana e Mbikëqyrësit.
Rëndësia	E lartë
Rekomandime	Ministria e Kulturës të marrë masat duke ngritur një grup pune për të saktësuar, njoftuar dhe kërkuar nga subjekti OE òRò shpk + òAL.Vò shpk, plotësimin e punimeve të pakryera sipas preventivit për vlerën 1,671,440 lekë me efekte negative ndaj buxhetit të shtetit.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi përfaqësuesi i Mbikëqyrësit të punimeve OE "A&E.E" sh.p.k., znj. E.Ç, sipas kontratës së mbikëqyrjes me nr 5267/8 prot, datë 11.12.2020.

IV. Procedura e Konkurrimit: "Realizimin me çelësa në dorë të projektit elektrik për ndriçimin e jashtëm të Kalasë së Beratit"

Nga auditimi konstatohet se dosjet janë të pa arkivuara dhe të pa inventarizuara.

-Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike

Me anë të memos nr.3538/1, datë 26.08.2020, është kërkuar miratimi i fillimit të procedurave të konkurrimit publik për Hartimin e projektit elektrik për ndriçimin e jashtëm të 15 kalave me një fond të alokuar prej 8,894,000 lekë me tvsh dhe për procedurat me objekt Projekti elektrik për ndriçimin e kalave të Shkodrës, Beratit, Gjirokastrës dhe Krujës me një fond total prej 74,000,000 lekë me tvsh.

Është ngritur Urdhri nr.348, datë 23.09.2020, ku përcaktohet lloji i procedurës òProcedurë konkurrimiò të dhënat për pasuri kulturore, lloji i investimit: projektim dhe punë, fondi limit 30,000,000 lekë pa tvsh, komisioni i konkurrimit publik i përbërë nga A.Xh (NJVO), K.N (NJVO), A.O (NJVO), E.K (NJHDPK), E.T (NJHDPK), T.H (NJHDPK).

Është mbajtur procesverbali për llogaritjen e fondit limit në datën 23.09.2020, në të njëjtën datë që është ngritur Urdhri i Zhvillimit të procedurës. Ky procesverbal është mbajtur nga njësia e hartimit të dokumenteve të procedurës së konkurrimit publik edhe pse nuk ka asnjë urdher që ky komision do të hartonte llogaritjen e fondit limit.

Sipas Procesverbalit të mbajtur ky komision ka testuar tregun duke marrë tre oferta përkatësisht:

òF.Eò me ofertë ekonomike 29,135,139 lekë pa tvsh

òAL.Vò shpk me vlerë 30,630,282 lekë pa tvsh

òHò shpk me vlerë 30,234,578 lekë pa tvsh

Fondi limit ka dalë në vlerën 30,000,000 lekë pa tvsh. Nga auditimi konstatohet se tre ofertat e marra në treg nuk përmbajnë datë, pra nuk mund të vërtetohet nëse këto oferta janë reale për kohën e zhvillimit të kësaj procedure.

Gjithashtu nga auditimi konstatohet se në llogaritjen e fondit limit nuk ka asnjë preventiv fillestar apo planimetri të objektit dhe se si kanë dalë këto zëra dhe sasitë e secilës prej tyre.

Është mbajtur procesverbali me nr.4049/1, datë 23.09.2020 për hartimin e dokumenteve të konkurrimit publik.

Në datën 16.10.2020 është mbajtur procesverbali për hapjen e procedurës së konkurrimit ku citohet se është paraqitur një operator ekonomik BOE òRò dhe òAL.Vò Shpk me vlerë 29,968,773 lekë pa tvsh.

Është mbajtur procesverbali i vlerësimit të procedurës ku është shpallur fitues BOE òRò dhe òAL.Vò Shpk me vlerë 29,968,773 lekë pa tvsh.

Është miratuar raporti përmbledhës nga Titullari i Autoritetit Kontraktor me nr.4049/6, datë 26.10.2020.

Nga auditimi i dokumentacionit të operatorit fitues konstatohet se janë në përputhje me dokumentet standarde të konkurrimit.

-Lidhja e kontratës.

Është lidhur kontrata me nr.4049/10, datë 28.10.2020 midis Ministrisë së Kulturës dhe BOE òRò dhe òAL.Vò Shpk me vlerë kontrate 29,968,773 lekë pa tvsh, dhe afat për realizimin e saj 90 ditë nga data e nënshkrimit .

-Zbatimi i kontratës.

Është nënshkruar aneks Kontrata nr.1 me nr.102/6 Prot. Me datë 29.01.2021 për një ndryshim në kontratën nr.4049/10 prot. Datë 28.10.2020 me objekt : ÷Realizimi me çelësa në dorë të projektit elektrik për ndriçimin e jashtëm të Kalasë së Beratit

Pika 3.2:

Afati për plotësimin dhe dorëzimin e dokumentacionit teknik përfundimtar objekt kontrate, zgjatet deri në përfundimin e procedurës së marrjes në dorëzim të punimeve nga AK nëpërmjet përfaqësuesve të caktuar nga Titullari i tij, por në çdo rast jo më vonë se afati i zbatimit të kontratës bazë.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me nr 5268/8 prot, datë 11.12.2020, midis Autoritetit Kontraktor Ministria e Kulturës, të përfaqësuar nga sekretari i përgjithshëm znj. E.Ç dhe Operatorit Ekonomik ÷A&E.Eö sh.p.k. me NIPT K72..... përfaqësuar nga znj. E.C me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1476/11, si dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 499,761 lekë pa tvsh / 599,713 lekë me tvsh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me OE ÷I.C&Cö, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 3646, si dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 64,800 lekë me tvsh.

Miratimi i lejes

Miratimi i projektit me anë të vendimit nr.376 datë 06.11.2020, me nr.1014 prot. Datë 09.11.2020 miratuar nga kryetari i KKTKM znj. E.M.

Projekti është hartuar nga ÷AL.Vö sh.p.k., pjesë e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik, duke qenë se është procedurë me çelësa në dorë.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se dorëzimi i sheshit të ndërtimit dhe fillimi i punimeve, proces verbali i fillimit të punimeve, sipas njoftimeve përkatëse është bërë në datën 18.11.2020. Punimet duhet të përfundonin në datën 22.01.2021 dhe kanë përfunduar me datë 24.12.2020, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve.

Sipas shkresës nr.43/1 prot., datë 23.01.2021, protokolluar në MK me nr. 102/1 Prot., datë 25.01.2021, mbikëqyrësi i punimeve ÷A&E.Eö sh.p.k. kërkon AK ***“Shtyrjen e Afatit të dorëzimit të dosjeve me dokumentacionin teknik përfundimtar (shtyrjen e kontratës), deri në marrjen në dorëzim të materialeve të sistemit ekzistues të demoluara për secilin objekt, nga Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore”***, duke qenë se ky i fundit ka miratuar kërkesën e BOE-së për përdorimin e fondit rezervë.

Mungon proces verbali i dorëzimit të materialeve të sistemit ekzistues të demoluara.

Është bërë kërkesë në datën 16.12.2020 nga sipërmarrësi i punimeve (kontraktori) drejtuar mbikëqyrësit të punimeve, për dijeni Ministrisë së Kulturës, për përdorimin e fondit rezervë me një vlerë prej 1,427,083 lekë pa t.v.sh., pas të cilës është bërë kërkesë me nr 490/3 prot, datë 16.12.2020 e mbikëqyrësit të punimeve drejtuar AK. Sipas kësaj letre thuhet se në preventivin e kontratës nuk janë parashikuar punime për demontimin e ndriçimit ekzistues, i cili interferon si nga pikëpamja funksionale ashtu dhe nga ana vizuale për peizazhin e kalasë.

Për këto pajisje mungon proces verbal dorëzimit.

- Konstatime të projekt-preventivit dhe legjislacioni i ndërtimit.

Nga verifikimi në objekt konstatohet se janë realizuar punime në objekt të ndryshme nga përcaktimi i tyre në preventiv dhe në situacion, të cilat renditen si mëposhtë:

1. Zëri ÷Çift Projektorësh të montuar në shtyllë, me optikë, ekran anti-verbim, fluksi i daljes min.9000lm dimërueshëm, ishin vendosur 26 copë projektor dhe jo 26 çift projektorësh.
2. Zëri ÷Krah për montimin e projektorëve në shtyllë ishin vendosur një krah për çdo shtyllë që kishte me më shumë se 1 projektor.
3. Zëri ÷Bllok betoni 1mx1m për instalimin e shtyllave nga verifikimi në terren përmasat ishin më të vogla se 1mx1m.
4. Zëri ÷Sensor Muzguö ishte vendosur vetëm 1 copë.
5. Situacioni përfundimtar mungon në dosje.

Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

3) Dokumentacioni teknik i zbatimit: Projekt preventivi, Libri i masave, ditarët e objektit etj. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Realizimin me çelësa në dorë të projektit elektrik për ndriçimin e jashtëm të kalasë së Beratit”		
14.Lidhja e kontratës nr. 4049/10 prot datë 23.10.2020	15.Vlera e kontratës (me tvsh) 35,962,528lekë BOE fitues “R” sh.p.k. dhe “AL.V” sh.p.k.,	16.Likuiduar deri dt USH 783 datë 28.12.2020 Deri në vlerën 32,912,832 lekë
17- Situacioni Përfundimtar -Vlera me tvsh 35,962,527 lekë me tvsh (Vlerë e marrë nga Akti i Kolaudimit)	18.Afati i kontratës në dite Parashikuar 90 ditë, Zbatuar 37 ditë. Fillimi punimeve: 18.11.2020 Përfundimi punimeve: 24.12.2020	19. Zgjatja e kontratës Aneks Kontrata nr.1 me nr.102/6 Prot. Me datë 29.01.2021 për një ndryshim në kontratën nr.4049/10 prot. Datë 28.10.2020
20. Mbikëqyrësi i punimeve OE òA&E.Esh.p.k.	Licenca Nr: MK 1476/11	Kontrata me nr. 5268/8 prot, datë 11.12.2020
21. Kolaudatori i punimeve òL.C&Cò	Licenca Nr: MK 3646	Kontrata
22.Akt Kolaudimi datë 21.04.2021	23.Akt i marrjes në dorëzim	

Nga auditimi i librezave të masave, projektit dhe preventivit bazë, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor.

Tabela nr. 1

Nr	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +		
							Vol.	Vlera	
1	Çift Projektorësh të Montuar në shtyllë, me optikë , ekran anti-verbim, fluksi i daljes MIN.9000lm Dimërueshëm	copë	99,400 63,870	26	26	26 tek projektorësh	26	923,780	
13	Krah për montimin e projektoreve në shtyllë	copë	1,720	244	244	140	104	178,880	
14	Bllok betoni 1mx1m për instalimin e shtyllave	copë	4,092	140	140	0	140	572,880	
20	Orë astronomike	copë	12,700	2	1	1	1	12,700	
21	Sensor muzgu	copë	6,800	7	1	1	6	40,800	
22	Kuadër jashtë muri metalik i kompletuar	copë	144,742	2	1	1	1	144,742	
<i>Shuma 1</i>									<i>1,873,782</i>
Fondi Rezervë									
Nr	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi	Preventivi i fondit rezervë	Çmimi i rillogaritur	Diferenca në çmim	Diferenca në +		
							Vol.	Vlera	
1	Demontimi I ndriçuesve ekzistues	copë	9,046.09	112	1,823	7,223.09	112	808,985	
2	Demontimi I stafave montuese	copë	6,682	23	987	5,695	23	130,985	
3	Pastrim nga ndryshku me rere abrazive (kuarci) me presion	copë	376	6	146	230	6	1,380	
4	Lyerje e shtyllave me bojë dekorative kundër korrozionit dhe ndryshkjes	copë	3,755	6	1,273	2,482	6	14,892	
5	Veshje me dru dekorit të shtyllave për përshtatjen e tyre me model	copë	6,925	34	5,662	1,263	15	18,945	
							19	131,575	

dekorativ								
							Shuma 2	1,106,762
							Total	2,980,544

Zëri 1. Çift Projektorësh të Montuar në shtyllë, me optikë , ekran anti-verbim, fluksi i daljes MIN.9000lm Dimërueshëm. Në preventiv ky zë pune ka emërtimin çift projektorësh. Nga verifikimi i librit të masave dhe verifikimit në terren, ky zë pune figuron në sasinë 26 copë sasi tek projektorësh. Sipas Specifikimeve teknike ky zë është i ngjashëm me zërin 2 tipi B i cili është tek projektor. Nga rillogaritja, volumi i këtij zëri pune sipas çmimit të zërit 2 tipi B i projektorëve, sipas çmimit të ri vlera e këtij volumit prej 923,780 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Zëri 13. Krah për montimin e projektorëve në shtyllë. Në preventivin bazë dhe në librin e masave sasia e këtij zëri pune është 244 copë. Sipas faktit, ky zë pune figuron në sasinë 140 copë. Nga rillogaritja, volumi i këtij zëri pune është 140 copë, ose 104 copë më pak se volumi i situacionuar, për pasojë vlera e këtij volumit është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Zëri 21. Sensor muzgu. Në preventivin bazë sasia e këtij zëri pune është 7 copë. Sipas faktit dhe në librin e masave, ky zë pune figuron në sasinë 1 copë. Nga rillogaritja, volumi i këtij zëri pune bazuar në librin e masave është 1 copë, ose 6 copë më pak se volumi i situacionuar, për pasojë vlera e këtij volumit është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Zëri 14. Bllok betoni 1mx1m për instalimin e shtyllave. Në preventivin bazë dhe në librin e masave dimensionet e bazamentit jepen 1mx1m. Sipas faktit, këto bazamente kishin dimensione më të vogla se 1mx1m, varionin 20x20cm deri 40x40 cm. Ky zë nuk është realizuar sipas specifikimeve, për pasojë vlera e këtij volumit është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Zëri 20. Orë astronomike. Në preventivin bazë sasia e këtij zëri pune është 2 copë. Sipas faktit dhe në librin e masave, ky zë pune figuron në sasinë 1 copë. Nga rillogaritja, volumi i këtij zëri pune bazuar në librin e masave është 1 copë, ose 1 copë më pak se volumi i situacionuar, për pasojë vlera e këtij volumit është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Zëri 22. Kuadër jashtë muri metalik i kompletuar. Në preventivin bazë sasia e këtij zëri pune është 2 copë. Sipas faktit dhe në librin e masave, ky zë pune figuron në sasinë 1 copë. Nga rillogaritja, volumi i këtij zëri pune bazuar në librin e masave është 1 copë, ose 1 copë më pak se volumi i situacionuar, për pasojë vlera e këtij volumit është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Fondi rezervë. Sipas analizës së çmimeve për zërat e fondit rezervë një pjesë e zërave nuk janë bazuar në manualin e çmimeve sipas VKM nr.629 datë 15.07.2015.

Sipas manualit të çmimeve:

Çmimi punëtorisë është 185 lekë;

Çmimi skelë inventari është 130 lekë;

Çmimi gur fleksibël është 84 lekë;

Çmimi trapano elektrik është 95 lekë;

Çmimi kompresorit është 858 lekë;

Çmimi rërë kuarci është 7 lekë;

Çmimi bojë zmalto është 250 lekë;

Çmimi për dru dekorativ, astar për bojën, bojë me bazë uji mungon çmimi I referencës.

Zëri 1 Demontimi i ndriçuesve ekzistues. Në preventivin e fondit rezervë çmimi e këtij zëri pune është llogaritur 9,046.09 lekë, sipas çmimeve të sipër përmendura bazuar në manualin e çmimeve sipas VKM nr.629 datë 15.07.2015. Çmimi i rillogaritur është 1,823 lekë.

Nga rillogaritja, sipas çmimit të ri vlera e këtij volumit prej 808,985 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Zëri 2 Demontimi i stafave montuese. Në preventivin e fondit rezervë çmimi e këtij zëri pune

është llogaritur 6,682 lekë, sipas çmimeve të sipër përmendura bazuar në manualin e çmimeve sipas VKM nr.629 datë 15.07.2015. Çmimi i rillogaritur është 987 lekë.

Nga rillogaritja, sipas çmimit të ri vlera e këtij volumit prej 130,985 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Zëri 3 Pastrim nga ndryshku me rërë abrazive (kuarci) me presion. Në preventivin e fondit rezervë çmimi e këtij zëri pune është llogaritur 376 lekë, sipas çmimeve të sipër përmendura bazuar në manualin e çmimeve sipas VKM nr.629 datë 15.07.2015. Çmimi i rillogaritur është 146 lekë.

Nga rillogaritja, sipas çmimit të ri vlera e këtij volumit prej 1,380 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Zëri 4 Lyerje e shtyllave me bojë dekorative kundër korrozionit dhe ndryshkjes. Në preventivin e fondit rezervë çmimi e këtij zëri pune është llogaritur 3,755 lekë, sipas çmimeve të sipër përmendura bazuar në manualin e çmimeve sipas VKM nr.629 datë 15.07.2015. Çmimi i rillogaritur është 1,273 lekë.

Nga rillogaritja, sipas çmimit të ri vlera e këtij volumit prej 14,892 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Zëri 5 Veshje me dru dekorativ të shtyllave për përshtatjen e tyre me model dekorativ. Në preventivin e fondit rezervë çmimi e këtij zëri pune është llogaritur 6,925 lekë, sipas çmimeve të sipër përmendura bazuar në manualin e çmimeve sipas VKM nr.629 datë 15.07.2015. Çmimi i rillogaritur është 5,662 lekë dhe janë 15 copë.

Nga rillogaritja, sipas çmimit të ri dhe sasisë prej 15 copësh vlera e këtij volumit prej 150,520 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Për këtë investim rezultoi se nuk argumentohet apo justifikohet vlera prej 2,980,544 lekë pa tvsh, e përfituar nga sipërmarrësi, për llogaritje të gabuara nga fakti i punës së realizuar.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

- **Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve** OE òA&E.Eò sh.p.k. nuk kanë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në:

5) Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, ku përcaktohet se:

“Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit.”

6) Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve me nr. 5268/8 prot. datë 11.12.2020.

- **Nga ana e kolaudatorit të punimeve** òl.C&Cò sh.p.k.nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në:

5) Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 12, ku përcaktohet se:

“Të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 duhet t'i nënshtrohen kolaudimit tekniko ekonomik, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse: 1. objekti është realizuar në kushtet teknike; 2. objekti është realizuar në përputhje me kontratën dhe anekset e saj; 3. çmimet e aplikuara janë sipas përcaktimeve të kontratës; 4. në këtë akt verifikohen edhe kërkesat e zbatuesit të paraqitura gjatë zbatimit të punimeve”

6) Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3 ku përcaktohet se:

Kolaudatori ose grupi i kolaudimit duhet të verifikojë me përgjegjësi:

a. Realizimin e objektit, në përputhje me projektin, lejen e ndërtimit, standardet dhe rregullat teknike.

b. Realizimin e objektit, në përputhje me kontratën e nënshkruar.

c. Përputhjen e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi.

Titulli i Gjetjes:	<i>Mbi Procedurën e Konkurrimit: “Realizimin me çelësa në dorë të projektit elektrik për ndriçimin e jashtëm të Kalasë së Beratit”</i>
Situata:1	<p>1.Nga auditimi i zhvillimit të procedurës u konstatua se është mbajtur procesverbali për llogaritjen e fondit limit në datën 23.09.2020, në të njëjtën datë që është ngritur Urdhri i Zhvillimit të procedurës. Ky procesverbal është mbajtur nga Njësia e hartimit të dokumenteve të procedurë së konkurrimit publik edhe pse nuk ka asnjë urdher që ky komision do të hartonte llogaritjen e fondit limit.</p> <p>2.Fondi limit ka dalë në vlerën 30,000,000 lekë pa tvsh. Nga auditimi konstatohet se tre ofertat e marra në treg nuk përmbajnë datë, pra nuk mund të vërtetohet nëse këto oferta janë reale për kohën e zhvillimit të kësaj procedure.</p> <p>3.Gjithashtu nga auditimi konstatohet se në llogaritjen e fondit limit nuk ka asnjë preventiv fillestar apo planimetri të objektit dhe se si kanë dalë këto zëra dhe sasi të secilës prej tyre.</p>
Kriteri:	Vkm nr.425, Datë 27.5.2020 ÷Për Procedurat E Përzgjedhjes Së Subjekteve Të Pajisura Me Licencë Për Projektim, Zbatim, Mbikëqyrje Dhe Kolaudim Në Pasuritë Kulturore, Për Kryerjen E Investimeve Me Fonde Publike Në Pasuritë Kulturore
Ndikimi/efekti:	-Marrja e tre ofertave pa datë ndikon në llogaritjen e saktë të fondit limit pasi nuk dihet nëse këto oferta janë aktuale apo jo. Nga Mungesa e preventivit fillestar apo planimetri të objektit konstatohet se nuk është e qartë se si kanë dalë zërat dhe sasi të .
Shkaku:	-Mos ngritja e komisionit të hartimit të llogaritjes së fondit limit. -Marrja e tre ofertave pa datë. - Mungesa e preventivit fillestar apo planimetri të objektit.
Rëndësia e shkeljes:	E mesme
Rekomandimi	-Nga ana e MK, të merren masa që në çdo procedurë konkurrimi , llogaritja e fondit limit të bëhet në bazë të ofertave reale dhe të përkojnë në kohën e zhvillimit të procedurës së konkurrimit. - Nga ana e Ministrisë së Kulturës të ngrihet një grup pune me qëllim verifikimin e planimetrive dhe preventivave fillestarë të Kalave, objekte të investimeve.

Titulli i gjetjes:	Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin <i>÷Realizimin me çelësa në dorë të projektit elektrik për ndriçimin e jashtëm të kalasë së Beratit”</i>
Situata:	<p>Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, për objektin: <i>÷Realizimin me çelësa në dorë të projektit elektrik për ndriçimin e jashtëm të kalasë së Beratit</i>, si dhe nga verifikimi i kryer në terren në prezencë të përfaqësuesve të KLSH, Ministrisë së Kulturës dhe Mbikëqyrësit të punimeve rezultuan që janë përfshirë në situacion punime të cilat nuk janë realizuar si dhe çmimet e reja nuk janë bazuar në manualin e çmimeve sipas VKM nr.629 datë 15.07.2015.</p> <p>Këto diferenca rezultuan në zërat si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ Zëri ÷Çift Projektorësh të montuar në shtyllë, me optikë, ekran anti-verbim, fluksi i daljes min.9000lm dimërueshëmö. Vlera prej 923,780 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve. ○ Zëri ÷Krah për montimin e projektorëve në shtyllëö. Vlera prej 178,880 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve. ○ Zëri ÷Bllok betoni 1mx1m për instalimin e shtyllaveö. Vlera prej 572,880 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve. ○ Zëri ÷Orë astronomikeö. Vlera prej 12,700 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve. ○ Zëri ÷Sensor Muzguö. Vlera prej 40,800 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

	<ul style="list-style-type: none"> ○ Zëri òKquadër jashtë muri metalik i kompletuarò. Vlera prej 144,742 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve. ○ Fondi rezervë. Referuar analizës së çmimeve për zërat e fondit rezervë, një pjesë e zërave nuk janë bazuar në manualin e çmimeve sipas VKM nr.629 datë 15.07.2015. <p>Zëri 1-Demontimi i ndriçuesve ekzistues. Vlera prej 808,985 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.</p> <p>Zëri 2-Demontimi i stafave montuese. Vlera prej 130,985 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.</p> <p>Zëri 3-Pastrim nga ndryshku me rërë abrazive (kuarci) me presion. Vlera prej 1,380 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.</p> <p>Zëri 4-Lyerje e shtyllave me bojë dekorative kundër korrezionit dhe ndryshkjes. Vlera prej 14,892 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.</p> <p>Zëri 5-Veshje me dru dekorativ të shtyllave për përshtatjen e tyre me model dekorativ. Vlera prej 150,520 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.</p>
Kriteri:	<p>Situacioni i punimeve dhe librezat e masave jo në përputhje me faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 òPër Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimitò, i ndryshuar, Kreu III, <u>ku përcaktohet se:</u> <p>Neni 7: <i>“Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit.”</i></p> <p>Neni 12: <i>Të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 duhet t'i nënshtrohen kolaudimit tekniko ekonomik, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. objekti është realizuar në kushtet teknike; 2. objekti është realizuar në përputhje me kontratën dhe anekset e saj; 3. çmimet e aplikuar janë sipas përcaktimeve të kontratës; 4. në këtë akt verifikohen edhe kërkesat e zbatuesit të paraqitura gjatë zbatimit të punimeve. <ul style="list-style-type: none"> - Udhëzim Nr.2, datë 13.5.2005 òPër Zbatimin e Punimeve të Ndërtimitò, Kreu II, <u>ku përcaktohet se:</u> <p><i>Pika 8.1 Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori. Zërat, sasi, çmimet jashtë kontratës dhe përdorimi i fondit rezervë në situacionin përfundimtar justifikohen me dokumentacionin përkatës.</i></p> <p><i>Pika 8.3 Çmimet jashtë kontratës caktohen sipas analizave teknike në fuqi, me vlerën ekonomike më të mirë.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Udhëzim Nr. 3 datë 15.2.2001 òPër Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimitò e konkretisht Kreu II, Pika 3, <u>ku përcaktohet se:</u> <p><i>Kolaudatori ose grupi i kolaudimit duhet të verifikojë me përgjegjësi:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> a. Realizimin e objektit, në përputhje me projektin, lejen e ndërtimit, standardet dhe rregullat teknike. b. Realizimin e objektit, në përputhje me kontratën e nënshkruar. c. Përputhjen e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi. <ul style="list-style-type: none"> - VKM nr.629 datë 15.07.2015 òPër Miratimin e Manualeve Teknike të Çmimeve të Punimeve të Ndërtimit dhe të Analizave Teknike të tyreò, i ndryshuar. - Kontratës publike shërbime me nr. 4049/10 prot. datë 23.10.2020 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Ministria e Kulturës dhe Bashkimi i Operatorëve Ekonomik òRò sh.p.k. dhe òAL.Vò sh.p.k. Vlera e kontratës është 29,968,773 lekë pa tvsh / 35,962,528 lekë me tvsh. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 90 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës. - Aneks Kontrata nr.1 me nr.102/6 prot. me datë 29.01.2021 òPër një ndryshim në kontratën nr.4049/10 prot. datë 28.10.2020 me objekt : òRealizimin me çelsa në

	<p>dorë të projektit elektrik për ndriçimin e jashtëm të Kalasë së Beratit.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me nr 5268/8 prot, datë 11.12.2020, midis Autoritetit Kontraktor Ministria e Kulturës dhe Operatorit Ekonomik òA&E.Eò sh.p.k., me vlerë të kontratës së shërbimit 499,761 lekë pa tvsh / 599,713 lekë me tvsh. - Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me OE òl.C&Cò, me vlerë të kontratës së shërbimit 64,800 lekë me tvsh. - Miratimi i projektit me anë të vendimit nr.376 datë 06.11.2020, me nr.1014 prot. Datë 09.11.2020 miratuar nga kryetari i KKTKM znj. E.M. - Librezat e masave, situacionet pjesore, vizatimet As Built etj.
Ndikimi/Efekti	Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar efekt negativ ndaj buxhetit të shtetit me vlerë prej 2,980,544 lekë pa tvsh në fondet e Buxhetit të Shtetit.
Shkaku	Mungesë e kontrollit periodik te punimeve nga ana e Mbikëqyrësit.
Rëndësia	E lartë
Rekomandime	Ministria e Kulturës të marrë masat duke ngritur një grup pune për të saktësuar, njoftuar dhe kërkuar nga subjekti OE òRò shpk + òAL.Vò shpk, plotësimin e punimeve të pakryera sipas preventivit për vlerën 2,980,544 lekë me efekte negative ndaj buxhetit të shtetit.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi përfaqësuesi i Mbikëqyrësit të punimeve OE "A&E.E" sh.p.k., znj. E.Ç, sipas kontratës së mbikëqyrjes me nr 5268/8 prot, datë 11.12.2020.

V. Procedura e Konkurrimit: "Realizimin me celësa në dorë të projektit elektrik për ndriçimin e jashtëm të Kalasë së Gjirokastrës"

-Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike

Me anë të memos nr.3538/1, datë 26.08.2020, është kërkuar miratimi i fillimit të procedurave të konkurrimit publik për Hartimin e projektit elektrik për ndriçimin e jashtëm të 15 kalave me një fond të alokuar prej 8,894,000 lekë me tvsh dhe për procedurat me objekt Projekti elektrik për ndriçimin e kalave të Shkodrës, Beratit, Gjirokastrës dhe Krujës me një fond total prej 74,000,000 lekë me tvsh.

Është ngritur Urdhri nr.351, datë 23.09.2020, ku përcaktohet lloji i procedurës òProcedurë konkurrimiò të dhënat për pasuri kulturore, lloji i investimit: projektim dhe punë, fondi limit 20,500,000 lekë pa tvsh, komisioni i konkurrimit publik i përbërë nga E.K (NJVO), K.N (NJVO), A.O (NJVO), E.P (NJHDPK), E.T (NJHDPK), T.H (NJHDPK).

Është mbajtur procesverbali për llogaritjen e fondit limit në datën 23.09.2020, pra në të njëjtën datë që është ngritur Urdhri i Zhvillimit të procedurës. Ky procesverbal është mbajtur nga Njësia e hartimit të dokumenteve të procedurës së konkurrimit publik edhe pse nuk ka asnjë urdher që ky komision do të hartonte llogaritjen e fondit limit.

Sipas Procesverbalit t ë mbajtur ky komision ka testuar tregun duke marrë tre oferta përkatësisht:

òF.Eò me ofertë ekonomike 19,565,335 lekë pa tvsh

òAl.Vò shpk me vlerë 20,999,755 lekë pa tvsh

òHò. shpk me vlerë 20,934,909 lekë pa tvsh

Fondi limit ka dalë në vlerën 20,500,000 lekë pa tvsh. Nga auditimi konstatohet se tre ofertat e marra në treg nuk përmbajnë datë, pra nuk mund të vërtetohet nëse këto oferta janë reale për kohën e zhvillimit të kësaj procedure.

Nga auditimi konstatohet se ofertat janë llogaritur në të njëjtën datë (sipas procesverbalit) dhe nga të njëjtët operatorë.

Gjithashtu nga auditimi konstatohet se në llogaritjen e fondit limit nuk ka asnjë preventiv fillestar apo planimetri të objektit dhe se si kanë dalë këto zëra dhe sasitë e secilës prej tyre.

Është mbajtur procesverbali me nr.4052/1, datë 24.09.2020 për hartimin e dokumenteve të konkurrimit publik.

Në datën 16.10.2020 është mbajtur procesverbali për hapjen e procedurës së konkurrimit ku citohet se është paraqitur një operator ekonomik BOE òRò dhe òAL.Vò Shpk me vlerë 20,361,852 lekë pa tvsh.

Është mbajtur procesverbali i vlerësimit të procedurës me nr.4052/69 ku është shpallur fitues BOE òRò dhe òAL.Vò Shpk me vlerë 20,361,852 lekë pa tvsh.

Është miratuar raporti përmbledhës nga Titullari i Autoritetit Kontraktor me nr.4050/8, datë 26.10.2020.

Nga auditimi i dokumentacionit të operatorit fitues konstatohet se janë në përputhje me dokumentet standarte të konkurrimit.

-Lidhja e kontratës.

Është lidhur kontrata me nr.4052/10, datë 28.10.2020 midis Ministrisë së Kulturës dhe BOE òRò dhe òAL.Vò Shpk me vlerë kontrate 20,361,852 lekë pa tvsh, dhe afat për realizimin e saj 90 ditë nga data e nënshkrimit.

-Zbatimi i kontratës.

Është nënshkruar aneks Kontrata nr.1 me nr.102/5 Prot. Me datë 29.01.2021 òPër një ndryshim në kontratën nr.4052/10 prot. Datë 28.10.2020 me objekt : òRealizimi me çelësa në dorë të projektit elektrik për ndriçimin e jashtëm të Kalasë së Gjirokastrës

Pika 3.2:

Afati për plotësimin dhe dorëzimin e dokumentacionit teknik përfundimtar objekt kontrate, zgjatet deri në përfundimin e procedurës së marrjes në dorëzim të punimeve nga AK nëpërmjet përfaqësuesve të caktuar nga Titullari i tij, por në çdo rast jo më vonë se afati i zbatimit të kontratës bazë.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me nr 5270/8 prot, datë 11.12.2020, midis Autoritetit Kontraktor Ministria e Kulturës, të përfaqësuar nga sekretari i përgjithshëm znj. E.Ç dhe Operatorit Ekonomik òA&E.Eò sh.p.k. me NIPT K72..... përfaqësuar nga znj. E.Ç. me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1476/11, si dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 355,895.07 lekë pa tvsh / 427,074.08 lekë me tvsh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me OE òA.SH.Eò, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 2463/6, si dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 46,800 lekë me tvsh.

Miratimi i lejes

Miratimi i projektit me anë të vendimit nr.376 datë 06.11.2020, me nr.1014 prot. Datë 09.11.2020 miratuar nga kryetari i KKTKM znj. E.M.

Projekti është hartuar nga òAL.Vò sh.p.k., pjesë e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik, duke qenë se është procedurë me çelësa në dorë.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se dorëzimi i sheshit të ndërtimit dhe fillimi i punimeve, proces verbali i fillimit të punimeve, sipas njoftimeve përkatëse është bërë në datën 18.11.2020. Punimet duhet të përfundonin në datën 22.01.2021 dhe kanë përfunduar me datë 24.12.2020, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve.

Sipas shkresës nr.43/1 prot., datë 23.01.2021, protokolluar në MK me nr. 102/1 Prot., datë 25.01.2021, mbikëqyrësi i punimeve òA&E.Eò sh.p.k. kërkon AK ***“Shtyrjen e Afatit të dorëzimit të dosjeve me dokumentacionin teknik përfundimtar (shtyrjen e kontratës), deri në marrjen në dorëzim të materialeve të sistemit ekzistues të demoluara për secilin objekt, nga Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore”***, duke qenë se ky i fundit ka miratuar kërkesën e BOE-së për përdorimin e fondit rezervë.

Për këto pajisje është mbajtur një proces verbal dorëzimi, i mbajtur midis sipërmarrësit të punimeve dhe Mbikëqyrësit të punimeve DRTK Gjirokastrë, Prot.227/1 datë 29.12.2020, dhe dërguar me shkresën përcjellëse me nr.84/1 prot. Gjirokastrë 31.03.2021 nga Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Gjirokastrë.

Është bërë kërkesë në datën 16.12.2020 nga sipërmarrësi i punimeve (kontraktori) drejtuar mbikëqyrësit të punimeve, për dijëni Ministrisë së Kulturës, për përdorimin e fondit rezervë me një

vlerë prej 969,611.91 lekë pa t.v.sh., pas të cilës është bërë kërkesë me nr 490/1 prot, datë 16.12.2020 e mbikëqyrësit të punimeve drejtuar AK. Sipas kësaj letre thuhet se në preventivin e kontratës nuk janë parashikuar punime për demontimin e ndriçimit ekzistues, i cili interferon si nga pikëpamja funksionale ashtu dhe nga ana vizuale për peizazhin e kalasë.

- Konstatime të projekt-preventivit dhe legjislacioni i ndërtimit.

Nga verifikimi në objekt konstatohet se janë realizuar punime në objekt të ndryshme nga përcaktimi i tyre në preventiv dhe në situacion, të cilat renditen si më poshtë:

1. Zëri ÷Çift Projektorësh të montuar në shtyllë, me optikë, ekran anti-verbim, fluksi i daljes min.9000lm dimërueshëm, ishin vendosur 75 copë projektor dhe jo 75 çift projektorësh.
2. Zëri ÷Krah për montimin e projektorëve në shtyllë ishin vendosur një krah për çdo shtyllë që kishte me më shumë se 1 projektor.
3. Zëri ÷Bllok betoni 1mx1m për instalimin e shtyllave nga verifikimi në terren përmasat ishin më të vogla se 1mx1m.
4. Zëri ÷Sensor Muzgu ishte vendosur vetëm 1 copë.
5. Situacioni përfundimtar mungon në dosje.

Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- 4) Dokumentacioni teknik i zbatimit: Projekt preventivi, Libri i masave, ditarët e objektit etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Realizimin me çelësa në dorë të projektit elektrik për ndriçimin e jashtëm të kalasë së Gjirokastrës”			
14.Lidhja e kontratës nr. 4052/10 prot datë 23.10.2020	15.Vlera e kontratës (me tvsh) 24,434,222 lekë BOE fitues “R” sh.p.k. dhe “AL.V” sh.p.k.,		16.Likuiduar deri dt USH 780 datë 28.12.2020 Deri në vlerën 22,239,536 lekë
17- Situacioni Përfundimtar -Vlera me tvsh 24,434,208 lekë me tvsh (Vlerë e marrë nga Akti i Kolaudimit)	18.Afati i kontratës në dite Parashikuar 90 ditë, Zbatuar 37 ditë. Fillimi punimeve: 18.11.2020 Përfundimi punimeve: 24.12.2020		19. Zgjatja e kontratës Aneks Kontrata nr.1 me nr.102/5 Prot. Me datë 29.01.2021 ÷Për një ndryshim në kontratën nr.4052/10 prot. Datë 28.10.2020
20. Mbikëqyrësi i punimeve OE ÷A&E.E÷ sh.p.k.	Licenca Nr: MK 1476/11	Kontrata me nr. 5270/8 prot, datë 11.12.2020	
21. Kolaudatori i punimeve ÷A.SH.E÷ sh.p.k.	Licenca Nr: 2463/6	Kontrata	
22.Akt Kolaudimi datë 23.04.2021	23.Akt i marrjes në dorëzim		

Nga auditimi i librezave të masave, projektit dhe preventivit bazë, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor.

Tabela nr. 1

Nr	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +		
							Vol.	Vlera	
1	Çift Projektorësh të Montuar në shtyllë, me optikë , ekran anti-verbim,fluksi i daljes MIN.9000lm Dimërueshëm	copë	94,500 88,584	75	75	75 tek projektorësh	75	443,700	
14	Bllok betoni 1mx1m për instalimin e shtyllave	copë	4,092	48	48	0	48	196,416	
13	Krah për montimin e projektorëve në shtyllë	copë	1,720	192	192	50	142	244,240	
21	Sensor muzgu	copë	6,800	6	1	1	5	34,000	
<i>Shuma 1</i>									918,356
Fondi Rezervë									
Nr	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi	Preventivi i fondit rezervë	Çmimi i rillogaritur	Diferenca në çmim	Diferenca në +		
							Vol.	Vlera	

1	Demontimi I ndriçuesve ekzistues-projektor	copë	6,040	83	1,488	4,552	83	377,816
2	Demontimi I stafave montuese	copë	2,840	83	488	2,352	83	195,216
3	Demontim I ndriçuesve ekzistues Neon 60-120cm	copë	1,283.43	56	709	574.43	56	32,167
4	Demontimi I linjave ekzistuese - Kabell ABC - 25mm2	ml	133	1,000	39	94	1,000	94,000
5	Veshje me dru dekorativ të shtyllave për pershtatjen e tyre me model dekorativ	copë	6,925	4	5,662	1,263	4	5,052
<i>Shuma 2</i>								<i>704,251</i>
Total								<u>1,622,607</u>

Zëri 1. Çift Projektorësh të Montuar në shtyllë, me optikë, ekran anti-verbim, fluksi i daljes MIN.9000lm Dimërueshëm. Në preventivi ky zë pune ka emërtimin çift projektorësh. Nga verifikimi i librit të masave dhe verifikimit në terren, ky zë pune figuron në sasinë 75 copë sasi tek projektorësh. Sipas Specifikimeve teknike ky zë është i ngjashëm me zërin 2 tipi B i cili është tek projektor. Nga rillogaritja, volumi i këtij zëri pune sipas çmimit të zërit 2 tipi B i projektorëve, sipas çmimit të ri vlera e këtij volumit prej 443,700 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Zëri 13. Krah për montimin e projektorëve në shtyllë. Në preventivin bazë dhe në librin e masave sasia e këtij zëri pune është 192 copë. Sipas faktit, ky zë pune figuron në sasinë 50 copë. Nga rillogaritja, volumi i këtij zëri pune është 50 copë, ose 142 copë më pak se volumi i situacionuar, për pasojë vlera e këtij volumit është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Zëri 21. Sensor muzgu. Në preventivin bazë sasia e këtij zëri pune është 6 copë. Sipas faktit dhe në librin e masave, ky zë pune figuron në sasinë 1 copë. Nga rillogaritja, volumi i këtij zëri pune është 1 copë, ose 5 copë më pak se volumi i situacionuar, për pasojë vlera e këtij volumit është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Zëri 14. Bllok betoni 1mx1m për instalimin e shtyllave. Në preventivin bazë dhe në librin e masave dimensionet e bazamentit jepen 1mx1m. Sipas faktit, këto bazamente kishin dimensione më të vogla se 1mx1m, varionin 20x20cm deri 40x40 cm. Ky zë nuk është realizuar sipas specifikimeve, për pasojë vlera e këtij volumit është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Fondi rezervë. Sipas analizës së çmimeve për zërat e fondit rezervë një pjesë e zërave nuk janë bazuar në manualin e çmimeve sipas VKM nr.629 datë 15.07.2015.

Sipas manualit të çmimeve:

Çmimi punëtorisë është 185 lekë;

Çmimi skelë inventari është 130 lekë;

Çmimi gur fleksibël është 84 lekë;

Çmimi trapano elektrik është 95 lekë;

Çmimi kompresorit është 858 lekë;

Çmimi për dru dekorativ, astar për bojën, bojë me bazë uji mungon çmimi I referencës.

Zëri 1 Demontimi i ndriçuesve ekzistues-projektor. Në preventivin e fondit rezervë çmimi e këtij zëri pune është llogaritur 6,040 lekë, sipas çmimeve të sipër përmendura bazuar në manualin e çmimeve sipas VKM nr.629 datë 15.07.2015. Çmimi i rillogaritur është 1,488 lekë.

Nga rillogaritja, sipas çmimit të ri vlera e këtij volumit prej 377,816 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Zëri 2 Demontimi i stafave montuese. Në preventivin e fondit rezervë çmimi e këtij zëri pune është llogaritur 2,840 lekë, sipas çmimeve të sipër përmendura bazuar në manualin e çmimeve sipas VKM nr.629 datë 15.07.2015. Çmimi i rillogaritur është 488 lekë.

Nga rillogaritja, sipas çmimit të ri vlera e këtij volumit prej 195,216 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Zëri 3 Demontim i ndriçuesve ekzistues Neon 60-120cm. Në preventivin e fondit rezervë çmimi e këtij zëri pune është llogaritur 1,283.43 lekë, sipas çmimeve të sipër përmendura bazuar në manualin e çmimeve sipas VKM nr.629 datë 15.07.2015. Çmimi i rillogaritur është 709 lekë.

Nga rillogaritja, sipas çmimit të ri vlera e këtij volumit prej 32,167 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Zëri 4 Demontimi i linjave ekzistuese - Kabull ABC - 25mm². Në preventivin e fondit rezervë çmimi e këtij zëri pune është llogaritur 133 lekë, sipas çmimeve të sipër përmendura bazuar në manualin e çmimeve sipas VKM nr.629 datë 15.07.2015. Çmimi i rillogaritur është 39 lekë.

Nga rillogaritja, sipas çmimit të ri vlera e këtij volumit prej 94,000 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Zëri 5 Veshje me dru dekorativ të shtyllave për përshtatjen e tyre me model dekorativ. Në preventivin e fondit rezervë çmimi e këtij zëri pune është llogaritur 6,925 lekë, sipas çmimeve të sipër përmendura bazuar në manualin e çmimeve sipas VKM nr.629 datë 15.07.2015. Çmimi i rillogaritur është 5,662 lekë.

Nga rillogaritja, sipas çmimit të ri vlera e këtij volumit prej 5,052 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Për këtë investim rezultoi se nuk argumentohet apo justifikohet vlera prej 1,622,607 lekë pa tvsh, e përfituar nga sipërmarrësi, për llogaritje të gabuara nga fakti i punës së realizuar.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

- **Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve** OE òA&E.Eò sh.p.k. nuk kanë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në:

7) Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, ku përcaktohet se:

“Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit.”

8) Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve me nr. 5270/8 prot, datë 11.12.2020.

- **Nga ana e kolaudatorit të punimeve** òA.SH.Eò sh.p.k.nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në:

7) Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 12, ku përcaktohet se:

“Të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 duhet t'i nënshtrohen kolaudimit tekniko ekonomik, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse: 1. objekti është realizuar në kushtet teknike; 2. objekti është realizuar në përputhje me kontratën dhe anekset e saj; 3. çmimet e aplikuar janë sipas përcaktimeve të kontratës; 4. në këtë akt verifikohen edhe kërkesat e zbatuesit të paraqitura gjatë zbatimit të punimeve”

8) Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3 ku përcaktohet se:

Kolaudatori ose grupi i kolaudimit duhet të verifikojë me përgjegjësi:

a. Realizimin e objektit, në përputhje me projektin, lejen e ndërtimit, standardet dhe rregullat teknike.

b. Realizimin e objektit, në përputhje me kontratën e nënshkruar.

c. Përputhjen e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi.

Titulli i Gjetjes:

Mbi Procedurën e Konkurrimit: “Realizimin me çelësa në dorë të projektit elektrik për ndriçimin e jashtëm të Kalasë së Gjirokastrës”

Situata:1	<p>1.Nga auditimi i zhvillimit të procedurës u konstatua se është mbajtur procesverbali për llogaritjen e fondit limit në datën 23.09.2020, në të njëjtën datë që është ngritur Urdhri i Zhvillimit të procedurës. Ky procesverbal është mbajtur nga Njësia e hartimit të dokumenteve të procedurës së konkurrimit publik edhe pse nuk ka asnjë urdhër që ky komision do të hartonte llogaritjen e fondit limit.</p> <p>2.Fondi limit ka dalë në vlerën 20,500,000 lekë pa tvsh. Nga auditimi konstatohet se tre ofertat e marra në treg nuk përmbajnë datë, pra nuk mund të vërtetohet nëse këto oferta janë reale për kohën e zhvillimit të kësaj procedure.</p> <p>3.Gjithashtu nga auditimi konstatohet se në llogaritjen e fondit limit nuk ka asnjë preventiv fillestar apo planimetri të objektit dhe se si kanë dalë këto zëra dhe sasitë e secilës prej tyre.</p>
Kriteri:	Vkm nr.425, Datë 27.5.2020 <i>o</i> Për Procedurat E Përzgjedhjes Së Subjekteve Të Pajisura Me Licencë Për Projektim, Zbatim, Mbikëqyrje Dhe Kolaudim Në Pasuritë Kulturore, Për Kryerjen E Investimeve Me Fonde Publike Në Pasuritë Kulturore
Ndikimi/efekti:	-Marrja e tre ofertave pa datë ndikon në llogaritjen e saktë të fondit limit pasi nuk dihet nëse këto oferta janë aktuale apo jo. Nga Mungesa e preventivit fillestar apo planimetri të objektit konstatohet se nuk është e qartë se si kanë dalë zërat dhe sasitë .
Shkaku:	-Mos ngritja e komisionit të hartimit të llogaritjes së fondit limit. -Marrja e tre ofertave pa datë. - Mungesa e preventivit fillestar apo planimetri të objektit.
Rëndësia e shkeljes:	E mesme
Rekomandimi	-Nga ana e MK, të merren masa që në çdo procedurë konkurrimi , llogaritja e fondit limit të bëhet në bazë të ofertave reale dhe të përkohet në kohën e zhvillimit të procedurës së konkurrimit. - Nga ana e Ministrisë së Kulturës të ngrihet një grup pune me qëllim verifikimin e planimeve dhe preventivave fillestarë të Kalave, objekte të investimeve.

Titulli i gjetjes:	Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin <i>o</i> Realizimin me çelësa në dorë të projektit elektrik për ndriçimin e jashtëm të kalasë së Gjirokastrës
Situata:	<p>Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, për objektin: <i>o</i>Realizimin me çelësa në dorë të projektit elektrik për ndriçimin e jashtëm të kalasë së Gjirokastrës, si dhe nga verifikimi i kryer në terren në prezencë të përfaqësuesve të KLSH, Ministrisë së Kulturës dhe Mbikëqyrësit të punimeve rezultuan që janë përfshirë në situacion punime të cilat nuk janë realizuar si dhe çmimet e reja nuk janë bazuar në manualin e çmimeve sipas VKM nr.629 datë 15.07.2015.</p> <p>Këto diferenca rezultuan në zërat si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> o Zëri <i>o</i>Çift Projektore të montuar në shtyllë, me optikë, ekran anti-verbim, fluksi i daljes min.9000lm dimërueshëm. Vlera prej 443,700 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve. o Zëri <i>o</i>Krah për montimin e projektorëve në shtyllë. Vlera prej 244,240 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve. o Zëri <i>o</i>Blok betoni 1mx1m për instalimin e shtyllave. Vlera prej 196,416 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve. o Zëri <i>o</i>Sensor Muzgu. Vlera prej 34,000 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve. o Fondi rezervë. Referuar analizës së çmimeve për zërat e fondit rezervë, një pjesë e zërave nuk janë bazuar në manualin e çmimeve sipas VKM nr.629 datë 15.07.2015. <p>Zëri 1-Demontimi i ndriçuesve ekzistues-projektor. Vlera prej 377,816 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.</p> <p>Zëri 2-Demontimi i stafave montuese. Vlera prej 195,216 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.</p>

	<p>Zëri 3- Demontim i ndriçuesve ekzistues Neon 60-120cm. Vlera prej 32,167 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.</p> <p>Zëri 4- Demontimi i linjave ekzistuese - Kabull ABC - 25mm². Vlera prej 94,000 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.</p> <p>Zëri 5-Veshje me dru dekorativ të shtyllave për përshtatjen e tyre me model dekorativ. Vlera prej 5,052 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.</p>
<p>Kriteri:</p>	<p>Situacioni i punimeve dhe librezat e masave jo në përputhje me faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 <i>o</i>Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit, i ndryshuar, Kreu III, <u>ku përcaktohet se:</u> <p>Neni 7: <i>“Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit.”</i></p> <p>Neni 12: <i>Të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 duhet t'i nënshtrohen kolaudit teknik ekonomik, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. objekti është realizuar në kushtet teknike; 2. objekti është realizuar në përputhje me kontratën dhe anekset e saj; 3. çmimet e aplikuar janë sipas përcaktimeve të kontratës; 4. në këtë akt verifikohen edhe kërkesat e zbatuesit të paraqitura gjatë zbatimit të punimeve. <ul style="list-style-type: none"> - Udhëzim Nr.2, datë 13.5.2005 <i>o</i>Për Zbatimin e Punimeve të Ndërtimit, Kreu II, <u>ku përcaktohet se:</u> <p><i>Pika 8.1 Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori. Zërat, sasi, çmimet jashtë kontratës dhe përdorimi i fondit rezervë në situacionin përfundimtar justifikohen me dokumentacionin përkatës</i></p> <p><i>Pika 8.3 Çmimet jashtë kontratës caktohen sipas analizave teknike në fuqi, me vlerën ekonomike më të mirë.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Udhëzim Nr. 3 datë 15.2.2001 <i>o</i>Për Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit të konkretisht Kreu II, Pika 3, <u>ku përcaktohet se:</u> <p><i>Kolaudatori ose grupi i kolaudit duhet të verifikojë me përgjegjësi:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> a. Realizimin e objektit, në përputhje me projektin, lejen e ndërtimit, standardet dhe rregullat teknike. b. Realizimin e objektit, në përputhje me kontratën e nënshkruar. c. Përputhjen e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi. <ul style="list-style-type: none"> - VKM nr.629 datë 15.07.2015 <i>o</i>Për Miratimin e Manualeve Teknike të Çmimeve të Punimeve të Ndërtimit dhe të Analizave Teknike të tyre, i ndryshuar. - Kontratës publike shërbime me nr. 4052/10 prot. datë 23.10.2020 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Ministria e Kulturës dhe Bashkimi i Operatorëve Ekonomik <i>o</i>RÖ sh.p.k. dhe <i>o</i>AL.Vö sh.p.k. Vlera e kontratës është 20,361,852 lekë pa tvsh / 24,434,222 lekë me tvsh. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 90 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës. - Aneks Kontrata nr.1 me nr.102/5 prot. me datë 29.01.2021 <i>o</i>Për një ndryshim në kontratën nr.4052/10 prot. datë 28.10.2020 me objekt : <i>o</i>Realizimin me çelësa në dorë të projektit elektrik për ndriçimin e jashtëm të Kalasë së Gjirokastrës. - Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me nr 5270/8 prot, datë 11.12.2020, midis Autoritetit Kontraktor Ministria e Kulturës dhe Operatorit Ekonomik <i>o</i>A&E.Eö sh.p.k., me vlerë të kontratës së shërbimit 355,895 lekë pa tvsh / 427,074 lekë me tvsh. - Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me OE <i>o</i>A.SH.Eö, me vlerë të kontratës së shërbimit 46,800 lekë me tvsh. - Miratimi i projektit me anë të vendimit nr.376 datë 06.11.2020, me nr.1014 prot. Datë 09.11.2020 miratuar nga kryetari i KKTKM znj. E.M.

	- Librezat e masave, situacionet pjesore, vizatimet As Built etj.
Ndikimi/Efekti	Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar efekt negativ ndaj buxhetit të shtetit me vlerë prej 1,622,607 lekë pa tvsh në fondet e Buxhetit të Shtetit.
Shkaku	Mungesë e kontrollit periodik te punimeve nga ana e Mbikëqyrësit.
Rëndësia	E lartë
Rekomandime	Ministria e Kulturës të marrë masat duke ngritur një grup pune për të saktësuar, njoftuar dhe kërkuar nga subjekti OE òRò shpk + òAL.Vò shpk, plotësimin e punimeve të pakryera sipas preventivit për vlerën 1,622,607 lekë me efekte negative ndaj buxhetit të shtetit.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi përfaqësuesi i Mbikëqyrësit të punimeve OE "A&E.E" sh.p.k., znj. E.Ç, sipas kontratës së mbikëqyrjes me nr 5270/8 prot, datë 11.12.2020.

VI. Procedura e Konkurrimit: "Ndërhyrje restauruese në Mozaikun e Tiranës"

-Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike

Është ngritur Urdhri nr.173, datë 19.03.2021, ku përcaktohet lloji i procedurës òProcedurë konkurrimiò të dhënat për pasuri kulturore, lloji i investimit: punë, fondi limit 102,598,981 lekë pa tvsh, komisioni i konkurrimit publik i përbërë nga E.K (NJVO), T.H (NJVO), A.O (NJVO), M.K (NJHDPK), K.Q (NJHDPK), K.M (NJHDPK).

Llogaritja e fondit limit është bërë nga NJHDKP bazuar mbi preventivin e projektit me projektues DRTK Tiranë miratuar nga Këshilli Kombëtar I Trashëgimisë Kulturore Materiale me vendimin nr. 148, datë 19.03.2021 dhe përcakton fondin limit në vlerën 102,598,981 lekë pa tvsh.

Është mbajtur procesverbali për hapjen e procedurës së prokurimit me nr.1455/5, datë 09.04.2021, ku citohet se në këtë procedurë janë paraqitur dy ofertues:

òFò Shpk, protokolluar në MK me nr.1832, datë 09.04.2021 me vlerë oferte.99,518,424 lekë pa tvsh;

BOE òAD-S shpkò dhe òGjò shpk, protokolluar në MK me nr.1838, datë 09.04.2021 me vlerë oferte 96,737,966 lekë pa tvsh.

Sipas VKM-së nr.425, datë 27.05.2020, Kreu II, neni 19 dhe 21: *"Njësia e vlerësimit hap ofertat ekonomike në datën, vendin dhe orën e caktuar në njoftimin për konkurrim në prani të të gjithë ofertuesve të pranishëm. Kryetari lexon ofertat ekonomike të paraqitura nga ofertuesit dhe dokumentacionin shoqërues. Procesverbali i hapjes së ofertave firmoset nga të gjithë të pranishmit. Ofertat ekonomike nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e njësisë së vlerësimit."*

Me Urdhrin e Ministrit të Kulturës me nr.273, datë 27.04.2021 është pezulluar procesi i vlerësimit të procedurës së konkurrimit publik, për shkak të fillimit të sondazheve arkeologjike të nisura nga Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Tiranë, përcjellë me shkresën nr.1970/2, datë 19.04.2021.

Komisioni I Vlerësimit të ofertave duhej të kishte kryer vlerësimin e ofertave ku në bazë të VKM-së nr.425, datë 27.05.2020, neni 23: *"Njësia e vlerësimit shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga ofertuesit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e hapjes së ofertave. Procesi i vlerësimit dokumentohet në një procesverbal dhe nënshkruhet nga anëtarët. Pas përfundimit të shqyrtimit, titullari i institucionit që zhvillon procedurën, njofton në formë shkresore dhe me postë elektronike ofertuesit pjesëmarrës për renditjen dhe vlerësimin e secilit prej tyre."*

Pra nga hapja e ofertave në datën 09.04.2021 dhe deri në datën 27.04.2021 kanë kaluar 16 ditë , periudhë në të cilën duhej të ishte kryer vlerësimi i ofertave.

Me shkresën nr.1970/6, datë 28.04.2021, Ju është përcjellë Urdhri i Ministrit të Kulturës dy operatorëve për pezullimin e vlerësimit të procedurës së prokurimit.

Subjekti òAD-Sò shpk me shkresën nr.2554, datë 18.05.2021 i kërkon Ministrisë pushimin e pezullimit të procedurës pasi vëzhgimet arkeologjike të cilat po zhvillohen në zonën e Mozaikut nuk është zona për të cilën kërkohet të zbatohet ndërhyrja.

Me Vendimin nr.25, datë 19.05.2021 është miratuar raporti i Sondazheve Arkeologjike .

Me shkresën nr.3193, datë 17.06.2021 nga Sekretari I Përgjithshëm i MK i është kërkuar Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore dhe Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore të japin

informacion të detajuar nëse këto sondazhe prekin/ndikojnë ose jo në realizimin e projektit òNdërhyrje restauruese në Mozaikun e Tiranës.

Me shkresën nr.351, datë 23.06.2021 të DRTKT, është kthyer përgjigje mbi informacionin e kërkuar për sondazhet arkeologjike ku shprehen se është caktuar të bëhen gërmime të cilat mund të ndikojnë mbi projektin e godinës por i takon Autoritetit Kontraktor që kryen këtë procedurë të vendosë mbi ecurinë e saj sipas legjislacionit në fuqi.

Me shkresën nr.2768/3, datë 02.07.2021 është mbajtur raporti I mbajtur nga Grupi I punës I ngritur me nr.362, datë 22.06.2021, I përbërë nga A.Q, M.T dhe R.C, ankesë e bërë nga operatori F. për shqyrtimin e ankesës me nr 2768, datë 27.05.2021.

Ky raport citon se në bazë të ankesës dhe pas vënies në dispozicion të gjithë dokumentacionit nga sektori I IT u konstatua se: Në sistem për këtë procedurë konkurrimi janë ngarkuar në sistem 3 DSKP me emërtimet si më poshtë:

DSKP mozaik dhe DSKP doc në datën 30 mars 2021 dhe DSKP Mozaik Finale është ngarkuar në sistem në datën 31 mars 2021 . Këto dokumente janë fshirë nga sistemi në datën 12 prill 2021.

Në dokumentin DSKP Mozaik Finale është hequr një nga kategoritë e licencave.

Në dokumentin DSKP Mozaik Finale është shtuar një inxhinier IT dhe 1 inxhinier elektrik.

Gjithashtu kanë ndodhur dhe disa ndryshime në Mozaik Final.

Për sa më sipër grupi i punës ka konstatuar:

Mosrespektimin e parimit të transparencës nga AK pasi janë fshirë/hequr nga sistemi DSKP për këtë procedurë, pra nuk ka patur transparencë në këtë proces për operatorët ekonomikë pjesëmarrës.

Grupi i punës ka propozuar pranimin e plotë të ankesës si dhe anulimin e procedurës.

Nga Ministri është ngritur Urdhri me nr.396, datë 02.07.2021 për pranimin e ankesës dhe anulimin e procedurës së konkurrimit nga Ministri i Kulturës.

Nga auditimi konstatohet se bazuar në VKM nr.425, datë 27.05.2020 si dhe Udhëzimit nr.269, datë 11.08.2020 “Për miratimin e dokumenteve standarde të konkurrimit publik, për përzgjedhjen e subjekteve të pajisura me licencë në projektim, zbatim mbikëqyrje dhe kolaudim në pasuritë kulturore për kryerjen e investimeve me fonde publike në pasuritë kulturore,” parashikohet që: Një kandidat që kërkon sqarime mbi dokumentet e konkurrimit publik duhet të bëjë kërkesë me shkrim drejtuar Komisionit të konkurrimit jo më vonë se 5 ditë para përmbushjes së afatit të hapjes së ofertave. Komisioni i konkurrimit do ti përgjigjet me shkrim kërkesës për sqarime Brenda dy ditëve nga depozitimi i kërkesës. Kopje me shkrim të përgjigjes do ti dërgohet të gjithë subjekteve që kanë kërkuar dokumentet e konkurrimit/kanë shprehur interes për pjesëmarrje.

Pra autoriteti kontraktor nuk duhej ta shqyrtonte ankesën pasi e para operatori nuk ka respektuar afatet e ankesës dhe ai ka dorëzuar ofertën e tij ekonomike pa pasur asnjë kundërshti . Gjithashtu në Udhëzim përcaktohet se “Me paraqitjen e ofertës ofertuesi pranon në mënyrë të plotë të gjitha afatet dhe kushtet e dokumenteve të konkurrimit dhe heq dorë nga kushtet e zbatimit të vet ofertuesit. Çdo klauzolë në ofertë në kundërshtim me këtë parashikim nuk do të vlerësohet ose do të çojë në refuzimin e ofertës.”

Nga ana e operatorit ekonomik është dorëzuar oferta ekonomike dhe nga operatori është plotësuar dhe firmosur Formulari I Ofertës Ekonomike.

Nga ana e autoritetit kontraktor nuk duhej të ishte pranuar ankesa dhe të ishte anuluar procedura pasi në raport dhe në vendim theksohet se procedura është anuluar vetëm për këtë shkak.

-Në lidhje mbi këto konstatime ka ardhur observacioni me nr1420/20, datë 06.02.2022.

Grupi i auditimit pasi i shqyrtoi observimet e paraqitura, mban këtë qëndrim si më poshtë vijon.

Qëndrimi i observimeve të MK, ku shprehen :

Lidhur me procedurën e konkurrimit òNdërhyrje restauruese në Mozaikun e Tiranës sqarohet se sic është bërë me dije në observacionin e mëparshëm se nuk kemi të bëjmë me kërkimin e sqarimeve mbi dokumentacionin e konkurrimit, por kemi të bëjmë me një ankesë në të cilën janë parashtruar dyshimet për ndryshimin e Dokumenteve Standarte të Konkurrimit pa u njoftuar ankuesi, nga ana e Ministrisë së Kulturës, sipas parashikimeve të akteve.Në këtë rast rezulton se nga Ana e Komisionit nuk janë respektuar parashikimet e Udhëzimit nr.269, datë 11.08.2020 pika 1, paragrafi 3,4

dhe 5 sepse objekti i ankimit të ofertuesit òFò shpk është i lidhur me një rrethanë të re dhe të paparashikuar të krijuar nga autoriteti kontraktor, ku ofertuesi ka dorëzuar ofertën e tij në Ministrinë e Kulturës në datën 09.04.2021 dhe ndërkohë në datën 12.04.2021, janë fshirë nga sistemi kriteret dhe kushtet e mëparshme duke ndryshuar DSKP . Fakti që nga subjekti F. nuk ka kërkuar sqarime tek Komisioni i Konkurrimit referuar konkluzionit të Grupit të Auditimit nuk përbën shkak për mospranimin e ankimit, sepse po nga ky Komision nuk janë respektuar parashikimet e udhëzimit, pasi ky subjekt tashmë kishte ofertuar dhe në këtë mënyrë ai i është drejtuar me ankesë tek Ministri i Kulturës, për parregullsi në zhvillimin e procedurës së konkurrimit publik. Në këtë mënyrë konkluzionet e Grupit të Auditimit në fund të faqes 93 dhe 94 nuk qëndrojnë sepse afati është 5 ditë pas marrjes në dijeni të vendimit të vlerësimit të ofertave dhe renditjes përfundimtare, ndërsa në këtë rast kemi të bëjmë me faktin se subjekti ka marrë dijeni për ndryshimin e DSKP pa njoftim dhe pa botimin përkatës ende pa u kryer , shpallur vlerësimi dhe renditja, dhe për këtë arsye i ka drejtuar ankesë Ministrin të Kulturës, për shkak se Komisioni ka vepruar sipas tin në keqbesim dhe në shkelje të dispozitave ligjore të lartpërmendura. Gjithashtu është e vërtetë që oferta ekonomike është dorëzuar pa kundërshti por është dorëzuar bazuar në kriteret dhe kushtet e shpallura deri në atë datë, që më pas rezultuan të ndryshuara pa asnjë lloj njoftimi. Për sa më sipër referuar rekomandimit tuaj shprehemi parimisht dakort, por sic jemi shpjeguar jemi të mendimit se ndryshimi i DSKP nuk është kryer si pasojë e ndërhyrjeve në faqen e Ministrisë, por si pasojë e kërkesave të personave të paaautorizuar për të kryer këto ndryshime, dhe ky aspekt ngelet për tu provuar nga grupi i punës që do të ngrihet për këtë qëllim.

-Përgjigje e grupit të auditimit të KLSH-së.

Nga auditimi konstatohet se bazuar në VKM nr.425, datë 27.05.2020 si dhe Udhëzimit nr.269, datë 11.08.2020 òPër miratimin e dokumenteve standarde të konkurrimit publik, për përzgjedhjen e subjekteve të pajisura me licencë në projektim, zbatim mbikëqyrje dhe kolaudim në pasuritë kulturore për kryerjen e investimeve me fonde publike në pasuritë kulturore, ò parashikohet që: Një kandidat që kërkon sqarime mbi dokumentet e konkurrimit publik duhet të bëjë kërkesë me shkrim drejtuar Komisionit të konkurrimit jo më vonë se 5 ditë para përmbushjes së afatit të hapjes së ofertave. Komisioni i konkurrimit do ti përgjigjet me shkrim kërkesës për sqarime Brenda dy ditëve nga depozitimi I kërkesës. Kopje me shkrim të përgjigjes do ti dërgohet të gjithë subjekteve që kanë kërkuar dokumentet e konkurrimit/kanë shprehur interes për pjesëmarrje.

Pra autoriteti kontraktor nuk duhej ta shqyrtonte ankesën pasi e para operatori nuk ka respektuar afatet e ankesës dhe ai ka dorëzuar ofertën e tij ekonomike pa pasur asnjë kundërshti . Gjithashtu në Udhëzim përcaktohet se òMe paraqitjen e ofertës ofertuesi pranon në mënyrë të plotë të gjitha afatet dhe kushtet e dokumenteve të konkurrimit dhe heq dorë nga kushtet e zbatimit të vet ofertuesit. Çdo klauzolë në ofertë në kundërshtim me këtë parashikim nuk do të vlerësohet ose do të çojë në refuzimin e ofertës. ò

Nga auditimi konstatohet se nga grupi i punës nuk janë të dokumentuara dhe të provuara se dyshimet e ankuesit ishin të bazuara.

Në këtë procedurë është kryer një anulim pa vërtetuar faktet dhe cfarë ka ndodhur nëse ka pasur ndërhyrje apo jo në serverin e faqes së Ministrisë së Kulturës.

Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.

Titulli i Gjetjes:	<i>Mbi Procedurën e Konkurrimit: Ndërhyrje restauruese në Mozaikun e Tiranës</i>
Situata:	Nga auditimi i procedurës òNdërhyrje Restauruese në Mozaikun e Tiranës ò konstatohet se është ngritur grupi I punës me nr.362, datë 22.06.2021, për shqyrtimin e ankesës lidhur me hedhjen në sistem të tre DSK të ndryshme mbi procedurën e konkurrimit. Bazuar në VKM nr.425, datë 27.05.2020 si dhe Udhëzimit nr.269, datë 11.08.2020 òPër miratimin e dokumenteve standarde të konkurrimit publik, për përzgjedhjen e subjekteve të pajisura me licencë në projektim, zbatim mbikëqyrje dhe kolaudim në pasuritë kulturore për kryerjen e investimeve me fonde publike në pasuritë kulturore, ò autoriteti kontraktor nuk duhej ta shqyrtonte ankesën pasi operatori nuk ka respektuar afatet e ankesës dhe ai ka dorëzuar ofertën e tij ekonomike pa pasur asnjë kundërshti. Nga ana e autoritetit kontraktor është ngritur Urdhri me nr.396, datë 02.07.2021 për pranimin e ankesës dhe anulimin e procedurës së konkurrimit pasi sipas grupit të punës së shqyrtimit të ankesës nuk është respektuar parimi i transparencës nga AK pasi janë fshirë/hequr nga sistemi DSKP për këtë procedurë, pra nuk ka patur transparencë në këtë proces për operatorët ekonomikë pjesëmarrës.
Kriteri:	Vkm nr.425, Datë 27.5.2020 òPër Procedurat E Përzgjedhjes Së Subjekteve Të Pajisura Me Licencë Për Projektim, Zbatim, Mbikëqyrje Dhe Kolaudim Në Pasuritë Kulturore, Për Kryerjen E Investimeve Me Fonde Publike Në Pasuritë Kulturore.

Ndikimi/efekti:	Shkelje e legjislacionit shqiptar në fuqi dhe gjithashtu cënimi rëndë i procesit të konkurrimit pasi është legjitimuar që një operator të ankimojë kriteret e dokumenteve të konkurrimit pasi janë njohur me këto dokumente dhe kanë paraqitur ofertat e tyre në kundërshtim me Udhëzimin e nxjerrë nga vet Ministri dhe gjithashtu nga VKM e cila legjitimon procesin e ankimit në fazën e daljes së vendimit të shpalljes së fituesit. Anullimi i Procedurës për shkaqe të pa legjitimua. Cënimi i sigurisë së faqes së internetit së Ministrisë së Kulturës.
Shkaku:	Shqyrtimi i ankesës pa respektuar afatet e ankesës. Ndërhyrje në faqen e Ministrisë së Kulturës për të cilën nuk është mbajtur asnjë përgjegjësi mbi personat që e kanë shkaktuar atë.
Rëndësia e shkeljes:	E lartë
Rekomandimi	-Nga ana e Ministrisë së Kulturës të ngrihet një grup pune me qëllim evidentimin e ndërhyrjeve që janë bërë në faqen zyrtare të Ministrisë së kulturës dhe nxjerrjen e përgjegjësve që e kanë shkaktuar këtë situatë.

VII. Procedura e Konkurrimit: “Restaurim i çatisë së banesës së S.Sh, Tiranë (Faza e Emergjencës)”

-Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike .

Është ngritur Urdhri nr.305, datë 08.09.2020, ku përcaktohet lloji i procedurës oProcedurë konkurrimi o të dhënat për pasuri kulturore, lloji i investimit: punë , fondi limit 1,250,000 lekë pa tvsh, komisioni i konkurrimit publik i përbërë nga E.K (NJVO), N.T (NJVO), T.H (NJVO), E.P (NJHDPK), B.H (NJHDPK), A.O (NJHDPK).

Është mbajtur procesverbali për llogaritjen e fondit limit në datën 09.09.2020.

Sipas Procesverbalit të mbajtur ky komision ka përcaktuar fondin limit bazuar mbi preventivin e projektit hartuar nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore në vlerën 1,250,000 lekë pa tvsh, miratuar me vendimin nr.328, datë 10.10.2019 nga KKR.

Nga auditimi konstatohet se në vendimin nr 328, datë 10.10.2019, KKR është cituar se nevojitet ndërhyrje emergjente si pasojë e tërmetit të shtatorit por në fakt procedura është realizuar në shtator të vitit 2020, pra rreth një vit më vonë. Nëse do të ishte emergjencë procedura duhej të realizohej në atë periudhë, fakti që është realizuar një vit më vonë domethënë që ska pasur emergjencë.

Në preventivin e punimeve të hartuara nga Ing.E.M nga Instituti i Monumenteve të Kulturës, shihen zëra punimesh që nuk kanë të bëjnë me ndërhyrjen emergjente në çatinë e këtij objekti, por punime të ndryshme si më poshtë:

PREVENTIV PUNIMESH

Objekti: Ndërhyrje emergjente ne Banesën e S.Sh Tirane

N r.	Analiza	Lloji i punimit	Njësia	Sasia
I. PUNIME SHITESASH				
1	2.426	Heqje pllakash	m ²	50
2	R. 64	Shtrese rëre	m ³	100
3	R. 73	Shtrese tulla te plota (rate) mbi rëre	m ³	50
4	R. 77	Dysheme druri (sofat)	m ²	8
5	R. 78	Restaurim dysheme druri	m ²	20

6	R. 78/1	Prishje dysheme druri (sofat)	m ²	8
II. PUNIME DYER DRITARE				
7	R. 104	F. V. grila druri	m ²	10
III. PUNIME BOJATISJE				
8	R. 105	Sherbetisje e bojatisje me gëlqere	m ²	350
9	R. 107	Lyerje sipërfaqe druri me antimol	m ²	150
10	R. 108	Lyerje sipërfaqe druri me vaj lini	m ²	150
11	R.60	Restaurim strehe çatie tjegulla vendi me dekor	m ³	7374
V. PUNIME TE NDRYSHME				
12	R 1/1	Heqje dherash dhe transport me karro dore	m ³	40
13	R. 113	Restaurim breza duri dhe arkitrare, dru pishë e stazhionuar	m ³	5
14	R. 132	Pastrim i fasades nga pluhuri dhe depozitimet sipërfaqesore me uje me pompe me presion (idropultrice)	m ³	200
15	2.37/5b	Transport materiale ndertimi, dheu dhe mbeturina me auto deri 10.0 km	m ³	40

Pra vihet re se zërat më të shumtë janë për një restaurim total të objektit dhe zëri “Restaurim strehe çatie tjegulla vendi me dekor” zë një pjesë shumë të vogël të këtij preventivi dhe e llogaritur në vlerën 221,220 lekë pa tvsh.

Është mbajtur procesverbali me nr.3751/1, datë 09.09.2020 për hartimin e dokumenteve standarte të konkurrimit publik.

-Mbi auditimin e realizimit të procedurës në bazë të DST dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues.

Në datën 29.09.2020 është mbajtur procesverbali për hapjen e procedurës së konkurrimit ku citohet se është paraqitur një operator ekonomik BOE ò6D-Pò shpk & òBM-Kò shpk.

Është mbajtur procesverbali i vlerësimit me nr.3751/3, datë 05.10.2020 ku është vendosur të shpallet fitues BOE ò6D-Pò shpk & òBM-Kò shpk.shpk me vlerë oferte 1,067,676 lekë pa tvsh.

-Lidhja e kontratës.

Është lidhur kontrata me nr.3751/5, datë 09.10.2020 midis Ministrisë së Kulturës dhe BOE ò6D-Pò shpk & òBM-Kò shpk.shpk me vlerë 1,067,676 lekë pa tvsh.

Zbatimi i Kontratës

Është likuiduar me Urdhër ó Shpenzimin nr.797, datë 31.12.2020 në vlerën 1,202,900 lekë me tvsh në bazë të Situacionit përfundimtar.

Nga auditimi në terren për të cilën është mbajtur dhe aktverifikimi me nr.1,protokolluar në MK me nr.1332, datë 07.03.2022, u konstatua se gjatë zbatimit nuk janë kryer zërat:

Restaurim strehë çatie tjegulla vendi me dekor, sasia 30m³, me vlerë totale 189,690 lekë pa tvsh.

Por është realizuar zëvendësimi i traut të thyer të çatisë. Analiza e çmimit për heqjen dhe vendosjen e traut e llogaritur nga ana e audituesve është 94,479 lekë.

-Në lidhje mbi këto konstatime kanë observuar me shkresë nr.1420/19 prot, datë 27.05.2022

Grupi i auditimit pasi i shqyrtoi observimet e paraqitura, mban këtë qëndrim si më poshtë vijon.

Qëndrimi i observimeve të MK, ku shprehen :

Observacion mbi Projekt Raportin për Akt konstatimin nr.10, Mbikëqyrësi i punimeve dhe Sipërmarrësi i punimeve sqarojnë se : Proçes Verbali që ne kemi dorëzuar nuk e përmban këtë vlerë të analizuar për arsye se trau i baballëkut të shtëpisë u ble i gatshëm nga kompania e ndërtimit dhe u vendos. për këtë gjë u morën tre oferta nga kompani të

ndryshme për ta realizuar si proces pune. Ashtu siç jemi shprehur dhe në observacionin e parë që trau i drurit kishte çmimin më të lartë se ai i preventivit, u ra dakortësi midis palëve, të zotëve të shtëpisë dhe firmës që si çmim të mbulonte problemin e traut. Më poshtë ju vemë në dispozicion ofertën e tre firmave që janë marrë për procesin e punës Blerje trau pishe 50x50, 15 ml të gjatë, paproçesin e punës vendosje.

-Përgjigje e grupit të auditimit të KLSH-së.

Pas shqyrtimit të observacioneve grupi i auditimit konstaton se dy ofertat bashkëlidhur observacionit nuk përmbajnë datën kur është marrë si ofertë, nuk janë nga letra zyrtare të kompanive që ofertojnë (të kenë të dhënat e kompanisë), dhe është furnizim vendosje. Pra ofertat që janë dërguar nuk do të merren në konsideratë.

Por duke marrë parasysh faktin që si proces pune është realizuar bazuar në manualin e çmimeve sipas VKM nr.629 datë 15.07.2015 zë i ngjashëm është marrë Zëri 2.292 i cili është modifikuar si mëposhtë:

Nr. Kodi	EMERTIMI	Njesia	PUNTORI			TRANSPORT			MAKINERI			MATERIAL			Shuma	Shp 8%	Fitim 10%	TOTALI
			op	çmimi	Vlefte	T*km	çmimi	Vlefte	o.p	çmimi	Vlefte	Sasia	çmimi	Vlefte				
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19
2.292/mod	Trare tavani te sharruar	m2																
	Sp + p		5	185	925													
	Siqurime shoqerore 16.7%	leke	925	0,167	154													
	Transport	T*km				12,00	21	252,0										
	Derrase pishe fm e stazhionuar	m3										0,25	28420	7105				
	Bitum M 3	kg										0,1	90	9				
	Gozhde	kg										0,01	90	0,9				
	Skele inventar	m2										1,2	130	156				
	Te ndryshme 1 %	leke										7271	1%	72,709				
	Shuma :				1079			252,0						7344	8675	694	868	10237
2.426/4mod	Heqje trare druri	m3																
	Sp + p		25,7	125	3213													
	Siqurime shoqerore 16.7%	leke	3213	0,167	536													
	Transport	T*km				12	21	252										
	Shuma :				3749			252							4001	320	400	4721

respektivisht Zëri 2.292/mod. Trarë tavani te sharruar çmimi është 10,237 lekë/m2 për trau me përmasa 0.50x0.50x15 m, vlera është 76,775 lekë.

Dhe zëri 2.426/4 mod. Heqje trarë druri çmimi është 4,721 lekë/m3 për trau me përmasa 0.50x0.50x15 m, vlera është 17,704 lekë. Totali heqje vendosje trau është 94,479 lekë.

Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.

Titulli i Gjetjes:	<i>Mbi Procedurën e Konkurrimit: "Restaurim i çatisë së banesës së S.SH , Tiranë (Faza e Emergjencës)"</i>
Situata	Nga auditimi në terren i kontratës me nr.3751/5, datë 09.10.2020 midis Ministrisë së Kulturës dhe BOE ò6D-Pòshpk & òBM-Kò shpk.shpk me vlerë 1,067,676 lekë pa tvsh u konstatua se gjatë zbatimit nuk janë kryer zërat: Restaurim strehë çatie tjegulla vendi me dekor, sasia 30m3, me vlerë totale 189,690 lekë pa tvsh. Por është realizuar zëvendësimi i traut të thyer të çatisë. Analiza e çmimit për heqjen dhe vendosjen e traut e llogaritur nga ana e audituesve është 94,479 lekë.
Kriteri:	Vkm nr.425, Datë 27.5.2020 òPër Procedurat E Përzgjedhjes Së Subjekteve Të Pajisura Me Licencë Për Projektim, Zbatim, Mbikëqyrje Dhe Kolaudim Në Pasuritë Kulturore, Për Kryerjen E Investimeve Me Fonde Publike Në Pasuritë Kulturoreò
Ndikimi/efekti:	Si pasojë e mangësive të mësipërme shpenzimi i pajustificuar është shuma me vlerë 95,211 lekë pa tvsh.
Shkaku:	Ndryshimi i zërit R.60 Restaurim strehë çatie tjegulla vendi me dekor në preventivin fillestar i pa justifikuar me dokumentacion mbështetës.
Rëndësia e shkeljes:	E lartë
Rekomandimi	Nga Ministria e Kulturës të merren masa për arkëtimin e shumës së përfutur padrejtësisht në vlerën 95,211 lekë pa tvsh.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi : Mbikëqyrësi i Punimeve O.P.

VIII. Procedura e Konkurrimit: "Restaurim i pjeshëm i tavanit me dekoracione murale ne ish muzeun popullor, kulla Inglizit, Shkodër"

-Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike .

Është ngritur Urdhri nr.398, datë 01.09.2020, ku përcaktohet lloji i procedurës òProcedurë konkurrimiò të dhënat për pasuri kulturore, lloji i investimit: punë , fondi limit 1,250,000 lekë pa

tvsh, komisioni i konkurrimit publik i përbërë nga E.K (NJVO), T.H (NJVO), A.O (NJVO), E.P (NJHDPK), B.H (NJHDPK), N.T (NJHDPK).

Është mbajtur procesverbali për llogaritjen e fondit limit në datën 07.09.2020

Sipas Procesverbalit të mbajtur ky komision ka përcaktuar fondin limit bazuar mbi preventivin e projektit hartuar nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore në vlerën 1,250,000 lekë pa tvsh, miratuar me vendimin nr.209, datë 21.07.2020

Është mbajtur procesverbali me nr.3617/1/1, datë 07.09.2020 për hartimin e dokumenteve standarte të konkurrimit publik.

-Mbi auditimin e realizimit të procedurës në bazë të DST dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues.

Në datën 29.09.2020 është mbajtur procesverbali për hapjen e procedurës së konkurrimit ku citohet se është paraqitur një operator ekonomik BOE ò6D-Pòshpk & òBM-Kò shpk.

Është mbajtur procesverbali i vlerësimit me nr.3617/3/10, datë 05.10.2020 ku është vendosur të shpallet fitues BOE ò6D-Pòshpk & òBM-Kò shpk. me vlerë oferte 1,016,142 lekë pa tvsh.

-Lidhja e kontratës.

Është lidhur kontrata me nr.3617/5, datë 09.10.2020 midis Ministrisë së Kulturës dhe BOE ò6D-Pò shpk & òBM-Kò shpk.shpk me vlerë 1,016,142 lekë pa tvsh.

Afati i realizimit të kontratës është vendosur vetëm në DST ku përcaktohet 90 ditë nga dita e nënshkrimit të kontratës.

Me shkresën nr.3617/7, datë 09.10.2020 nga Ministria e Kulturës i është kërkuar Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore caktimi i një mbikëqyrësi për zbatimin e kontratës, e cila ka vendosur tre mbikëqyrës me shkresën nr 2066/1, datë 13.10.2020 përkatësisht: F.M, G.V dhe G.T.

Më pas nga Ministria e Kulturës me Shkresën nr.4948/5, datë 30.12.2020 (dy muaj e gjysmë nga fillimi i kontratës) ka dërguar një shkresë Institutit Kombëtar të Trashëgimisë dhe operatorit ekonomik òMbi konstatimin e pamundësisë së realizimit të kontratës për shkak të ndryshimeve të vlerës së projektit. Në të cilën citohet se me vendimin nr.446, datë 03.12.2020 të KKTKM është rishikuar projekti i këtij objekti. Rishikimi i këtij projekti konsiston dhe në tejkalimin e fondeve mbi vlerën 20% nga vlera e kontratës. Sipas autoritetit kontraktor vlera e ndryshuar me shumë se parashikimet kontraktore përbën shkak për zgjidhjen e kontratës për pasojë në mosrealizimin e objektit të saj.

IX. Procedura e Konkurrimit: “Restaurimi, Rikonstruksioni dhe Rehabilitimi i Hapësirave në Muzeun Kombëtar të Arteve të Bukura (Galeria e Arteve)”

-Auditimi i hartimit të fondit limit, vendosjen e specifikimeve teknike

Është ngritur Urdhri nr.172, datë 19.03.2021, ku përcaktohet lloji i procedurës òProcedurë konkurrimiò të dhënat për pasuri kulturore, lloji i investimit: punë, fondi limit 1,130,329,899 lekë pa tvsh, komisioni i konkurrimit publik i përbërë nga A.Xh (NJVO), A.O (NJVO), O.P (NJVO), E.K (NJHDPK), D.A (NJHDPK), T.H (NJHDPK).

Llogaritja e fondit limit është bërë nga NJHDKP bazuar mbi preventivin e projektit me projektues DRTK Tiranë miratuar nga Këshilli Kombëtar I Trashëgimisë Kulturore Materiale dhe përcakton fondin limit në vlerën 1,130,329,899 lekë pa tvsh.

Me shkresën nr.1451/1, datë 19.03.2021, janë miratuar dokumentet standarde të konkurrimit.

Është mbajtur procesverbali për hapjen e procedurës së prokurimit me nr.1451/4, datë 14.04.2021, ku citohet se në këtë procedurë janë paraqitur tre ofertues:

1-BOE ò A-S shpk, AD-S shpkò dhe òIò shpk, protokolluar në MK me nr.1917, datë 14.04.2021 me vlerë oferte 1,004,953,715 lekë pa tvsh.

2. BOE òFò.Shpk dhe R shpkò protokolluar në MK me nr.1918, datë 14.04.2021 me vlerë oferte.1,096,421,016 lekë pa tvsh.

3. BOE ò4A-M Shpk, K.shpk dhe I&CD shpkò protokolluar në MK me nr.1916, datë 14.04.2021 me vlerë oferte.936,234,014 lekë pa tvsh.

Anëtarët e Njësisë së Vlerësimit të Ofertave kanë dalë me dy vlerësime të ndryshme përkatësisht:

Anëtari O.P me shkresën nr.2295/1, datë 05.05.2021 ka mbajtur procesverbalin ku ka vlerësuar në vend të parë operatorin F.shpk, i cili ka qenë dhe operatori me vlerën më të lartë dhe ka skualifikuar dy operatorët e tjerë.

Anëtarët , A.Xh dhe A.O kanë mbajtur procesverbalin për vlerësimin e procedurës me nr.1451/6, datë 10.05.2021 ku kanë renditur në vend të parë operatorin me vlerë ofertë më të ulët BOE ò4A-M Shpk, K.shpk dhe I&CD shpk me vlerë oferte.936,234,014 lekë pa tvsh.

Nga titullari i autoritetit kontraktor është miratuar raporti përmbledhës ku është shpallur fitues operatorin me vlerë më të vogël BOE ò4A-M Shpk, K.shpk dhe I&CD shpk me vlerë oferte 936,234,014 lekë pa tvsh.

Është lidhur kontrata midis BOE ò4A-M Shpk, K.shpk dhe I&CD shpk dhe Ministrisë së Kulturës me nr.3047, datë 10.06.2021. Kontrata është në zbatim.

X. Procesi i zbatimit të punimeve në objektin “Rikonstruksioni i aneksit të Bibliotekës Kombëtare (fondi i Biblotekës Kombëtare)”

Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës publike shërbime me nr. 16246/10 prot datë 03.12.2020 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Ministria e Kulturës, të përfaqësuar nga sekretari i përgjithshëm znj. E.Ç dhe Operatorit Ekonomik òLKò sh.p.k., me përfaqësues z. F.Sh , me NIPT K71....., liçencë në zbatim NZ.5621/23. Vlera e kontratës është 41,192,400 lekë pa tvsh / 44,636,849 lekë me tvsh. Afati zbatimit të kontratës fillon nga data e nënshkrimit të saj nga palët dhe do të përfundoj në dhjetor 2022, e ndarë në 3(tre) faza kontratës.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me nr 5346/8 prot, datë 14.12.2020, midis Autoritetit Kontraktor Ministria e Kulturës, të përfaqësuar nga sekretari i përgjithshëm znj. E.Ç dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomik òM.Sò sh.p.k. & òA&E.ò sh.p.k. përfaqësuar nga Z. G.K me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1476/11, si dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 305,808.54 lekë pa tvsh / 366,970.24 lekë me tvsh.

Miratimi i lejes

Mungon leja për miratimin e ndërhyrjes nga KKTKM.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se dorëzimi i sheshit të ndërtimit dhe fillimi i punimeve, proces verbali i fillimit të punimeve, sipas njoftimeve përkatëse është bërë në datën 18.11.2020. Punimet duhet të përfundojnë në datën 31.12.2022, deri me tani janë kryer punime deri në situacionin nr.3 më datë 22 dhjetor 2021, ku janë situacionuar 98.9 % e punimeve.

Është bërë kërkesë në datën 08.06.2021 nga sipërmarrësi i punimeve (kontraktori) drejtuar mbikëqyrësit të punimeve, për miratimin e ndryshimit të volumeve, preventivin e ripunuar dhe projektin e rishikuar. Gjithashtu janë mbajtur proçes verbal përkatëse për miratimet e ndryshimeve dhe tabelat e balancimit të volumeve dhe preventivi i rishikuar.

Me anë të letrës nr.extra Prot. me datë 08.06.2021 me lëndë Kërkesë mbi përdorimin e fondit rezervë, Mbikëqyrësi i punimeve përfaqësuar nga ing.T.S i drejtohet Autoritetit Kontraktor Ministrisë së Kulturës, në lidhje me argumentet për përdorimin e fondit rezervë

- Konstatime të projekt-preventivit dhe legjislacioni i ndërtimit.

Nga verifikimi në objekt konstatohet se janë realizuar punime në objekt të ndryshme nga përcaktimi i tyre në preventiv dhe në situacion, të cilat renditen si më poshtë:

1. Ulluk shkarkimi vertikal bakri janë 6 copë në fasadën ballore dhe 6 copë në fasadën e pasme.
2. Gjelbërimi nuk ndodhej në objekt.
3. Kompjuter, Monitor 19ò për CCTV+Mouse+Tastiera nuk ndodheshin në objekt.
4. Ndriçues tip 6 ishin 116 copë nga 124 që ishin situacionuar.

Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

5) Dokumentacioni teknik i zbatimit: Projekt preventivi, Libri i masave, ditarët e objektit etj. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Rikonstruksioni I aneksit të Bibliotekës Kombëtare (fondi I Bibliotekës Kombëtare)”			
14.Lidhja e kontratës nr. 16246/10 prot datë 03.12.2020	15.Vlera e kontratës (me tvsh) 44,636,849 lekë OE fitues “L.K” sh.p.k.		16.Likuiduar deri dt Datë 22 dhjetor 2021 likuiduar 44,142,252 lekë
17- Situacioni Përfundimtar	18.Afati i kontratës në dite Nga data e lidhjes së kontratës deri dhjetor 2022 (730 ditë)		19. Zgjatja e kontratës Nuk ka
20. Mbikëqyrësi i punimeve BOE ððMö. Studioö sh.p.k. & öA&E.Eö sh.p.k.	Licenca Nr: MK 1476/11	Kontrata me nr. 5346/8 prot. datë 14.12.2020	
21. Kolaudatori i punimeve	Licenca Nr:	Kontrata	
22.Akt Kolaudimi	23.Akt i marrjes në dorëzim		

Nga auditimi i librezave të masave, projektit dhe preventivit bazë, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor.

Tabela nr. 1

Nr	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
							Vol.	Vlera
F.5	Ulluk shkarkimi vertikal bakri	m	3,235	112	112	103.32	8.68	28,079
H.3	Gjelbërimi	copë	5,000	10	10	0	10	50,000
L.57	Ndriçues Tip 6 (Sipas Arkitektures).	copë	14,500	124	124	116	8	116,000
L.72	Monitor 19ö për CCTV+Mouse+Tastiera	copë	38,500	1	1	0	1	38,500
L.80	Kompjuter	copë	53,126.15	6	6	0	6	318,756
							Total	551,336

Zëri - Ulluk shkarkimi vertikal bakri. Në situacion dhe libri i masave ky zë pune ka gjatësi 112 m. Nga verifikimit në terren, ky zë pune në fasadën ballore ka 6 ullukë, në total në një gjatësi prej 103.32 m.

Zëri Gjelbërimi. Në situacion dhe në librin e masave sasia e këtij zëri pune është 10 copë. Sipas faktit, ky zë pune nuk ndodhej në objekt edhe pse ishte situacionuar sasia prej 10 copësh.

Zëri Ndriçues Tip 6 (Sipas Arkitektures). Në situacion dhe në librin e masave sasia e këtij zëri pune është 124 copë. Sipas faktit, ky zë pune figuron në sasinë 116 copë.

Zëri Monitor 19” për CCTV+Mouse+Tastiera. Në situacion dhe në librin e masave sasia e këtij zëri pune është 1 copë. Sipas faktit, ky zë pune nuk ndodhej në objekt edhe pse ishte situacionuar sasia prej 1 copë.

Zëri Kompjuter. Në situacion dhe në librin e masave sasia e këtij zëri pune është 6 copë. Sipas faktit, ky zë pune nuk ndodhej në objekt edhe pse ishte situacionuar sasia prej 6 copësh.

Zërat e rinj mungojnë çmimet e referencës për materiale të cilat nuk gjenden në manualin e çmimeve të ndërtimit sipas VKM nr.629 datë 15.07.2015, (çmimi i rezinës dhe kondicionerit).

Sipas zërave të situacioni pjesor nr.2 ka zëra që janë paguar në situacionin nr.1 por nuk janë

realizuar dhe janë zbritur në situacionin nr.2 kjo sjell përdorimin jo efektiv të fondeve.

Vlera e marrë më shumë në situacionin 1 dhe zbritur në situacionin nr.2 është:

Punime ndërtimore: 3,069,291 lekë pa tvsh ose 3,683,149 lekë me tvsh

Punime mobilimi: 2,243,742 lekë pa tvsh.

Totali : 5,926,891 lekë. (13.3% e vlerës së kontratës bazë).

Për këtë investim, i cili është në proces, rezultoi se nuk argumentohet apo justifikohet vlera prej 551,336 lekë pa tvsh, e përfituar nga sipërmarrësi, për llogaritje të gabuara nga fakti i punës së realizuar.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

- **Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve** BOE òM.Sò sh.p.k. & òA&E.Eò sh.p.k.nuk kanë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në:

9) Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, ku përcaktohet se:

“Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit.”

10) Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve me nr. 5346/8 prot. datë 14.12.2020.

Titulli i gjetjes: xx	Punime të situacionuara por të pajustificuar në objektin “Rikonstruksioni i aneksit të Bibliotekës Kombëtare (fondi i Bibliotekës Kombëtare)”
Situata:	<p>Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, për objektin: “Rikonstruksioni i aneksit të Bibliotekës Kombëtare (fondi i Bibliotekës Kombëtare)”, si dhe nga verifikimi i kryer në terren në prezencë të përfaqësuesve të KLSH, Ministrisë së Kulturës dhe Mbikëqyrësit të punimeve rezultuan që janë përfshirë në situacion punime të cilat nuk justifikoheshin.</p> <p>Këto diferenca rezultuan në zërat si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none">o Zëri òUlluk shkarkimi vertikal bakriò. Vlera prej 28,079 lekë është e pajustificuar me dokumentacion mbështetës.o Zëri òGjelbërimiò. Vlera prej 50,000 lekë është e pajustificuar me dokumentacion mbështetës.o Zëri òNdriçues Tip 6 (Sipas Arkitekturës)ò. Vlera prej 116,000 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.o Zëri òMonitor 19ò për CCTV+Mouse+Tastieraò. Vlera prej 38,500 lekë është e pajustificuar me dokumentacion mbështetës.o Zëri òKompjuterò. Vlera prej 318,756 lekë është e pajustificuar me dokumentacion mbështetës.o Zbritje të punimeve në situacionin nr.2, të cilat janë certifikuar/paguar në situacionin nr.1 me një vlerë 5,313,033 lekë pa tvsh.o Mungon leja për miratimin e ndërhyrjes nga KKTKM.
Kriteri:	<p>Situacioni i punimeve dhe librezat e masave jo në përputhje me faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:</p> <ul style="list-style-type: none">- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 òPër Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimitò, i ndryshuar, Kreu III, <u>ku përcaktohet se:</u> <p>Neni 7: “Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit.”</p> <ul style="list-style-type: none">- Udhëzim Nr.2, datë 13.5.2005 òPër Zbatimin e Punimeve të Ndërtimitò, Kreu II, <u>ku përcaktohet se:</u> <p>Pika 8.1 Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori. Zërat, sasi, çmimet jashtë kontratës dhe përdorimi i fondit rezervë në situacionin përfundimtar justifikohen me</p>

	<p><i>dokumentacionin përkatës</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Udhëzim Nr. 3 datë 15.2.2001 ðPër Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit, i ndryshuar me Udhëzimin nr.1, datë 16.6.2011, Kreu I, Pika 3, nën-pika 3.2 dhe 3.3 <u>ku përcaktohet se:</u> <p>3.2 <i>Libreza e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit.</i></p> <p>3.3 <i>Situacionet mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e vëllimeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. Ato firmosen nga drejtuesi teknik i objektit, mbikëqyrësi i punimeve dhe përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit për të cilin është miratuar leja e ndërtimit.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Ligji nr.27/2018 ðPër Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë Neni 77, Ndërhyrjet e lejuara, pika 1, <u>ku përcaktohet se:</u> <p><i>Çdo ndërhyrje në pasuritë kulturore të paluajtshme dhe të luajtshme kryhet vetëm pas miratimit nga ana e KKTKM-së ose ministrit, sipas rastit të ndërhyrjes në pikën 3, të këtij neni, referuar intensitetit të ndërhyrjeve të parashikuara në kartelën e pasurisë.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Kontratës publike shërbime me nr. 16246/10 prot datë 03.12.2020 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Ministria e Kulturës dhe Operatorit Ekonomik ðL. Kò sh.p.k., Vlera e kontratës është 41,192,400 lekë pa tvsh / 44,636,849 lekë me tvsh lekë me tvsh. Afati zbatimit të kontratës fillon nga data e nënshkrimit të saj nga palët dhe do të përfundoj në dhjetor 2022, e ndarë në 3(tre) faza kontratës. - Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me nr 5346/8 prot, datë 14.12.2020, midis Autoritetit Kontraktor Ministria e Kulturës dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomik ðM.Sò sh.p.k. & ðA&E.Eò sh.p.k., vlera e kontratës së shërbimit 305,808 lekë pa tvsh / 366,970 lekë me tvsh. - Librezat e masave dhe situacionet progresive, Urdhër Ndryshimet etj.
Ndikimi/Efekti	Si pasojë e mangësive të mësipërme, shpenzim i pajustificuar shuma 551,336 lekë pa tvsh.
Shkaku	Mungesë e kontrollit periodik të punimeve nga ana e Mbikëqyrësit dhe mosplotësimit të kushteve të vendosura nga Këshilli Kombëtar i Territorit nga Autoriteti Kontraktor.
Rëndësia	E lartë
Rekomandime	Ministria e Kulturës të marrë masat duke ngritur një grup pune për të saktësuar, njoftuar dhe kërkuar nga subjekti ðL.Kò sh.p.k, plotësimin e punimeve të pakryera sipas preventivit për vlerën 551,336 lekë me efekte negative ndaj buxhetit të shtetit. Nga ana e Ministrisë së Kulturës dhe strukturat përkatëse të merren masat e nevojshme për pajisjen me leja për miratimin e ndërhyrjes nga KKTKM për të gjitha projektet e së ardhmes.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi përfaqësuesi i Mbikëqyrësit të punimeve BOE ““M.S” sh.p.k. & “A&E.E” sh.p.k., z. T.S, sipas kontratës së mbikëqyrjes me nr 5346/8 prot, datë 14.12.2020.

Për leja për miratimin e ndërhyrjes nga KKTKM ngarkohet me përgjegjësi Znj. E.Ç .

XI. Procesi i zbatimit të punimeve në objektin “Rikonstruksioni/Rivitalizimi i Magazinave të TKOBAP,në Brar” (Faza I’.

Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës publike shërbime me nr. 5173 prot., datë 03.12.2020 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Ministria e Kulturës, të përfaqësuar nga sekretari i përgjithshëm znj. E.Ç dhe Operatorit Ekonomik ð6D-Pò sh.p.k. përfaqësuar nga administratori Z. S.K, me NIPT

L62..... , liçencë në zbatim NZ.7741/5. Vlera e kontratës është 15,828,383 lekë pa tvsh /18,994,060 lekë me tvsh.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me nr 5206/8 prot., datë 10.12.2020, midis Autoritetit Kontraktor Ministria e Kulturës, të përfaqësuar nga sekretari i përgjithshëm znj. E.Ç dhe Operatorit Ekonomik òA&E.Eò sh.p.k. me NIPT K72..... përfaqësuar nga znj. E.Ç me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1476/10, si dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 330,000 lekë pa tvsh / 396,000 lekë me tvsh..

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me OE òS.R-Gò me vlerë të kontratës së shërbimit 25,949 lekë me tvsh.

Miratimi i lejes

Mungon leja e ndërtimit

Projekti është hartuar nga "I.D - A" sh.p.k.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se dorëzimi i sheshit të ndërtimit dhe fillimi i punimeve, proces verbali i fillimit të punimeve, sipas njoftimeve përkatëse është bërë në datën 10.12.2020. Punimet kanë përfunduar me datë 31.12.2020, brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve.

Oponenca teknike është sjellë nga Instituti I Ndërtimit Ministrisë së Kulturës me anë të letrës nr.2482/2 Prot. Datë 13.11/2020, dhe kanë arritur në përfundimin:

Nga studimi i materialeve të vëna në dispozicion, për projektin të zbatimit të objektit: òRikonstruksion/Rivitalizimi dhe vënia në funksion të TKOBAP të magazinave në Brarë (ish reparti ushtarak 5011), realizim in e zërit ndërtim montimeò, grupi i oponencës del në përfundimin se : Projekti i paraqitur plotëson kushtet teknike të projektimit, konkluzionet e dhëna në këtë oponencë teknike të plotësohen para zbatimit të punimeve.

- Konstatime të projekt-preventivit dhe legjislacioni i ndërtimit.

Nga verifikimi në objekt konstatohet se janë realizuar punime në objekt të ndryshme nga përcaktimi i tyre në preventiv dhe në situacion, të cilat renditen si më poshtë:

1. Zëri Ulluk shkarkimi horizontal është vendosur vetëm në pjesën anësore dhe pjesën e prapme ku janë vendosur dhe ullukët vertikal.
2. Zëri Ulluk shkarkimi vertikal janë 4 copë të vendosur në pjesën e prapme të godinës dhe janë ulluk plastik.
3. Zëri Kasete Shkarkimi nuk janë vendosur.
4. Zëri Derë dekorative hekuri me veshje prej druri është realizuar vetëm prej hekuri nuk ka veshje me dru.
5. Për shkarkimin e ujrave të zeza: Puseta betoni C 20/25, me sifon, 40x60 cm H=1 m me kapak gize 4 copë nuk janë realizuar.
6. Për punime KUB: Pusetë b/a shiu 40x60, h=100cm, me kapak gize 8 copë nuk janë realizuar.
7. Për punime elektrike: Pusetë elektrike kontrolli PVC 40x40x40cm 7 copë nuk janë realizuar.

Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

6) Dokumentacioni teknik i zbatimit: Projekt preventivi, Libri i masave, ditarët e objektit etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Rikonstruksioni/Rivitalizimi i Magazinave të TKOBAP,në Brarë" (Faza I)"		
14.Lidhja e kontratës nr. 5173 prot., datë 03.12.2020	15.Vlera e kontratës (me tvsh) 18,994,060 lekë OE fitues "6D-P" sh.p.k	16.Likuiduar deri dt 31.12.2020 me vlerë 18,994,024 lekë
17- Situacioni Përfundimtar -Vlera me tvsh 18,994,024 lekë me tvsh	18.Afati i kontratës në dite Fillimi punimeve: 10.12.2020 Përfundimi punimeve: 31.12.2020	19. Zgjatja e kontratës Nuk ka

20. Mbikëqyrësi i punimeve OE ãA&E.Eò sh.p.k.	Licenca Nr: MK 1476/10	Kontrata me nr. 5206/8 prot., datë 10.12.2020		
21. Kolaudatori i punimeve òS.R-Gò sh.p.k.	Licenca Nr:	Kontrata		
22.Akt Kolaudimi datë 31.12.2021	23.Akt i marrjes në dorëzim			

Nga auditimi i librezave të masave, projektit dhe preventivit bazë, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor.

Në lidhje konstatimet kanë observuar respektivisht me shkresat me nr. 1420/18prot, datë 27.05.2022. Grupi i auditimit pasi i shqyrtoi observimet e paraqitura, mban këtë qëndrim si më poshtë vijon.

Qëndrimi i observimeve të subjektit, ku shprehen:

Sipas Kolaudatorit dhe sipërmarrësit të punimeve:

-Zëri Nr.An.3.25/b Gërmim dheu themeli me krah h=1.5m pretendohet që gërmimi është realizuar me eskavator dhe është gërmim i veçuar për çdo plint. Volumi i këtij zëri pune është 69.12m³. Sqarojmë se në bazë të fotove të paraqitura dokumentohet vizualisht që jo vetëm janë realizuar me krah, jo vetëm që janë realizuar me krah këto punime por edhe punimet e prishjeve janë realizua me makineri dhe krah pasi ka pasur trarë dhe kolona që nuk thyeshin me makineri. (Punime te cilat firma nuk i ka situacionuar) . Eskavatori i vogël është përdorur si mjet ndihmës në rast të hapjes se dheut apo në raste kur gërmohej në shtresë betoni. (punime shtesë që nuk është situacionuar nga firma sipërmarrëse).

Sqarojmë se të gjitha ndryshimet e bëra në projektin si dhe në preventivin e rishikuar të shoqëruara nga Proçesverbali përkatës janë miratuar nga Autoriteti Kontraktor. Këto ndryshime janë bërë, referuar gjëndjes faktike. Të gjitha volumet e hedhura në librezën e masave, janë punime faktike të kryera.

-Zëri Transport dheu me auto deri në 1.0 km - Në argumentimin e bërë nga ana juaj përse i takon zërit "Transport dheu me auto deri në1.0 km" pretendohet qe referuar zërit të manualeve të çmimit sipas VKM nr.629 datë 15.07.2015, për punimet e prishjes dhe mbushjes e kanë të përfshirë në çmim transportin.

Sipas faktit ky zë pune përfshin dhe transportin e materialeve nga prishja dhe mbushja. Nga rillogaritja ju pretendoni se volumi i këtij zëri pune është 985.29 m³ më pak se volumi i situacionuar. Pra vlera e këtij zëri është përfutur padrejtësisht nga ana e sipërmarrësit të punimeve.

Sqarojmë se në bazë të preventivit fitues dhe situacionit përfundimtar, themi që në kantier kanë qenë prishur dy godina (godina e rrënuar tek porta hyrëse dhe godina nr.2) të cilat nuk janë transportuar në 1.0 km por në 10 km. Pasi legjislacioni përkatës i Bashkisë së Tiranës, monitoruar nga inspektorati ndërtimor , nuk e lejon depozitimin e këtyre materialeve përveçse në landfillin e SHARRËS.

Materialet janë depozituar atje por mqs nuk kishim zë manuali në preventiv dhe nuk bëmë preventiv të rishikuar të materialit për këtë zë pune, u dakortësuar me firmën zbatuese se pjesa e kësaj sasive të vendosej tek ky zë manuali. Në dëm të firmës sipërmarrëse dhe në të mirë të investitorit. Pra akt konstatimi juaj për dëm ekonomik nuk qëndron.

-Zëri Ulluk shkarkimi vertikal ó Preventivi i parë në tërësi, në kollonën para emërtimit është kollona me nr e analizës dhe nqs i referohemi atij nr analize mund të përcaktohet shumë qartë materiali edhe pse nuk është shkruar në emërtim. Observojmë se objekti është funksional edhe me materialin e përdorur plastik, pra nuk kanë ndonjë dëmtim të rëndësisë së veçantë fakti që është përdorur plastik apo metalik.

- Zëri Kaseta shkarkimi ó Referuar fotografive që keni observuar theksojmë që ai zë është llogaritur si ulluk horizontal nuk mund të llogaritet njëkohësisht në dy zëra.

Observojmë se shkarkimet janë bërë të fshehta dhe zhvillimi këtij ulluku që ne kemi përdorur është sa dyfishi apo trefishi i atyre që përdoret në manual. Shkarkimi i këtyre ulluqeve bëhet në mënyrë të fshehtë. Për këtë arsye themi që nuk kemi një rakordim të zërave të punimeve dhe jo dëm ekonomik.

- Zëri puseta betoni C 20/25 me sifon, 40x60 cm me kapak gize.- Pusetat për të cilën ju i referoheni në observacionin tuaj sipas fotografive nuk kanë përmasat 40x60 cm, por grupi i auditimit i ka konsideruar që i përkasin përkatësisht zërave: Puse kontrolli 1x1x1.5 m (3 copë) në zërat e kapitullit të furnizimit me ujë, dhe Ndërtim puseta betonarme, 1.0x1.0x1.5 m, me kapak gize (2 copë) në kapitullin e shkarkimit të ujrave të zeza. Pra ky zë nuk është realizuar.

-Zëri puseta elektrike kontrolli PVC 40x40x40- Pusetat të cilat ju i referoheni në observacionin tuaj sipas fotografive bashkëlidhur i përkasin zërit F.V. puset plastike 40x40x40, kapak të fortë RIC 1084+1086 që i korrespondojnë dhe nr të shtyllave (8 copë). Pra ky zë nuk është realizuar.

- Zëri suva brenda mur tulle h-4 me krahe , llac i perzier M25. Nuk është realizuar pasi është marr në fazën e dytë. Në fazën e dytë janë situacionuar punime që kanë të bëjnë me fazën e dytë, në fazën e parë është situacionuar punimet që kanë të bëjnë me fazën e parë, dhe observojmë që këto punime janë bërë në fazën e parë , në fazën e dytë është bërë suvatim me grafiato, pra mbi suvatimin është shtruar rrjet + kolle dhe grafiato në fazën e dytë. Po të shikohen analizat e dy zërave në fazën e parë dhe të dytë nuk janë të njëjta fazën e parë është situacionuar me nr.analize 2.310 ndërsa në fazën e dytë është situacionuar analiza me zë 2.308/a. Përse më sipër kërkojmë ta merrni në konsideratë këtë observim

pasi është punim i kryer dhe nuk është dëm ekonomik.

-Zëri bojë hidroplastike importi cilësia I-rë. Përsa i përket zërit të punës bojë hidroplastike importi cilësia e parë themi që janë lyer shtesë xokolatrat e tre objekteve gjithashtu edhe një pjesë e murit rrethues është lyer. Pra firma e ka bërë si zë pune këtë gjë por nuk e ka rakorduar me emërtim përkatës tjetër.

Kjo përbën një dëm për shkak të mosrakordancës por jo dëm ekonomik!

Pasi firma e ka realizuar si punime shtesë!

-Përgjigje e grupit të auditimit të KLSH-së.

Lidhur me observacionet e Kolaudatorit dhe sipërmarrësit të punimeve:

-Zëri Nr.An. 3.25/b Gërmim dhe themele me krah $h=1.5\text{ m}$ ó Referuar fotove të punimeve, shikohet që gërmimi për themele është gërmim i veçuar për çdo plint. Diferenca e volumit $320-69.12=250.88\text{ m}^3$ është përfituar padrejtësisht nga Sipërmarrësi i punimeve.

-Zëri Transport dhe me auto deri në 1.0 km - Ky observacion nuk merret në konsideratë.

-Zëri Ulluk shkarkimi vertikal ó Objekti është funksional dhe nuk kanë ndonjë dëmtim të rëndësishëm së veçantë fakti që është përdorur plastik apo metalik, por duhet negociuar çmimi sipas materialit të përdorur.

Ky observacion nuk merret në konsideratë.

- Zëri Kaseta shkarkimi ó Referuar observacionin tuaj të parë dhe të dytë janë dy shpjegimeve krejtësisht të kundërta. Shkarkimi me ulluk siç pretendohet nga ana juaj duhet të bëhet me anë të preventivit të rishikuar nuk mund të merret në zëra të ndryshëm nga përshkrimi. Mungon pika e shkarkimit të shkarkimeve të fshehura, dokumentacioni fotografik dhe proces verbale të punimeve të maskuara.

Ky observacion nuk merret në konsideratë.

-Zëri Suva brenda mur tulle $h=4\text{m}$ me krah, llaç përzier M25ó Ky observacion nuk merret në konsideratë.

-Zëri Bojë hidroplastike importi cilësi e I-rë ó Referuar librezës së masave të miratuar nga mbikëqyrësi i punimeve dhe sipërmarrësi i punimeve në këtë zë janë përfshirë lyerja e brendshme e godinës nr.2. Gjithashtu observacioni juaj nuk qëndron pasi gjatë zbatimit të kësaj kontratë është realizuar vetëm godina nr.2 dhe jo godinat e tjera.

Për sa më sipër ky observacion merret pjesërisht në konsideratë.

Titulli i gjetjes:	Punime të situacionuara por të pakryera në objektin “Rikonstruksioni/Rivitalizimi i Magazinave të TKOBAP,në Brar” (Faza I)”
Situata:	<p>Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, për objektin: “Rikonstruksioni/Rivitalizimi i Magazinave të TKOBAP,në Brar” (Faza I)”, si dhe nga verifikimi i kryer në terren në prezencë të përfaqësuesve të KLSH Ministrisë së Kulturës rezultuan që janë përfshirë në situacion punime të cilat nuk janë realizuar.</p> <p>Këto diferenca rezultuan në zërat si mëposhtë:</p> <ul style="list-style-type: none">○ Zëri ðGërmim dheuó. Vlera prej 143,001 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.○ Zëri ðUlluk shkarkimi horizontaló. Vlera prej 152,888 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.○ Zëri ðUlluk shkarkimi vertikaló. Vlera prej 75,084 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.○ Zëri ðKaseta Shkarkimió. Vlera prej 8,456 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.○ Zëri ðBojë hidroplastike importi cilësi e I-rëó. Vlera prej 239,636 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.○ Zëri ðDerë dekorative hekuri me veshje prej drurió, nuk është realizuar sipas emërtimit të zërit.○ Zëri ðPuseta betoni C 20/25, me sifon, 40x60 cm H=1 m me kapak gize, KUZó. Vlera prej 63,052 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.○ Zëri ðPusetë b/a shiu 40x60, h=100cm, me kapak gize, KUBó. Vlera prej 150,968 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.○ Zëri ðPusetë elektrike kontrolli PVC 40x40x40cmó. Vlera prej 19,180 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

	<p>o Leja e ndërtimit nuk administrohet në dosje.</p> <p>Argumentimi i këtyre diferencave pasqyrohen të përshkruara në Akt Konstatimin nr.14 bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.</p>
Kriteri:	<p>Situacioni i punimeve dhe librezat e masave jo në përputhje me faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 òPër Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimitò, i ndryshuar, Kreu III, <u>ku përcaktohet se:</u> <p>Neni 7: <i>“Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit.”</i></p> <p>Neni 12: <i>Të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 duhet t'i nënshtrohen kolaudimit tekniko ekonomik, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. objekti është realizuar në kushtet teknike; 2. objekti është realizuar në përputhje me kontratën dhe anekset e saj; 3. çmimet e aplikuara janë sipas përcaktimeve të kontratës; 4. në këtë akt verifikohen edhe kërkesat e zbatuesit të paraqitura gjatë zbatimit të punimeve. <ul style="list-style-type: none"> - Udhëzim Nr.2, datë 13.5.2005 òPër Zbatimin e Punimeve të Ndërtimitò, Kreu II, <u>ku përcaktohet se:</u> <p><i>Pika 8.1 Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori. Zërat, sasi, çmimet jashtë kontratës dhe përdorimi i fondit rezervë në situacionin përfundimtar justifikohen me dokumentacionin përkatës</i></p> <p><i>Pika 8.3 Çmimet jashtë kontratës caktohen sipas analizave teknike në fuqi, me vlerën ekonomike më të mirë.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Udhëzim Nr. 3 datë 15.2.2001 òPër Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimitò e konkretisht Kreu II, Pika 3, <u>ku përcaktohet se:</u> <p><i>Kolaudatori ose grupi i kolaudimit duhet të verifikojë me përgjegjësi:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> a. Realizimin e objektit, në përputhje me projektin, lejen e ndërtimit, standardet dhe rregullat teknike. b. Realizimin e objektit, në përputhje me kontratën e nënshkruar. c. Përputhjen e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi. <ul style="list-style-type: none"> - Ligji Nr. 107/2014 òPër Planifikimin dhe Zhvillimin e Territoritò, neni 39 Leja e Ndërtimit pika 1, <u>ku përcaktohet se:</u> <p><i>Leja e ndërtimit është e nevojshme për çdo ndërtim, riparim, restaurim apo prishje të objekteve ekzistuese, instalim apo ngritje të ndërtimeve të përkohshme, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 41 i këtij ligji.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Kontratës publike shërbime me nr. 5173 prot., datë 03.12.2020 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Ministria e Kulturës dhe Operatorit Ekonomik ò6D-Pò sh.p.k., Vlera e kontratës është 15,828,383 lekë pa tvsh /18,994,060 lekë me tvsh lekë me tvsh. - Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me nr 5206/8 prot., datë 10.12.2020, midis Autoritetit Kontraktor Ministria e Kulturës dhe Operatorit Ekonomik òA&E.Eò sh.p.k. me vlerë të kontratës së shërbimit 330,000 lekë pa tvsh / 396,000 lekë me tvsh. - Librezat e masave dhe situacioni përfundimtar, Urdhër Ndryshimet etj.
Ndikimi/Efekti	<p>Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik me vlerë prej 852,265 lekë pa tvsh në fondet e Buxhetit të Shtetit.</p> <p>Si dhe kryerja e punimeve civile pa dokumentacionin e nevojshëm.</p>
Shkaku	<p>Mungesë e kontrollit periodik të punimeve nga ana e Mbikëqyrësit dhe mosplotësimi i kushteve të vendosura nga Këshilli Kombëtar i Territorit nga ana e Autoritetit Kontraktor.</p>
Rëndësia	<p>E lartë</p>

Rekomandime	Nga Ministria e Kulturës të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 852,265 lekë pa tvsh nga OE ò6D-Pò sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve sipas kontratës me nr. 5173 prot., datë 03.12.2020, me objekt òRikonstruksioni/Rivitalizimi i Magazinave të TKOBAP,në Brarò (Faza I)ò,vlerë kjo që përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit.
--------------------	--

*Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi përfaqësuesi i Mbikëqyrësit të punimeve OE "A&E.E" sh.p.k., znj. E.Ç , sipas kontratës së mbikëqyrjes me nr 5206/8 prot., datë 10.12.2020.
Për lejen e ndërtimit ngarkohet me përgjegjësi Znj. E.Ç.*

XII. zbatimit të punimeve në objektin "Rikonstruksioni/Rivitalizimi i Magazinave të TKOBAP,në Brarò" (Faza II)."

Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës publike shërbime me nr. 2455 prot., datë 12.05.2021 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Ministria e Kulturës, të përfaqësuar nga sekretari i përgjithshëm znj. E.Ç dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomik òCò sh.p.k & ò6D-Pò sh.p.k. përfaqësuar nga Z. S.K, me NIPT L62..... , liçencë në zbatim NZ.7741/5. Vlera e kontratës është 34,020,265 lekë pa tvsh /40,824,318 lekë me tvsh.

Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 5 muaj nga data e fillimit të punimeve dhe marrja e lejes së ndërtimit.

Është nënshkruar aneks Kontrata nr.1 me nr.5816/1 Prot. Me datë 15.11.2021 òPër një ndryshim në kontratën nr.2455 prot. Datë 12.05.2021 me objekt : òRikonstruksioni/Rivitalizimi i Magazinave të TKOBAP,në Brarò (Faza II)òò

Pika 5.2:

Afati për zbatimin e punimeve objekt kontrate zgjatet deri më 12.02.2022.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me nr 2679/9 prot., datë 8.6.2021, midis Autoritetit Kontraktor Ministria e Kulturës, të përfaqësuar nga sekretari i përgjithshëm znj. E.Ç dhe Operatorit Ekonomik òLò sh.p.k. me NIPT L86..... përfaqësuar nga znj. L.D me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 333/1, si dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 404,663lekë pa tvsh / 485,596lekë me tvsh..

Miratimi i lejes

Vendim nr.07, datë 17.03.2021 për miratimin e lejes së ndërtimit për objektin: òRikonstruksion i Magazinave në Brarò, me vendndodhje në Bashkinë Tiranë, me zhvillues Ministrinë e Kulturës, miratuar nga KKT.

Ky vendim i është dërguar Ministrisë së Kulturës me anë të letrës 2877/3 datë 28.09.2021.

Projekti është hartuar nga I.D - A" sh.p.k.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se dorëzimi i sheshit të ndërtimit dhe fillimi i punimeve, proces verbali i fillimit të punimeve, sipas njoftimeve përkatëse është bërë në datën 14.06.2021. Punimet janë pezulluar deri në marrjen e lejes së ndërtimit dhe kanë rifilluar në shtator 2021.

Oponenca teknike është sjellë nga Instituti I Ndërtimit Ministrisë së Kulturës me anë të letrës nr.2482/2 Prot. Datë 13.11/2020, dhe kanë arritur në përfundimin:

Nga studimi i materialeve të vëna në dispozicion, për projektin të zbatimit të objektit: òRikonstruksion/Rivitalizimi dhe vënia në funksion të TKOBAP të magazinave në Brarò (ish reparti ushtarak 5011), realizim in e zërit ndërtim montimeò, grupi i oponencës del në përfundimin se : Projekti i paraqitur plotëson kushtet teknike të projektimit, konkluzionet e dhëna në këtë oponencë teknike të plotësohen para zbatimit të punimeve.

- Konstatime të projekt-preventivit dhe legjislacioni i ndërtimit.

Nga verifikimi në objekt konstatohet se janë realizuar punime në objekt të ndryshme nga përcaktimi i tyre në preventiv dhe në situacion, të cilat renditen si më poshtë:

1. Zëri Ulluk shkarkimi vertikal janë 4 copë të vendosur në pjesën e prapme të godinës dhe janë ulluk plastik.
2. Zëri Davancale mermeri për dritare janë 6 dritare 1.2x0.4.
3. Zëri Pusetë plastike 30x30x30cm 17 copë nuk janë realizuar.

Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

7) Dokumentacioni teknik i zbatimit: Projektpreventivi, Libri i masave, ditarët e objektit etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Rikonstruksioni/Rivitalizimi i Magazinave të TKOBAP,në Brar” (Faza II)”			
14.Lidhja e kontratës nr. 2455 prot., datë 12.05.2021	15.Vlera e kontratës (me tvsh) 40,824,318 lekë BOE fitues “C” sh.p.k & “6D-P” sh.p.k.		16.Likuiduar deri dt 30.12.2021 vlera 37,916,463 lekë
17- Situacioni Përfundimtar	18.Afati i kontratës Afati 5 muaj 150 ditë Fillimi punimeve: 14.06.2021 Përfundimi punimeve: 14.11.2022		19. Zgjatja e kontratës Aneks Kontrata nr.1 me nr.5816/1 Prot. Me datë 15.11.2021 Deri më 12.02.2022
20. Mbikëqyrësi i punimeve BOE òLò sh.p.k & òC.Gò sh.p.k	Licenca Nr: MK. 333/1	Kontrata me nr. 2679/9 prot., datë 8.6.2021	
21. Kolaudatori i punimeve	Licenca Nr:	Kontrata	
22.Akt Kolaudimi	23.Akt i marrjes në dorëzim		

Nga auditimi i librezave të masave, projektit dhe preventivit bazë, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor.

Titulli i gjetjes:	Punime të situacionuara por të pajustificuar në objektin “Rikonstruksioni/Rivitalizimi i Magazinave të TKOBAP,në Brar” (Faza II)”
Situata:	<p>Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, për objektin: “Rikonstruksioni/Rivitalizimi i Magazinave të TKOBAP,në Brar” (Faza II)”, si dhe nga verifikimi i kryer në terren në prezencë të përfaqësuesve të KLSH, Ministrisë së Kulturës dhe Mbikëqyrësit të punimeve rezultuan që janë përfshirë në situacion punime të cilat nuk justifikohen.</p> <p>Këto diferenca rezultuan në zërat si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> o Zëri òTransport dheu me auto deri 10.0 kmò. Vlera prej 200,930.4 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve. o Zëri òHekur betoniò. Vlera prej 191,620 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve. o Zëri òUlluk shkarkimi vertikalò. Vlera prej 17,928 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve. o Zëri òSkelë metalike me tubo tavaniò. Vlera prej 63,280 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve. o Zëri òSkelë metalike me tubo fasadeò. Vlera prej 174,501 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve. o Zëri òMure tulleò. Vlera prej 440,264 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve. o Zëri òShtresë betoni C20/25 t 10cm me zgarë hekuriò. Vlera prej 343,860 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve. o Zëri òShtresë stabilizanti t=15cmò. Vlera prej 354,775 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve. o Zëri òShtresë çakëlli mbeturine kave t=20cmò. Vlera prej 37,700 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

	<ul style="list-style-type: none"> ○ Zëri òRrethim me rrjetë teliò. Vlera prej 4,716 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve. ○ Zëri òDavancale mermeri për dritareò. Vlera prej 2,880 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve. ○ Zëri òPusetë plastike 30x30x30, kapak të fortë RIC 1084ò. Vlera prej 51,000 lekë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
Kriteri:	<p>Situacioni i punimeve dhe librezat e masave jo në përputhje me faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 òPër Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimitò, i ndryshuar, Kreu III, <u>ku përcaktohet se:</u> <p>Neni 7: “Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit.”</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ligji nr. 120/2020 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, òPër Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimitò, të ndryshuar, Neni 7/1 , <u>ku përcaktohet se:</u> <p>Neni 7/1: 1. Mbikëqyrësi/grupi i mbikëqyrësve të punimeve është i detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit. Ai është i detyruar të kontrollojë librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit. Kur mbikëqyrësi i punimeve konstaton raste të ndryshimit të projektit, është i detyruar të njoftojë menjëherë Inspektoratin Vendor të Mbrojtjes së Territorit të bashkisë.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Udhëzim Nr.2, datë 13.5.2005 òPër Zbatimin e Punimeve të Ndërtimitò, Kreu II, <u>ku përcaktohet se:</u> <p>Pika 8.1 Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori. Zërat, sasi, çmimet jashtë kontratës dhe përdorimi i fondit rezervë në situacionin përfundimtar justifikohen me dokumentacionin përkatës</p> <ul style="list-style-type: none"> - Udhëzim Nr. 3 datë 15.2.2001 òPër Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimitò, i ndryshuar me Udhëzimin nr.1, datë 16.6.2011, Kreu I, Pika 3, nënpika 3.2 dhe 3.3 <u>ku përcaktohet se:</u> <p>3.4 Libreza e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit.</p> <p>3.5 Situacionet mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. Ato firmosen nga drejtuesi teknik i objektit, mbikëqyrësi i punimeve dhe përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit për të cilin është miratuar leja e ndërtimit.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kontratës publike shërbime me nr. 2455 prot., datë 12.05.2021 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Ministria e Kulturës dhe BOE òCò sh.p.k & ò6D-Pò sh.p.k. vlera e kontratës është 34,020,265 lekë pa tvsh /40,824,318 lekë me tvsh. - Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me nr 2679/9 prot., datë 8.6.2021, midis Autoritetit Kontraktor Ministria e Kulturës dhe Operatorit Ekonomik òLò sh.p.k. me vlerë të kontratës së shërbimit 404,663 lekë pa tvsh / 485,596 lekë me tvsh. - Librezat e masave dhe situacionet pjesore, Urdhër Ndryshimet.
Ndikimi/Efektí	Si pasojë e mangësive të mësipërme, shpenzim i pajustificuar dhe i përfituar pa të drejtë

	shuma 1,883,454 lekë pa tvsh.
Shkaku	Mungesë e kontrollit periodik te punimeve nga ana e Mbikëqyrësit.
Rëndësia	E lartë
Rekomandime	Nga ana e Ministrisë së Kulturës të merren masa të menjëhershme për ngritjen e grupit të punës për evidentimin e diferencave të volumeve dhe certifikimin e tyre në situacionin përfundimtar. Mos evidentimi i diferencave të mësipërme në situacionin përfundimtar i vlerës prej 1,883,454 lekë pa tvsh, nga BOE òCò sh.p.k & òD-Pò sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve sipas kontratës me nr.2455 prot., datë 12.05.2021 me objekt òRikonstruksioni/Rivitalizimi i Magazinave të TKOBAP,në Brarò (Faza II)ò, përbën efekt negativ ndaj buxhetit të shtetit.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi përfaqësuesi i Mbikëqyrësit të punimeve OE "L" sh.p.k. znj. L.D , sipas kontratës së mbikëqyrjes me nr 2679/9 prot., datë 8.6.2021.

2.6. MBI PROCEDURAT E FINANCIMIT DHE MBËSHTETJES NGA MK, PËR PROJEKTET NË FUSHËN E ARTIT DHE KULURËS;

Në zbatim të pikës 6 të programit të auditimit nr. 1420/1 prot., datë 12.01.2022 u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Projekte me inicim të brendshëm të Drejtorisë së Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve të Kulturës.
2. Procedurat administrative në kuadër të thirrjeve për projekt-propozimeve në fushën e artit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore, për vitet buxhetore 2020-2021.
3. Procedurat administrative të kërkesave për mbështetje financiare për realizimin e projekteve kulturore, të brendshme në mbështetje të prioriteteve të Ministrisë së Kulturës.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Për vitin 2020 rezulton se ka pasur 64 projekte fituese, nga të cilat 37 projekte kulturore të brendshme në mbështetje të prioriteteve të Ministrisë së Kulturës dhe 27 projekte kulturore me thirrje. Për vitin 2021 rezulton se ka patur 166 projekte, nga të cilat 160 projekte me thirrje dhe 6 projekte të brendshme të Drejtorisë së Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve të Kulturës.

Për shkak të numrit të madh të projekteve për periudhën objekt auditimi, është bërë një përzgjedhje e një numri të caktuar të projekteve dhe procedurave që do të auditohen, duke vendosur si kriter vlerën e tyre, e cila duhet të jetë mbi 1.000.000 lekë.

Nga sa më sipër, janë kërkuar dosjet në lidhje me 11 projekte me thirrje dhe 4 projekte të brendshme për vitet 2020-2021, dhe më konkretisht:

I. PROJEKTE ME INICIIM TË BRENDSHËM TË DREJTORISË SË KONCEPTIMIT DHE FIZIBILITETIT TË PROJEKTEVE TË KULURËS.

1. “ Gjirokastra 15 vite në UNESCO”.

Ky projekt e ka zanafillën në një nga ngjarjet e shënuara të trashëgimisë tonë materiale, në pranimin e qytetit të Gjirokastrës në listën botërore të pasurive të UNESCO në Korrik 2005.

Kryesisht kjo ngjarje është festuar në Gjirokastrë në krye të çdo jubileu 5-vjecar.

I tillë ishte edhe viti 2020, i cili përkonte me 15- vjetorin e kësaj ngjarje.

- Projekti Kulturor nisi me MEMO-n (nr. 2918 prot., datë 08.07.2020) drejtuar Ministrit të Kulturës, Sekretarit të Përgjithshëm dhe Drejtorit të Financës, ku përshkruhej rëndësia e një aktiviteti të tillë, në vija të përgjithshme mënyra dhe propozimet për organizimin e aktivitetit kulturor, nevojat që parashikohen për këtë aktivitet, një kosto e përafërt financiare për

zhvillimin e tij, bashkëpunëtorët e propozuar për realizimin e këtij aktiviteti dhe propozimi për anëtarët e kolegjiut për shqyrtimin e veprimeve administrative dhe ekonomike për realizimin e këtij projekti. (*Ligji 10352 “Për Artin dhe Kulturën” me ndryshime, Neni 26 Pika 1/a*)

- Pas marrjes dijeni nga Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtori i Financës, Ministri i Kulturës pasi ka miratuar MEMO-n (nr. 2918 Prot., datë 08.07.2020), ka nënshkruar **Urdhrin nr. 229, datë 08.07.2020** për ngritjen e kolegjiut për realizimin e procedurave administrative të eventit kulturor me rastin e 15 vjetorit të regjistrimit të Gjirokastrës në listën e pasurive kulturore të UNESCOë në Gjirokastër, më datë 14 dhe 15 Korrik 2020 dhe emërtimin e stafit. (*Mbështetur në Ligjin nr. 10352 “Për Artin dhe Kulturën”, me ndryshime, Neni 27 Pika 1/a dhe b, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, pika 4, neni 102 dhe Ligjit nr. 9000, datë 30.01.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave*).
- Në Urdhrin e Ministrisë të Kulturës nr. 229, datë 08.07.2020, janë parashikuar:
 - o Përbërja e Kolegjiut me nëpunës të mesëm të Ministrisë së Kulturës (3 drejtorë të drejtorive të përmbajtjes), konkretisht z. A.A (Kryetar), z. H.D dhe znj. K.A. Janë parashikuar detyrat dhe detyrimet specifike të anëtarëve të Kolegjiut për këtë projekt, të tilla si shqyrtimi i përmbajtjes së projektit kulturor dhe çdo veprim tjetër që lidhet me ecurinë dhe realizimin cilësor të këtij projekti, duke nënshkruar vendimet e marra nga ky Kolegjiut për tëa përcjellë më tej Ministrinë të Kulturës.
 - o Përbërja e sekretarisë teknike, detyrat e anëtarëve të sekretarisë teknike për negocimin e kontratave dhe monitorimin e tyre.
 - o Autorizimi për nënshkrimin e kontratave nga personi përgjegjës.
- Urdhri u siglua rregullisht (siç kërkohet në manualin e procedurave të Ministrisë së Kulturës, pika 3.2, paragrafi 68) nga konceptuesi, Drejtori i DDFZHPK, Drejtori Juridik dhe Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës.
- Me shkresën nr. 2918/2 prot., datë 08.07.2020, Sekretari i Përgjithshëm u është drejtuar bashkëpunëtorëve të jashtëm, të propozuar në Memon fillestare dhe bazuar në Urdhrin e Ministrisë të Kulturës, me qëllim dakordësimin dhe identifikimin specifik të ideve për realizimin e projektit si edhe për negocimin e kontratave me personat përgjegjës, sipas Urdhrit të Ministrisë të Kulturës nr. 229, datë 08.07.2020.
- Në datën 09.07.2020, në Ministrinë e Kulturës janë zhvilluar negociata me regjizorin, kompozitorin, kuratorin, koordinatorin etj. Njëkohësisht, nëpërmjet negociatave, janë paraqitur me shkrim idetë regjisoriale, organizative dhe kuratoriale, të cilat janë vlerësuar nga grupi i emëruar nga Ministri i Kulturës, në bazë të Urdhrit nr. 229, datë 08.07.2020, pika 4 dhe 5.
- Negociatat janë nënshkruar rregullisht nga palët duke përcaktuar detyrat dhe detyrimet e personave që kontraktohen dhe vlerën ekonomike të kontratës.
- Me shkresën nr. prot. 2918/3/4/5 janë paraqitur: ideja regjisoriale nga regjizori i eventit kulturor; ideja artistike e koncertit nga drejtuesi artistik dhe kompozitori; si edhe ideja për ekspozitat në kuadër të këtij eventit nga kuratori. Në të treja materialet, personat e ngarkuar kanë paraqitur edhe nevojat për suportet teknike dhe njerëzore, me qëllim përmbushjen e detyrimeve dhe realizimin e eventit kulturor.

- Me shkresën përcjellëse nr. 2918/6, datë 09.07.2020 sekretaria teknike i ka përcjellë Kolegjiut idenë regjizoriale, artistike dhe kurative të projektit dhe nevojat për paisje, mjete, material publicitare etj.
- Me proces-verbalin nr. prot. 2918/7, datë 09.07.2020, anëtarët e Kolegjiut janë mbledhur dhe kanë shqyrtuar rëndësinë e projektit, idenë regjizoriale, artistike, kuratoriale, nevojat në paisje dhe specifikimet teknike të paisjeve të kërkuara dhe materialit publicitar duke i miratuara ato. *(Ligji 10352 “Për Artin dhe Kulturën “ me ndryshime, Neni 27, Pika 1 a dhe b, Urdhri i Ministrit të Kulturës nr. 229, datë,08.07.2020).*
- Me Vendimin nr. prot. 2918/8, datë 09.07.2020 anëtarët e Kolegjiut kanë vendosur ti propozojnë Ministrit të Kulturës, miratimin e skaletës së aktiviteteve për këtë rast, lidhjen e kontratës me bashkëpunëtorët e jashtëm të këtij eventi (regjizor, kompozitor, koordinator, kurator etj), kryerjen e negociatave me artistët pjesëmarrës të propozuar, miratimin e nevojave për realizimin e këtij projekti të materializuara në preventiv dhe miratimin e formularit të ofertave për kryerjen e sondazhit të tregut, për këto nevoja sipas grupeve, specifikimeve etj.. *(Ligji 10352 “Për Artin dhe Kulturën “ me ndryshime, Neni 27, Pika 1 a dhe b, Urdhri i Ministrit të Kulturës nr. 229, datë,08.07.2020).*
- Me Urdhri nr. 231, datë 09.07.2020, për miratimin e kushteve ekonomike të bashkëpunëtorëve të jashtëm, kryerjen e negociatave me artistët pjesëmarrës në koncert, miratimin e specifikimeve teknike të maketit të kalasë së Gjirokastrës, materialit publicitar, paisjeve teknike, kushtet e akomodimit dhe ushqimit, listës së personave që akomodohen, formularit të ofertës për subjektet dhe skaletës së aktiviteteve kulturore, Ministri i Kulturës ka urdhëruar, miratimin e skaletës së aktiviteteve për këtë rast, lidhjen e kontratës me bashkëpunëtorët e jashtëm të këtij eventi (regjizor, kompozitor, koordinator, kurator etj.), kryerjen e negociatave me artistët pjesëmarrës të propozuar, miratimin e nevojave për realizimin e këtij projekti të materializuara në preventiv dhe miratimin e formularit të ofertave për kryerjen e sondazhit të tregut për këto nevoja, sipas grupeve, specifikimeve etj.. *(Ligji 10352 “Për Artin dhe Kulturën “ me ndryshime, neni 27, Pika 1 dhe 2, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, pika 4, neni 102 dhe të Ligjit nr. 9000, datë 30.01.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave).*
- Kontratat nr. 2918/10/11/12/13/14/15, datë 09.07.2020, të lidhura me bashkëpunëtorët e jashtëm për realizimin e këtij projekti, janë në zbatim të Urdhrit të Ministrit të Kulturës nr. 231, datë 09.07.2021, pikat 1,2,3,4,5,6.
- Shkresa e Sekretarit të Përgjithshëm nr. 2941 prot., datë 09.07.2020, drejtuar artistëve të propozuar për të marrë pjesë në këtë event, buron nga detyrimet e Urdhrit nr. 231, datë 09.07.2021 të Ministrit të Kulturës, pika 7.
- Me shkresën nr. 2941/1 prot., datë 09.07.2020, në zbatim të Urdhrit të Ministrit të Kulturës nr. 231 datë 09.07.2020, pika 8,9,10,11 dhe 13, Sekretari i Përgjithshëm i është drejtuar me kërkesë për ofertë subjekteve për akomodimin dhe ushqimin, pajisjet teknike dhe materialet publicitare, sipas modelit të ofertës dhe specifikimeve teknike të miratuara në këtë Urdhër, ku është përcaktuar edhe vlera e fondit limit.

Nga sa më lart, rezulton se nuk ka një dokumentacion justifikues në lidhje me përcaktimin e vlerës së fondit limit. Po kështu, nuk është justifikuar mënyra e përzgjedhjes së subjekteve të cilëve u është drejtuar kërkesa për ofertë.

- Në datën 10 Korrik 2020, janë mbajtur proces-verbalet e zhvillimit të negociatave me artistët pjesëmarrës në këtë event, në zbatim të Urdhrit të Ministrit të Kulturës nr. 229, datë

08.07.2020, pika 4 dhe 5 dhe Urdhrit të Ministrisë të Kulturës nr. 231, datë 09.07.2021, pika 7. Proces-verbalet janë nënshkruar nga negociatorët dhe artistët.

- Në datën 10 Korrik 2020 me nr. 2918/16/17/18 janë paraqitur ofertat e sondazhit që u krye në 3 subjekteve për produktet publicitare të kërkuara.
- Në datën 10 Korrik 2020 me nr. 2918/19/20/21 janë paraqitur ofertat e sondazhit që u krye në 3 subjekteve për huazimin e pajisjeve teknike të kërkuara për këtë event nga regjizori dhe drejtuesi artistik.
- Me shkresën nr. prot. 2918/22, datë 10.07.2020 dhe nr. prot. 2918/23/24, datë 11.07.2020, janë paraqitur ofertat ekonomike nga subjektet për akomodimin dhe ushqimin për këtë event kulturor.
- Me shkresën nr. prot. 2918/25, datë 13.07.2020, Sekretaria e Teknikës i ka përcjellë Kolegjumit negociatat e kryera me artistët dhe ofertat ekonomike të ardhura për realizimin e nevojave dhe shërbimeve të kërkuara për këtë projekt kulturor, në zbatim të Urdhrit të Ministrisë të Kulturës nr. 229, datë 08.07.202 dhe Urdhrit të Ministrisë të Kulturës nr. 231, datë 09.07.2020.
- Me proces-verbalin nr. 2918/ 26, datë 13 Korrik 2020, Kolegjumi i krijuar me Urdhrin nr. 229, datë 08.07.2020 u mbledh dhe shqyrtoi negociatat me artistët dhe ofertat e paraqitura për teknikën, publicitetin dhe akomodimin.
- Me proces-verbalin nr. 2918/ 26, datë 13 Korrik 2020 Kolegjumi i krijuar me Urdhrin nr. 229, datë 08.07.2020 u mbledh dhe shqyrtoi negociatat me artistët dhe ofertat e paraqitura për teknikën, publicitetin dhe akomodimin. (*Ligji nr. 10352 "Për Artin dhe Kulturën", me ndryshime, neni 27, pika 1 a dhe b, Urdhri i Ministrisë të Kulturës nr. 229, datë 08.07.2020*).
- Me Vendimin e Kolegjumit nr. 2918/ 27, datë 13.07.2020 Kolegjumi i krijuar me Urdhrin nr. 229, datë 08.07.2020, pasi shqyrtoi negociatat me artistët dhe ofertat e paraqitura për teknikën, publicitetin dhe akomodimin, vendosi të propozojë Ministrisë të Kulturës miratimin e subjekteve që kanë paraqitur ofertën më të mirë ekonomike për lidhjen e kontratës së shërbimit, me qëllim marrjen e shërbimeve të kërkuara për realizimin e aktiviteteve. (*Ligji nr. 10352 "Për Artin dhe Kulturën", me ndryshime, neni 27, pika 1 a dhe b, Urdhri i Ministrisë të Kulturës nr. 229, datë 08.07.2020*).
- Me Urdhrin nr. 235 datë 13.07.2020, për lidhjen e kontratës me artistët dhe subjektet juridike dhe fizike, të cilët kanë paraqitur ofertën më të mirë ekonomike për realizimin e projektit kulturor "Gjirokastra 15 vite në UNESCO", Ministri i Kulturës ka urdhëruar lidhjen e kontratës me artistët e seleksionuar për këtë event kulturor, subjekte të cilat kanë paraqitur ofertat më të ulëta ekonomike dhe autorizimin për monitorimin e kontratave që do të lidhen. Të gjitha këto bazuar në Vendimin nr. 2918/27 të Kolegjumit, datë 13.07.2020. (*Ligji nr. 10352 "Për Artin dhe Kulturën" me ndryshime, neni 27, pika 1 dhe 2, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, pika 4, neni 102 dhe të Ligjit nr. 9000, datë 30.01.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave*).

Nga sa më lart, rezulton se nuk ka një analizë të detajuar të çmimeve të përcaktuara në kërkesë, pasi nuk ka tarifa të përcaktuara për këtë qëllim dhe si referencë përdoren çmimet e tregut.

- Në zbatim të Urdhrit nr. 235, datë 13.07.2020 për lidhjen e kontratës me artistët dhe subjektet juridike dhe fizike, të cilët kanë paraqitur ofertën më të mirë ekonomike për realizimin e projektit kulturor "Gjirokastra 15 vite në UNESCO", u nënshkruan kontratat me nr. 2918/29/30/31/32/33/34/35/36/37, datë 13.07.2020.
- Anëtarët e sekretarisë teknike kanë ndjekur zbatimin e kontratave që u lidhen për këtë projekt kulturor dhe në mbyllje të tij kanë përpiluar proces-verbalet e monitorimit të

kontratave të lidhura për këtë qëllim, përkatësisht me nr. 3110/1/2/3/4/5/6/7/8/9/10/11/12/13/14 prot., datë 20.07.2020, bazuar në Urdhrin nr. 229, datë 08.07.2020 òPër ngritjen e Kolegjumit për realizimin e procedurave administrative të eventit kulturor me rastin e 15 vjetorit të regjistrimit të Gjirokastrës në listën e pasurive kulturore të UNESCO, Gjirokastrë 14 dhe 15 Korik 2020 dhe emërtimin e stafitò, Urdhrin nr. 231, datë 09.07.2020, òPër miratimin e kushteve ekonomike të bashkëpunëtoreve të jashtëm, kryerjen e negociatave me artistët pjesëmarrës në koncert, miratimin e specifikimeve teknike të maketit të kalasë së Gjirokastrës, materialit publicitar, pajisjeve teknike, kushtet e akomodimit dhe ushqimit, listës së personave që akomodohen, formularit të ofertës për subjektet dhe skaletës së aktiviteteve kulturoreò dhe Urdhërin nr. 235, datë 13.07.2020, òPër lidhjen e kontratës me artistët dhe subjektet juridike dhe fizike, të cilët kanë paraqitur ofertën më të mire ekonomike për realizimin e projektit kulturor òGjirokastra 15 vite në UNESCOò. Ministri i Kulturës ka urdhëruar lidhjen e kontratës me artistët e seleksionuar për këtë event kulturor, subjekte të cilat kanë paraqitur ofertat më të ulëta ekonomike dhe autorizimin për monitorimin e kontratave që do të lidhen.

Pas kryerjes dhe realizimit të këtij projekti kulturor janë dorëzuar në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtorinë e Financës, sipas procedurave të këtyre Drejtorive, një kopje e urdhrave të Ministrisë të Kulturës për këtë projekt, kontratat e lidhura me subjektet fizike dhe juridike për këtë projekt, proces-verbalet e monitorimit dhe çdo dokument tjetër i kërkuar.

2. Konkursi Kombëtar “Novelat Grafike Shqiptare”, Edicioni 6

Ky Projekt kulturor që organizohet dhe financohen nga Ministria e Kulturës, e ka zanafillën në vitin 2014 kur u propozua për herë të parë si konkurs në nivel kombëtar, ku marrin pjesë nxënës, studente, njerëz që lëvrojnë fushën e dizainimit dhe të novelës grafike etj.

Në këtë konkurs kanë marrë pjesë nxënës të shkollave të mesme artistike në Tiranë, Elbasan, Korçë, Gjirokastrë, Shkodër, Berat, Vlorë, Fier dhe Durrës, studentë të Universitetit të Arteve, Fakultetit të Arteve Figurative, Albanian University, nga universitete të tjera dega dizajn, si edhe të tjerë individë të interesuar.

- Projekti Kulturor nisi me MEMO-n nr. 4456 prot., datë 19.10.2020 drejtuar Ministrisë të Kulturës dhe Sekretarit të Përgjithshëm, ku përshkruhet rëndësia e një projekti të tillë në vija të përgjithshme, mënyra dhe propozimet për organizimin e aktivitetit kulturor, nevojat që parashikohen për këtë aktivitet, një kosto e përafërt financiare për zhvillimin e tij dhe propozimi për anëtarët e kolegjumit për shqyrtimin e veprimeve administrative dhe ekonomike për realizimin e këtij projekti, si edhe teksti i cili shpallet në faqen Web të Ministrisë së Kulturës me kriteret e pjesëmarrjes në këtë konkurs, mënyrën e punës, mënyrën e paraqitjes, afatin e dorëzimit të punëve dhe të tjera hollësi specifike për pjesëmarrësit. (*Ligji nr. 10352 “Për Artin dhe Kulturën”, me ndryshime, neni 26 Pika 1/a*)
- Pas marrjes dijeni Ministri i Kulturës ka miratuar Memo-n e sipërcituar dhe ka nënshkruar Urdhërin nr. 400, datë 19.10.2020 òPër ngritjen e kolegjiumit për realizimin e procedurave administrative të projektit kulturor òNovelat Grafike Shqiptareò, Edicioni VI. (*Mbështetur në Ligjin nr. 10352 “Për Artin dhe Kulturën”, me ndryshime, neni 27 Pika 1/a dhe b, Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 102 pika 4 dhe të Ligjit nr. 9000, datë 30.01.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave*).
- Në Urdhrin e Ministrisë të Kulturës nr. 400, datë, 19.10.2020, janë parashikuar:

- Përbërja e Kolegjimit me nëpunës të mesëm të Ministrisë së Kulturës (3 drejtorë të drejtorive të përmbajtjes), konkretisht z. A.A (Kryetar), z. H.D, znj. K.A. Detyrat dhe detyrimet specifike të anëtarëve të Kolegjimit për këtë projekt janë të tilla si: shqyrtimi i përmbajtjes së projektit kulturor dhe çdo veprim tjetër që lidhet me ecurinë dhe realizimin cilësor të këtij projekti, duke nënshkruar vendimet e marra nga ky Kolegjum për t'ia përcjellë më tej Ministrisë së Kulturës.
- Përbërja e sekretarisë teknike, detyrat e anëtarëve të sekretarisë teknike për negocimin e kontratave dhe monitorimin e tyre.
- Autorizimi për nënshkrimin e kontratave nga personi përgjegjës.
- Urdhri është nënshkruar nga konceptuesi Drejtori i DDFZHPK, Drejtori Juridik dhe Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës.
- Me tej, pas mbylljes së afatit të dorëzimit të punëve është hartuar një tjetër Memo me nr. 1539 prot., datë 25.03.2021, ku vihet në dijeni Ministri i Kulturës për punët pjesëmarrëse në konkurs dhe propozimin për anëtarët e jurisë, të cilët do të bëjnë shqyrtimin, seleksionimin dhe përcaktimin e fituesve të këtij konkursi. Urdhri shoqërohet nga CV-t përkatëse të anëtarëve të jurisë.
- Me shkresën nr. 1539/1 prot., datë 25.03.2021, sekretaria teknike e Kolegjimit mbështetur në punët e paraqitura në konkurs, ka hartuar nevojat dhe specifikimet teknike për ekspozitën dhe botimin që realizohet për ceremoninë e ndarjes së çmimeve për këtë konkurs dhe së bashku me emrat e propozuar për jurinë ia ka përcjellë Kolegjimit të krijuar për këtë qëllim nëpërmjet Urdhrit nr. 400, datë 19.10.2020, mbështetur në pikën 4 të këtij Urdhri.
- Anëtarët e Kolegjimit kanë mbajtur proces-verbalin nr. 1539/2 prot., datë 31.03.2021, ku kanë shqyrtuar dhe miratuar specifikimet teknike, modelin e ofertës për botimin dhe materialin publicitar, çmimet fituese dhe anëtarët e jurisë. *(Ligji nr. 10352 “Për Artin dhe Kulturën”, me ndryshime, neni 27, pika 1 a dhe b, Urdhri i Ministrisë së Kulturës nr. 400, datë 19.10.2020, “Për ngritjen e kolegjiut për realizimin e procedurave administrative të projektit kulturor “Novelat Grafike Shqiptare”, Edicioni VI).*
- Anëtarët e Kolegjimit me Vendim nr. 1539/3 prot., datë 31.03.2021 i kanë propozuar Ministrinë të Kulturës për miratim specifikimet teknike, modelin e ofertës për botimin dhe materialin publicitar, çmimet fituese dhe anëtarët e jurisë. *(Ligji nr. 10352 “Për Artin dhe Kulturën”, me ndryshime, neni 27, pika 1 a dhe b, Urdhri i Ministrisë së Kulturës nr. 400, datë 19.10.2020 “Për ngritjen e kolegjiut për realizimin e procedurave administrative të projektit kulturor “Novelat Grafike Shqiptare”, Edicioni VI).*
- Me Memon nr. 1539/4 prot., datë 31.03.2021, i është bërë me dije Ministrisë së Kulturës dhe Sekretarit të Përgjithshëm procedura administrative e kryer nga Kolegjiut për këtë qëllim, ku janë të miratuara në parim emrat e jurisë për konkursin, vlera e çmimeve fituese si edhe specifikimet teknike të botimit dhe materialeve të tjera promovionale për këtë rast.

- Me Urdhrin nr. 203 prot., datë 31.03.2021, òPër shpalljen e përbërjes së jurisë të Edicionit VI të konkursit òNovelat grafike Shqiptareò, përcaktimin e shpërblimit financiar për anëtarët e jurisë, çmimet fituese dhe miratimin e specifikimeve teknikeò, Ministri i Kulturës ka vendosur miratimin e jurisë së konkursit, miratimin e shpërblimit financiar për 5 çmimet e para fituese, miratimin e sondazheve ekonomike në treg për subjektet, të cilat do të ofrojnë shërbimet e kërkuara për këtë aktivitet kulturor, çmimet fituese dhe autorizimin për nënshkrimin e kontratave për këtë qëllim.
- Me shkresën nr. 1539/6 prot., datë 14.04.2021, në zbatim të Urdhërit të Ministrit të Kulturës nr. 203 datë 31.03.2020, pika 5, Sekretari i Përgjithshëm i është drejtuar me kërkesë për ofertë 3 subjekteve të fushës për botimin dhe materialet publicitare, sipas modelit të ofertës dhe specifikimeve teknike, të miratuara nga Kolegjumi dhe Ministri i Kulturës.
- Në datën 16.04.2021, me shkresën nr. 1539/7 prot. dhe në datën 19.04.2021, me shkresën nr. 1539/8/9 prot., janë paraqitur ofertat e sondazhit që janë kryer në 3 subjekte për produktet publicitare të kërkuara dhe botimin për këtë rast.
- Me proces-verbalin nr. 1539/ 10, datë 04.05.2021, Kolegjumi i krijuar me Urdhrin nr. 400, datë 19.10.2020, òPër ngritjen e kolegjiut për realizimin e procedurave administrative të projektit kulturor òNovelat Grafike Shqiptare, Edicioni VIò, u mblodh dhe shqyrtoi ofertat e paraqitura për publicitetin dhe botimin për këtë rast.
- Me Vendimin nr. 1539/11, datë 04.05.2021, Kolegjumi i krijuar me Urdhërin nr. 400, datë 19.10.2021, òPër ngritjen e kolegjiut për realizimin e procedurave administrative të projektit kulturor òNovelat Grafike Shqiptare, Edicioni VIò, vendosi ti propozojë Ministrit të Kulturës miratimin e subjektit, i cili ka rezultuar me çmimin më të ulët në sondazhin e zhvilluar në treg dhe lidhjen e kontratës. (*Ligji nr. 10352 “Për Artin dhe Kulturën“, me ndryshime, neni 27, pika 1 a dhe b, Urdhri i Ministrit të Kulturës nr. 400, datë 19.10.2020*).

Rezultoni se nuk ka një analizë të detajuar të çmimeve të përcaktuara në kërkesë, pasi nuk ka tarifa të përcaktuara për këtë qëllim dhe si referencë përdoren çmimet e tregut.

- Me Urdhrin nr. 290, datë 10.05.2021 òPër miratimin e subjektit dhe lidhjen e kontratës për materialet e kërkuara për realizimin e ceremonisë së ndarjes së çmimeve për Edicionin e 6-të të Konkursit òNovelat Grafike Shqiptareò, Ministri i Kulturës ka urdhëruar lidhjen e kontratës me subjektin, i cili ka rezultuar me vlerën më të ulët ekonomike nga sondazhi i kryer në treg, bazuar në Vendimin nr. 1539/11 të Kolegjiut, datë 04.05.2021. (*Ligji nr. 10352 “Për Artin dhe Kulturën”, me ndryshime, neni 27, pika 1 dhe 2, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 102 pika 4, dhe Ligji nr. 9000, datë 30.01.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave*).
- Në zbatim të Urdhërit nr. 290, datë 10.05.2020 òPër miratimin e subjektit dhe lidhjen e kontratës për materialet e kërkuara për realizimin e ceremonisë së ndarjes së çmimeve për Edicionin e 6-të të Konkursit òNovelat Grafike Shqiptareò, u nënshkruan kontratat me nr. 1539/13 prot., datë 01.10.2021, për botimin me punët e këtij konkursi dhe disa materiale publicitare në funksion të ceremonisë së ndarjes së çmimeve për këtë konkurs.
- Me shkresën nr. 1539/14, datë 02.12.2021 në mbështetje të Urdhërit të Ministrit të Kulturës nr. 400, datë 19.10.2020 òPër ngritjen e kolegjiut dhe realizimin e procedurave administrative të projektit kulturor Novelat Grafike Shqiptareò, Edicioni 6-tëò, pika 4 dhe të Urdhërit nr. 290 prot., datë 10.05.2021 òPër miratimin e subjektit dhe lidhjen e kontratës për materialet e kërkuara për realizimin e ceremonisë së ndarjes së çmimeve për Edicionin e 6-të të Konkursit òNovelat Grafike Shqiptareò, kanë përpiluar dhe nënshkruar proces-verbalin e monitorimit të kontratës nr.

1539/13, datë 01.10.2021, duke e nënshkruar atë rregullisht, mbështetur në specifikimet teknike për materialet e kërkuara nga porositi.

- Me nr. 1539/15/16/17, datë 02.12.2021 janë nënshkruar kontratat me anëtarët e jurisë se këtij konkursi, në zbatim të Urdhrit të Ministrit të Kulturës nr. 203 prot. datë 31.03.2021, òPër shpalljen e përbërjes së jurisë të Edicionit VI të konkursit òLegjendat shqiptare në novelat grafikeò, përcaktimin e shpërblimit financiar për anëtarin e jurisë, çmimet fituese dhe miratimin e specifikimeve teknikeò, Ministri i Kulturës ka urdhëruar miratimin e jurisë së konkursit sondazhet ekonomike në treg për subjektet, të cilat do të ofrojnë shërbimet e kërkuara për këtë aktivitet kulturor, çmimet fituese dhe autorizimin për nënshkrimin e kontratave për këtë qëllim.
- Me proces-verbalin nr. 1539/18, datë 22.12.2021, anëtarët e sekretarisë teknike dhe anëtarët e jurisë kanë shpallur zyrtarisht emrat e artistëve fitues të Edicionit të 6-të të Novelave Grafike Shqiptare, bazuar në Urdhrin nr. 400, datë 19.10.2020 të Ministrit të Kulturës òPër ngritjen e kolegjiut për realizimin e procedurave administrative të projektit kulturor òNovelat Grafike Shqiptareò, Edicioni VIò, pika 4 dhe Urdhrit të Ministrit të Kulturës nr. 203 prot., datë 31.03.2021 òPër shpalljen e përbërjes së jurisë të Edicionit VI të konkursit Novelat Grafike Shqiptare, përcaktimin e shpërblimit financiar për anëtarin e jurisë, çmimet fituese dhe miratimin e specifikimeve teknikeò. Proces-verbali është nënshkruar normalisht nga 3 anëtarët e jurisë dhe 2 anëtarët e sekretarisë teknike të Kolegjiut.
- Me proces-verbalin nr. 1539/19, datë 22.12.2021 anëtarët e sekretarisë teknike kanë përcaktuar emrat e artisteve fitues të Edicionit të 6 të Novelave Grafike Shqiptare, bazuar në Urdhrin nr. 400, datë 19.10.2020 të Ministrit të Kulturës òPër ngritjen e kolegjiut për realizimin e procedurave administrative të projektit kulturor òNovelat Grafike Shqiptareò, Edicioni VIò, pika 4 dhe Urdhërit të Ministrit të Kulturës nr. 203 prot. Datë 31.03.2021 òPër shpalljen e përbërjes së jurisë të Edicionit VI të konkursit Novelat Grafike Shqiptare, përcaktimin e shpërblimit financiar për anëtarin e jurisë, çmimet fituese dhe miratimin e specifikimeve teknikeò. Proces-verbali është nënshkruar nga 2 anëtarët e sekretarisë teknike të Kolegjiut.
- Me proces verbalin nr. 1539/20, datë 22.12.2021 anëtarët e sekretarisë teknike, bazuar në Urdhrin nr. 400, datë 19.10.2020 të Ministrit të Kulturës òPër ngritjen e kolegjiut për realizimin e procedurave administrative të projektit kulturor òNovelat Grafike Shqiptareò, Edicioni VIò, pika 4 dhe Urdhrit të Ministrit të Kulturës nr. 203 prot., datë 31.03.2021, òPër shpalljen e përbërjes së jurisë të Edicionit VI të konkursit Novelat Grafike Shqiptare, përcaktimin e shpërblimit financiar për anëtarin e jurisë, çmimet fituese dhe miratimin e specifikimeve teknikeò, kanë bërë monitorimin e kontratave nr. 1539/15/16/17 prot., datë 02.12.2021 të punës që kanë kryer anëtarët e jurisë në funksion të mbarëvajtjes së këtij konkursi. Proces-verbali është nënshkruar normalisht nga 2 anëtarët e sekretarisë teknike të Kolegjiut.

Pas kryerjes dhe realizimit të këtij projekti kulturor janë dorëzuar në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtorinë e Financës, sipas procedurave të këtyre Drejtorive, një kopje të Urdhrave të Ministrit të Kulturës për këtë projekt, kontratat e lidhura me subjektet fizike dhe juridike për këtë projekt, proces-verbalet e monitorimit dhe çdo dokument tjetër i kërkuar.

Për sa më lart, bazuar në evidencën dokumentare të vendosur në dispozicion grupit të auditimit të KLSH, u arrit në gjetjet e auditivit, si më poshtë vijon:

Titulli i Gjetjes:	Mangësi në procedurat e ndjekura për projektet kulturore me inicim të brendshëm të drejtorisë së konceptimit dhe fizibilitetit të projekteve të kulturës: òGjirokastra 15 vite në UNESCOò dhe Konkursi Kombëtar òNovelat Grafike Shqiptareò, Edicioni 6.
---------------------------	--

Situata:	Nuk ka një dokumentacion justifikues në lidhje me përcaktimin e vlerës së fondit limit. Po kështu, nuk është justifikuar mënyra e përzgjedhjes së subjekteve të cilëve u është drejtuar kërkesa për ofertë. Nuk ka një analizë të detajuar të çmimeve të përcaktuara në kërkesë, pasi nuk ka tarifa të përcaktuara për këtë qëllim dhe si referencë përdoren çmimet e tregut.
Kriteri:	-Ligji 10352 “Për Artin dhe Kulturën“, i ndryshuar; -Ligji nr. 9000, datë 30.01.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave; -Urdhër i Ministrit të Kulturës nr. 229, datë 08.07.2020; -Urdhër nr. 231, datë 09.07.2020 “Për miratimin e kushteve ekonomike të bashkëpunëtoreve të jashtëm, kryerjen e negociatave me artistët pjesëmarrës në koncert, miratimin e specifikimeve teknike të maketit të kalasë së Gjirokastrës, materialit publicitar, pajisjeve teknike, kushtet e akomodimit dhe ushqimit, listës së personave që akomodohen, formularit të ofertës për subjektet dhe skaletës së aktiviteteve kulturore”; -Urdhër i Ministrit të Kulturës nr. 231 datë 09.07.2020; -Urdhër nr. 235 datë 13.07.2020, “Për lidhjen e kontratës me artistët dhe subjektet juridike dhe fizike, të cilët kanë paraqitur ofertën më të mirë ekonomike për realizimin e projektit kulturor “Gjirokastra 15 vite në UNESCO”; -Urdhri i Ministrit të Kulturës nr. 400, datë 19.10.2020 “Për ngritjen e kolegjiut për realizimin e procedurave administrative të projektit kulturor “Novelat Grafike Shqiptare”, Edicioni VI.
Ndikimi/Efekti:	Mos veprimet dhe neglizhenca e konstatuara kanë sjelle si pasojë efekt negativ të shkaktuar nga menaxhimi jo me ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet në kryerjen e shpenzimeve buxhetore.
Shkaku:	Mosrespektimi i përcaktimeve ligjore në fuqi; Menaxhimi jo efektiv i buxhetit institucional. Efekt negativ.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	MK të marrë masa për llogaritjen e fondeve limite në të tilla procedura, në kuadër të menaxhimit sa më efektiv të fondeve publike.

II. PROJEKTET KULTURORE ME THIRRJE TË VITIT 2020 -2021.

Projektet me Thirrje janë projekte kulturore që mbështeten financiarisht me fonde publike nga Ministria e Kulturës. Mbështetja financiare për projektet në art-kulturë-trashëgimi buron nga Programi i Qeverisë Shqiptare, programi vjetor i Ministrisë së Kulturës, Strategjia për Kulturën 2019-2025, veprimtaria kulturore periodike, ngjarje të rëndësishme kulturore, festivale kombëtare, etj.

Në Thirrjen për projekt-propozime në art-kulturë-trashëgimi shprehen qartë politikat kulturore, prioritetet, sektorët kulturorë që marrin vëmendje bazuar në zhvillime dhe projeksione afatmesme e afatgjata.

Viti 2020

1. Me shkresën nr. 191 prot., datë 14.01.2020 është hartuar Memo informuese mbi hapjen e thirrjes, bazuar në Programin e Qeverisë, politikat e Ministrisë së Kulturës, strategjinë e saj, prioritetet sipas periudhës, etj..
2. Me Urdhrin nr. 10, datë 14.01.2020 të Ministrit të Kulturës është urdhëruar hapja e thirrjes për projekt propozime për fonde dhe/ose mbështetje nga Ministria e Kulturës për vitin 2020, mënyra e shpalljes, fondi nga do të mbështeten, miratimi i udhëzuesit për aplikim, periudha e pranimit të projekt-propozimeve, krijimi i regjistrit protokoll për aplikimet në zyrën e protokollit të MK, drejtoritë përgjegjëse për zbatim dhe njoftim te urdhrin të ministrit.
3. Pas miratimit të ministrit përgjegjës për kulturën të propozimit për hapjen e thirrjes, është hartuar teksti i thirrjes, udhëzuesi, formularët e aplikimit, formulari i buxhetit, formulari i aktiviteteve të projektit, lista e dokumentacionit të individit/personit fizik/personit juridik.
4. Thirrja është shpallur në faqen ëeb të Ministrisë, bashkëngjitur linku me dokumentacionin e sipërpërmendur, afatet dhe oraret e përfundimit të aplikimeve, mënyrat e aplikimit etj..

5. Me shkresën nr. 191/3 prot., datë 12.02.2020 Drejtoria e Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve të Kulturës me memo i është drejtuar Ministrit të Kulturës, me propozime për ngritjen e kolegjiut dhe masën e shpërblimit të tij, bazuar në nenin 27, 27/1 pika a dhe b.
6. Me Urdhrin nr. 83, datë 12.02.2020 të Ministrit të Kulturës është miratuar përbërja e Kolegjiut, me përbërje:
 - Z. A.P , ekspert për projektet, ekspert i jashtëm (Kryetar);
 - Znj. E.C , Sekretare e Përgjithshme (anëtar);
 - Z. A.A, Drejtor i DKFPK (anëtar);
 - Znj. A.M , Këshilltare (anëtare);
 - Z. A.B , Drejtor i QKKF (anëtar);
 - Znj.M.K , muzikologe, eksperte e jashtme (anëtare);
 - Znj.D.A, Këshilltare (anëtare).

Kolegjiu do të vlerësojë, klasifikojë dhe përzgjedhë projektet e artit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore, duke përcaktuar edhe masën e shpërblimit të tij. *(Mbështetur në Ligjin nr. 10352 “Për Artin dhe Kulturën”, i ndryshuar, neni 27 pika 1).*

Referuar Ligjit nr. 10352 òPër Artin dhe Kulturën, neni 27 pika 2 përcaktohet:

“Mënyra e funksionimit të këtij kolegjiu përcaktohet me urdhër të ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën”. Rezulton se nuk eeshtee njerrë njee urdhër për mënyrën e funksionimit të kolegjiut. Nga shqyrtimi i përbërjes së kolegjiut rezulton se pjesë e tij janë edhe këshilltar, në shkelje me përcaktimet e nenit 48, pika 2 të Rregullores së Organizimit dhe Funksionimit të Brendshëm të Ministrisë së Kulturës.

7. Rezulton se kanë aplikuar 149 subjekte për thirrjen 2020.
8. Me Urdhrin nr. 132, datë 08.03.2020 të Ministrit të Shëndetësisë, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infektimi i shkaktuar nga COVID-2019 është vendosur mbyllja e aktiviteteve publike dhe jo publike, të tilla si aktivitete sportive, kulturore dhe konferenca, deri në datën 3 Prill 2020.
9. Ministria e Kulturës ka njoftuar për ndryshime në Udhëzimin për zbatimin e thirrjes 2020, në zbatim të Urdhërit nr. 132, datë 08.03.2020 të MSHMS òPër mbylljen e aktiviteteve publike dhe jopublike dhe anulimin e grumbullimeve për parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19.
10. Me Urdhërin nr. 351, datë 29.05.2020 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 2565 prot., datë 29.05.2020 òPër marrjen e masave të veçanta dhe kufizimeve për parandalimin dhe përhapjen e COVID-19 është ndaluar zhvillimi i aktiviteteve kulturore.
11. Me shkresën nr. 191/5 prot., datë 05.06.2020 Kolegjiu ka mbajtur proces-verbalin e datës 05.06.2020 dhe ka përzgjedhur që të propozojë realizimin e 27 projekteve. Nuk ka patur një proces të përzgjedhjes të ndarë në dy faza, sipas përcaktimeve të Udhëzuesit të Ministrisë së Kulturës. Nuk rezulton të ketë proces-verbal të mbledhjes së Kolegjiut për fazën e parë të procesit, ku të jenë përcaktuar se cilët janë subjektet të cilët kalojnë fazën e parë. Referuar procesverbalit të mbajtur nga Kolegjiu nuk është përcaktuar metodologjia e përzgjedhjes dhe e klasifikimit të subjekteve fitues.
12. Me Vendimin nr. 191/6, datë 05.06.2020 Kolegjiu ka vendosur propozimin pranë Ministrit të Kulturës për miratimin e financimit të 27 projekteve në shumat dhe zërat e përcaktuar në aplikim.

Rezulton se Kolegjiu ka miratuar preventivat e paraqitur nga subjektet fitues pa bërë një analizë të detajuar të kostove.

13. Me Urdhrin nr. 195, datë 12.06.2020 të Ministrit të Kulturës është vendosur mbështetja totale prej 33.000.000 lekë nga zëri 06040 i aparatit, 0Projekte në art-kulturë, projektet e propozuara nga Kolegjiumi dhe nënshkrimi i kontratave me subjektet fituese.

14. Në datën 21.09.2020 është lidhur kontrata e shërbimit me nr. 3978 prot., datë 21.09.2020 midis Ministrisë së Kulturës dhe z. A.P , si ekspert i jashtëm, për pjesëmarrje në mbledhjet e Kolegjiumit, si dhe në audicionet që do të zhvillohen.

Rezulton se kontrata është lidhur pas përzgjedhjes së subjekteve fitues nga ana e Kolegjiumit dhe lidhjes së kontratave me Ministrinë e Kulturës, ndërkohë që z. A.P , ka ushtruar funksionet si Kryetar i Kolegjiumit, pa patur një akt ligjor të ushtrimit të funksioneve. Referuar kontratës së lidhur midis Ministrisë së Kulturës dhe z. A.P , në nenin 3 të saj përcaktohet që efektet juridike të saj fillojnë që nga dita e nënshkrimit të kësaj kontrate, e cila përkon me datën 21.09.2020.

Gjithashtu, referuar nenit 48, pika 2 të Rregullores së Organizimit dhe Funksionimit të Brendshëm të Ministrisë së Kulturës, parashikohet që ekspertët e fushës nuk kanë të drejtë vote në Kolegjium. Z. A.P rezulton të jetë pjesëmarrës në procesin e votimit dhe gjithashtu gëzon statusin e kryetarit të Kolegjiumit.

Rezulton se nuk ka kontratë të lidhur midis Ministrisë së Kulturës dhe znj. M.K , në cilësinë e ekspertes, pjesë e Kolegjiumit. Në këto kushte znj. M.K ka ushtruar funksionet pa patur një akt ligjor.

15. Janë lidhur kontratat me subjektet fitues, të përzgjedhur për tu audituar si më poshtë:

- Kontratë nr. 2567 prot., datë 15.06.2020 0O0. Aneks 1 me të dhënat e subjektit, aneks 2 Preventiv, të dhënat e llogarise bankare të subjektit.
- Kontratë nr. 2575 prot., datë 15.06.2020, 0A0. Aneks 1 me të dhënat e subjektit, aneks 2 preventiv, të dhënat e llogarisë bankare të subjektit.
- Kontratë nr. 2574 prot., datë 15.06.2020 0B0. Aneks 1 me të dhënat e subjektit, aneks 2 preventiv, të dhënat e llogarisë bankare të subjektit.
- Kontratë nr. 2762 prot., datë 29.06.2020, 0S0. Aneks 1 me të dhënat e subjektit, aneks 2 preventiv, të dhënat e llogarisë bankare të subjektit.
- Kontratë nr. 2765 prot., datë 29.06.2020 0Q.Sh.P.Nj.Zh.T.Q0. Aneks 1 me të dhënat e subjektit, aneks 2 preventiv, të dhënat e llogarisë bankare të subjektit.
- Kontratë nr. 3517 prot., datë 25.8.2020 0A.M.A0. Aneks 1 me të dhënat e subjektit, aneks 2 preventiv, të dhënat e llogarisë bankare të subjektit.

16. Me Urdhërin nr. 336, datë 22.09.2020 Ministri i Kulturës ka urdhëruar monitorimin dhe mbarëvajtjen e aktiviteteve në fushën Art-Kulturë-Trashëgimi, bazuar në Urdhrin nr. 195, datë 12.06.2020.

17. Janë hartuar raportet e monitorimit për kontratat e lidhura si më poshtë:

- Raport monitorimi nr. 4562 prot., datë 27.10.2020. Dokumentacioni justifikues i zërave të paraqitura në preventive (fatura, kalime bankare, pagesa honorarësh, kontrata me të tretë, tatime në burim, etj., administrohen nga zyra e financës);
- Raport monitorimi nr. 5455 prot., datë 16.12.2020. Dokumentacioni justifikues i zërave të paraqitura në preventive (fatura, kalime bankare, pagesa honoraresh, kontrata me të tretë, tatime në burim, etj., administrohen nga zyra e financës);
- Raport monitorimi nr. 4544 prot., datë 26.10.2020. Dokumentacioni justifikues i zërave të paraqitura në preventive (fatura, kalime bankare, pagesa honoraresh, kontrata me të tretë, tatime në burim, etj., administrohen nga zyra e financës);
- Raport monitorimi nr. 2762 prot., datë 29.06.2020. Dokumentacioni justifikues i zërave të paraqitura në preventive (fatura, kalime bankare, pagesa honoraresh, kontrata me të tretë, tatime në burim, etj., administrohen nga zyra e financës);

- Raport monitorimi nr. 5308 prot., datë 10.12.2020. Dokumentacioni justifikues i zërave të paraqitura në preventive (fatura, kalime bankare, pagesa honoraresh, kontrata me të tretë, tatime në burim, etj., administrohen nga zyra e financës); dhe
- Raport Monitorimi nr. 4453 prot., datë 19.10.2020. Dokumentacioni justifikues i zërave të paraqitura në preventive (fatura, kalime bankare, pagesa honoraresh, kontrata me të tretë, tatime në burim, etj., administrohen nga zyra e financës).

18. Drejtoria e financës ka kryer pagesat sipas procedurave përkatëse, në fillim të implementimit të projektit 60 % të vlerës së akorduar dhe 40 % në mbyllje të projektit, shoqëruar me fatura justifikuese, kalime bankare, kontrata dhe shlyerje të detyrimeve të tatimit në burim.

Ne zbatim të përcaktimeve të nenit 5 të çdo kontrate “Të drejtat dhe detyrimet e përfituesit” parashikohet që: Shpenzimet e kryera nga përfituesi, për të gjithë zërat e financuara nga financuesi, duhet të justifikohen me raport përshkrues nga përfituesi mbi realizimin e veprimtarive që financohen nga financuesi sipas kësaj kontrate. Rezulton se në të gjithë dokumentacionin bashkëlidhur urdhër shpenzimeve mungojnë raportet përmbledhëse.

Viti 2021

1. Me shkresën nr. 5109 prot., datë 01.12.2020 është hartuar Memo informuese mbi hapjen e thirrjes për vitin 2021, bazuar në Programin e Qeverisë, politikat e Ministrisë së Kulturës, strategjinë e saj, prioritetet sipas periudhës, etj..
2. Me Urdhrin nr. 488, datë 01.12.2020 të Ministrit të Kulturës është urdhëruar hapja e thirrjes për projekt propozime për fonde dhe/ose mbështetje nga Minsitria e Kulturës për vitin 2021, mënyra e shpalljes, fondi nga do të mbështeten, miratimi i udhëzuesit për aplikim, periudha e pranimit të projekt-propozimeve, krijimi i regjistrit protokoll për aplikimet në zyrën e protokollit të MK, drejtoritë përgjegjëse për zbatim dhe njoftim ete urdhrit të ministrit.
3. Pas miratimit nga Ministri përgjegjës për kulturën të propozimit për hapjen e thirrjes, është hartuar teksti i thirrjes, udhëzuesi, formularët e aplikimit, formulari i buxhetit, formulari i aktiviteteve të projektit, lista e dokumentacionit të individit/personit fizik/personit juridik.
4. Thirrja është shpallur në faqen web të Ministrisë, bashkëngjitur linku me dokumentacionin e sipërpërmendur, afatet dhe oraret e përfundimit të aplikimeve, mënyrat e aplikimit, etj..
5. Me shkresën nr. 343 prot., datë 22.01.2021 Drejtoria e Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve të Kulturës me memo i është drejtuar Ministrit të Kulturës me propozime për ngritjen e kolegjiut, duke paraqitur disa propozime dhe masën e shpërblimit të tij, bazuar në nenin 27, 27/1 pika a dhe b.
6. Me Urdhrin nr. 30, datë 22.01.2021 të Ministrit të Kulturës është miratuar përbërja e Kolegjiut, me përbërje:
 - Z. A.P , ekspert për projektet, ekspert i jashtëm (Kryetar);
 - Znj. E.C , Sekretare e Përgjithshme (anëtar);
 - Z. A.A , Drejtor i DKFPK (anëtar);
 - Znj. A.M , Këshilltare (anëtare);
 - Z. A.B , Drejtor i QKKF (anëtar).

Kolegjiut do të vlerësojë, klasifikojë dhe përzgjedhë projektet e artit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore, duke përcaktuar edhe masën e shpërblimit të tij. (Mbështetur në Ligjin nr. 10352 “Për Artin dhe Kulturën”, i ndryshuar, neni 27 pika 1).

Referuar Ligjit nr. 10352 òPër Artin dhe Kulturën, neni 27 pika 2 përcaktohet:

òMënyra e funksionimit të këtij Kolegjiut përcaktohet me urdhër të ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën. Rezulton se nuk është nxjerrë urdhër për mënyrën e funksionimit të kolegjiut. Nga

shqyrtimi i përbërjes së kolegjiut rezulton se pjesë e tij janë edhe këshilltar, në shkelje me përcaktimet e nenit 48, pika 2 të Rregullores së Organizimit dhe Funksionimit të Brendshëm të Ministrisë së Kulturës.

7. Rezulton se kanë aplikuar 252 subjekte për thirrjen 2021.

8. Me shkresën nr. 343/2 prot., datë 21.01.2021 Kolegjiumi ka mbajtur procesverbalin e datës 21.01.2021 dhe ka përzgjedhur që të propozojë realizimin e 160 projekteve.

Nuk ka patur një proces të përzgjedhjes të ndarë në dy faza sipas përcaktimeve të Udhëzuesit të Ministrisë së Kulturës. Nuk rezulton të ketë procesverbal të mbledhjes së Kolegjiumit për fazën e parë të procesit, ku të jenë përcaktuar se cilët janë subjektet të cilët kalojnë fazën e parë. Referuar procesverbalit të mbajtur nga Kolegjiumi, nuk është përcaktuar metodologjia e përzgjedhjes dhe e klasifikimit të subjekteve fituese.

9. Me Vendimin nr. 343/3, datë 21.01.2021 Kolegjiumi ka vendosur propozimin pranë Ministrisë së Kulturës, për miratimin e financimit të 160 projekteve në shumat dhe zërat e përcaktuar në aplikim.

Rezulton se Kolegjiumi ka miratuar preventivat e paraqitur nga subjektet fitues pa bërë një analizë të detajuar të kostove.

10. Me Urdhrin nr. 63, datë 09.02.2021 të Ministrisë së Kulturës është vendosur mbështetja totale prej 84.040.000 lekë nga zëri 06040 i aparatit, 0Projekte në art-kulturë, projektet e propozuara nga Kolegjiumi dhe nënshkrimi i kontratave me subjektet fitues.

11. Janë lidhur kontratat me subjektet fituese, të përzgjedhur për tu audituar si më poshtë:

- Kontratë nr. 1039 prot., datë 01.03.2021 0T.Iö. Aneks 1 me të dhënat e subjektit, aneks 2 preventiv, të dhënat e llogarisë bankare të subjektit.
- Kontratë nr. 1044 prot., datë 01.03.2021 0K.Nö. Aneks 1 me të dhënat e subjektit, aneks 2 preventiv, të dhënat e llogarisë bankare të subjektit.
- Kontratë nr. 1048 prot., datë 01.03.2021 0CSDA- Q.P.Zh.T.Qö. Aneks 1 me të dhënat e subjektit, aneks 2 preventiv, të dhënat e llogarisë bankare të subjektit.
- Kontratë nr. 1135 prot., datë 04.03.2021 0SIGö. Aneks 1 me të dhënat e subjektit, aneks 2 preventiv, të dhënat e llogarisë bankare të subjektit.
- Kontratë nr. 1534 prot., datë 24.03.2021 0GIDö. Aneks 1 me të dhënat e subjektit, aneks 2 preventiv, të dhënat e llogarisë bankare të subjektit.

12. Në datën 02.03.2021 është lidhur kontrata e shërbimit me nr. 343/7 prot., datë 02.03.2021 midis Ministrisë së Kulturës dhe z. A.P, si ekspert i jashtëm, për pjesëmarrje në mbledhjet e Kolegjiumit, si dhe në audicionet që do zhvillohen.

Rezulton se kontrata është lidhur pas përzgjedhjes së subjekteve fitues nga ana e Kolegjiumit dhe lidhjes së kontratave me Ministrinë e Kulturës, ndërkohë që z. A.P ka ushtruar funksionet si Kryetar i Kolegjiumit pa patur një akt ligjor të ushtrimit të funksioneve. Referuar kontratës së lidhur midis Ministrisë së Kulturës dhe z. A.P, në nenin 3 të saj përcaktohet që efektet juridike të saj fillojnë që nga dita e nënshkrimit të kësaj kontrate, e cila përkon me datën 02.03.2021.

Gjithashtu referuar nenit 48, pika 2 të Rregullores së Organizimit dhe Funksionimit të Brendshëm të Ministrisë së Kulturës, parashikohet që ekspertët e fushës nuk kanë të drejtë vote në Kolegjium. Z. A.P rezulton të jetë pjesëmarrës në procesin e votimit dhe gjithashtu gëzon statusin e kryetarit të Kolegjiumit.

13. Me Urdhrin nr. 120, datë 08.03.2021 Ministri i Kulturës ka urdhëruar monitorimin dhe mbarëvajtjen e aktiviteteve në fushën art-kulturë-trashëgimi, bazuar në Urdhrin nr. 63, datë 09.02.2021.

14. Janë hartuar raportet e monitorimit për kontratat e lidhura si më poshtë:

- Raport Monitorimi nr. 2051 prot., datë 19.04.2021. Dokumentacioni justifikues i zërave të paraqitura në preventive (fatura, kalime bankare, pagesa honorarësh, kontrata me të tretë, tatime në burim, etj., administrohen nga zyra e financës);
- Raport Monitorimi nr. 2617 prot., datë 19.05.2021. Dokumentacioni justifikues i zërave të paraqitura në preventive (fatura, kalime bankare, pagesa honorarësh, kontrata me të tretë, tatime në burim, etj., administrohen nga zyra e financës);
- Raport Monitorimi nr. 3952 prot., datë 27.07.2021. Dokumentacioni justifikues i zërave të paraqitura në preventive (fatura, kalime bankare, pagesa honorarësh, kontrata me të tretë, tatime në burim, etj., administrohen nga zyra e financës);
- Raport Monitorimi nr. 4005 prot., datë 29.07.2021. Dokumentacioni justifikues i zërave të paraqitura në preventive (fatura, kalime bankare, pagesa honorarësh, kontrata me të tretë, tatime në burim, etj., administrohen nga zyra e financës);
- Raport monitorimi nr. 5308 prot., datë 10.12.2020. Dokumentacioni justifikues i zërave të paraqitura në preventive (fatura, kalime bankare, pagesa honorarësh, kontrata me të tretë, tatime në burim, etj., administrohen nga zyra e financës); dhe
- Raport Monitorimi nr. 3951 prot., datë 27.07.2021. Dokumentacioni justifikues i zërave të paraqitura në preventive (fatura, kalime bankare, pagesa honorarësh, kontrata me të tretë, tatime në burim, etj., administrohen nga zyra e financës).

15. Drejtoria e financës ka kryer pagesat sipas procedurave përkatëse, në fillim të implementimit të projektit 60 % të vlerës së akorduar dhe 40 % në mbyllje të projektit, shoqëruar me fatura justifikuese, kalime bankare, kontrata dhe shlyerje të detyrimeve të tatimit në burim.

Në zbatim të përcaktimeve të nenit 5 të çdo kontrate ÷Të drejtat dhe detyrimet e përfituesitö prarashikohet që: ÷Shpenzimet e kryera nga përfituesi, për të gjithë zërat e financuara nga financuesi, duhet të justifikohen me raport përshkrues nga përfituesi mbi realizimin e veprimtarive që financohen nga financuesi sipas kësaj kontrateö. Rezulton se në të gjithë dokumentacionin bashkëlidhur urdhër shpenzimeve mungojnë raportet përmbledhëse.

Nga shqyrtimi i listës së projekteve fituese për vitet 2020 dhe 2021 evidentohet disa subjekte të cilët janë subvencionuar duke qenë individ, ndër të cilët edhe subjekti K.N, i cili është përzgjedhur për tu audituar. Referuar Ligjit nr. 10352, datë 18.11.2010 ÷Për Artin dhe Kulturënö, i ndryshuar, neni 26 parashikon se MK financon projekte të paraqitura nga persona fizik dhe juridik. Gjithashtu, referuar edhe udhëzimeve të Ministrisë së Kulturës, në seksionin se cilët mund të aplikojnë, është parashikuar që individët nuk kanë të drejtën e aplikimit. Në këto kushte të gjithë individët që kanë përfituar fonde dhe/ose mbështetje nga Ministria e Kulturës janë në shkelje të përcaktimeve ligjore.

Për sa më lart, bazuar në evidencën dokumentare të vendosur në dispozicion grupit të auditimit të KLSH, u arrit në gjetjet e auditivit, si më poshtë vijon:

Titulli i Gjetjes:	Mangësi në procedurat e ndjekura për projektet kulturore me thirrje të vitit 2020 -2021.
Situata:	<p>Për vitin 2020:</p> <p>Ministri i Kulturës nuk ka nxjerrë urdhër për mënyrën e funksionimit të kolegjiut, në shkelje të përcaktimeve ligjore. Nga shqyrtimi i përbërjes së kolegjiut rezulton se pjesë e tij janë edhe këshilltar, në shkelje me përcaktimet e nenit 48, pika 2 të Rregullores së Organizimit dhe Funksionimit të Brendshëm të Ministrisë së Kulturës. Nuk ka patur një proces të përzgjedhjes të ndarë në dy faza, sipas përcaktimeve të Udhëzuesit të Ministrisë së Kulturës, të miratuar me Urdhrin nr. 10, datë 14.01.2020 të Ministrisë së Kulturës, shkronja (h).</p> <p>Nuk rezulton të ketë proces-verbal të mbledhjes së Kolegjiut për fazën e parë të procesit, ku të jenë përcaktuar se cilët janë subjektet të cilët kalojnë fazën e parë, në shkelje me përcaktimet e Ligjit Nr.8480, date 27.5.1999 ÷Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publikeö, neni 16.</p> <p>Referuar procesverbalit të mbajtur nga Kolegjiut nuk është përcaktuar metodologjia e përzgjedhjes dhe e klasifikimit të subjekteve fitues. Kolegjiut ka miratuar preventivat e paraqitur nga subjektet fitues pa bërë një analizë të detajuar të kostove.</p>

	<p>Kontrata është lidhur pas përzgjedhjes së subjekteve fitues nga ana e Kolegjiumit dhe lidhjes së kontratave me Ministrinë e Kulturës, ndërkohë që z. A.P, ka ushtruar funksionet si Kryetar i Kolegjiumit, pa patur një akt ligjor të ushtrimit të funksioneve. Referuar kontratës së lidhur midis Ministrisë së Kulturës dhe z. A.P , në nenin 3 të saj përcaktohet që efektet juridike të saj fillojnë që nga dita e nënshkrimit të kësaj kontrate, e cila përkon me datën 21.09.2020.</p> <p>Gjithashtu, referuar nenit 48, pika 2 të Rregullores së Organizimit dhe Funksionimit të Brendshëm të Ministrisë së Kulturës, parashikohet që ekspertët e fushës nuk kanë të drejtë vote në Kolegjium. Z. A.P rezulton të jetë pjesëmarrës në procesin e votimit dhe gjithashtu gëzon statusin e kryetarit të Kolegjiumit.</p> <p>Rezulton se nuk ka kontratë të lidhur midis Ministrisë së Kulturës dhe znj. M.K , në cilësinë e ekspertes, pjesë e Kolegjiumit. Në këto kushte znj. M.K ka ushtruar funksionet patur një akt ligjor.</p> <p>Ne zbatim të përcaktimeve të nenit 5 të çdo kontrate òTë drejtat dhe detyrimet e përfituesitò parashikohet që: Shpenzimet e kryera nga përfituesi, për të gjithë zërat e financuara nga financuesi, duhet të justifikohen me raport përshkrues nga përfituesi mbi realizimin e veprimtarive që financohen nga financuesi sipas kësaj kontrate. Rezulton se në të gjithë dokumentacionin bashkëlidhur urdhër shpenzimeve mungojnë raportet përmbledhëse.</p> <p>Për vitin 2021:</p> <p>Ministri i Kulturës nuk ka nxjerrë urdhër për mënyrën e funksionimit të kolegjiumit në shkelje të përcaktimeve ligjore. Nga shqyrtimi i përbërjes së kolegjiumit rezulton se pjesë e tij janë edhe këshilltar, në shkelje me përcaktimet e nenit 48, pika 2 të Rregullores së Organizimit dhe Funksionimit të Brendshëm të Ministrisë së Kulturës. Nuk ka patur një proces të përzgjedhjes të ndarë në dy faza, sipas përcaktimeve të Udhëzuesit të Ministrisë së Kulturës, të miratuar me Urdhrin nr. 488, datë 01.12.2020 të Ministrit të Kulturës, shkronja (h). Nuk rezulton të ketë proces-verbal të mbledhjes së Kolegjiumit për fazën e parë të procesit, ku të jenë përcaktuar se cilët janë subjektet të cilët kalojnë fazën e parë, në shkelje me përcaktimet e Ligjit Nr.8480, date 27.5.1999 òPër funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publikeò, neni 16. Referuar procesverbalit të mbajtur nga Kolegjiumi nuk është përcaktuar metodologjia e përzgjedhjes dhe e klasifikimit të subjekteve fitues. Kolegjiumi ka miratuar preventivat e paraqitur nga subjektet fitues pa bërë një analizë të detajuar të kostove.</p> <p>Kontrata është lidhur pas përzgjedhjes së subjekteve fitues nga ana e Kolegjiumit dhe lidhjes së kontratave me Ministrinë e Kulturës, ndërkohë që z. A.P ka ushtruar funksionet si Kryetar i Kolegjiumit pa patur një akt ligjor të ushtrimit të funksioneve. Referuar kontratës së lidhur midis Ministrisë së Kulturës dhe z. A.P, në nenin 3 të saj përcaktohet që efektet juridike të saj fillojnë që nga dita e nënshkrimit të kësaj kontrate, e cila përkon me datën 02.03.2021.</p> <p>Gjithashtu referuar nenit 48, pika 2 të Rregullores së Organizimit dhe Funksionimit të Brendshëm të Ministrisë së Kulturës, parashikohet që ekspertët e fushës nuk kanë të drejtë vote në Kolegjium. Z. A.P rezulton të jetë pjesëmarrës në procesin e votimit dhe gjithashtu gëzon statusin e kryetarit të Kolegjiumit.</p> <p>Në zbatim të përcaktimeve të nenit 5 të çdo kontrate òTë drejtat dhe detyrimet e përfituesitò parashikohet që: Shpenzimet e kryera nga përfituesi, për të gjithë zërat e financuara nga financuesi, duhet të justifikohen me raport përshkrues nga përfituesi mbi realizimin e veprimtarive që financohen nga financuesi sipas kësaj kontrateò. Rezulton se në të gjithë dokumentacionin bashkëlidhur urdhër shpenzimeve mungojnë raportet përmbledhëse.</p> <p>Nga shqyrtimi i listës së projekteve fituese për vitet 2020 dhe 2021 evidentohet disa subjekte të cilët janë subvencionuar duke qenë individ, ndër të cilët edhe subjekti K.N, i cili është përzgjedhur për tu audituar. Referuar Ligjit nr. 10352, datë 18.11.2010 òPër Artin dhe Kulturënò, i ndryshuar, neni 26 parashikon se MK financon projekte të paraqitura nga persona fizik dhe juridik. Gjithashtu, referuar edhe udhëzimeve të Ministrisë së Kulturës, në seksionin se cilët mund të aplikojnë, është parashikuar që individët nuk kanë të drejtën e aplikimit. Në këto kushte të gjithë individët që kanë përfituar fonde dhe/ose mbështetje nga Ministria e Kulturës janë në shkelje të përcaktimeve ligjore.</p>
Kriteri:	<ul style="list-style-type: none"> - Ligji nr. 10352, datë 18.11.2010 “Për Artin dhe Kulturën”, i ndryshuar, neni 26; - Ligji nr. 8480, date 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, neni 16; - Rregullore e Organizimit dhe Funksionimit të Brendshëm të Ministrisë së Kulturës,

	<p>neni 48, pika 2; - Udhëzuesi i Ministrisë së Kulturës, i miratuar me Urdhërin nr. 10, datë 14.01.2020 të Ministrit të Kulturës, shkronja (h); - Kontratat e nënshkruara ndërmjet institucionit dhe subjekteve përfituese, neni 5 “Të drejtat dhe detyrimet e përfituesit”; - Udhëzime të Ministrisë së Kulturës.</p>
Ndikimi/Efekti:	Mos veprimet dhe neglizhenca e konstatuara kanë sjelle si pasojë efekt negativ të shkaktuar nga menaxhimi jo me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet në kryerjen e shpenzimeve buxhetore.
Shkaku:	Mosrespektimi i përcaktimeve ligjore në fuqi; Menaxhimi jo efektiv i buxhetit institucional. Efekt negativ.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Ministri i Kulturës të marrë masa për nxjerrjen e urdhrit për mënyrën e funksionimit të Kolegjiumeve, si kërkesë e Ligjit 10352 për Artin dhe Kulturën, neni 27, pika 2.

III. PROJEKTE KULTURORE, TË BRENDSHME NË MBËSHTETJE TË PRIORITETEVE TË MINISTRISË SE KULTURËS.

1. **“Gjirokastra – Oyteti i Gurte”- Album fotografik 2020 (vlera 1.500.000 lekë)**

- Memo nr. 68/1 prot., datë 11.02.2020 për mbështetje financiare për projektin i DKFPK.
- Kartelë shoqëruese e kërkesës së ardhur nga z. N.K , protokolluar me nr. 68 prot., datë 09.01.2020. Kërkesë për mbështetje financiare, prezantim i projektit, objektiva, preventiv.
- Memo nr. 68/2 prot., datë 23.06.2020 e DKFPK mbi përbërjen e Kolegjiumit për shqyrtimin e kërkesës.
- Urdhër Ministri nr. 212, datë 23.06.2020 për ngritjen e kolegjiumit për realizimin e mbështetjes financiare të projektit, me përbërje: z. Gj.N, Kryetar; znj. A.M, anëtar dhe z. A.A, anëtar.
- Procesverbal i Kolegjiumit, i datës 24.06.2020, protokolluar me nr. 68/4 prot., datë 24.06.2020 bashkëngjitur aneks 1: të dhënat e subjektit, aneks 2: preventivi, të dhënat bankare.

Referuar përmbajtjes së procesverbalit evidentohet se Kolegjiumi ka vlerësuar projektin duke bërë një përshkrim, i cili është identik me përmbajtjen e kërkesës së ardhur nga kërkuesi, pa një qëndrim të qartë në lidhje me procesin e vlerësimit të bërë nga ana e Kolegjiumit. Gjithashtu, nuk ka një analizë financiare të kostos së projektit, por është marrë i mirëqenë preventivi i paraqitur nga kërkuesi.

- Vendimi i Kolegjiumit nr. 68/5, datë 24.06.2020 për miratimin e mbështetjes financiare, bashkëngjitur aneks 1: të dhënat e subjektit, aneks 2: preventivi, të dhënat bankare.
- Urdhër Ministri nr. 219, datë 29.06.2020 për miratimin e mbështetjes financiare, bashkëngjitur aneks 1: të dhënat e subjektit, aneks 2: preventivi, të dhënat bankare.
- Kontratë nr. 58/7, datë 29.06.2020 për mbështetje financiare, bashkëngjitur aneks 1: të dhënat e subjektit, aneks 2: preventivi, të dhënat bankare.
- Raport monitorimi nr. 4661, datë 02.01.2020.
- Drejtoria e financës me Urdhër Shpenzimin nr. 323, datë 01.07.2020 ka kryer pagesën për 60% të vlerës shoqëruar me fatura justifikuese, kalime bankare, kontrata dhe shlyerje të detyrimeve të tatimit në burim dhe me Urdhër shpenzimin nr. 589, datë 10.11.2020 ka kryer pagesën për 40% të vlerës, shoqëruar me fatura justifikuese, kalime bankare, kontrata dhe shlyerje të detyrimeve të tatimit në burim.

2. “Më shumë dije – për një brez të ri të ndritur e të kulturuar”-nobelistët/klasikët në shkolla 2020 (vlera 2.855.075,75 lekë).

- Memo nr. 3655 prot., datë 13.10.2020 e DKFPK për mbështetje financiare për projektin.
- Kartele shoqëruese e kërkesës së ardhur nga z. Sh.N, protokolluar me nr. 3655 prot., datë 02.09.2020. Kërkesë për mbështetje financiare, prezantim i projektit, tituj të kolanës, autorët, objektiva, preventiv.
- Memo nr. 3655/2 prot., datë 19.10.2020 e DKFPK për mbështetjen financiare të projektit, me specifikime të titujve, tirazhit, totalit të librave, çmim për njësi.
- Kërkesë e z. R.J , protokolluar me nr. 3655 prot., datë 02.09.2020 me specifikime titujsh për dizajnimin grafik dhe përshtatjen e kopertinave të kolanës për nxënës.
- Urdhër Ministri nr. 409, datë 22.10.2020 për ngritjen e kolegjiut për realizimin e mbështetjes financiare të projektit, me përbërje: A.M, Kryetar; A.A , anëtar dhe H.D, anëtare.
- Procesverbal i datës 23.10.2020 i Kolegjiut, bashkëngjitur: aneks 1: të dhënat e subjektit, aneks 2: preventivi, të dhënat bankare.

Referuar përmbajtjes së procesverbalit, evidentohet se Kolegjiut ka vlerësuar projektin duke bërë një përshkrim i cili është identik me përmbajtjen e kërkesës së ardhur nga kërkuesi, pa një qëndrim të qartë në lidhje me procesin e vlerësimit të bërë nga ana e Kolegjiut. Gjithashtu, nuk ka një analizë financiare të kostos së projektit, por është marrë i mirëqenë preventivi i paraqitur nga kërkuesi.

- Vendimi i Kolegjiut nr. 3655/5, datë 23.10.2020 për miratimin e mbështetjes financiare, bashkëngjitur aneks 1: të dhënat e subjektit, aneks 2: preventivi, të dhënat bankare.
- Urdhri i Ministrisë nr. 423, datë 27.10.2020 për miratimin e mbështetjes financiare, bashkëngjitur aneks 1: të dhënat e subjektit, aneks 2: preventivi, të dhënat bankare.
- Kontratë nr. 3655, datë 28.10.2020 për mbështetje financiare, bashkëngjitur aneks 1: të dhënat e subjektit, aneks 2: preventivi, të dhënat bankare.
- Marrëveshje bashkëpunimi e datës 02.11.2020 me dizajnerin për kopertinat, kushtet dhe kërkesat, e panoterizuar.
- Raport Monitorimi nr. 5521, datë 21.12.2020 i DKFPK.
- Drejtoria e Financës me Urdhër Shpenzimit nr. 600, datë 16.11.2020 ka kryer pagesën për 60% të vlerës shoqëruar me fatura justifikuese, kalime bankare, kontrata dhe shlyerje të detyrimeve të tatimit në burim dhe me Urdhër shpenzimit nr. 761, datë 24.12.2020 ka kryer pagesën për 40% të vlerës shoqëruar me fatura justifikuese, kalime bankare, kontrata dhe shlyerje të detyrimeve të tatimit në burim.

3. Projekti: “Artizanati-një mënyrë jetese” 2020 (vlera 2.468.799,52 lekë).

- Memo nr. 3394/1 prot., datë 17.08.2020 për mbështetje financiare për projektin.
- Kartelë shoqëruese e kërkesës së ardhur nga z. D.C, protokolluar me nr. 3394, datë 10.08.2020.
- Kërkesë për mbështetje financiare, prezantim i projektit, objektiva, preventiv.
- Urdhër Ministrisë nr. 276, datë 18.08.2020 për ngritjen e kolegjiut për realizimin e mbështetjes financiare të projektit, me përbërje: z. Gj.N, Kryetar; z. D.A, anëtar dhe z. A.A, anëtar.
- Procesverbal i Kolegjiut, i datës 24.08.2020, protokolluar me nr. 3394/3, datë 24.08.2020, bashkëngjitur aneks 1: të dhënat e subjektit, aneks 2: preventivi, të dhënat bankare.

- Vendimi i Kolegjiumit nr. 3394/4, datë 24.08.2020 për miratimin e mbështetjes financiare, bashkëngjitur aneks 1: të dhënat e subjektit, aneks 2: preventivi, të dhënat bankare.

Referuar përmbajtjes së procesverbalit evidentohet se Kolegjiumi ka vlerësuar projektin duke bërë një përshkrim, i cili është identik me përmbajtjen e kërkesës së ardhur nga kërkuesi, pa një qëndrim të qartë në lidhje me procesin e vlerësimit të bërë nga ana e Kolegjiumit. Gjithashtu, nuk ka një analizë financiare të kostos së projektit, por është marrë i mirëqenë preventivi i paraqitur nga kërkuesi.

- Urdhër Ministri nr. 284, datë 27.08.2020 për miratimin e mbështetjes financiare, bashkëngjitur aneks 1: të dhënat e subjektit, aneks 2: preventivi, të dhënat bankare.
- Kontratë nr. 3394/6, datë 28.08.2020 për mbështetje financiare, bashkëngjitur aneks 1: të dhënat e subjektit, aneks 2: preventivi, të dhënat bankare.
- Procesverbal i datës 14.12.2020 i DKFKP për kalimin 100% të shumës subjektit dhe shlyerje të faturave në total.
- Raport Monitorimi nr. 5564 prot., datë 23.12.2020 i DKFKP.

4. Projekti: “Ekspozita e etnografise- nga tradita ne moderne” 2020 (vlera 1.550.000 lekë)

- Memo nr. 4967/1 prot., datë 10.12.2020 për mbështetje financiare për projektin
- Kartelë shoqëruese e kërkesës së ardhur nga znj. A.K, protokolluar me shkresën nr. 4967, datë 20.11.2020.
- Kërkesë për mbështetje financiare, prezantim i projektit, objektiva, preventiv.
- Urdhër nr. 526, datë 11.12.2020 i Ministrisë të Kulturës për ngritjen e kolegjiumit për realizimin e mbështetjes financiare të projektit me përbërje: z. Gj.N, Kryetar; z. A.A , anëtar dhe znj. A.M , anëtare.
- Procesverbal i datës 14.12.2020 i Kolegjiumit, bashkëngjitur aneks 1: të dhënat e subjektit, aneks 2: preventivi, të dhënat bankare.
- Vendim Kolegjiumi nr. 4967, datë 14.12.2020 për miratimin e mbështetjes financiare, bashkëngjitur aneks 1: të dhënat e subjektit, aneks 2: preventivi, të dhënat bankare.

Referuar përmbajtjes së procesverbalit evidentohet se Kolegjiumi ka vlerësuar projektin duke bërë një përshkrim, i cili është identik me përmbajtjen e kërkesës së ardhur nga kërkuesi, pa një qëndrim të qartë në lidhje me procesin e vlerësimit të bërë nga ana e Kolegjiumit. Gjithashtu, nuk ka një analizë financiare të kostos së projektit, por është marrë i mirëqenë preventivi i paraqitur nga kërkuesi.

- Urdhër nr. 537, datë 15.12.2020 i Ministrisë të Kulturës për miratimin e mbështetjes financiare, bashkëngjitur aneks 1: të dhënat e subjektit, aneks 2: preventivi, të dhënat bankare.
- Kontratë nr. 4967/6, datë 15.12.2020 për mbështetje financiare, bashkëngjitur aneks 1: të dhënat e subjektit, aneks 2: preventivi, të dhënat bankare.
- Procesverbal i datës 18.12.2020 për kalimin 100% të shumës subjektit dhe shlyerje të faturave në total.
- Raport monitorimi nr. 5467 prot., datë 16.12.2020 i Drejtorisë së Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve në Kulturë.
- Drejtoria e Financës me Urdhër Shpenzimit nr. 748, datë 23.12.2020 ka kryer pagesat në 100% të vlerës shoqëruar me fatura justifikuese, kalime bankare, kontrata dhe shlyerje të detyrimeve të tatimit në burim.

Nga dokumentacioni i shqyrtuar, rezulton se fatura tatimore bashkëlidhur urdhër shpenzimit është e datës 11.12.2020, ndërkohë që kontrata është lidhur në datën 15.12.2020. Ky fakt i evidentuar

përveç se është në shkelje të kontratës së lidhur midis palëve, paragjykon edhe procesin e mbështetjes financiare të projektit.

Për sa më lart, bazuar në evidencën dokumentare të vendosur në dispozicion grupit të auditimit të KLSH, u arritë në gjetjet e auditimit si më poshtë vijon:

Titulli i Gjetjes:	Mangësi në procedurat e ndjekura për projektet kulturore të brendshme në mbështetje të prioriteteve të ministrisë së kulturës: ÷Gjirokastra ó Qyteti i Gurtëo- Album fotografik 2020; ÷Më shumë dije ó për një brez të ri të ndritur e të kulturuar÷nobelistët/klasikët në shkolla 2020; ÷Artizanati-një mënyrë jeteseo 2020 dhe Projekti: ÷Ekspozita e etnografise- nga tradita ne moderneo 2020.
Situata:	<p>Referuar përmbajtjes së procesverbalit evidentohet se Kolegjiumi ka vlerësuar projektin duke bërë një përshkrim, i cili është identik me përmbajtjen e kërkesës së ardhur nga kërkuesi, pa një qëndrim të qartë në lidhje me procesin e vlerësimit të bërë nga ana e Kolegjiumit. Gjithashtu, nuk ka një analizë financiare të kostos së projektit, por është marrë i mirëqenë preventivi i paraqitur nga kërkuesi.</p> <p>Referuar përmbajtjes së procesverbalit, evidentohet se Kolegjiumi ka vlerësuar projektin duke bërë një përshkrim i cili është identik me përmbajtjen e kërkesës së ardhur nga kërkuesi, pa një qëndrim të qartë në lidhje me procesin e vlerësimit të bërë nga ana e Kolegjiumit. Gjithashtu, nuk ka një analizë financiare të kostos së projektit, por është marrë i mirëqenë preventivi i paraqitur nga kërkuesi.</p> <p>Referuar përmbajtjes së procesverbalit evidentohet se Kolegjiumi ka vlerësuar projektin duke bërë një përshkrim, i cili është identik me përmbajtjen e kërkesës së ardhur nga kërkuesi, pa një qëndrim të qartë në lidhje me procesin e vlerësimit të bërë nga ana e Kolegjiumit. Gjithashtu, nuk ka një analizë financiare të kostos së projektit, por është marrë i mirëqenë preventivi i paraqitur nga kërkuesi.</p> <p>Nga dokumentacioni i shqyrtuar, rezulton se fatura tatimore bashkëlidhur urdhër shpenzimit është e datës 11.12.2020, ndërkohë që kontrata është lidhur në datën 15.12.2020. Ky fakt i evidentuar përveç se është në shkelje të përcaktimeve të kontratës së lidhur midis palëve, paragjykon edhe procesin e mbështetjes financiare të projektit.</p>
Kriteri:	<ul style="list-style-type: none"> - Urdhër Ministri nr. 212, datë 23.06.2020 për ngritjen e kolegjiut për realizimin e mbështetjes financiare të projektit; - Urdhër Ministri nr. 219, datë 29.06.2020 për miratimin e mbështetjes financiare, bashkëngjitur aneks 1: të dhënat e subjektit, aneks 2: preventivi, të dhënat bankare. - Raport monitorimi nr. 4661, datë 02.01.2020; - Urdhër Ministri nr. 409, datë 22.10.2020 për ngritjen e kolegjiut për realizimin e mbështetjes financiare të projektit; - Urdhër Ministri nr. 423, datë 27.10.2020 për miratimin e mbështetjes financiare, bashkëngjitur aneks 1: të dhënat e subjektit, aneks 2: preventivi, të dhënat bankare; - Kontratë nr. 3655, datë 28.10.2020 për mbështetje financiare, bashkëngjitur aneks 1: të dhënat e subjektit, aneks 2: preventivi, të dhënat bankare; - Raport Monitorimi nr. 5521, datë 21.12.2020 i DKFKP; - Urdhër Ministri nr. 276, datë 18.08.2020 për ngritjen e kolegjiut për realizimin e mbështetjes financiare të projektit; - Urdhër Ministri nr. 284, datë 27.08.2020 për miratimin e mbështetjes financiare, bashkëngjitur aneks 1: të dhënat e subjektit, aneks 2: preventivi, të dhënat bankare. - Raport Monitorimi nr. 5564 prot., datë 23.12.2020 i DKFKP; - Urdhër nr. 526, datë 11.12.2020 i Ministrisë të Kulturës për ngritjen e

	<i>kolegjiumit për realizimin e mbështetjes financiare të projektit;</i> - Urdhër nr. 537, datë 15.12.2020 i Ministrit të Kulturës për miratimin e mbështetjes financiare, bashkëngjitur aneks 1: të dhënat e subjektit, aneks 2: preventivi, të dhënat bankare; - Kontratë nr. 4967/6, datë 15.12.2020 për mbështetje financiare, bashkëngjitur aneks 1: të dhënat e subjektit, aneks 2: preventivi, të dhënat bankare; - Raport monitorimi nr. 5467 prot., datë 16.12.2020 i Drejtorisë së Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve në Kulturë.
Ndikimi/Efekti:	Mos veprimet dhe neglizhenca e konstatuara kanë sjelle si pasojë efekt negativ të shkaktuar nga menaxhimi jo me ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet në kryerjen e shpenzimeve buxhetore.
Shkaku:	Mosrespektimi i përcaktimeve ligjore në fuqi; Menaxhimi jo efektiv i buxhetit institucional. Efekt negativ.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Ministri i Kulturës të marrë masa për nxjerrjen e urdhrit për mënyrën e funksionimit të Kolegjiumeve, si kërkesë e Ligjit 10352 òPër Artin dhe Kulturën, neni 27, pika 2.

2.7. MBI VLERËSIMIN E FUNKSIONIMIT TË SISTEMEVE TË MENAXHIMIT FINANCIAR

Në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, është kryer vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të Ministrisë së Kulturës.

Planifikimi buxhetor për funksionimin normal të tij hartohet nga institucioni, duke ndjekur ecurinë për miratimin përfundimtar për tu vënë në dispozicion fondet buxhetore. Monitorimi i veprimtarisë së këtij institucioni është si më poshtë vijon;

Për periudhën objekt auditimi 01.01.2020 deri në 31.12.2021 rezultoi se:

Ministria e Kulturës ushtron veprimtarinë e saj në drejtimet si vijon:

ó Harton, programon dhe zhvillon politikat kombëtare të kulturës, të trashëgimisë kulturore, materiale dhe shpirtërore, të rritjes së tolerancës fetare e të dialogut kulturor dhe integritetit kulturor në familjen, evropiane dhe botërore.

ó Harton dhe bashkërendon punën për politikën në fushën e artit e të kulturës nëpërmjet edukimit të popullsisë, rritjes së vlerave dhe trashëgimisë kulturore, nxitjes së investimeve, publike dhe private, në këta sektorë, monitorimit të mënyrës së përdorimit të fondeve publike në mbështetje të zhvillimit kulturor, edukimit në kulturë, mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, ruajtjes dhe vijimësisë së traditës së harmonisë fetare në kulturën shqiptare, si dhe të bashkëpunimit rajonal.

ó Harton politikën, mbrojtëse dhe promovuese, për trashëgiminë kulturore, materiale ose shpirtërore, si dhe krijon hapësirat e nevojshme, ligjore e mbështetëse, për ruajtjen e kultivimin e kulturës së shkruar, për krijimtarinë artistike në përgjithësi, si dhe për të promovuar arritjet e kulturës shqiptare e për të rritur konkurrencën e produktit shqiptar kulturor përtej kufijve.

ó Udhëheq, programon dhe mbështet veprimtarinë, kombëtare e ndërkombëtare, me qëllim identifikimin dhe zhvillimin e tendencave kulturore, artistike dhe letrare, brenda vendit, si dhe përfshirjen e ballafaqimin e vlerave më të mira kombëtare me ato rajonale, si ato të trashëguara dhe ato bashkëkohore dhe për krijimin e një hapësire dialogu mbarë shqiptar dhe të diversitetit kulturor, etj.

Me synim verifikimin e implementimit të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe akteve të tjera rregullatore është kërkuar nga MK: regjistri i riskut, pyetësorët e vetëvlerësimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, deklaratat e cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm, raportet vjetore mbi cilësinë dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm,

shkresat mbi ndarjen dhe delegimin e kompetencave, caktimit të Nëpunësit Autorizues dhe Nëpunësit Zbatues, koordinatorit të riskut, Ekipi i Menaxhimit të Programit, rishikimi i regjistrit të riskut, rivlerësimi dhe plani i veprimit me masa korrigjuese, dokumentimi i gjurmës së auditimit, harta e proceseve të punës etj.

Ministria e Kulturës ka caktuar znj. E.Ç (Sekretare e Përgjithshme) si Nëpunës Autorizues me anë të shkresës nr. 4017 prot., datë 20.06.2019 dhe znj. E.R (Drejtoreshë e Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar) si Nëpunës Zbatues me anë të shkresës nr. 6601/1 prot., datë 22.12.2021. Sa më sipër, në përmbushje të kërkesave të pikës të nenit 18/1, nenit 19, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 òPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, i ndryshuar, òNëpunësi autorizues i çdo njësie të qeverisjes së përgjithshme, në bazë të vetëvlerësimit depoziton te titullari i njësisë publike dhe nëpunësi i parë autorizues deklaratën dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm të njësisë publike që mbulon, për vitin e mëparshëm, jo më vonë se fundi i muajit shkurt aktual.

Ministria e Kulturës, në bazë të nenit 19 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me ligjin nr.110/2015, ka hartuar dhe dërguar pyetësorin vjetor të vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm për vitin 2020 dhe vitin 2021 me shkresat nr. 6/2, datë 23.02.2021, dhe nr. 6695/1 prot., datë 28.02.2022 drejtuar strukturës përgjegjëse për Harmonizimin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Me anë të shkresave të cituara, Ministria e Kulturës ka dërguar deklaratat për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe raportet për funksionimin e kontrollit të brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Struktura e raportimit respekton përcaktimet e Udhëzimit nr. 28, datë 15.12.2011 òMbi paraqitjen e Deklaratës dhe Raportit Vjetor për cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm në Njësitë Publike.

Referuar përgjigjeve të pyetësorit, më poshtë rendisim punën e bërë nga ky institucion, si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët e kontrollit të brendshëm në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij. Aktivitetet e planifikuara për tu ndërmarrë me qëllim zgjidhjen e mangësive të zbuluara gjatë përgatitjes së raporteve vjetore mbi funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit janë si më poshtë:

Nga auditimi u konstatua se MK ka ngritur Ekipin e Menaxhimit të Programit me shkresat nr. 1667, datë 03.04.2020 dhe nr. 1152, datë 05.03.2021 në zbatim të udhëzimit nr.7, datë 28.02.2018 të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë òPër procedurat standarde të përgatitjes së PBA-sëo paragrafi 2.5 pika 1/a në njësitë e qeverisjes qendrore që zbatojnë më shumë se një program buxhetor. Drejtuesi i programit si rregull është respektivisht nëpunësi autorizues i njësisë publike. Paragrafi 2.5 pika 2 citon se òDrejtuesit e programit janë përgjegjës për të garantuar që janë duke u realizuar siç duhet përgjegjësitë e ekipit të menaxhimit të programit, si një komponent kyç i organizimit institucional për përgatitjen e kërkesave buxhetore.

Në zbatim të udhëzimit nr. 7, datë 28.02.2018 paragrafi 2.5 pika 5 citohet se òDrejtuesi i programit (Drejtori Ekzekutiv) dërgon tek të gjithë anëtarët e Ekipit të Menaxhimit të Programit (a) Udhëzimin e Përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm, (b) përshkrimin e Misionit (c) propozimin e anëtarëve të Ekipit të Menaxhimit të Programit dhe (d) kalendarin për fazën e parë të hartimit të kërkesave buxhetore etj. ò Në referim të shkresave nr. 1667 prot., datë 03.04.2020, nr. 1667/1 prot., datë 21.07.2020 dhe nr. 1152, datë 05.03.2021 konstatohet se veprimet e Ministrisë së Kulturës janë në linjë me kërkesat e udhëzimit.

1. Mjedisi i kontrollit

Mjedisi i kontrollit është baza e menaxhimit të fondeve buxhetore dhe përbën themelin, ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm. Mjedisi i kontrollit përmban: Integritetin

personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike; politikat menaxheriale dhe stilin e punës; strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit; Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe aftësitë profesionale të punonjësve.

a. Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të kësaj njësie publike.

Në referencë të ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 òPër rregullat e etikës në administratën publikeò, si dhe ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 òPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò, nevojitet që punonjësit të respektojnë normat etike dhe profesionale të bashkëpunimit e të ndihmës së ndërsjellë, mbështetur në krijimin e një Kodi të Brendshëm Etik. Nga auditimi u konstatua se, institucioni ka hartuar dhe zbaton një kod etike, i cili është miratuar nga Ministri i Kulturës dhe ka hyrë në fuqi më datë 19.02.2020.

b. Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.

Ministria e Kulturës funksionon në bazë të strukturës së miratuar me Urdhër të Kryeministrit Nr. 164, datë 05.10.2017, òPër miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Kulturësò, i cili nuk ka pasur ndryshime gjatë periudhës së auditimit. Krahas tij janë edhe Urdhërat e Ministrit të Kulturës, të cilat përcaktojnë organikën e institucioneve në varësi. MK ushtron veprimtarinë e vet mbi bazën e Rregullores së Organizimit dhe Funksionimit të Brendshëm, miratuar nga Ministri i Kulturës, ku janë përcaktuar: struktura organizative e MK, funksionet dhe detyrat e funksioneve të larta të Drejtimit, funksionet e drejtorive dhe sektorëve, si dhe marrëdhëniet midis tyre, kanalet dhe mënyrat e komunikimit, etj.

c. Stili i të vepruarit dhe filozofia e menaxhimit. Në Përputhje me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 òPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò, neni 15 òRregulla të përgjithshme për delegimin e detyraveò, si dhe Kapitulli III òDelegimi i detyraveò, të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, kemi konstatuar se ka rregullore të brendshme të miratuar nga Ministri i Kulturës, ku janë evidentuar delegimi i detyrave dhe mënyra e dokumentimit të tyre.

d. Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore. Në Ministrinë e Kulturës, burimet njerëzore menaxhohen nga Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme, në varësi të të cilës është vendosur Sektori i Burimeve Njerëzore. Nga auditimi u konstatua se për periudhën 01.01.2020 - 31.12.2021 janë kryer dhe janë përfshirë në dosje vlerësimet e punonjësve për vitet 2020 dhe 2021.

e. Për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve gjatë viteve objekt auditimi, u konstatua se ky institucion ka paraqitur programe specifike për trajnimin e punonjësve të administratës për periudhën janar ó dhjetor 2020 dhe janar ó dhjetor 2021 referuar Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. II, pika 2.5.1 òMjedisi i kontrollit (ose mjedisi i brendshëm i njësisë)ò, paragrafët òPolitikat dhe praktikat që lidhen me burimet njerëzoreò dhe òProfesionalizmi i stafitò. Punonjësit e institucionit kanë kryer trajnime të ndryshme gjithëpërfshirëse, kryesisht të organizuara nga ASPA, si për sa i përket detyrave specifike të punonjësve, ashtu edhe në fushën e menaxhimit të financave, etikës dhe integritetit, etj.

2. Menaxhimi i riskut

Risku dhe menaxhimi i riskut përcaktohet në Nenin 21 të Ligjit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Risku zakonisht përcaktohet si pasiguria e rezultatit, qoftë kjo mundësi pozitive apo negative i veprimeve dhe ngjarjeve. Kjo është mundësia që një ngjarje e caktuar, e cila do të ketë ndikim në arritjen e objektivave të njësisë, mund të ndodhë. Risku matet me efektin e tij dhe shkallën e mundësisë së ndodhjes. Menaxhimi i riskut përfshin identifikimin, vlerësimin, kontrollin

dhe monitorimin e këtyre ngjarjeve të mundshme apo situatave që mund të kenë një efekt negativ në arritjen e objektivave të njëjësive dhe është projektuar për të dhënë siguri të arsyeshme se objektivat do të arrihen.

Nga auditimi u konstatua se, ky institucion ka miratuar regjistrin e riskut me shkresë nr. 1363/2 prot., datë 06.04.2020, pra ka bërë vlerësimin dhe kontrollin e risqeve. Gjithashtu në regjistrin e riskut janë përfshirë të gjitha aktivitetet e institucionit, si edhe proceset më me risk për të. Ministria e Kulturës nuk ka zhvilluar plane veprimi të veçanta për menaxhimin e riskut, por ka plotësuar planet e veprimit të parashikuara nga manuali për MFK.

Me shkresën nr. 1667 prot., datë 03.04.2020, ndryshuar me shkresën nr. 1667/1 prot., datë 21.07.2020 dhe shkresën nr. 1152, datë 05.03.2021 është ngritur Grupi për Menaxhimin Strategjik (GMS) në Ministrinë e Kulturës. Nuk konstatohet të ketë ndonjë urdhër të veçantë për ngritjen e grupit të menaxhimit të riskut apo përcaktimin e koordinatorëve të deleguar në çdo njësi.

Nga auditimi u konstatua se për periudhën 2020-2021, asnjë punonjës nuk ka marrë pjesë në trajnime mbi menaxhimin e riskut, element ky shumë i rëndësishëm në veprimtarinë e një institucioni bazuar në ligjin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin si dhe referuar kapitullit III të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit i cili citon se punonjësit duhet të kryejnë trajnime në fushën e përdorimit të metodikës së pranuar në identifikimin, analizën dhe menaxhimin e riskut. Mungesa e trajnimeve për menaxhimin e riskut dhe komponentët e MFK-së është edhe më e theksuar tek punonjësit e institucioneve në varësi të MK.

Titulli i gjetjes	Mungesë e trajnimeve të stafit mbi menaxhimin e riskut
Situata:	Nga auditimi i komponentëve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në zbatim të Ligjit nr. 10 296, datë 8.7.2010 për menaxhimin financiar dhe kontrollin, i ndryshuar, u konstatua se punonjësit e MK nuk kanë marrë pjesë në trajnime mbi menaxhimin e riskut, element ky shumë i rëndësishëm në veprimtarinë e një institucioni bazuar në ligjin për MFK, si dhe referuar kapitullit III të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit i cili citon se punonjësit duhet të kryejnë trajnime në fushën e përdorimit të metodikës së pranuar në identifikimin, analizën dhe menaxhimin e riskut.
Kriteri:	Ligj nr. 10 296, datë 8.7.2010 për menaxhimin financiar dhe kontrollin, i ndryshuar. Manuali i Menaxhimit financiar dhe kontrollit, miratuar me vendimin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III.
Ndikimi/Efekti:	Punonjësit janë të pa trajnuar në lidhje me menaxhimin e riskut, si komponent i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Ministria e Kulturës të marrë masa për planifikimin dhe trajnimin e punonjësve të saj, në lidhje me komponentët e MFK-së dhe veçanërisht për menaxhimin e riskut.

3. Aktivitetet e kontrollit

Nga auditimi është konstatuar se Ministria e Kulturës ka hartuar dhe miratuar gjurmët e auditimit sipas kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 për menaxhimin financiar dhe kontrollin nëneni 16 detyrimi për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit pika 2 ku përcaktohet: *“Titullarët e njëjësive publike miratojnë gjurmët e auditimit për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njëjësive dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njëjësive publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit. Gjurma e auditimit arkivohet sipas dispozitave ligjore në fuqi”,* si dhe Manualit të Menaxhimit financiar dhe kontrollit, miratuar me vendimin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016 anekset 2, 3 dhe 4. Dokumenti i gjurmëve të auditimit është miratuar me Urdhër të Ministrit të Kulturës nr. 346, datë 14.06.2021 (shkresë nr. 3079/1, datë 14.06.2021) dhe përfshin proceset dhe aktivitetet e drejtorive të aparatit të Ministrisë. Për sa i përket institucioneve në varësi nuk konstatohen të kenë gjurmë auditimi të miratuara.

Titulli i gjetjes	Mungesë e dokumentit të gjurmës së auditimit në institucionet e varësisë
Situata:	Nga auditimi është konstatuar se dokumenti i gjurmëve të auditimit është miratuar me Urdhër të Ministrit të Kulturës nr. 346, datë 14.06.2021 (shkresë nr. 3079/1, datë 14.06.2021) dhe përfshin proceset dhe aktivitetet e drejtorive të aparatit të Ministrisë. Për sa

	i përket institucioneve në varësi nuk konstatohen të kenë gjurmë auditimi të miratuara, sipas kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 me ndryshime òPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò neni 16 òDetyrimi për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimitò pika 2 ku përcaktohet: <i>“Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit. Gjurma e auditimit arkivohet sipas dispozitave ligjore në fuqi.</i>
Kriteri:	Ligj nr. 10 296, datë 8.7.2010 òPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar, neni 16/2. Manuali i Menaxhimit financiar dhe kontrollit, miratuar me vendimin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, anekset 2, 3 dhe 4.
Ndikimi/Efekti:	Asnjë nga institucionet e varësisë nuk ka miratuar një nga komponentët e kërkuar nga ligji për MFK.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Ministria e Kulturës të marrë masa për të nxitur institucionet në varësi të saj të hartojnë dhe miratojnë dokumentin përkatës të gjurmës së auditimit.

4. Informimi dhe komunikimi

Nga auditimi u konstatua se, përgjithësisht komunikimi me titullarin dhe nëpunësit e tjerë është bërë në formën dhe kohën e duhur, për ti ndihmuar ata në përmbushjen e detyrave dhe të përgjegjësisve. Titullari është informuar nga drejtuesit me anë të mbledhjeve, nëpërmjet relacioneve dhe raporteve rreth këtyre mbledhjeve. Drejtuesit e programeve kanë raportuar tek nëpunësi autorizues për ecurinë e veprimtarisë, planeve të punës dhe objektive të vendosur për realizimin e politikave, duke hartuar raporte monitorimi periodike në varësi të punës. Punonjësit brenda institucionit komunikojnë me postë elektronike dhe në mënyrë verbale, ndërsa jashtë institucionit komunikohet kryesisht në formë shkresore zyrtare dhe ka korrespondencë të rregullt me subjektet e tjera, pa përjashtuar komunikimin elektronik dhe atë telefonik. Ministria e Kulturës ka faqen e saj zyrtare në internet dhe nëpërmjet kësaj të fundit të gjithë të interesuarit mund të informohen rreth veprimtarisë së institucionit.

5. Monitorimi

Nga auditimi konstatohet se në vijim të përcaktimit në pikën 23/1 të nenit 4 të ligjit nr. 10 296, datë 08.07.2010 i ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 òPër menaxhimin financiar dhe kontrollin: òNëpunës autorizues i nivelit të dytë”, dhe /ose të niveleve të tjera, janë nëpunës të administratës publike në secilën nga njësitë e vartëse, me buxhet më vete të njësisë së qeverisjes së përgjithshme, përgjegjës për përgatitjen, zbatimin, kontrollin e brendshëm financiar, monitorimin, raportimin, kontabilitetin dhe auditimin e brendshëm të buxhetit të tyre, që përgjigjet përpara nëpunësit autorizues...ò, për periudhën objekt auditimi janë hartuar raportet e monitorimit 4-8-12 mujore të buxhetit të MK të cilat dërgohen në Ministrinë e Financave.

Monitorimet dhe raportimet për ekzekutimin e buxhetit konsistojnë në rakordimet mujore dhe vjetore me degën e thesarit, si dhe në raportimet që Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar bën për raportin vjetor të MK-së mbi performancën e produkteve të buxhetit për institucionin.

Raportet e monitorimit 4-8-12 mujore si dhe relacionet shpjeguese asistojnë në monitorimin e performancës financiare të objektivave të politikës së programit të synuara dhe produkteve të parashikuara në buxhetin vjetor, si dhe marrjen e masave korrigjuese që duhet të ndërmerren për përmirësimin e situatës, sipas pikës 42 kapitulli III të 41.2 kapitulli III, të Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016, òPër procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendroreò.

b. Mbi Vlerësimin e auditimit të brendshëm.

Auditimi synon të analizojë planifikimin dhe miratimin e programeve vjetore dhe strategjike të auditimeve, realizimin e programit vjetor të auditimit nga ana sasiore dhe analiza sipas llojeve dhe zbulimeve, kapacitetet audituese të sektorit, si dhe përputhshmërinë me Ligjin nr. 114/2015, dt. 22.10.2015 òPër auditimin e brendshëm në sektorin publikò.

- Struktura e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Kulturës është e organizuar në rang Sektori

dhe përmban në organikën e saj 3 auditues (1 përgjegjës sektori dhe 2 specialistë), sipas Urdhrit të Kryeministrit Nr. 164, datë 05.10.2017, òPër miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Kulturës.

- ❖ Gjatë vitit 2020, struktura e miratuar ka pasur 3 auditues (1 përgjegjës sektori dhe 2 specialistë). Për periudhën janar ó 16 nëntor 2020, sektori ka funksionuar vetëm me 1 punonjës (përgjegjës sektori) dhe për periudhën 17 nëntor 2020 ó 31 dhjetor 2020, sektori ka funksionuar sipas përbërjes së miratuar me 3 punonjës (1 përgjegjës sektori dhe 2 specialistë). Përgjegjësi i sektorit dhe një nga specialistët kanë qenë të pajisur me òCertifikatën e Audituesit të Brendshëm në Sektorin Publikò.
- ❖ Gjatë vitit 2021, struktura e miratuar ka pasur 3 auditues (1 përgjegjës sektori dhe 2 specialistë). Për periudhën 16 nëntor 2020 ó 25 janar 2021, sektori ka funksionuar sipas përbërjes së miratuar me 3 punonjës (1 përgjegjës sektori dhe 2 specialistë), ndërsa nga 25 janar 2021 e në vazhdim, sektori ka funksionuar vetëm me 2 punonjës (1 përgjegjës sektori dhe 1 specialist), duke qenë se njëri nga specialistët është dorëhequr.
- ❖ Në fillim të vitit 2022, struktura e miratuar vazhdon të ketë 3 auditues (1 përgjegjës sektori dhe 2 specialistë). Megjithatë, Sektori i AB funksionon me 2 punonjës, duke qenë se 1 pozicioni specialisti është vakant. Nga auditimi i dosjeve të personelit të Sektorit të Auditit të Brendshëm, rezultoi se të 2 nëpunësit e këtij sektori (përkatesisht përgjegjësi i sektorit dhe një specialist) zotërojnë òCertifikatën e Audituesit të Brendshëm në Sektorin Publikò.

Objektivat kryesore: Në funksion të përmbushjes së misionit të Sektorit të Auditimit të Brendshëm, objektivat kryesore audituese të njësisë janë:

- *Përfshirja në planin e auditimit të të gjitha subjekteve, duke u fokusuar në identifikimin e fushave, të cilat kanë ndikim në arritjen e objektivave të përcaktuara nga Ministria;*
- *Programimi dhe kryerja e auditimeve në bazë të planit të miratuar, duke u munduar të ruhet frekuenca e auditimit, vlerësimi i riskut dhe niveli i materialitetit, në raport edhe me mjaftueshmërinë e burimeve të auditimit;*
- *Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm lidhur me përshtatshmërinë dhe efektivitetin e këtij kontrolli, sipas sistemeve / fushave të identifikuar për auditim;*
- *Dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm, si dhe ndjekja me prioritet e zbatimit të tyre.*

Raportimi me Drejtorinë e Harmonizimit për Auditimit e Brendshëm (DHAB) në Ministrinë e Financave

Nga auditimi u evidentua se në muajin tetor të vitit paraardhës janë hartuar planet strategjike dhe vjetore të auditimit të brendshëm që do realizohen për vitin pasardhës, duke marrë miratimin nga Ministri i Kulturës, për vitet 2020, 2021 dhe 2022, si dhe duke i përcjellë në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Në përputhje me Ligjin nr. 114, datë 22.10.2015 òPër auditimin e brendshëm në sektorin publikò, neni 12, pika d, është dërguar në DHAB:

- òPlani strategjik dhe vjetor i veprimtarisë së Sektorit të Auditimit të Brendshëm për vitet 2020-2022ò me shkresën nr. 6195/5 prot., datë 21.10.2019; ndryshuar me shkresën nr. 2912/1 prot., datë 07.07.2020.
- òPlani strategjik dhe vjetor i veprimtarisë së Sektorit të Auditimit të Brendshëm për vitet 2021-2023ò me shkresën nr. 4176/3 prot., datë 19.10.2020; ndryshuar me shkresën nr. 4712/2 prot., datë 20.09.2021.
- òPlani strategjik dhe vjetor i veprimtarisë së Sektorit të Auditimit të Brendshëm për vitet 2022-2024ò me shkresën nr. 5276/3 prot., datë 18.10.2021.

Në zbatim të ligjit nr. 114, datë 22.10.2015 òPër auditimin e brendshëm në sektorin publikò, neni 14, pika ç, Ministria e Kulturës ka dërguar pranë Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të

Brendshëm:

- òRaporti vjetor i veprimtarisë së Sektorit të Auditimit të Brendshëm për vitin 2020 me shkresën nr. 222/3, datë 01.02.2021.
- òRaporti vjetor i veprimtarisë së Sektorit të Auditimit të Brendshëm për vitin 2021 me shkresën nr. 151/3, datë 04.02.2022.

Raportimet janë dërguar brenda afateve kërkuara dhe janë sipas kërkesave dhe metodologjisë së kërkuar nga DHAB dhe Manuali i Auditimit të Brendshëm.

Në zbatim të ligjit 114/2015 të òAuditimit të Brendshëm për Sektorin Publikò dhe Manualit të Auditimit të Brendshëm, çdo njësi duhet të ketë kartën e saj të auditimit të brendshëm. Karta e Auditimit është një akt administrativ që miratohet me urdhër të titullarit të njësisë publike, e cila përcakton statusin organizativ të njësisë, qëllimin, misionin, objektivat e punës, përgjegjshmërinë dhe përgjegjësinë e njësisë së auditimit të brendshëm. Sektori i auditimit të brendshëm ka hartuar kartën e auditimit, miratuar me Urdhrin nr. 13, datë 15.01.2020 të Ministrit të Kulturës, znj. E.M. Ky dokument, i cili ka shfuqizuar kartën e mëparshme miratuar më datë 15.01.2016, është hartuar në përputhje me kërkesat dhe formatin standard të Manualit të Auditimit të Brendshëm.

Viti 2020

Në Planin Vjetor të Auditimit të miratuar për vitin 2020, shkresa nr. 6195/5 prot., datë 21.10.2019, **ishin parashikuar gjithsej 16 misione auditimi, nga të cilat 1 auditim përputhshmërie do të kryhej në Sektorin e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit Kulturor (Drejtoria e Integritimit Koordinimit Marrëveshjes dhe Asistencës në MK) dhe 15 auditime të kombinuara do të kryheshin në institucionet e varësisë.** Strukturat e audituara sipas planifikimit të vitit 2020 ishin si më poshtë:

1. *Sektori i Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit Kulturor (Aparat)*
2. *DRKK Korçë*
3. *DRKK Shkodër*
4. *DRKK Durrës*
5. *Qendra Kombëtare e Inventarizimit të P. Kulturore*
6. *Qendra Kombëtare e Kulturës, Fem*
7. *Qendra Kombëtare e Veprimtarive Folklorike*
8. *Muzeu i Pavarësisë Vlorë*
9. *Agjencia e Shërbimit Arkeologjik*
10. *Biblioteka Kombëtare*
11. *Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe A. Popullor*
12. *Teatri Kombëtar*
13. *Cirku Kombëtar*
14. *Galeria Kombëtare e Arteve*
15. *Muzeu Etnografik Gjergj Kastrioti, Krujë*
16. *Alba-film Studio*

Pas kërkesës së Sektorit të Auditimit të Brendshëm për shkak të pandemisë dhe mungesës së burimeve njerëzore, është miratuar ndryshimi i planit vjetor 2020 me shkresën nr. 2912 prot., datë 07.07.2020 të Ministrit të Kulturës. **Ky ndryshim planifikoi zhvillimin e 4 misioneve të auditimit për vitin 2020, nga 16 të tilla që përmbante plani fillestar.** Strukturat e audituara sipas planifikimit të ndryshuar të vitit 2020 ishin si më poshtë:

1. *DRTK Shkodër*
2. *Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore*
3. *Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë*
4. *Galeria Kombëtare e Arteve*

Për periudhën janar ó 16 nëntor 2020, sektori ka funksionuar vetëm me 1 punonjës (përgjegjës

sektori), ndërsa për periudhën 17 nëntor 2020 ó 31 dhjetor 2020, sektori ka funksionuar sipas përbërjes së miratuar me 3 punonjës (1 përgjegjës sektori dhe 2 specialistë).

Gjatë vitit 2020, Sektori i auditimit të brendshëm ka realizuar Planin e rishikuar Vjetor të auditimit duke realizuar 4 misione auditimi. Gjatë vitit 2020 janë kryer 2 misione auditimi më pak, krahasuar me vitin 2019. Sektori i auditimit të brendshëm planifikonte që në vitin 2021 të kryente auditimin e strukturave që nuk u audituan gjatë 2020.

Veprimtaria e punës audituese është bërë mbi bazën e vlerësimit të riskut, ndërsa numri i auditimeve të kryera ka qenë i reduktuar për shkak të pandemisë dhe burimeve njerëzore. Për përmirësimin e sistemeve janë dhënë rekomandime të cilat konsistojnë në korrigjimin e gabimeve/pasaktësive, krijimin e gjurmëve të auditimit për çdo proces apo transaksion në zbatim të akteve ligjore.

Bazuar në gjetjet e rezultuara sipas auditimeve me bazë sistemi, për përmirësimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe të kontrollit të brendshëm, përmirësimeve organizative dhe për arkëtim për vitin 2020, janë dhënë 38 rekomandime. Për vitin 2020 janë raportuar edhe 33 rekomandime për auditimet e paevaduara të vitit 2019.

Rekomandime të dhëna sipas kategorive për vitin 2020:

Nr.	Kategoria	Statusi i rekomandimeve				
		Të dhëna	Të pranuar	Të zbatuara	Në proces zbatimi	Të pazbatuara
1.	Rekomandime për përmirësimin e sistemeve të KB	14	14	-	-	-
2.	Të karakterit organizativ	19	19	-	-	-
3.	Rekomandime për arkëtime	1	1	-	-	-
4.	Të tjera	4	4	-	-	-
TOTALI		38	38	25	7	1

Nga auditimi i grupit të KLSH për vitin 2020 janë audituar 2 praktika (Galeria Kombëtare e Arteve dhe Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Shkodër), nga ku ka rezultuar se dosjet nga ana e dokumentimit administrativ janë përgjithësisht korrekte, pra nuk ka patur mangësi në plotësimin e kërkesave që janë parashikuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm (2016), ndryshuar me Urdhrin nr. 4, datë 10.01.2020 të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë. Në praktikën e audituar vërehet se afatet e misioneve të auditimit janë zbatuar.

Në dosjen e inventarizuar të auditimit të ushtruar në Drejtorinë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Shkodër, për periudhën e auditimit 01.07.2016-31.05.2020, konstatohet mungesa e dokumentit standard -Buxheti dhe afati kohor për angazhimin e auditimit (Formulari Standard nr. 6 i Manualit). Gjithashtu, fleta e inventarit të dosjes nuk ka qenë në përputhje me Formularin Standard nr. 1 të Manualit të Auditimit të Brendshëm.

Në dosjen e inventarizuar të auditimit të ushtruar në Galerinë Kombëtare të Arteve, për periudhën e auditimit 01.01.2018-31.12.2019, konstatohet mungesa e dokumentit standard -Buxheti dhe afati kohor për angazhimin e auditimit (Formulari Standard nr. 6 i Manualit). Gjithashtu, fleta e inventarit të dosjes nuk ka qenë në përputhje me Formularin Standard nr. 1 të Manualit të Auditimit të Brendshëm.

Siç u theksua edhe më lart, për periudhën janar ó 16 nëntor 2020, sektori ka funksionuar vetëm me 1 punonjës. Kjo ka bërë që thujtje e gjithë veprimtaria audituese e sektorit të ushtrohet nga përgjegjësja e sektorit, me anëtarë që vinin nga struktura të tjera brenda Ministrisë së Kulturës. Një organizim i tillë vështirëson respektimin e funksioneve të monitorimit të vazhdueshëm në njësinë e auditimit të brendshëm (Kapitulli VII i Manualit të Auditimit të Brendshëm) *óDrejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm është përgjegjës për cilësinë e përgjithshme të punës të njësisë së auditimit*

të brendshëm dhe në këtë rol rishikon punën e përgjegjës të grupit në mënyrë që të sigurojë se ai/ajo ka zbatuar veprimtaritë përkatëse të monitorimit të vazhdueshëm, duke mbikëqyrur përputhjen me politikën e auditimit të brendshëm. Në kushtet e mungesave në staf, funksionet e hallkave të ndryshme të monitorimit të vazhdueshëm ushtrohen nga i njëjti punonjës. Në rastin konkret, drejtuesi i njësisë së AB ka ushtruar dhe rolin e përgjegjës të grupit në misionet audituese. Për më tepër, angazhimi i punonjësve të tjerë të institucionit si auditues nuk është në linjë me kërkesat e neneve 11 dhe 17/a të ligjit nr. 114/2015 për auditimin e brendshëm në sektorin publik. Ky i fundit parashikon se *Audituesve të brendshëm u ndalohej të përfshihen në kryerjen e funksioneve dhe veprimtarive të tjera të njësisë publike, përveç veprimtarisë audituese.*

Viti 2021

Në Planin Vjetor të Auditimit të miratuar për vitin 2021, shkresa nr. 4176/3 prot., datë 19.10.2020, **ishin parashikuar gjithsej 8 misione auditimi të kombinuara (financiar + përputhshmëri), të cilat do të kryheshin në institucionet e varësisë.** Strukturat e audituara sipas planifikimit të vitit 2021 ishin si më poshtë:

1. *Zyra e Administrimit dhe Koordinimit të Parkut*
2. *Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor*
3. *Teatri Kombëtar*
4. *Teatri Kombëtar Eksperimental "Kujtim Spahivogli"*
5. *Cirku Kombëtar*
6. *Albafilm sha*
7. *Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit*
8. *Biblioteka Kombëtare*

Pas kërkesës së Sektorit të Auditimit të Brendshëm për shkak të efekteve të pandemisë dhe mungesës së burimeve njerëzore, është miratuar ndryshimi i planit vjetor 2021 me shkresën nr. 4712/1 prot., datë 20.09.2021 të Ministrit të Kulturës. **Ky ndryshim planifikoi zhvillimin e 6 misioneve të auditimit për vitin 2021, nga 8 të tilla që përmbante plani fillestar.** Strukturat e audituara sipas planifikimit të ndryshuar të vitit 2021 ishin si më poshtë:

1. *Zyra e Administrimit dhe Koordinimit të Parkut Arkeologjik Bylis*
2. *Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor*
3. *Teatri Kombëtar*
4. *Teatri Kombëtar Eksperimental "Kujtim Spahivogli"*
5. *Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit*
6. *Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna gjatë vitit 2020*

Për periudhën 16 nëntor 2020 ó 25 janar 2021, sektori ka funksionuar sipas përbërjes së miratuar me 3 punonjës (1 përgjegjës sektori dhe 2 specialistë), ndërsa nga 25 janar 2021 e në vazhdim, sektori ka funksionuar vetëm me 2 punonjës (1 përgjegjës sektori dhe 1 specialist), duke qenë se njëri nga specialistët është dorëhequr.

Gjatë vitit 2021, Sektori i auditimit të brendshëm ka realizuar Planin e rishikuar Vjetor të auditimit duke realizuar **6 misione auditimi.** Gjatë vitit 2021 janë kryer 2 misione auditimi më shumë, krahasuar me vitin 2020. Misionet e auditimit në Teatrin Kombëtar dhe Teatrin Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor nuk janë evaduar ende.

Veprimtaria e punës audituese është bërë mbi bazën e analizës së riskut, ndërsa numri i auditimeve të kryera ka qenë i reduktuar për shkak të pandemisë dhe burimeve njerëzore. Për përmirësimin e sistemeve janë dhënë rekomandime të cilat konsistojnë në korrigjimin e gabimeve/pasaktësive, krijimin e gjurmëve të auditimit për çdo proces apo transaksion në zbatim të akteve ligjore.

Bazuar në gjetjet e rezultuara sipas auditimeve me bazë sistemi, për përmirësimin e sistemeve të

menaxhimit financiar dhe të kontrollit të brendshëm, përmirësimeve organizative dhe për arkëtim për vitin 2021, janë dhënë **82** rekomandime. Për vitin 2021 janë raportuar edhe 35 rekomandime për auditimet e paevaluara të vitit 2020.

Rekomandime të dhëna sipas kategorive për vitin 2021:

Nr.	Kategoria	Statusi i rekomandimeve				
		Të dhëna	Të pranuar	Të zbatuara	Në proces zbatimi	Të pazbatuara
1.	Rekomandime për përmirësimin e sistemeve të KB	6	6	-	-	-
2.	Të karakterit organizativ	63	63	-	-	-
3.	Rekomandime për arkëtime	4	4	-	-	-
4.	Të tjera	9	9	-	-	-
TOTALI		82	82	10	70	2

- Nga auditimi i grupit të KLSH për vitin 2021 janë audituar 2 praktika (Zyra e Administrimit dhe Koordinimit të Parkut Arkeologjik Bylis dhe Teatri Kombëtar Eksperimental òKujtim Spahivogliò), nga ku ka rezultuar se dosjet nga ana e dokumentimit administrativ janë përgjithësisht korrekte, pra nuk ka patur mangësi në plotësimin e kërkesave që janë parashikuar në Manualin e Auditimit të brendshëm të miratuar nga Ministri i financave dhe Udhëzimi nr. 12, datë 05.06. 2012 òMbi procedurat e kryerjes së veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publikò. Në praktikat e audituara vërehet se afatet e misioneve të auditimit janë zbatuar.

-Në dosjen e inventarizuar të auditimit të ushtruar në Zyrën e Administrimit dhe Koordinimit të Parkut Arkeologjik Bylis, për periudhën e auditimit 01.10.2017-31.12.2020, konstatohet mungesa e dokumentit standard ÒBuxheti dhe afati kohor për angazhimin e auditimitò (Formulari Standard nr. 6 i Manualit).

-Në dosjen e inventarizuar të auditimit të ushtruar në Drejtorinë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Shkodër, për periudhën nga auditimi i fundit deri më 31.05.2021, konstatohet mungesa e dokumentit standard ÒBuxheti dhe afati kohor për angazhimin e auditimitò (Formulari Standard nr. 6 i Manualit).

Problematika e pozicioneve vakante në stafin e njësisë së auditimit të brendshëm është prezente edhe gjatë vitit 2021. Një organizim i tillë vështirëson respektimin e funksioneve të monitorimit të vazhdueshëm në njësinë e auditimit të brendshëm (Kapitulli VII i Manualit të Auditimit të Brendshëm) òDrejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm është përgjegjës për cilësinë e përgjithshme të punës të njësisë së auditimit të brendshëm dhe në këtë rol rishikon punën e përgjegjës të grupit në mënyrë që të sigurojë se ai/ajo ka zbatuar veprimtaritë përkatëse të monitorimit të vazhdueshëm, duke mbikëqyrur përputhjen me politikat e auditimit të brendshëm.ò Në kushtet e mungesës së stafit, funksionet e hallkave të ndryshme të monitorimit të vazhdueshëm ushtrohen nga i njëjti punonjës. Në rastin konkret, drejtuesi i njësisë së AB ka ushtruar dhe rolin e përgjegjës të grupit në misionet audituese. Për më tepër, angazhimi i punonjësve të tjerë të institucionit si auditues nuk është në linjë me kërkesat e neneve 11 dhe 17/a të ligjit nr. 114/2015 òPër auditimin e brendshëm në sektorin publikò. Ky i fundit parashikon se òAudituesve të brendshëm u ndalohet të përfshihen në kryerjen e funksioneve dhe veprimtarive të tjera të njësisë publike, përveç veprimtarisë audituese.ò Vakancat në strukturë rrezikojnë të çënojnë funksionimin me efektivitet të proceseve dhe procedurave. Këto vakanca, së bashku me kufizimet e pandemisë COVID-19, kanë bërë që në të dy vitet 2019-2020 të jenë miratuar ndryshime të planit të auditimeve.

Titulli i gjetjes	Angazhimi i punonjësve të tjerë të institucionit si auditues dhe komprometim i hallkave të kontrollit të cilësisë
Situata:	Problematika e pozicioneve vakante në stafin e njësisë së auditimit të brendshëm është prezente gjatë të dy viteve të periudhës nën auditim. Në rastin e MK, drejtuesi i njësisë së AB ka ushtruar dhe rolin e përgjegjës të grupit, për shkak të mungesës së stafit. Një organizim i tillë vështirëson respektimin e funksioneve të monitorimit të vazhdueshëm në

	njësine e auditimit të brendshëm (Kapitulli VII i Manualit të Auditimit të Brendshëm) <i>o Drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm është përgjegjës për cilësinë e përgjithshme të punës të njësisë së auditimit të brendshëm dhe në këtë rol rishikon punën e përgjegjës të grupit në mënyrë që të sigurojë se ai/ajo ka zbatuar veprimtaritë përkatëse të monitorimit të vazhdueshëm, duke mbikëqyrur përputhjen me politikat e auditimit të brendshëm.</i> Për më tepër, angazhimi i punonjësve të tjerë të institucionit si auditues nuk është në linjë me kërkesat e neneve 11 dhe 17/a të ligjit nr. 114/2015 <i>o</i> Për auditimin e brendshëm në sektorin publik.
Kriteri:	Ligj nr. 114/2015 <i>o</i> Për auditimin e brendshëm në sektorin publik, i ndryshuar, nenet 11 dhe 17/a. Manuali i Auditimit të Brendshëm, Kapitulli VII.
Ndikimi/Efekti:	Rrezikohet cilësia e misioneve audituese të zhvilluara nga sektori.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Ministria e Kulturës të trajtojë me prioritet plotësimin e vendeve vakante, veçanërisht në sektorin e auditimit të brendshëm, me qëllim korrigjimin e parregullsive që vijnë si pasojë e mungesës së burimeve njerëzore në misionet audituese.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave të konkurrencës publik për periudhën objekt auditimi, në zbatim të VKM nr.425, datë 27.5.2020 *o*Për procedurat e përzgjedhjes së subjekteve të pajisura me licencë për projektim, zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim në pasuritë kulturore, për kryerjen e investimeve me fonde publike në Pasuritë Kulturore *o* rezultoi se:

- Në VKM nuk parashikohet komisioni dhe mënyra e llogaritjes së fondit limit, hallkë shumë e rëndësishme e procesit, e cila është reflektuar si problematikë në të gjitha procedurat e konkurrencës.
- Në faqen zyrtare të Ministrisë së Kulturës nuk ka një rubrikë të dedikuar për procedurat e konkurrencës publik duke vështirësuar në këtë mënyrë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, në faqet 45-121 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi:

Nga ana e Ministrisë së Kulturës të ngrihet një grup pune për përmirësimin ligjor të VKM-së nr.425, datë 27.5.2020 *o*Për procedurat e përzgjedhjes së subjekteve të pajisura me licencë për projektim, zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim në pasuritë kulturore, për kryerjen e investimeve me fonde publike në Pasuritë Kulturore *o*, me qëllim arritjen e një procesi të konkurrencës publik sa më transparent, rritjen e konkurrencës dhe menaxhimin me efikasitet, efikasitet dhe ekonomikitet të fondeve publike duke përcaktuar qartë në VKM komisionin dhe mënyrën e llogaritjes së fondit limit.

-Në nenin 13 të VKM-së nr.425, datë 27.5.2020 *o*Për procedurat e përzgjedhjes së subjekteve të pajisura me licencë për projektim, zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim në pasuritë kulturore, për kryerjen e investimeve me fonde publike në Pasuritë Kulturore *o*, duhet të përcaktohet në mënyrë të saktë rubrika e dedikuar për procedurat e konkurrencës publik, në mënyrë lehtësimin e marrjes së informacionit për të gjithë operatorët ekonomik të interesuar.

Në vijimësi

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Llog.210 *o*Toka Troje, Terenë paraqitet në vlerën 261,298,634 lekë pa ndryshuar nga viti i mëparshëm (viti 2019). Për vitin 2020 referuar VKM nr.665, datë 27.08.2020, kanë kaluar në administrim të MK, një sipërfaqe prej 2.488 m² trualli dhe 4 objekteve (nr.10, nr.11, nr.17, nr.18) *o*Grup Depo Ish-reparti ushtarak nr.5001*o*, me vendodhje në BRAR. Me akt dorëzimin, miratuar nga përfaqësuesit e Repartit ushtarak si dhe nga grupi i punës së MK, janë marrë në

dorëzim objektet nga ku është përshkruar për secilin nga objektet viti i ndërtimit, vlera fillestare, vlera e mbetur në kontabilitet, sipërfaqja sipas planit të rilevimit etj. *Nga auditimi u konstatua se kjo vlerë nuk është pasqyruar në kontabilitet duke mos paraqitur kështu një vlerë realë të këtij zëri. Sipërfaqja totale e tokës që ka MK në dispozicion nuk është vlerësuar dhe nuk është pasqyruar në kontabilitet në kundërshtim me ligji nr. 9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" i ndryshuar.*

Llog.212 ÷Ndërtime e konstruksioneö, paraqitet në fund të vitit 2020 në vlerën prej 832,370,619 lekë, ku është zbritur vlera prej 10,648,392 lekë nga vitit i mëparshëm, vlerë e cila ka të bëjë amortizimin vjetor të ndërtesës. Sipas regjistrimit është bërë shtesë e krijuar pa pagës në vlerën 8,183,950 lekë e cila ka të bëjë me rikonstruksionin nga reparti i filmit për godinën e cila është në administrim të MK si dhe rikonstruksion i godinës në MK. *Referuar VKM së sipërpërmendur, 4 godinat të cilat kanë kaluar në administrim të MK, nuk janë regjistruar si vlerë ndërtese edhe pse janë marrë në dorëzim nga MK në kundërshtim me Udhëzimi nr. 8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".*

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, në faqet 34-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Titullari i Institucionit të marrë masa për ngritjen e nje grupi pune me qëllim vlerësimin dhe saktësimin e vlerës së aktiveve afatgjata jo materiale ÷Toka troje terrenö, në administrim të institucionit MK. Nga Drejtoria e Buxhetimit dhe Menaxhimit Financiar (Sektori i Financës) të merren masa për të kontabilizuar dhe paraqitur në pasqyrat financiare vlerën e drejtë të Aktiveve Afatgjata Materiale, menjëherë pas përfundimit të procesit të vlerësimit nga grupi i punës. Të ngrihet një grup pune për të pasqyruar dinamikën dhe lëvizjet e aktiveve afatgjata materiale, të ndërtojë gjurmën e auditimit të këtyre pasurive, duke saktësuar dhe administruar dokumentacionin e nevojshëm.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, pyetëtori dhe shënimet shpjeguese për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore (formati nr.5), për njësitë e qeverisjes së përgjithshme, është i miratuar nga MFE dhe përbëhet nga 19 pika. Në informacionin shpjegues për pasqyrat financiare të viteve 2018 dhe 2019, evidentohen mangësi në plotësimin e tyre si në vendosjen e përgjigjeve respektive öpoö ose öjoö, ashtu edhe në zbërthimin me analizë të llogarive përkatëse, në kundërshtim me pikën 3.7 të UMF nr.8 datë 09.03.2018 ÷Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeö.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, në faqet 34-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Nga Drejtoria e Buxhetimit dhe Menaxhimit Financiar (Sektori i Financës) të merren masat që në vijimësi, pyetëtori dhe shënimet shpjeguese për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore (formati nr.5), të përgatiten dhe paraqiten në përputhje me standardet kontabël kombëtare dhe ky seksion të plotësohet me të dhëna të sakta për elementë të ndryshme të raportimit financiar të njësisë.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se në të gjitha rastet procedurat e blerjeve të biletave jashtë vendit realizohen në një afat shumë të shkurtër nga data e udhëtimit, duke sjelle si pasojë, mungesë të studimit të tregut si rrjedhojë e afateve të limituara dhe rrit riskun e përzgjedhjes së çmimit me të lartë, pasi biletat e avionit blihen në datën e nisjes ose me datë më të afërt me nisjen, ku edhe çmimet kapin vlerën më të lartë të tyre.

Gjithashtu nga auditimi i shpenzimeve për udhëtime dieta me jashtë dhe dokumentacionit justifikues të mandat pagesave tek të gjitha praktikant mungon ftesa e vendit organizator pritis si dhe draft agjenda e punimeve. Me këto dokumente, vërtetohet qëllimi dhe objekti i shërbimit si dhe pjesa e shpenzimeve që do të mbulojë organizatori dhe pjesa që do të mbulojë buxheti i shtetit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, në faqet 24-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Nga Titullari i Institucionit, të merren masa që pas ardhjes së ftesës nga organizatorët për takime/evente jashtë vendit, të nxirret menjëherë autorizimi i pjesëmarrjes në to, në mënyrë që të minimizohet risku i blerjes së biletave me çmim më të lartë si rezultat i kryerjes së procedurës së prokurimit në data të afërta me datën e nisjes së udhëtimit.

3.2 Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa që në të gjitha praktikatat për udhëtime dieta për jashtë shtetit, dokumentit të pagesave ti bashkëngjitet ftesa e vendit pritës dhe draft agjenda e punimeve.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se komisioni i inventarizimit i ngritur me urdhër të Ministrit nr.5701, prot datë 30.12.2020 *“Ngritja e komisionit për inventarizimin fizik të aktiveve në Ministrinë e Kulturës” për vitin 2020*, në përfundim të inventarit ka hartuar një relacion me shkresë nr.1388 prot, datë 17.03.2021 në lidhje me rezultatet, ku ka konstatuar se ka mallra të dëmtuar. Ndërkohë nga MK nuk është ngritur një komision mbi vlerësimin e aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi duke mos e çuar kështu procesin deri në fund në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, i ndryshuar*.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, në faqet 24-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandimi: Institucioni të ndjekë hapat e mëtejshëm bazuar në konkluzionet e grupeve të inventarizimit për procesin e vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi në njësinë shpenzuese, duke bërë të mundur kështu përfundimin e procesit të inventarizimit si dhe heqjen nga kontabiliteti referuar masave të cilat do merren për aktivet e vlerësuara për tu nxjerrë jashtë përdorimit.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga kryerja e testeve mbi urdhër shpenzimet, rezultuan shkelje të disiplinës buxhetore sa i takon likuidimit të faturave duke tejkaluar afatin ligjor. Konkretisht, janë likuiduar fatura mbi afatin e parashikuar 30 ditor duke shkelur disiplinën buxhetore që dikton ligji për *“Menaxhimin e Sistemit Buxhetorë si dhe Ligji nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” neni 7 në 6 urdhër shpenzime*, në shumën totale prej 1,588,870 lekë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, në faqet 24-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1 Rekomandimi: Nëpunësi Zbatues të marrë masat të paraqesë në strukturën e thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të OE-ik, dhe jo ndryshe, me qëllim respektimin e disiplinës buxhetore dhe shmangien e riskut për krijimin e detyrimeve të prapambetura.

Në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me përzgjedhje i kartelave të automjeteve të cilat janë dokumentet vërtetues për lëvizjet, kilometrazhin dhe shpenzimet e karburantit të automjeteve, rezultoi se në të gjitha flete-udhëtimet e shoferëve janë të përshkruara itineraret e lëvizjeve brenda rrethit të Tiranës, por nuk janë të përshkruara kilometrat dhe litrat e harxhuara për secilin nga itineraret e lëvizjeve në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, i ndryshuar*.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, në faqet 24-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1 Rekomandimi: Sektori i administrimit të aseteve dhe shërbimeve të përgjithshme të marrë masa që për çdo fletë-udhëtim të dorëzuar nga shoferet, në fund të muaj të jenë të plotësuara në

mënyrë të sakte me të gjithë elementet e nevojshme siç janë 1. *intenerari i udhëtimit të përshkruar*, 2. *kilometrat e udhëtimit të përshkruar si dhe litrat e karburantit të harxhuar për intenerarin e udhëtimit*, 3. *Punonjësi i MK në me të cilin ka udhëtuar shoferi për arsye pune si dhe firma e tij*. Në fund të fletë udhëtimeve të bëhet përmbledhja e kilometrave të përshkruara si dhe litrat e harxhuara.

Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit, konstatohet se komisioni i prokurimit të blerjeve me vlerë të vogël (KPVV) ka mbajtur proces verbalin e rasteve emergjente dhe vlera e urdhër shpenzimit nr.1096 datë 21.12.2021 është 250,000 lekë pa tvsh. Ndërkohe që në rastet emergjente ku situata është e paparashikuar vlera nuk duhet të jetë më e madhe se 100,000 leke, në këtë situatë KPVV ka shmangur procedurën standarde të prokurimit me vlerë të vogël duke cenuar barazinë e pjesëmarrësve në tendera si dhe ka krijuar premisa për shmangien e konkurrencës në kundërshtim me Ligjin nr.162 dt. 23.12.2020, òPër Prokurimin Publikò.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, në faqet 24-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1 Rekomandimi: Institucioni të marrë masa që në procedurat e ardhshme kur situata është emergjente dhe e pa parashikuar, të mos tejkalohej shumat e lejuar për procedura të kësaj natyre.

Në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zhvillimit të procedurave të auditimit me objekt *òRealizimin me çelësa në dorë të projektit elektrik për ndriçimin e jashtëm të Kalave”, të Shkodrës, Krujës, Beratit dhe Gjirokastrës* u konstatua se është mbajtur procesverbali për llogaritjen e fondit limit në datën 23.09.2020, në të njëjtën datë që është ngritur Urdhri i Zhvillimit të procedurës. Ky procesverbal është mbajtur nga Njësia e Hartimit të Dokumenteve të Procedurës së Konkurrimit Publik edhe pse nuk ka asnjë urdhër që ky komision do të hartonte llogaritjen e fondit limit.

Nga auditimi konstatohet se tre ofertat e marra në treg nuk përmbajnë datë, pra nuk mund të vërtetohet nëse këto oferta janë reale për kohën e zhvillimit të kësaj procedure.

Gjithashtu nga auditimi konstatohet se në llogaritjen e fondit limit nuk ka asnjë preventiv fillestar apo planimetri të objektit dhe se si kanë dalë këto zëra dhe sasitë e secilës prej tyre.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, në faqet 45-121 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1 Rekomandimi:

-Nga ana e Ministrisë së Kulturës, të merren masa që në çdo procedurë konkurrimi , llogaritja e fondit limit të bëhet në bazë të ofertave reale dhe të përkojnë në kohën e zhvillimit të procedurës së konkurrimit.

-Nga ana e Ministrisë së Kulturës të ngrihet një grup pune me qëllim verifikimin e planimetrive dhe preventivave fillestarë të Kalave, objekte të investimeve.

Në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës òNdërrhyrje Restauruese në Mozaikun e Tiranësò konstatohet se është ngritur grupi i punës me nr.362, datë 22.06.2021, për shqyrtimin e ankesës lidhur me hedhjen në sistem të tre DSK të ndryshme mbi procedurën e konkurrimit.

Bazuar në VKM nr.425, datë 27.05.2020 si dhe Udhëzimit nr.269, datë 11.08.2020 òPër miratimin e dokumenteve standarde të konkurrimit publik, për përzgjedhjen e subjekteve të pajisura me licencë në projektim, zbatim mbikëqyrje dhe kolaudim në pasuritë kulturore për kryerjen e investimeve me fonde publike në pasuritë kulturore,ò autoriteti kontraktor nuk duhej ta shqyrtonte ankesën pasi operatori nuk ka respektuar afatet e ankesës dhe ai ka dorëzuar ofertën e tij ekonomike pa pasur asnjë kundërshti.

Nga ana e autoritetit kontraktor është ngritur Urdhri me nr.396, datë 02.07.2021 për pranimin e ankesës dhe anulimin e procedurës së konkurrimit pasi sipas grupit të punës së shqyrtimit të ankesës nuk është respektuar parimi i transparencës nga AK pasi janë fshirë/hequr nga sistemi DSKP për këtë procedurë, pra nuk ka patur transparencë në këtë proces për operatorët ekonomikë pjesëmarrës.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, në faqet 45-121 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1 Rekomandimi:

-Nga ana e Ministrisë së Kulturës të ngrihet një grup pune me qëllim evidentimin e ndërhyrjeve që janë bërë në faqen zyrtare të Ministrisë së Kulturës dhe nxjerrjen e përgjegjësve që e kanë shkaktuar këtë situatë.

Në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ne terren i dy kontratave, respektivisht: kontratës me 16246/10 prot, datë 03.12.2020 me objekt òRikonstruksioni i aneksit të Bibliotekës Kombëtare (fondi i Bibliotekës Kombëtare)ò lidhur midis Ministrisë së Kulturës dhe OE òL.Kò sh.p.k., me vlerë 41,192,400 lekë pa tvsh dhe kontrata 5173 prot. datë 03.12.2020 me objekt òRikonstruksioni/Rivitalizimi i Magazinave të TKOBAP, në Brarò (Faza I)ò lidhur midis Ministrisë së Kulturës dhe OE ò6D-Pò sh.p.k., me vlerë 15,828,383 lekë pa tvsh, u mungon leja për miratimin e ndërhyrjes nga KKTKM.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, në faqet 45-121 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1 Rekomandimi: Nga ana e Ministrisë së Kulturës dhe strukturat përkatëse të merren masat e nevojshme për pajisjen me leje ndërtimi ose leje për miratimin e ndërhyrjes nga KKTKM sipas legjislacionit në fuqi për të gjitha projektet ne vijimësi.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi:

- Nga auditimi i procedurave të projekteve me inicim të brendshëm të Drejtorisë së Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve të Kulturës, ka rezultuar se Kolegjiumi nuk ka një dokumentacion justifikues në lidhje me përcaktimin e vlerës së fondit limit. Po kështu, nuk është justifikuar mënyra e përzgjedhjes së subjekteve të cilëve u është drejtuar kërkesa për ofertë.

- Rezulton se Kolegjiumi nuk ka bërë një analizë të detajuar të çmimeve të përcaktuara në kërkesë, pasi nuk ka tarifa të përcaktuara për këtë qëllim dhe si referencë përdoren çmimet e tregut.

- Rezulton se Ministri i Kulturës nuk ka nxjerrë urdhër për mënyrën e funksionimit të kolegjiemeve. Nga shqyrtimi i përbërjes së kolegjiemeve në projektet kulturore me thirrje të viteve 2020 dhe 2021 rezulton se pjesë e tij janë edhe këshilltar, në shkelje me përcaktimet e nenit 48, pika 2 të Rregullores së Organizimit dhe Funksionimit të Brendshëm të Ministrisë së Kulturës.

- Nga ana e Kolegjiumit nuk ka patur një proces të përzgjedhjes të ndarë në dy faza, sipas përcaktimeve të Udhëzuesit të Ministrisë së Kulturës. Nuk rezulton të ketë proces-verbal të mbledhjes së Kolegjiumit për fazën e parë të procesit, ku të jenë përcaktuar se cilët janë subjektet të cilët kalojnë fazën e parë. Referuar procesverbalit të mbajtur nga Kolegjiumi nuk është përcaktuar metodologjia e përzgjedhjes dhe e klasifikimit të subjekteve fitues.

- Rezulton se Kolegjiumi ka miratuar preventivat e paraqitur nga subjektet fitues pa bërë një analizë të detajuar të kostove.

- Rezulton se kontratat me ekspertin, në cilësinë e Kryetarit të Kolegjiumit, për vitet 2020 dhe 2021 janë lidhur pas përzgjedhjes së subjekteve fitues nga ana e Kolegjiumit dhe lidhjes së kontratave me Ministrinë e Kulturës.

- Kryetari i Kolegjiumeve ka ushtruar funksionet, pa patur një akt ligjor të ushtrimit të tyre.

- Gjithashtu, referuar nenit 48, pika 2 të Rregullores së Organizimit dhe Funksionimit të Brendshëm të Ministrisë së Kulturës, parashikohet që ekspertët e fushës nuk kanë të drejtë vote në Kolegjium. Kryetari i Kolegjiumit rezulton të jetë pjesëmarrës në procesin e votimit dhe gjithashtu gëzon statusin e ekspertit.

- Rezulton se nuk ka kontratë të lidhur midis Ministrisë së Kulturës dhe ekspertes (muzikante), si anëtare e Kolegjiumit. Në këto kushte ekspertja ka ushtruar funksionet pa patur një akt ligjor.

- Në zbatim të përcaktimeve të nenit 5 të çdo kontrate “*Të drejtat dhe detyrimet e përfituesit*” parashikohet që: *Shpenzimet e kryera nga përfituesi, për të gjithë zërat e financuara nga financuesi, duhet të justifikohen me raport përshkrues nga përfituesi mbi realizimin e veprimtarive që financohen nga financuesi sipas kësaj kontrate*, rezulton se në të gjithë dokumentacionin

bashkëlidhur urdhër shpenzimeve mungojnë raportet përmbledhëse.

- Nga shqyrtimi i listës së projekteve fituese për vitet 2020 dhe 2021 evidentohet disa subjekte të cilët janë subvencionuar duke qenë individ. Referuar Ligjit nr. 10352, datë 18.11.2010 òPër Artin dhe Kulturën, i ndryshuar, neni 26 parashikon se MK financon projekte të paraqitura nga persona fizik dhe juridik. Gjithashtu, referuar edhe udhëzimeve të Ministrisë së Kulturës, në seksionin se cilët mund të aplikojnë, është parashikuar që individët nuk kanë të drejtën e aplikimit. Në këto kushte të gjithë individët që kanë përfituar fonde dhe/ose mbështetje nga Ministria e Kulturës janë në shkelje të përcaktimeve ligjore.

- Referuar përmbajtjes së procesverbaleve të kolegjiemeve për projektet kulturore, të brendshme në mbështetje të prioriteteve të Ministrisë së Kulturës, evidentohet se Kolegjiumi ka vlerësuar projektet duke bërë një përshkrim, i cili është identik me përmbajtjen e kërkesave të ardhur nga kërkuesi, pa një qëndrim të qartë në lidhje me procesin e vlerësimit të bërë nga ana e Kolegjiomit. Gjithashtu, nuk ka një analizë financiare të kostos së projektit, por është marrë i mirëqenë preventivi i paraqitur nga kërkuesi.

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të procedurave në një rast, rezulton se fatura tatimore bashkëlidhur urdhër shpenzimit është e datës 11.12.2020, ndërkohë që kontrata është lidhur në datën 15.12.2020. Ky fakt i evidentuar përveç se është në shkelje të kontratës së lidhur midis palëve, paragjykon edhe procesin e mbështetjes financiare të projektit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, në faqet 121-144 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1. Rekomandimi: Ministri i Kulturës të marrë masa për nxjerrjen e urdhrit për mënyrën e funksionimit të Kolegjiemeve, si kërkesë e Ligjit 10352 òPër Artin dhe Kulturën, neni 27, pika 2

Në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i komponentëve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në zbatim të Ligjit nr. 10 296, datë 8.7.2010 òPër menaxhimin financiar dhe kontrollin, i ndryshuar, u konstatua se punonjësit e Ministrisë së Kulturës nuk kanë marrë pjesë në trajnime mbi menaxhimin e riskut, element ky shumë i rëndësishëm në veprimtarinë e një institucioni bazuar në ligjin për MFK, si dhe referuar kapitullit III të òManualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, i cili citon se punonjësit duhet të kryejnë trajnime në fushën e përdorimit të metodikës së pranuar në identifikimin, analizën dhe menaxhimin e riskut.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 7, në faqet 144-148 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1 Rekomandim: Ministria e Kulturës të marrë masa për planifikimin dhe trajnimin e punonjësve të saj, në lidhje me komponentët e MFK-së dhe veçanërisht për menaxhimin e riskut.

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi është konstatuar se dokumenti i gjurmëve të auditimit është miratuar me Urdhër të Ministrisë së Kulturës nr. 346, datë 14.06.2021 (shkresë nr. 3079/1, datë 14.06.2021) dhe përfshin proceset dhe aktivitetet e drejtorive të aparatit të Ministrisë. Për sa i përket institucioneve në varësi nuk konstatohen të kenë gjurmë auditimi të miratuara, sipas kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 me ndryshime òPër menaxhimin financiar dhe kontrollin neni 16 òDetyrimi për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit pika 2 ku përcaktohet: *“Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësive publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit. Gjurma e auditimit arkivohet sipas dispozitave ligjore në fuqi”*.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 8, në faqet 149-154 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1 Rekomandim: Ministria e Kulturës të marrë masa për të nxitur institucionet në varësi të saj të hartojnë dhe miratojnë dokumentin përkatës të gjurmës së auditimit.

Menjëherë

14. Gjetje nga auditimi: Problematika e pozicioneve vakante në stafin e njësisë së auditimit të brendshëm është prezentë gjatë të dy viteve të periudhës nën auditim. Në rastin e Ministrisë së Kulturës, drejtuesi i njësisë së AB ka ushtruar dhe rolin e përgjegjës të grupit, për shkak të mungesës së stafit. Një organizim i tillë vështirëson respektimin e funksioneve të monitorimit të vazhdueshëm në njësinë e auditimit të brendshëm (Kapitulli VII i Manualit të Auditimit të Brendshëm) *“Drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm është përgjegjës për cilësinë e përgjithshme të punës të njësisë së auditimit të brendshëm dhe në këtë rol rishikon punën e përgjegjës të grupit në mënyrë që të sigurojë se ai/ajo ka zbatuar veprimtaritë përkatëse të monitorimit të vazhdueshëm, duke mbikëqyrur përputhjen me politikat e auditimit të brendshëm.*”

Për më tepër, angazhimi i punonjësve të tjerë të institucionit si auditues nuk është në linjë me kërkesat e neneve 11 dhe 17/a të ligjit nr. 114/2015 *“Për auditimin e brendshëm në sektorin publik.*” (Më hollësisht trajtuar në pikën 8, në faqet 149-154 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1 Rekomandim: Ministria e Kulturës të trajtojë me prioritet plotësimin e vendeve vakante, veçanërisht në sektorin e auditimit të brendshëm, me qëllim korrigjimin e parregullsive që vijnë si pasojë e mungesës së burimeve njerëzore në misionet audituese.

Në vijimësi

C.1 MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në terren i kontratës “Restaurim i çatisë së banesës së S.Sh., Tiranë (Faza e Emergjencës)” me nr.3751/5, datë 09.10.2020 midis Ministrisë së Kulturës dhe BOE ò6D-Pòshpk & òBM-Kò shpk, me vlerë 1,067,676 lekë pa tvsh u konstatua se gjatë zbatimit nuk janë kryer zërat:

Restaurim strehë çatie tjegulla vendi me dekor, sasia 30m³, me vlerë totale 189,690 lekë pa tvsh. Por është realizuar zëvendësimi i traut të thyer të çatisë. Analiza e çmimit për heqjen dhe vendosjen e traut e llogaritur nga ana e audituesve është 94,479 lekë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, në faqet 45-121 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Nga Ministria e Kulturës të merren masa për arkëtimin e shumës së përfituar padrejtësisht nga operatori ekonomik BOE ò6D-Pòshpk & òBM-Kò shpk në vlerën 95,211 lekë pa tvsh.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në terren i kontratës me 5173 prot. datë 03.12.2020 me objekt òRikonstruksioni/Rivitalizimi i Magazinave të TKOBAP, në Brarò (Faza I)ò lidhur midis Ministrisë së Kulturës dhe OE ò6D-Pò sh.p.k., me vlerë 15,828,383 lekë pa tvsh u konstatua se gjatë zbatimit ka diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera, me vlerë totale 852,265 lekë pa tvsh.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, në faqet 45-121 të Projekt Raportit të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Nga Ministria e Kulturës të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 852,265 lekë pa tvsh nga OE ò6D-Pò sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve sipas kontratës me nr. 5173 prot., datë 03.12.2020, me objekt òRikonstruksioni/Rivitalizimi i Magazinave të TKOBAP, në Brarò (Faza I)ò, vlerë kjo që përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit.

Menjëherë

C.2. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet është lidhur kontrata me nr.4053/14, datë 28.10.2020 midis Ministrisë së Kulturës dhe BOE òAL.Vò Shpk & òC-96ò shpk me vlerë 6,833,000

lekë pa tvsh, dhe afat për realizimin e saj 90 ditë nga data e nënshkrimit .

Në këto kushte vlera e financuar nga Ministria e Kulturës prej 6,833,000 **nuk** është përdorur me ekonomikitet, efektivitet dhe efikasitet, pasi konstatuam se kjo procedurë nuk është zhvilluar më tej me kryerjen e procedurave të zbatimit të këtij projekti deri në përfundim të periudhës objekt auditimi, gjithashtu këto procedura nuk janë planifikuar për tu kryer as në vitin 2022.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, në faqet 45-121 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Nga ana e Ministrisë së Kulturës të merren masa të menjëhershme për ngritjen e grupit të punës për evidentimin e shkaqeve që kanë sjellë mos zhvillimin e projekt zbatimit të kësaj procedure, duke rrezikuar përdorim jo efektiv të fondeve prej 6,833,000 lekë.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës nr. 4049/10, datë 23.10.2020 me objekt: “Realizimin me çelësa në dorë të projektit elektrik për ndriçimin e jashtëm të kalasë së Beratit”, me vlerë kontrate (pa TVSh) 29,968,773 lekë, realizuar nga bashkimi i OE òRò shpk + òAL.Vò shpk, rezultuan diferenca në volume punimesh të pakryera sipas preventivit të miratuar nga investitori në vlerën 2,980,544 lekë pa TVSh, veprime në kundërshtim me kontratën të cilat kanë sjellë efekt negativ në buxhetin e shtetit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, në faqet 45-121 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Ministria e Kulturës të marrë masat duke ngritur një grup pune për të saktësuar, njoftuar dhe kërkuar nga subjekti OE òRò shpk + òAL.Vò shpk, plotësimin e punimeve të pakryera sipas preventivit për vlerën 2,980,544 lekë me efekte negative ndaj buxhetit të shtetit.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me nr.4050/10 prot. datë 23.10.2020 me objekt òRealizimin me çelësa në dorë të projektit elektrik për ndriçimin e jashtëm të kalasë së Shkodrësò , me vlerë 17,422,642 lekë pa tvsh realizuar nga bashkimi i OE òRò sh.p.k. dhe òAL.Vò sh.p.k rezultuan diferenca në volume punimesh të pakryera sipas preventivit të miratuar nga investitori në vlerën 1,748,264 lekë pa TVSh, veprime në kundërshtim me kontratën të cilat kanë sjellë efekt negativ në buxhetin e shtetit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, në faqet 45-121 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Ministria e Kulturës të marrë masat duke ngritur një grup pune për të saktësuar, njoftuar dhe kërkuar nga subjekti OE òRò shpk + òAL.Vò shpk, plotësimin e punimeve të pakryera sipas preventivit për vlerën 1,748,264 lekë me efekte negative ndaj buxhetit të shtetit.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me nr.4051/10 prot. datë 23.10.2020 me objekt òRealizimin me çelësa në dorë të projektit elektrik për ndriçimin e jashtëm të kalasë së Krujësò , me vlerë 14,155,008 lekë pa tvsh realizuar nga bashkimi i OE òRò sh.p.k. dhe òAL.Vò sh.p.k rezultuan diferenca në volume punimesh të pakryera sipas preventivit të miratuar nga investitori në vlerën 1,671,440 lekë pa TVSh, veprime në kundërshtim me kontratën të cilat kanë sjellë efekt negativ në buxhetin e shtetit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, në faqet 45-121 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandimi: Ministria e Kulturës të marrë masat duke ngritur një grup pune për të saktësuar, njoftuar dhe kërkuar nga subjekti OE òRò shpk + òAL.Vò shpk, plotësimin e punimeve të pakryera sipas preventivit për vlerën 1,671,440 lekë me efekte negative ndaj buxhetit të shtetit.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me nr.4052/10 prot. datë 23.10.2020 me objekt òRealizimin me çelësa në dorë të projektit elektrik për ndriçimin e jashtëm të kalasë së Gjirokastrësë , me vlerë 20,361,852 lekë pa tvsh realizuar nga bashkimi i OE òRö sh.p.k. dhe òAL.Vö sh.p.k rezultuan diferenca në volume punimesh të pakryera sipas preventivit të miratuar nga investitori në vlerën 1,622,607 lekë pa TVSh, veprime në kundërshtim me kontratën të cilat kanë sjellë efekt negativ në buxhetin e shtetit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, në faqet 45-121 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1 Rekomandimi: Ministria e Kulturës të marrë masat duke ngritur një grup pune për të saktësuar, njoftuar dhe kërkuar nga subjekti OE òRö shpk + òAL.Vö shpk, plotësimin e punimeve të pakryera sipas preventivit për vlerën 1,622,607 lekë me efekte negative ndaj buxhetit të shtetit.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me 16246/10 prot datë 03.12.2020 me objekt òRikonstruksioni i aneksit të Bibliotekës Kombëtare (fondi i Bibliotekës Kombëtare)ö, me vlerë 41,192,400 lekë pa tvsh realizuar nga OE òL.Kö sh.p.k., rezultuan diferenca në volume punimesh të pakryera sipas preventivit të miratuar nga investitori në vlerën 551,336 lekë pa TVSh, veprime në kundërshtim me kontratën të cilat kanë sjellë efekt negativ në buxhetin e shtetit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, në faqet 45-121 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1 Rekomandimi: Ministria e Kulturës të marrë masat duke ngritur një grup pune për të saktësuar, njoftuar dhe kërkuar nga subjekti òL.Kö sh.p.k, plotësimin e punimeve të pakryera sipas preventivit për vlerën 551,336 lekë me efekte negative ndaj buxhetit të shtetit.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në terren i kontratës me nr.2455 prot., datë 12.05.2021 me objekt òRikonstruksioni/Rivitalizimi i Magazinave të TKOBAP,në Brarö (Faza II)ö lidhur midis Ministrisë së Kulturës dhe BOE òCö sh.p.k & ò6D-Pö sh.p.k., me vlerë 34,020,265 lekë pa tvsh u konstatua se gjatë zbatimit ka punime të situacionuara por të pajustificuar, me vlerë totale 1,883,454 lekë pa tvsh.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, në faqet 45-121 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1 Rekomandimi: Nga ana e Ministrisë së Kulturës të merren masa të menjëhershme për ngritjen e grupit të punës për evidentimin e diferencave të volumeve dhe certifikimin e tyre në situacionin përfundimtar. Mos evidentimi i diferencave të mësipërme në situacionin përfundimtar i vlerës prej 1,883,454 lekë pa tvsh, nga BOE òCö sh.p.k & ò6D-Pö sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve sipas kontratës me nr.2455 prot., datë 12.05.2021 me objekt òRikonstruksioni/Rivitalizimi i Magazinave të TKOBAP, në Brarö (Faza II)ö, përbën efekt negativ ndaj buxhetit të shtetit.

Menjëherë

V. ANEKSE

Anekset japin informacion mbi:

Aneksi 1. òSqarim rreth llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga KLSHö;

Aneksi 2. òQasja dhe metodologjia e auditimitö;

Aneksi 3. òAnaliza e risqeveö.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT

ANEKSI I - SQARIM RRETH LLOJEVE TË NDRYSHME TË OPINIONEVE TË APLIKUARA NGA KLSH

Llojet e opinionëve të aplikuar nga KLSH

a. OPINIONI I PAMODIFIKUAR:

Një opinion i pamodifikuar jepet kur audituesi arrin në konkluzionin se për të gjitha aspektet materiale, pasqyrat financiare paraqesin një pamjen të vërtetë dhe të drejtë si dhe pasqyrat janë përgatitur në përputhje me bazën ligjore në fuqi për raportimin financiar. Audituesi duhet të tërheq vëmendjen e përdoruesit për një ose disa çështje të paraqitura ose të evidentuara në pasqyrat financiare, të cilat janë të rëndësishme për të kuptuar pasqyrat financiare. Përdoruesit e pasqyrave financiare në sektorin publik janë ligjvënësit, Parlamenti, komitetet mbikëqyrëse, komisione të ndryshëm dhe qytetarët, të cilët janë dhe përdoruesit e fundit.

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes.

Në rrethana të caktuara, audituesi mund të marrë në konsideratë faktin se lexuesi nuk do të arrijë në kuptimin e saktë të pasqyrave financiare nëse atij nuk do t'i tërhiqet vëmendja mbi çështjet të pazakonta ose të rëndësishme. Si parim i përgjithshëm, audituesi nuk i referohet aspekteve specifike të pasqyrave financiare kur jep një opinion të pamodifikuar, në rast se kjo ndodh mund të keqinterpretohet si modifikim. Për të evituar dhënien e kësaj përshtypje të gabuar, referencat e menduara si ÷theksimi i çështjes ÷ përfshihen në një paragraf të veçuar nga ai i opinionit. Theksimi i referohet një çështjeje të paraqitur ose shpalosur në mënyrë të duhur në pasqyrat financiare e cila, sipas gjykimit të audituesit, ka një rëndësi thelbësore për përdoruesin në mënyrë që të arrijnë të kuptojnë pasqyrat financiare. (ISSAI 1706.5).

b. OPINIONET E MODIFIKUARA:

Audituesi duhet të modifikojë opinionin në rastet kur:

- Bazuar në evidencat e auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi përmbajnë anomali materiale; ose
- Nuk është në gjendje të sigurojë evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme për auditin. (ISSAI 1700.4;6;17)
- Evidentohet që njësisia ekonomike nuk ka përmbushur përgjegjësitë e përcaktuara nga legjislacioni i raportimit financiar për:
 - Prezantimin e drejtë të informacionit financiar.
 - Mos plotësimin e të gjitha kërkesave ligjore të raportimit financiar. (ISSAI 1700.18;19)

- Evidentohen raste që lidhen me mosrespektimin e legjislacionit ose dobësi të kontrollit të brendshëm, të cilat ka një efekt material ose të përhapur në pasqyrat financiare. (ISSAI 1705 P4; P5; P6)

Përhapja është një term i përdorur për të përshkruar efektet në pasqyrat financiare të anomalive ose efektet të mundshme nëse ka, që nuk zbulohen për shkak të pa mundësisë për të marrë evidenca të mjaftueshme të auditimit. Përhapja e gjetjes do të përcaktojë llojin e opinionit të modifikuar të auditimit i cili do të jepet.

Efektet e përhapjes në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të audituesit: Nuk kufizohen në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare; Mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose janë të rëndësime për përdoruesit e pasqyrave financiare. (ISSAI 1700.5)

Audituesi duhet të zgjedhë opinionin më të përshtatshëm të modifikuar nga 3 opsionet e përshkruara më poshtë:

Opinion i modifikuar. Opinion i modifikuar do të jepet në rastet kur audituesi nuk është dakord ose është i pasigurt për një ose më shumë çështje specifike që bëjnë pjesë në pasqyrat financiare të cilat janë materiale por jo thelbësore për arsyetimin e pasqyrave. Formulimi i opinionit zakonisht tregon një rezultat të kënaqshëm të subjektit të auditimit në një deklaratë të qartë dhe konçize të çështjeve të mospajtimit ose të pasigurisë, duke çuar në opinionin e modifikuar. Nëse efekti financiar i paqartësisë apo i mosmarrëveshjes është i përcaktuar si shumë nga audituesi, ndonëse nuk është gjithmonë e praktikuar ose e përshtatshme, atëherë kjo do të shërbente si ndihmë për përdoruesit e pasqyrave.

Opinion negativ (kundërshtues). Opinion negativ (kundërshtues) do të jepet në rastet kur audituesi e ka të pamundur të krijojë një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, si pasojë e mospërputhjes aq shumë vendimtare sa të përmbys situatën e paraqitur në atë masë që një opinion i modifikuar në aspekte të caktuara nuk do të ishte i përshtatshëm. Formulimi i këtij opinion qartëson faktin se pasqyrat financiare nuk janë deklaruar saktësisht duke specifikuar në mënyrë të thjeshtë dhe koncize të gjitha rastet e mospërputhjes. Gjithashtu, aty ku është me vend dhe e praktikueshme, do të ishte e dobishme sikur ndikimi financiar mbi pasqyrat financiare të përcaktohej në shumë.

Refuzim i opinionit. Refuzimi i opinionit do të jepet në rastet kur audituesi e ka të pamundur që të mbërrijë në një opinion për sa i përket pasqyrave financiare të marra në tërësi, si pasojë e pasigurisë apo e kufizimit të fushëveprimit aq shumë thelbësor, në mënyrë që një opinion i kualifikuar në disa aspekte të caktuara të mos jetë i përshtatshëm. Formulimi i refuzimit të opinionit qartëson faktin se është e pamundur të jepet një opinion duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha rastet e paqartësisë.

ANEKSI II - QASJA DHE METODOLOGJIA E AUDITIMIT

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal nivelin të devijimit që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 1.5% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar. Nën gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës ka ulur gamën e gabimeve për tu konsideruar, duke marrë në konsideratë pragun e materialitetit prej 1.5%, pasi gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është konkluduar që sistemet e kontrollit të brendshëm kanë risk të moderuar. Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti dhe verifikimin e tyre me evidencat periodike me Thesarin, si dhe dokumentacionin shoqërues (praktikën e urdhër shpenzimit). Konkretisht, mbi transaksionet u aplikuan:

- teste të kontroleve për të verifikuar se si kanë funksionuar sistemet e kontrollit të brendshëm (trajtuar gjerësisht në pikën e programit mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin); dhe
- teste të detajeve.

Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim,

në zërat e shpenzimeve, u morën në konsideratë dy elementë:

✓ Risku i lidhur me shpenzimin specifik, nga ku nën gjykimin profesional të audituesit niveli i riskut për shpenzime që lidhen me llogarinë 602 dhe me llogarinë 231 u vlerësuan me 2; dhe

✓ Pesha specifike që ky zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit.

Për të përzgjedhur minimumin e çështjeve për auditim, mbi këta zëra shpenzimesh, u aplikuan format e përlogaritjes si më poshtë:

Ministria e Kultures			
Emërtimi i Shpenzimeve 2020	Vlera e Popullatës	Faktori i Riskut (0.7-2-3)	Çështje për tu shqyrtuar
Paga (600)	78,582,199	0.70	2
Sigurime Shoqërore (601)	12,668,722	0.70	0
Mallra e Shërbime (602)	47,446,280	0.70	1
Investime të brend. (230-231)	2,037,359,488	2.00	116
Te tjera transfer. korrente (606)	1,103,759	0.70	0
Total	2,177,160,448		
<i>Materialiteti në %</i>	2%		
Materialiteti në vlerë	43,543,209		
<i>Kalkulimi i precizionit</i>			
Materialiteti	43,543,209		
<i>Gabimi i lejuar (10% - 20%)</i>	4,354,321		
Nëntotali	39,188,888		
<i>Precizioni i planifikuar (80-90%)</i>	90%		
Vlera e precizionit	35,269,999		

Nisur nga rezultatet sa më sipër, për analizën e pasqyrave financiare të vitit 2020, grupi i auditimit mori në shqyrtim 20 çështje për të verifikuar saktësinë, ndodhjen, ligjshmërinë, dhe kontabilizimin, mbi llogarinë 600 dhe 601 nga 2 çështje në total që është minimumi i kërkuar për të dhënë siguri të arsyeshme.

Gjithashtu u shqyrtuan 20 çështje për të verifikuar përkatësinë, plotësinë, saktësinë, periudhën, klasifikimin dhe përputhshmërinë, nga 12 çështje në total që është minimumi i kërkuar për të dhënë siguri të arsyeshme, si dhe nga llogaria 231, 200 çështje, nga 116 çështje në total që është minimumi i kërkuar për të dhënë siguri të arsyeshme.

Ndërsa sa i takon pohimeve rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese më së shumti u mor në konsideratë kuptueshmëria, saktësia dhe vlerësimi i zërave në këto relacione.

1. Mbulimi me auditim i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore (llogaria 600 dhe 601)

Klasa 6 (llog 600)	Pagat faktike	Mbuluar me auditim (leke)	Mbuluar me auditim (%)
Viti 2020	78,582,199	20	29%
Viti 2021	78,870,200	20	24%

2020: Minimumi i çështjeve që u vlerësuan për auditim duke marrë në konsideratë nivelin e riskut për këtë zë specifik shpenzimi, rezultoi 7, nga ku grupi i auditimit për të rritur sigurinë e arsyeshme mori përsëri në shqyrtim 40 çështje (pagat e 40 punonjësve të shtrira në muajt si vijon:

Nr	Viti 2020	Llogaria 600
1	Tetor	6,548,571

2	Nëntor	6,548,517
3	Dhjetor	6,548,517
	Total audituar	19,645,713

2021: Minimumi i çështjeve që u vlerësuan për auditim duke marrë në konsideratë nivelin e riskut për këtë zë specifik shpenzimi, rezultoi 6, nga ku grupi i auditimit për të rritur sigurinë e arsyeshme mori përsëri në shqyrtim 30 çështje (pagat e 40 punonjësve të shtrira në muajt si vijon:

Nr	Viti 2021	Llogaria 600
1	Janar	6,548,571
2	Shkurt	6,548,517
3	Mars	6,548,517
	Total audituar	19,645,713

2. Mbulimi me auditim i shpenzimeve operative dhe shpenzimeve për investime (llogaria 602 dhe 231)³

Klasa 6 (llog 602)	Shpenzime operative faktike	Mbuluar me auditim (leke)	Mbuluar me auditim (%)
Viti 2020	47,446,280	3,888,171	56%
Viti 2021	47,446,280	6,622,045	49%

3. Mbulimi me auditim i të ardhurave dytësore

U mbulua 100% auditimi mbi të ardhurat dytësore

4. Mbulimi me auditim i prokurimeve:

për vitin 2020 në Ministrinë e Kulturës janë realizuar 80 procedura prokurimi, me vlerë totale 255,423,338 lekë me TVSH dhe 10 procedura konkurrimi publik në zbatim të VKM-së 425, datë 27.05.2020 e ndryshuar me fond limit 149,494,167 lekë pa tvsh dhe vlerë kontrate në total 134,483,433 lekë pa tvsh. Në total fondi 389,906,771 lekë pa tvsh.

Ndër të cilat :

- Procedure e Hapur -Vlera e Kontratave pa TVSH- 15,828,383 leke- 1 procedurë;
- Kerkese për propozim- Vlera e Kontratave pa TVSH- 1,556,449 leke- 1 procedurë;
- Marrëveshje Kuadër (ABP)- Vlera e Kontratave pa TVSH ó 1,500,000 leke-1 procedurë;
- Negocim pa shpallje paraprake- Vlera e Kontratave pa TVSH- 1,370,597 leke- 6 procedura ;
- Prokurim me vlerë të vogël- Vlera e Kontratave pa TVSH ó 8,551,167 leke- 19 procedura;
- Blerje nën 100.000 leke- Vlera e Kontratave pa TVSH ó1,305,209 leke- 21 procedura;
- Procedure me emergjencë - Vlera e Kontratave pa TVSH- 289,717 leke- 5 procedura;
- Shërbimi Rojeve (Sipas Udhëzimit të Përbashkët të Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 407/1, datë 14.06.2019)- Vlera e Kontratave pa TVSH- 6,566,009 leke pa TVSH- 1 procedure;

-Për vitin 2021 në Ministrinë e Kulturës janë realizuar 58 procedura prokurimi, me vlerë totale fondi limit 122,375,214 lekë pa tvsh dhe 5 procedura konkurrimi publik në zbatim të VKM-së 425, datë 27.05.2020 e ndryshuar me fond limit 1,641,322,089 lekë me tvsh. Në total fondi 1,763,697,303 lekë pa tvsh.

Ndër të cilat :

- Procedurë e Hapur e Thjeshtuar -Vlera e Kontratave pa TVSH- 5,453,700 leke- 2 procedura
- Kerkesë për propozim- Vlera e Kontratave pa TVSH- 2,988,000 leke- 1 procedurë
- Marrëveshje Kuadër (ABP)- Vlera e Kontratave pa TVSH - 1,163,993 leke- 1 procedurë

³Aneksi 1 – urdhër shpenzimet, objekt verifikimi

- Procedure e hapur- Vlera e Kontratave pa TVSH - 34,020,265 leke- 1 procedurë
 - Prokurim me vlere të vogël- Vlera e Kontratave pa TVSH - 8,519,422 leke- 20 procedura
 - Shërbim konsulence- Vlera e Kontratave pa TVSH - 62,795,285 leke- 5 procedura
 - Sistemi dinamik i blerjeve (bileta)- Vlera e Kontratave pa TVSH -1,855,634 leke- 8 procedura
 - Blerje nën 100.000 leke- Vlera e Kontratave pa TVSH -1,270,520 leke-16 procedura
 - Procedurë me emergjencë - Vlera e Kontratave pa TVSH- 742,572 leke- 4 procedura
- Procedurat për tu audituar janë përzgjedhur në bazë të vlerave më të larta të zhvilluara.

ANEKSI III:

ANALIZA E RISQEVË:

1.Risku i brendshëm (i trashëgueshëm) IR për MK

Risku i brendshëm i shmangies nga përputhshmëria, ose gabimi, është analizuar nga grupi i auditimit duke përdorur gjykimin në vlerësimin e një sërë faktorësh, (në referencë të kreut 4.2 të MAP të KLSH, fq. 33- 35), që përfshijnë:

Shkallëzimi IR:

Risku i ulët: ngjyrë jeshile, deri në 0,5

Risku i moderuar: ngjyrë verdhë, 0.6 deri në 0,9

Risku i larte: ngjyrë kuqe, 1

- kompleksitetin e strukturave menaxhuese: verdhe, vlerësuar **0,6**
- kompleksitetin e kuadrit normues dhe ligjor: jeshile, vlerësuar **0.4**
- hyrjen në zbatim të dispozitave të reja ligjore ose ndryshimet në rregullat ekzistuese: verdhë, vlerësuar **0,7**
- shërbime dhe programe të realizuara nga palë të treta: jeshile deri tek e verdhë në pak raste, vlerësuar **0,8**
- pagesa dhe fatura të kryera mbi baza pretendimesh ose deklarimesh: (nuk janë vërtetuar raste të tilla nga testimi), jeshile, vlerësuar **0,3**
- numrin dhe shumë llojshmërinë e përfituesve: verdhë, vlerësuar **0,8** meqenëse nomenklatura e çështjeve që trajtohen dhe operatorëve që operojnë është shumë e shtrirë dhe mund të kërcënohet nga risqet e keqmenaxhimit material.

Mesatarja për 6 zërat e listuar më sipër: $3,6/6 = 0,6$ d.m.th ngjyrës te verdhë, risk i mesëm.

2. Risku i kontrollit (CR) për institucionin MK:

Risku i kontrollit është risku që një anomali materiale mund të ndodhë dhe mund mos të parandalohet ose zbulohet dhe korrigjohet në kohë nga sistemet e kontrollit të brendshëm. Kur audituesi parashikon të mbështetet në vlerësimin e riskut të kontrollit për të zvogëluar shkallën e përdorimit të procedurave thelbësore (substantive) sa i takon përputhshmërisë, ai kryen gjithashtu vlerësime paraprake të riskut të kontrollit dhe planifikon e kryen teste të kontrollit, në mënyrë që të mbështesë këtë vlerësim. (Shiko fq. 34 të manualit)

Statusi i kontrollit te brendshëm	Risku i kontrollit	Përshkrimi	Risku i kontrollit për AZHBR-në
Shumë i mirë	I ulët Deri në 0.15	kontrollat kanë funksionuar vazhdimisht në mënyrë efektive, gjatë gjithë periudhës në shqyrtim.	
I mirë	I ulët 0.15 - 0.25	janë vërejtur mangësi në efektivitetin dhe vazhdimësinë e kontrollit, por sistemi në tërësi nuk konsiderohet ëjjo i besueshëm.	I mesëm (vlerësuar 0.21)
dobët	I lartë 0.26 - 1.0	kontrollat janë të pabesueshme, p.sh. kontrollat nuk kanë funksionuar sipas pritshmërive dhe/ose në mënyrë të vazhdueshme gjatë periudhës nën shqyrtim dhe/ose nuk është i mundur testimi i tyre.	

3. Risku i moszbulimit (DR) për institucionin AZHBR-së:

Risku i moszbulimit është risku që grupi i auditimit të mos zbulojë gabime materiale të cilat kanë ndodhur dhe nuk janë parandaluar ose zbuluar dhe korigjuar në kohë nga sistemi i kontrollit të brendshëm.

ëKontrolli i Lartë i Shtetit kërkon një nivel sigurie 95% nga testet e kryera, që mund të vijnë nga kontrollat ose tërësisht nga procedurat thelbësore, në varësi të vlerësimit të audituesit sa i takon riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollitë (faqe 35). Për institucionin e KLSH risku i auditimit është pranuar 5 %. Pra AR= 5%.

Risku i auditimit AR:

$AR = IR \times CR \times DR$

$5\% = 0.63 \times 0.23 \times DR$

$0.05 = 0.63 \times 0.23 \times DR$

$DR = 0.05 / 0.126 = 0.39 < 5\%$.

PERZGJEDHJA E KAMPIONIT TË AUDITIMIT:

Tre mënyrat e përzgjedhjes së kampioneve: Statistikore dhe Jostatistikore:

- Përzgjedhja e 100% të artikujve,
- Përzgjedhja e artikujve të veçantë;
- Testimi i kampionëve
- *Pasqyrat financiare te bilancit: audituar 100 % llogaritë e bilancit për vitin 2020, për të cilin jepet opinion; transaksionet financiare janë audituar me zgjedhje dhe sondazhe llogaritë e tjera (aktivit dhe pasivit);*
- *Audituar 100 % llogaritë e të drejtave të arkëtueshme dhe detyrimeve të pagueshme;*
- *Prokurimet dhe konkurrimet publike e audituara janë 68 % për vitin 2020 dhe 70% për vitin 2021 e fondeve mbuluar me auditim .*
- *Inventarizimi i pasurisë audituar 100 % për gjithë periudhën objekt auditimi;*
- *Nga kontrolli i sistemit të dokumentacionit justifikuese, për urdhër shpenzimet, u testuan me zgjedhje muajt qershor, korrik dhe dhjetor 2020, korrik, tetor dhe dhjetor 2021.*
- *Procedurat e MFK audituar 100 % për gjithë periudhën objekt auditimi;*

■ **Konfirmim nga të tretët**

Në bazë të të dhënave kontabile përkatëse janë përpiluar Pasqyrat e llogaridhënies vjetore mbi llogaritë e vitit ushtrimor (bilanci), që janë raportuar rregullisht, si më poshtë:

- për vitin 2020 janë dorëzuar pranë Degës së Thesarit Tiranë me shkresën nr. 1605 datë 29.03.2021, ëPër dorëzimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit ushtrimorë duke respektuar afatet ligjore.

Transaksionet e përzgjedhura për tøj nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Dega e Thesarit. U verifikuan situacionet dhe akt-rakordimet e mbajtura për vitet

objekt auditimi me degën e thesarit.

■ **Raporte dhe Informacione**

Janë administruar dhe shfrytëzuar:

- PBA 2020-2022 dhe 2021-2023
- Raportet vjetore të performace të hartuara nga institucioni.
- Pyetësorët e vetëvlerësimit për vitin 2020 dhe 2021
- Raportet e auditimit të brendshëm.